



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Peqin**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**  
**“FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË”**  
**TË USHTRUAR NË BASHKINË PEQIN**

**Tiranë 2023**

# **PËRMBAJTJA**

<b>I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b> .....	4
1. Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit. ....	4
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve. ....	4
3. Konkluzion i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit.....	11
<b>II. HYRJA (Të dhëna mbi Projektin e Auditimit).....</b>	<b>14</b>
<b>OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA</b> .....	<b>14</b>
1. Objektivi i auditimit.....	14
2. Qëllimi i auditimit.....	14
3. Identifikimi i çështjes.....	15
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	15
5. Përgjegjësitë e audituesve .....	15
6. Kriteret e vlerësimit .....	15
7. Standardet e auditimit .....	16
8. Metoda e auditimit.....	17
9. Dokumentimi i auditimit.....	18
<b>III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b> .....	<b>19</b>
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin. ....	19
2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	19
2.1 Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.....	19
2.2 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.....	23
2.3 Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitin 2021.....	49
2.4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.....	71
2.5 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit. ....	125
2.6 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Territorit të Njësisë Vendore. .....	138
2.7 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm. ....	141
<b>IV. GJETJE DHE REKOMANDIME</b> .....	<b>156</b>
<b>MASA DISIPLINORE</b> .....	<b>174</b>

## Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### 1. Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit.

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 429/1 Prot, datë 19.05.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, i ndryshuar, nga data 24.05.2023 deri në datë 28.06.2023, në Institucionin Bashkia Peqin u krye auditimi “Financiar dhe i përputhshmërisë”.

Auditimi u shtri mbi çështjet kryesore të veprimtarisë së institucionit si: menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, vlerësimi i pasqyrave financiare, prokurimet publike, zbatimi i kontratave të punimeve, lejet e ndërtimit, aktiviteti i IMT, zbatimi i rekomandimeve, administrimi i aseteve, si dhe çështje të dala gjatë auditimit.

Për përfitimin e rezultateve të auditimit, grupi i auditimit u mbështet mbi dy elementë: në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe në punën konkrete mbi evidencat e auditimit, por kryesisht mbi këtë të fundit. Audituesit janë kujdesur që evidencat me të cilat kanë punuar për të argumentuar rezultatet e auditimit, të plotësonin tre cilësi: të ishin të përshtatshme (të kishin lidhje me çështjen që auditohej), të besueshme (burimi nga vjen evidenca të ketë besueshmëri) dhe të mjaftueshme (sasia e evidencës të jetë e mjaftueshme për arritjen e konkluzioneve të auditimit). Në përfundim të punës audituse në terren, nga grupi i auditimit janë mbajtur dhe protokolluar në subjekt 16 akt konstatime dhe 1 (një) akt verifikim.

Pas hartimit të akteve të konstatimit dhe projektraportit, nga subjekti i audituar janë bërë kundërshtime, të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit dhe janë bërë pjesë e materialit në projektraport dhe në raportin përfundimtar të auditimit.

Pas trajtimit të observacioneve për projektraportin, me subjektin Bashkia Peqin është kërkuar që të kryhet takimi përmbyllës pranë zyrave të KLSH, i cili u zhvillua me datë 08.09.2023.

### 2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

NR.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca në raportin përfundimtar (Nr. Fq)	Rëndësia	Rekomandimi
I	<p>Nga auditimi i dokumentacionit mbi Menaxhimin financiar dhe kontrollin, u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>-Nuk janë hartuar hapat e proceseve të punës për burimet njerëzore .</li><li>-Në Bashkinë Peqin, për periudhën objekt auditimi, mungon dokumentacioni shkresor që pasqyron minutat e takimit dhe marrjen e vendimeve për mbledhjet që realizon GMS dhe si rrjedhojë e kësaj nuk është hartuar plani i veprimit për arritjen e objektivave dhe plani për kontrollin e brendshëm.</li></ul> <p>Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se, në Bashkinë Peqin për vitin 2022 nuk vertetohet me dokumentacion se GMS ka kryer takime pune për periudhën objekt auditimi. Në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 27, pika 1, gjithashtu dhe Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pika 3.3, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.</p> <ul style="list-style-type: none"><li>-Nuk janë përditësuar raportet periodike apo publikimet vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet</li></ul>	20-25	I mesëm	<p>Të hartohet dhe miratohet plani i veprimit për dokumentimin shkresor që pasqyron minutat e takimit.</p> <p>Të hartohet dhe miratohet strategjia për të dokumentuar mbledhjet e Grupit të Menaxhimit Strategjik.</p> <p>Të hartohet Plan i veprimit për MFK dhe të raportohet për realizimin e tyre nga sektorët përkatës.</p>

	e ofruara publikut, planifikimin dhe realizimin prokurimeve,, institucionet e varësisë, nuk përditësohet informacioni mbi ndryshimet në strukturën e bashkisë, paketat fiskale.			
2	Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura nga dokumentet analitike të Bashkisë Peqin nga fatura të pa likuiduara brenda afatit 60 ditor përgjatë vitit 2022, duke krijuar në fund të vitit buxhetor detyrime të prapambetura, si dhe mosrespektimi i radhës në likuidimin e tyre rezulton se, vlera e detyrimeve të prapambetura deri në fund të këtij viti të paraqitet 137,497,700 lekë.	25-50	Lartë	Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues në Bashkinë Peqin të marrë masa për likuidimin në kohë të të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, duke paraqitur pranë degës së thesarit, të gjithë dokumentacionin përkatës brenda afatit nga momenti i prerjes së faturës, si dhe të raportojë periodikisht në MFE.
3	Mos pasqyrim i saktë në kontabilitetin e institucionit të llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” për vlerën 137,497,700 lekë. në kundërshtim me ligjin 68/2012 “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 34, pika 1, neni 40 pika 3. urdhërit nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.8 “Të ardhurat”, pika 8 e standardit ku përcaktohet njohja fillestare e të ardhurës.	50-74	Lartë	Drejtoria e Financës së Bashkisë Peqin të marrë masa për sistemimin e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”,për vlerën 137,497,700 lekë, e cila është njohur me vlerën 0 në pasqyrat financiare.
4	Mos shlyerje e pagave të punonjësve në vlerën 36,552,054 lekë, për muajt Korrik, Gusht, Shtator dhe Dhjetor të vitit 2022 procedurë kjo e ndjekur në kundërshtim me ligjin 68/2012 “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 34, pika 1, neni 40 pika 3, Udhëzimi i MFE-së, nr.2 datë, 06.02.2012, pika101, Kodi i Punës, neni 95, neni 101 pika 283, neni 119 pika 2.	25-50	Lartë	Kryetari i Bashkisë Peqin dhe Drejtoria e Financës së Bashkisë Peqin të marrin masa të menjëhershme për shlyerjen e pagesave të punonjësve në vlerën 36,552,054 lekë duke respektuar të drejtën themelore të punonjësve aspektin social dhe shoqëror.
5	Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit publik u konstatua se <b>në 6 (gjashtë)</b> procedura prokurimi, në kriteret e veçanta të kualifikimit, është kërkuar nga Autoriteti Kontraktor që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të kenë si kusht s’kualifikimi kërkesa/kritere të cilat nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Gjithashtu rezulton se disa prej kërkesave të veçanta, në këto procedura si dhe specifikimet teknike nuk janë argumentuar në mënyrë teknike dhe ligjore. Veprimet e mësipërme ndikojnë në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorve ekonomik, uljen e konkurrencës.	74-128	Lartë	Autoritetit Kontraktor Bashkia Peqin, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kriterëve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave të pa argumentuara, ndaj operatorëve ekonomikë.
6	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se; për vitin 2021 janë kryer 2 procedura blerje me vlera të vogla duke copëzuar fondin dhe duke shmangur procedurat standarde të prokurimit, konkretisht: Në 2 procedura në shumën totale të fondit limit në vlerën 957 827 leke lekë pa TVSH, procedura duhet të kryheshin tenderim, pasi kanë objekt të njëjtë procedurë; është kryer procedura me objekt “Ndërtim bazamenti Qendra Shëndetësore Shez”, në muajin prill me fond limit në shumën 512,500 lekë pa tvsh, procedura me objekt “Ndërtim bazamenti Qendra Shëndetësore Shez , me fond limit në shumën 783,761 lekë pa tvsh e zhvilluar në muajin shtator, procedura me objekt “Ndërtim i bazamentit Qendra Shëndetësore	74-128	I mesëm	Autoriteti kontraktor Bashkia Peqin, të marrë masa që në planifikimin e rregjistrimit të prokurimeve, përzgjedhja e metodës që përdoret për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit, të shmang copëzimin e fondeve, me qëllim që procedurat e prokurimit të zhvillohen sipas kufijve monetar.

	Karine”, me fond limit në shumën 795.689 lekë pa TVSh, e zhvilluar në muajin shtator, dhe procedura me objekt “Ndërtim i bazamentit Qendra Shëndetësore Karine)” me fond limit në shumën 795.689 lekë pa TVSh zhvilluar në muajin mars.			
7	Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit u konstatua se në <b>gjashtë</b> procedura prokurimi, nuk argumentohet dhe dokumentohet llogaritja e fondit limit dhe përzgjedhja e procedurës. Nga ana e titullarit të AK, nuk ka urdhër për caktimin e një personi apo ngritjen e një komisioni për llogaritjen e vlerës së fondit limit të procedurës së prokurimit. Nisja e kësaj procedure referuar dhe inventarizimit të dosjes, ka filluar me urdhrin e prokurimit nr. 310 prot, datë 08.02.2021. Sipas Vkm nr.914, datë 29.12.2014, Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në nenin 60, përcaktohet se; “ <i>Pas përlllogaritjes së fondit limit sipas nenit 59 të këtyre rregullave, titullari i autoritetit kontraktor, nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit.</i> ”. Pra nuk argumentohet dhe dokumentohet mënyra e llogaritjes së si është nxjerrë kjo vlerë limit e kontratës, veprim jo në përputhje me nenin 59, pika 2. Gjithashtu rezulton se nuk është bërë një përshkrim i punëve të cilat do të kryhen dhe arsyeja e përzgjedhjes së kësaj procedure prokurimi “E hapur punë”.	74-128	I mesëm	Titullari i Autoritetit Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimit, të marrin masat që, në procedurat e prokurimit në vijim, përpara hartimit të urdhrin të prokurimit të aplikojë mënyrën dhe përlllogaritjen e vlerës së kontratës me qëllim dokumentimin dhe argumentimin e saj në përputhje me fondet buxhetore të miratuara. Gjithashtu të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e përzgjedhjes së procedurës së prokurimit.
8	Nga auditimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me zbatimin e kontratës me objekt furnizim me “ <i>Blerje Automjeti për Bashkinë Peqin</i> ” me vlerë 3,360,000 lekë me TVSh, rezulton se: Nga titullari i AK, nuk janë marrë masat e duhura për caktimin e personave për mbikëqyrjen e zbatimit të kontratës, hartimin e planit për zbatimin e kontratës, për tu siguruar nëse cilësia e mallrave të furnizuar është në përputhje me ato të kërkuara. Nga komisioni i krijuar për marrjen në dorëzim të automjetit, është mbajtur procesverbali nr. 532/1prot., datë 15.03.2021, në të cilin citohet ndër të tjera se verifikimi i automjetit është kryer pranë një Autoservisi në emër të F.K. Me këtë subjekt AK nuk ka asnjë marrëdhënie kontraktuale apo dokumentacion mbi të cilin komisioni ti drejtohej për të garantuar cilësinë e mallit të kërkuar nëse është në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktor apo jo. Këtë veprim komisioni e ka kryer pa autorizim nga titullari i AK dhe pa asnjë marrëveshje midis palëve (Autoservisit dhe AK). Pavarësisht se nga Autoservisi është lëshuar një dokument si Çertifikatë e kontrollit teknik të automjetit, në këtë dokument nuk përshkruhen të gjitha cilësitë për të cilat janë hartuar specifikimet teknike të mjetit në Dokumentet e Tenderit. Pra marrja në dorëzim e mjetit, nuk është bërë në përputhje me legjisllacionin në fuqi pasi nuk është në përputhje me kushtet e kontratës. Gjithashtu nuk është raportuar pranë APP sipas formularit përkatës për ecurinë e zbatimit të kontratës.	74-128	I mesëm	Titullari i Autoritetit Kontraktor të marrë masat që në të gjitha kontratat e furnizimit të mallrave, të caktojë personat përgjegjës për mbikëqyrjen e kontratës me qëllim garantimin e cilësisë së aktiveve të furnizuara në përputhje me kriteret dhe specifikimet e kërkuara. Gjithashtu të raportohet në APP për cdo rast mbi ecurinë e zbatimit të kontratës.
9	Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në tre raste të audituara, projekti	128-141	Lartë	Nga DPKZHT dhe Bashkia Peqin, të merren masa për të kërkuar në cdo

	<p>ndërtimor nuk është i plotë, si dhe mungon dokumentacioni shoqërues, siç janë problematika me kartelat e pasurisë së paluajtshme, mangësi në projektet që përbëjnë projektin ndërtimor, policat e sigurimit të përgjegjësive profesionale dhe licencat. Në një rast konstatohet se informacioni i dokumentacionit të aplikimit për leje ndërtimi nuk është i saktë në të gjitha rastet, pasi plani i rievimit nuk është i plotësuar me të gjitha të dhënat e domosdoshme, policat e sigurimit nuk është brenda afatit të vlefshmërisë, informacioni i vendosur në plan-vendosjen e miratuar nuk është i saktë. Gjithashtu, nga auditimi i procedurave të miratimit të kërkesave për pajisje me çertifikatë përdorimi, konstatohet se në dy raste, këto çertifikata janë miratuar në mungesë të theksuar të dokumentacionit të detyrueshëm, siç janë policat e sigurimit të përgjegjësive profesionale për hartuesit e projekteve ndërtimore, aktet përkatëse nga UK, OSHEE, PMNZSH, menaxhimi i mbetjeve urbane, kontrata midis zhvilluesit dhe shoqërisë ndërtuese, licencat e shoqërive ndërtuese, çertifikata përfundimtare e auditimit të efikasitetit energjitike, etj.</p>			<p>rast që aplikohet për t'u pajisur me leje ndërtimi ose çertifikatë përdorimi, të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, sipas legjislacionit dhe rregulloreve në fuqi, si dhe të mos miratojnë asnjë leje ndërtimi me mangësi në projektin ndërtimor dhe dokumentacionin shoqërues të tij. Gjithashtu, DPKZHT të kontrollojë vërtetësinë, saktësinë dhe origjinalitetin e dokumentacionit të dorëzuar nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, si dhe të shmangë miratimin e lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit, deri në plotësimin e dokumentacionit sipas kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi.</p>
10	<p>Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në tre raste nuk është kërkuar mendimi i asnjë prej autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit.</p> <p>Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se <b>në asnjë rast</b>, objekti i miratuara me leje ndërtimi nuk është pajisur me vërtetim për riskun nga organi kompetent që lëshon lejen. Edhe pse në sistemin elektronik të lejeve nuk është parashikuar dritarja e nevojshme aplikim për pajisje me vërtetim për riskun, DPKZHT nuk ka kërkuar asnjë rast dokumentacionin e parashikuar në vendimin e poshtë-cituar.</p>	128-141	Lartë	<p>Nga DPKZHT Peqin të merren të gjitha masat për marrjen dhe respektimin e mendimit dhe vendimeve të të gjitha autoriteteve, të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit.</p> <p>DPKZHT të ndërpresë praktikën e miratimit të lejeve të ndërtimit, për objekte të cilat nuk janë të pajisura me vërtetim për riskun nga organi kompetent që lëshon lejen. Në çdo rast, DPKZHT të kërkojë dokumentacionin e detyrueshëm sipas legjislacionit në fuqi, deri në krijimin e hapsirës së nevojshme në sistemin elektronik të lejeve për pajisje me vërtetim për riskun.</p>
11	<p>IMTV Bashkia Peqin nuk ka respektuar procedurat e parashikuara në ligj në lidhje me mbajtjen e akteve përkatëse. IMTV nuk ka mbajtur në asnjë rast proces verbalin e pezullimit të punimeve. Gjithashtu IMTV nuk ka ndërmarrë të gjitha masat për prishjen e objekteve pa leje, pasi IMTV ka detyrimin të kërkojë asistencë nga IKMT për kthimin në gjendjen fillestare të këtyre shkeljeve. IMTV nuk ka kallëzuar penalisht në asnjë rast kundërvajtësit, duku mos përdorur të gjitha masat ndëshkuese dhe shtrënguese për të parandaluar shkelje të tilla. IMTV nuk ka kërkuar në asnjë rast heqje e licencës profesionale për zhvilluesin, subjektin ndërtues, mbikëqyrësin e punimeve ose kolaudatorin.</p>	141-144	Lartë	<p>Nga ana e IMTV Bashkia Peqin të merren masat që për çdo rast, të respektohen procedurat sipas parashikimeve ligjore, në varësi të shkeljes së konstatuar, të aplikohen të gjitha masat ndëshkuese ndaj kundërvajtësve, si dhe të kërkohet e gjithë asistencë e nevojshme për ekzekutimin e vendimeve të prishjes.</p>
12	<p>Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me ekzekutimin, kontabilizimin dhe vjeljen e gjobave, konstatohet se nga struktura e Inspektoratit të Mbrojtjes së Teritorit, për periudhën objekt auditimi, janë vendosur 23 gjoba me</p>	141-144	Lartë	<p>Nga Bashkia Peqin, Drejtoria e Financës, Drejtoria Juridike, në bashkëpunim me IMTV, të marrin masa për kryerjen e të gjitha</p>

	<p>vlerë 11,500,000 lekë, të cilat nuk janë arkëtuar. Për 14 vendime për gjobë në vlerën 7,000,000 lekë, IMTV i është drejtuar Gjykatës Administrative, duke i kërkuar nxjerrjen e titullit ekzekutiv, nuk është vendosur në dispozicion asnjë dokumentacion që të vërtetojë nxjerrjen e këtij titulli, duke pretenduar se IMTV dhe Bashkia Peqin nuk janë informuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Peqin, mbi vendimet e marra për këto raste, nëse për këto vendime gjykata e ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit. Bashkia Peqin, IMTV, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Financës nuk kanë përdorur mënyrat e parashikuara në Ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, Neni 31, pika 5, për arkëtimin e këtyre masave administrative, siç janë vjelja e gjobës nëpërmjet pagës ose vendosje sekuestro mbi pasuri deri në pagimin e gjobës. Në asnjë rast nuk është faktuar se vlera e masës administrative është e barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje.</p>			<p>procedurave që ligji parashikon, siç janë vjelja e gjobës nëpërmjet pagës ose vendosje sekuestro mbi pasurinë e të dënuarit, për të bërë të mundur arkëtimin vlerave financiare në gjobat e aplikuar, si dhe përlllogaritjen e kamatvonesave, sipas afateve dhe kritereve ligjore.</p> <p>Nga ana e IMTV Bashkia Peqin, të merren masa për ndëshkimin e kundërvajtësve, në raport të drejtë me llojin e shkeljes së konstatuar, duke përdorur mënyrat e parashikuara në ligj për përlllogaritjen e vlerës së masës administrative në varësi të investimit të kryer pa leje të miratuar ose në shkelje të saj.</p>
13	<p>Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm u konstatua se, Bashkia Peqin nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe anekseve përkatëse, përcjellë nga KLSH me shkresën nr. 1683/1, datë 15.11.2022 për zbatimin e rekomandimeve pasi nuk ka ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative e ligjore për përmirësimin e gjendjes, konkretisht:</p> <p>- Nga 15 masa organizative janë pranuar 15 masa nga të cilat është realizuar 1 masa, janë zbatuar pjesërisht 3 masa dhe nuk janë zbatuar 11 masa.</p> <p>Nga 5 për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia - të ardhura të munguara, janë pranuar për zbatim 5 masa, nuk janë zbatuar të 5 masat.</p> <p>Në lidhje me masat disiplinore në kompetencë të Bashkisë Peqin, për punonjësit e saj konstatohet se nga ana e Bashkisë Peqin nuk janë marrë masat e duhura për dhënien e masave disiplinore për punonjësit e konstatuar me shkelje dhe me përgjegjësi në Raportin e auditimit të mëparshëm, për të cilën kjo masë rezultoi e pa zbatuar.</p>	144-	Lartë	<p>Kryetari i Bashkisë Peqin të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Rikërkojmë zbatimin e rekomandimeve që janë të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht dhe përsheptimin e zbatimit të atyre në proces zbatimi.</p>
14	<p>Për vitin 2022, janë legalizuar gjithsej 122 objekte me vlerë totale të detyrimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet, në vlerën 7,526,463 lekë. Rezultoni se kanë paguar detyrimet 34 qytetarë me vlerë 1,600,529 lekë dhe janë debitorë ndaj bashkisë 88 prej tyre në vlerën 5,925,934 lekë.</p> <p>Gjithashtu për periudhën përpara vitit 2022, për këtë taksë u konstatua se janë debitorë 386 qytetarë për vlerën 15,910,147 lekë. Në total vlera e detyrimeve ndaj Bashkisë Peqin, nga mos pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet nga 474 objekte të legalizuara, rezultoni në vlerën 21,836,081 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Peqin.</p>	141-144	Lartë	<p>Titullari i Bashkisë Peqin të marra masa që Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të angazhohet në procesin e planifikimit të të ardhurave nga taksat e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet. Gjithashtu, të dyja drejtoritë, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave dhe Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit duhet të bashkëpunojnë dhe të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 474</p>



				<b>debitorë në vlerën 21,836,081 lekë</b> si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Nga strukturat e Bashkisë Peqin të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen si dhe për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.
15	Nga 5 subjekte që kanë kontratë qiraje në vitin 2022 rezultojnë se vetëm qiramarrësi "A.M." për vlerën 116,100 lekë nuk kanë paguar detyrimet e kontratës. Detyrimi që subjekti ka ndaj Bashkisë Peqin për vitin 2022 në vlerën është 116,100 lekë, dhe detyrime progresive deri në fund të vitit 2022 janë 1615 akt marrëveshje për dhënie sipërfaqesh toke me qira familjeve në P. njësitë e saj administrative. Nga këto akt marrëveshje priten që të arkëtohen të ardhura vjetore në vlerën 5,982,624 lekë. Nga auditimi i pagesave të qirave për këto akt marrëveshje rezultoi se, për vitin 2022 nuk është paguar asnjë detyrim dhe mbetet për t'u paguar detyrimi në vlerën 5,982,624 lekë. Të ardhurat e munguara në buxhetin e Bashkisë Peqin më datë 31.12.2022 si rezultat i mos pagesës së detyrimit për sipërfaqet e marra me qira janë në vlerën totale 5,982,624 lekë.	25-50	Lartë	Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë të marrin masa dhe të ndjekin të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës <b>5,982,624 lekë</b> nga qiramarrësit që nuk kanë paguar detyrimet për tokën e marrë me qira.
16	Vlera e detyrimeve ndaj Bashkisë Peqin për taksat dhe tarifatat vendore, e krijuar vetëm gjatë vitit 2022 është 16,882,981 lekë, nga e cila vlera 9,008,131 lekë I përket detyrimeve nga debitorët private dhe 7,874,850 lekë detyrimeve nga debitorët e kategorisë familjare. Vlera e detyrimeve progresive ndaj Bashkisë Peqin për taksat dhe tarifatat vendore, në datën 31.12.2022 është 30,568,308 lekë, nga e cila vlera prej 11,590,558 lekë është krijuar nga 238 debitorë privat, ndërsa vlera 18,977,750 lekë nga debitorët familjar (përfshirë edhe taksën e tokës bujqësore në vlerën 9,873,750 lekë nga 4 930 familjeve) Vlera prej 30,568,308 lekë konsiderohet e ardhur e planifikuar, por e pa arkëtuar. Për taksën e tokës bujqësore për vitin 2022 janë debitorë 4 930 familjeve me vlerë të detyrimit 9,873,750 lekë, ndërsa vlera progresive deri më 31.12.2022, që përbën të ardhura të munguara për Bashkinë Peqin është në vlerën 10,200,000 lekë. Dokumentacioni i vënë në dispozicion lidhur me hapat që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezultojnë se, janë njoftuar të gjithë bizneset debitorë për kalimin e afatit të pagesave të detyrimit për taksat dhe tarifatat vendore. Pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet vendore, <u>nuk janë marrë masa të tjera</u> bazuar në përcaktimet e ligjit.	25-50	Lartë	Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Peqin, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën: - 11,590,558 lekë për 238 biznese; - 9,104,000 lekë nga taksat dhe tarifatat vendore për familjet; - 10,200,000 lekë për taksën e tokës bujqësore; a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare. b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme). c- Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Tatim Taksave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar. d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk

				<p>pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Sektorit të Tatim Taksave, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.</p> <p>e- Sektori i Tatim Taksave të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Peqin, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.</p> <p>f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.</p>
17	<p>Nga auditimi i dokumentacionit që administrojnë IMTV-ja në Bashkinë Peqin u konstatua se për vitin 2022 janë mbajtur në total 15 proces verbale për konstatimin e kundërvajtjes. Janë dhënë 15 masa për “Prishje të objekteve të kundërligjshëm” si dhe 15 masa “Dënim me gjobë”. Nuk ka paguar asnjë subjekt vullnetarisht me vlerë totale të gjobave prej 7,500,000 lekë të vendosura për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, duke krijuar të ardhura të munguara në Bashkinë Peqin.</p>	141-144	Lartë	<p>Inspektorati i Mbrojtës Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekin me përpikmëri procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjobat e vendosura nga IMTV për vlerën totale <b>7,500,000 lekë</b>. Gjithashtu, IMTV të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrit ligjor në fuqi.</p>
18	<p>Bashkia Peqin nga 7 subjekte që kanë aktivitet tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, 2 subjekte (“B.” SHPK dhe “J. P.” SHPK) <u>nuk janë pajisur me autorizim/licencë për ushtrimin e aktivitetit</u>, që sjellin të ardhura të munguara në Bashkinë Peqin në vlerën 400,000 lekë. Subjekti “D.O.” SHPK, është pajisur me autorizim nga data 07.10.2021-06.10.2022, për periudhën 07.10.2022-31.12.2022 është i pa pajisur me autorizim duke sjellë të ardhura të munguara për 9 muaj në vlerën 153,340 lekë. Subjekti “K.” SHPK, është pajisur me autorizim nga data 11.10.2022-10.10.2023, për periudhën 01.01.2022-10.10.2022 është i pa pajisur me autorizim duke sjellë të ardhura të munguara për 9 muaj në vlerën 155,550 lekë. Subjekti “O.” SHPK për të dy pikat e aktivitetit të mësipërm, është pajisur me autorizim nga data 10.06.2022-09.06.2023 dhe 10.06.2022-09.06.2027, për periudhën 01.01.2022-09.06.2022 të dy pikat janë të pa pajisura me autorizim duke sjellë të ardhura të munguara për 5 muaj e në vlerën 176,666 lekë. Ushtrimi i aktivitetit nga subjektet që tregtojnë lëndë djegëse të pa pajisur me autorizim/licencën përkatëse ka sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Peqin për vitin 2022 në vlerën 885,556 lekë.</p>	25-50	Lartë	<p>Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave të marrë masa që subjektet “B.” SHPK, “J. P.” SHPK, “K.” SHPK, “O.” SHPK, “D.O.” SHPK, “S.G” ShPK dhe “O.” SHPK të plotësojnë kriteret e nevojshme e më pas të pajisen me autorizimin përkatës për ushtrimin e aktivitetit duke paguar detyrimet ndaj Bashkisë Peqin me vlerë vjetore 200,000 lekë secili. Gjithashtu, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet me qëllim që të kryhen pagesat e plota brenda afateve.</p>

### 3. Konkluzion i përgjithshëm dhe opinionit i auditimit.

#### OPINIONI I AUDITIMIT

##### **Opinion mbi pasqyrat financiare të vitit 2022:**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkia Peqin, për vitin ushtrimor 2022, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyra e performancës, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e fluksit të mjeteve monetare, fondet neto, investimet e aktivet afatgjata si dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

##### **Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes:**

Sipas mendimit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin e Pakualifikuar”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale (pa anomali materiale), pozitën financiare të shoqërisë më 31 dhjetor 2022, në përputhje me bazën ligjore që rregullon raportimin financiar dhe atë buxhetor mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare, por ekzistojnë aspekte që duhen theksuar.

##### **Baza për opinionin e pamodifikuar**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Subjekti i audituar në përputhje me kërkesat etike, që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në [juridiksionin], dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit, që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISSAI 1700) Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se; pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare nuk përmbanin gabime materiale, por ekzistojnë aspekte që duhen nënvizuar. Këto aspekte nuk konsiderohen materiale, prandaj vetëm meritojnë evidentim, si theksim çështjesh. Për këto arsye kemi dhënë opinion të pakualifikuar me theksim të çështjes, sipas përshkrimit të çështjeve të trajtuara në gjetjet e raportit Përfundimtar të Auditimit.

##### **Theksim të çështjeve:**

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë nivelin e materialitetit për shpenzimet, i cili ka vlerën 19,571,057 lekë, si dhe faktin se disa llogari në pasqyrat financiare nuk paraqesin saktë vlerën e tyre reale, si më poshtë:

- Nga grupi i auditimit u konstatua se llog. 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është në vlerën 0, ku në rakordimet me thesarin rezulton se llog.486“Shpenzime të periudhave të ardhshme” është në vlerën 104,162,356 lekë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga subjekti vihet re se në dokumentat, letrat e veta llogaria nr.486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është në vlerën 137,497,700 lekë.

- U konstatua se në Bashkinë Peqin ndër arsyet e rritjes së detyrimeve nga viti ne vit ka ardhur dhe si pasojë e mos shlyerjes së pagave të punonjësve. Për të cilat vlera totale është 36,552,054 lekë, nga ku rakordimi me thesarin për vitin 2022 është në vlerën 22,677,047 lekë.

##### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Institucionit të Bashkisë Peqin.**

Drejtimi i Bashkisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar dhe të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme", kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare.**

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomalitë materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticismin tonë profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

### **II. Opinioni mbi përputhshmërinë.**

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Peqin janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opininion", të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar.

#### **Baza për dhënien e opinionit të përputhshmërisë:**

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë, si më poshtë:

-Bashkia Peqin nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim.

-Nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura nga debitorët, duke bërë që detyrimet e pa arkëtuara për taksat dhe tarifën vendore në mënyrë progresive më datën 31.12.2022, në kenë vlerën 20,694,558 lekë.

-Në 6 raste në procedurat e prokurimit janë vendosur kritere të cilët nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë dhe konkretisht për procedurat me objekt: "Ndërtimi i tregut të fruta perimeve Bashkia Peqin", "Ndërtim i rrjetit Ujësjellës të fshatit Bicaj dhe Caushaj", "Blerje automjeti për Bashkinë Peqin", "Ndërtim dhe sistemim gabioni i perroit të Rrushtes, Nj.ADM Karine, Bashkia Peqin", "Rikonstrukcion i rruges Demir

*G. Peqin”, “Ndertim i pritave lumore dhe perforcim i kembeve te Ures ne shtratin e Lumit Shkumbin, Bashkia Peqin”.*

*-Nga auditimi i dokumentacionit të zbatimit të kontratave të punëve civile u konstatua se në 3 raste nuk janë kryer punimet në përputhje me likuidimet e kryera nga ku rezultoi një dëm ekonomik në shumën 18,920,760 lekë.*

*-Janë konstatuar anomali në fushën e lejeve të ndërtimit dhe zbatimit të tyre në teren.*

*1-Në 3 raste Projekti ndërtimor nuk është i plotë, si dhe mungon dokumentacioni shoqërues.*

*2-Në 1 rast Informacioni i dokumentacionit të aplikimit për leje ndërtimi nuk është i saktë.*

*3-Në 3 raste Nuk është kërkuar mendimi i të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit.*

*4-Në 3 raste objektet e miratuara me leje ndërtimi, nuk janë pajisur me vërtetim për riskun nga organi kompetent që lëshon lejen.*

*5-Në 1 raste u konstatua se nuk janë respektuar kondicionet urbane.*

*6-Në 1 lloji i ndërhyrjes që parashikohet të kryhet nuk i përshtatet kategorisë së lejes së ndërtimit për të cilën është aplikuar.*

*7- Në 2 raste u konstatua se dokumentacioni i nevojshëm për pajisje me çertifikatë përdorimi nuk është i plotë.*

*8-Në lidhje me auditimin e IMTV rezultoi se janë vendosur në total 23 gjoba me vlerë 11,500,000 lekë, asnjë nga këto masa nuk është paguar, ose të jetë bërë vjelja e gjobës sipas parashikimeve ligjore.*

#### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Peqin:**

Drejtimi i njësisë vendore, është përgjegjës për përgatitjen dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi të raportimit financiar. Drejtimi është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifatat vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit dhe të gjithë veprimtarisë që zhvillon Bashkia Peqin.

#### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:**

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojme bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar, si dhe nëse hartimi i kritereve të DT, vlerësimi i ofertave dhe zbatimi i kontratave të punimeve janë në përputhshmëri me kriteret e fushës së prokurimeve publike dhe kriteret e kontratave të lidhura. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe fushave të tjera të auditimit dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë.

Përgjegjësia e audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme për shkallën e përputhshmërisë së aktivitetit të institucionit të audituar me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe të japë opinion për këtë.

## **II. HYRJA (Të dhëna mbi Projektin e Auditimit)**

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 429/1 Prot, datë 19.05.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH-së<sup>1</sup>, i ndryshuar, nga data 24.05.2023 deri në datë 28.06.2023, në subjektin Bashkia Peqin u krye auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022.

Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:

1. E.M., *Përgjegjës Grupi*
2. V.Sh., *Anëtar*
3. E.K., *Anëtare*
4. K.F., *Anëtar*
5. E.Rr., *Anëtar*
6. P.Xh., *Anëtar*.

Auditimi u krye me zgjedhje, mbi bazë rrishtu.

### **OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA**

#### **1. Objektivi i auditimit.**

Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Bashkinë Peqin kishte si objektiva kryesore:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)<sup>1</sup>;
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

#### **2. Qëllimi i auditimit**

Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Peqin është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

---

<sup>1</sup>Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

### **3. Identifikimi i çështjes**

Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Peqin dhe përgjegjësi, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

- Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Auditin e Brendshëm.
- Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.
- Vlerësimi i raportimit financiar për vitin 2022.
- Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike për periudhën 01.01.2021-31.12.2022.
- Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.
- Mbi administrimin e asetëve të Bashkisë Peqin.
- Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit në Bashkinë Peqin.

### **4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese**

Strukturat drejtuese të Bashkisë Peqin, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.

### **5. Përgjegjësitë e audituesve**

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë e zbatimit të procedurave të prokurimit dhe zbatimit të kontratave në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit.

### **6. Kriteret e vlerësimit**

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Peqin është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Peqin. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;
- Ligji nr. 88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 137/2020, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 115/2021, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, u ndryshuar;
- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”;
- V.K.M nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”;
- V.K.M Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- V.K.M Nr.165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njërive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njërive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar;
- VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim;
- Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”;
- Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”;
- Udhëzimi i MFE nr. 10, datë 28.02.2020 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2021-2023".
- Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njërive të Vetëqeverisjes Vendore”;
- Udhëzimi i MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar;
- UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;
- Udhëzim i KM nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njërive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”;
- Rregullore e Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH<sup>së</sup>”, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH<sup>së</sup> nr. 85, datë 30.06.2015 e ndryshuar;
- Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH<sup>së</sup> e ndryshuar;
- Rregullore mbi organizimin e funksionimin e Bashkisë Peqin, etj.
- Etj.

## **7. Standardet e auditimit**

Për kryerjen e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë në Bashkinë Peqin grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë:

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”;
- ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200;



- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC.

## **8. Metoda e auditimit**

### 1. Kontrolli aritmetik

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

### 2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*), konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

### 3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

### 4. Kontrolli i vlerësimit

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

### 5. Konfirmim nga të tretët

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

### 6. Kontrolli sipas një treguesi

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsisve kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

### 7. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Peqin me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

### 8. Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

### *Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit*

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu

bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale<sup>2</sup>.

Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH-J<sup>a</sup> aplikon<sup>3</sup>.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose ne trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe *së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

## 9. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

---

<sup>2</sup> ISSAI 1315

<sup>3</sup> *Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm \* Risku i kontrollit \* Risku i Zbulimit*

### **III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**

#### **1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin.**

**Zona Gjeografike:** Bashkia Peqin kufizohet në veri me bashkinë Tiranë, në lindje me bashkinë Elbasan, në jug-lindje me bashkinë Cërrik, në jug-perëndim me bashkinë Lushnje dhe në jug me bashkinë Belsh. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Peqinit.

**Popullsia:** Sipas Censurit të vitit 2011, Peqini ka një popullsi prej 26.136 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron 38.900 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 197.79 km<sup>2</sup> me një densitet prej 196.67 banorë/km<sup>2</sup> sipas regjistrimit civil dhe 132 banorë/km<sup>2</sup> sipas censurit.

**Të dhëna të tjera:** Bashkia e re e Peqinit shtrihet përgjatë rrugës së vjetër Egnatia, ndërsa kalaja Klaudiana në qendër të qytetit është dëshmi e lashtësisë së këtij vendbanimi. Qyteti dhe të 50 fshatrat e kësaj bashkie shtrihen në një zonë fushore dhe kodrinore. Banorët e bashkisë së Peqinit janë të orientuar ndaj bujqësisë dhe vreshtarisë, por edhe mbarështimit të shpendëve. Kultivimi i ullinjve, i perimeve të serave dhe i produkteve të tjera bujqësore janë gjithashtu karakteristike e zonës. Peqini është i njohur për rritjen e gjelit të detit, mjaft i kërkuar në të gjithë Shqipërinë në kohë festash si dhe për sportin e ndeshjeve me gjela. Bizneset janë kryesisht të përqendruar në shërbime, ndërkohë që në Peqin janë ngritur edhe disa punishte për vajin e ullirit. Problemi më i madh i Peqinit është punësimi. Edhe pse një pjesë e mirë e banorëve merren me bujqësi, mundësitë ekonomike për ta janë të pakta. Sfidat e bashkisë së re janë të harmonizojë zonën urbane me zonën rurale si dhe hapja e bizneseve prodhuese, që mund t'i jepnin një hov punësimit të banorëve të Peqinit.

Misioni i Bashkisë Peqin është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve. duke garantuar vetë-qeverisjes në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore. Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

#### **2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit**

##### **2.1 Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.**

**2.1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.**

##### **Pika 1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.**

**1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.**

**1.2. Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm;**

**1.3. Vlerësim mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.**

Në zbatim të nënpikës 1.1 të programit të auditimit: “Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi dhe Komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike”, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

1. Rregullorja e brendshme e miratuar;
2. Kod i brendshëm etik ose një kod sjellje, apo udhëzim për zbatimin e etikës;
3. Strukturën organike të institucionit me ndryshimet për vitet objekt auditimi dhe nëse ka pasur ndryshime në strukturë, a është reflektuar edhe në rregullore;
4. Shkresat e përcaktimit të NA në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;
5. Shkresat për krijimin e grupeve të Menaxhimit Strategjik;
6. Trajnimet e stafit si dhe planifikimet për trajnime të tyre;
7. Strategjinë dhe Regjistrin e Riskut;
8. Lista ose harta e proceseve të punës;
9. Raportet e Monitorimit;
10. Pyetësori i Vetëvlerësimit dhe a është dërguar në Ministrinë e Financave

**Baza ligjore ku mbështetet auditimi mbi MFK është:**

- ✓ Ligji nr.10296/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar
- ✓ “Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin” miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016;
- ✓ Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- ✓ Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar
- ✓ Ligji nr.7961 /1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar,
- ✓ VKM nr.243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar me VKM nr.746/2018
- ✓ Ligji nr.68/2017 “Për financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”.
- ✓ Ligji “Për menaxhimin e sistemit buxhetor të RSH”
- ✓ Udhëzimi nr. 15 dt 20.07.2016
- ✓ Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Drejtimit kryesore të auditimit të MFK-së janë:

- Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.
- Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi/ Komunikimi, si dhe Monitorimi.
- Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Peqin, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “*Mjedisi i Kontrollit*”, “*Menaxhimi i Riskut*”, “*Aktivitetet e Kontrollit*”, “*Informimi dhe Komunikimi*” si dhe “*Monitorimi*”, sipas përcaktimit të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” i ndryshuar, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijon dhe vlerëson sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit, si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

Në zbatim të auditimit, u kërkua dokumentacioni i mëposhtëm:

1. Baza rregullatore mbi të cilën ushtron funksionet e saj Bashkia e Peqin: Rregullorja e brendshme e miratuar, Rregullorja për sinjalizimin, planet mujore dhe vjetore të punës. etj .
2. Strukturën organizative dhe organigramën e institucionit me ndryshimet për vitet objekt auditimi; dhe nëse ka pasur ndryshime në strukturë, a është reflektuar edhe në rregullore;
3. Shkresat e përcaktimit të NA dhe NZ në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligjin “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, si dhe ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
4. Shkresat për krijimin e grupeve të menaxhimit strategjik [GMS]
5. Trajnimet e stafit si dhe planifikimet për trajnime të tyre në një vit;
6. Regjistrin e riskut
7. Raportet e monitorimit ku përfshihen edhe Deklarata e cilësisë dhe Pyetëtori i vetëvlerësimit;
8. Plotësimi i pyetësorëve të KLSH për bashkinë e Peqinit, dërguar me E-mail
9. Nga auditimi i dokumentacionit të vene në dispozicion nga Bashkia e Peqin, në përgjigje të kërkesave të përshkuara më lart lidhur me MFK-në, grupi i auditimit rezulton me këto konstatime:

➤ Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Peqin, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “*Mjedisi i kontrollit*”, “*Menaxhimi i riskut*”, “*Aktivitetet e kontrollit*”, “*Informimi dhe Komunikimi*” si dhe “*Monitorimi*”, në referim të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 “*Për disa shtesa dhe ndryshime*”, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijojnë dhe vlerësojnë sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri-tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

Ne lidhje me observacionin me nr.118/1 prot derguar me shkresë percjellese nr.118/2 date 05/07/2023 te Bashkise Peqin nga procedura blerje me vlera të vogla për punë, grup mallrash e shërbimesh të ndryshme për vitet 2021, të cilat për shkak të ngjashmërisë apo funksionit të tyre duhet të prokurorëshin bashkë pasi, për copëzimit dhe përpjestimit të vlerave të kontratave dhe fondeve të tyre, rekomandojmë zbatimin e procedurave standarde të prokurimit, bazuar në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 2, në të cilën citohet se;

Observacioni i paraqitur nga Zj. O. S. me shkresën percjellese nr.1182/1 prot. date 05.07.2023 te bashkise Peqin ne lidhje me AKT-Kostatimin Nr.1 date 27.06.2023 mbi auditimin e ushtruar ne Bashkine Peqin ne pozicionin pergjegjese e struktures finances dhe buxhetit se” *nuk eshte pjese e Grupit Strategjik dhe Auditit te Brendshem*“, duke paraqitur si dokumenta provuese vendimin nr.34 date 08.02.2022 si dhe shkresën e dates 30.03.2022 te “Te planit te veprimit per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin te Bashkise Peqin.

Merren ne konsiderate observacioni i Zj. O. S. dhe hiqet emri nga AKT-Kostatimin Nr.1 date 27.06.2023 mbi auditimin e ushtruar ne Bashkine Peqin

**Titulli i gjetjes:** Mangësi në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

**Situata:** Nga auditimi i P. komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, u konstatua se:  
-Nuk është hartuar harat e proceseve të punës për burimet njerezore .

- Nga auditimi konstatohet se: Në Bashkinë Peqin, për periudhën objekt auditimi, mungon dokumentacioni shkresor që pasqyron minutat e takimit dhe marrjen e vendimeve për mbledhjet që realizon GMS dhe si rrjedhojë e kësaj nuk është hartuar plani i veprimit për arritjen e objektivave dhe plani për kontrollin e brendshëm.

Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se, në Bashkinë Peqin për vitin 2022 nuk janë dokumentuar mbledhjet që ka realizuar Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe si rrjedhojë nuk rezulton një dokument shkresor me vendimet që GMS ka marrë për periudhën objekt auditimi. Nisur nga ky fenomen vihet re edhe mos përgatitja e dokumenteve të tjera si plani i veprimit për arritjen e objektivave dhe plani për kontrollin e brendshëm. Në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Neni 8, pika 8 a) dhe Neni 27, pika 1, gjithashtu dhe Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pika 3.3, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016

-Bashkia Peqin nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT.

-Nuk janë përditësuar raportet periodike apo publikimet vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut, planifikimin dhe realizimin prokurimeve,, institucionet e varësisë, nuk përditësohet informacioni mbi ndryshimet në strukturën e bashkisë, paketat fiskale.

**Kriteret:** -Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kreu III, paragrafi 3.1.

-Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kreu III, paragrafi Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit.

-Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kreu III, paragrafi Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore.

-Udhëzimi nr 16 dt 20.07.2016 për Koordinatorin MFK dhe koordinatorin e riskut në njësinë publike, pika 3.2.5.

-Ligji nr. 10296 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin neni 8, pika a. Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kreu III, paragrafi 3.2.

-Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kreu III, paragrafi 3.2.

-Udhëzimi nr. 16 dt 20.07.2016 pika 3.2.2.

-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 21, pika 2.

-Ligji nr.10296 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, neni 8, pika 8. shkronja a.

-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 12, pika 3.

-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 22, pika 5.

-Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kreun III, paragrafi 3.3.

-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 16, pika 2.

-Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kreu III, paragrafi 3.4.

**Ndikimi:** Mosnjohja e plotë si dhe sa duhet e koncepteve të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin duke sjellë një nivel mesatar të riskut të funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Funksionimi i institucionit Bashkia Peqin dhe përmbushja e detyrimet të saj ligjore dhe kushtetuese.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandimi 1.** Te hartohet dhe dhe miratohet plani i veprimit për arritjen e objektivave dhe plani për kontrollin e brendshëm , për dokumentimin shkresor që pasqyron minutat e takimit .

**Rekomandimi 1.2:** Të hartohet dhe miratohet Plani Strategjik i institucionit. Të hartohet dhe miratohet strategjia për të dokumentuar mbledhjet që ka realizuar Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe vendimet që GMS ka marrë për periudhën objekt auditimi.

**Rekomandimi 1.3:** Të garantohet zbatimi i aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit për MFK dhe të raportohet për realizimin e tyre nga sektorët përkatës të ngarkuar me pikat specifike.

1.1, 1.2: Organizimi dhe Veprimtaria e Njesisë së Auditit të Brendshëm.

Nga grupi i auditimit u kërkua dokumentacioni i mëposhtëm:

1. Karta e Auditimit të Njesisë AB të bashkisë Peqin
2. Plani Strategjik dhe pasqyrat shoqëruese
3. Planifikimi vjetor për vitin 2022 dhe pasqyrat shoqëruese
4. Programimi i auditimeve të brendshme për vitin 2022
5. Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmoizimit të Auditit të Brendshëm.
6. Dosjet e përhershme të subjekteve të audituara
7. Dosjet koherente të subjekteve të audituara
8. Projekt-raportet dhe raportet përfundimtare të auditimit të brendshëm të njësive publike.
9. Rekrutimi i punonjësve në Njësinë e Auditit të Brendshëm dhe ngritja e nivelit

**Titulli i gjetjes:** Mos pajisen me certifikaten e auditit te brendshem specialistet e Sektorit të Auditimit të Bashkisë Peqin.

**Situata:** Bashkia Peqin e ka parashikuar Njësinë e Auditit të Brendshëm në Strukturën e saj Organizative,

a) Z. A.D. me arsim të lartë, Ekonomik Plan ILB Kamëz, Përgjegjës i NjAB i pajisur me certifikatë të Audituesit të Brendshëm me nr. regjistri 1966 datë 05.07.2019 dhe emëruar në këtë pozicion në periudhën 10.04.2018, bazuar në Aktin e emërimit nr. 66 Prot., datë 10.04.2018.

b) Znj. M.Sh., me arsim të lartë, Administrim Biznesi – Ekonomik (Master Profesional), Specialiste e NjAB me emërim të përkohshëm duke nisur nga data 01.02.2019 bazuar në Aktin e emërimit nr. 372 Prot., datë 01.02.2019, e cila është në proces të marrjes së certifikatës së auditit të brendshëm.

c) Z. A.Gj., me arsim të lartë, ekonomik dhe Master Profesional, Specialist i NjAB me emërim të përkohshëm duke nisur nga data 01.12.2022, bazuar në Aktin e emërimit nr. 243 Prot., datë 30.11.2022, i pa pajisur me certifikatë të auditit të brendshëm.

**Kriteri:** 1) Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”

1.Urdhëri nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhërin nr.100, datë 25.10.2016”;

2.VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

**Ndikimi:** Duhet te pajisen me certifikaten e audituesit si specialist te Sektorit të Auditimit të Bashkisë Peqin si dhe te shtohen trajnimet per te rritur efektshmerine ne ushtrimin e mekanizimint mbikqyrës dhe korrigjues te Sektorit te Auditit të Brendshëm.

**Shkaku:** Specialist i ri i punesuar muajt e fundit

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandimi:** Nga Bashkia Peqin të merren masat e duhura që të pajisen me certifikatën e audituesit të brendshëm, punonjësi në pozicionin e Specialistit te NjAB, Z. A.Gj. Gjithashtu të vazhdojë ndjekja e trajnimeve të vijueshme profesionale për specialistët e Nj.A.B., e Specialistit te NjAB, Z. A.Gj. Gjithashtu të vazhdojë ndjekja e trajnimeve të vijueshme profesionale për specialistët e Nj.A.B.

**2.2 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.**

2.2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2022;

2.2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura;

2.2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Fondet e shpenzuara nga njëzia vendore për shkak të situatës COVID -19, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi.

2.2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministrinë e linjës etj.).

2.2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;

2.2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Në zbatim të Programit të Auditimit cituar më sipër, pika 2, u auditua *planifikimi dhe zbatimi i planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 993, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjet vjetore për buxhetin e shtetit të vitit 2022, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit.*

Dokumentacioni që u shqyrtua për auditimin e kësaj pike të programit të auditimit është si vijon:

- PBA 2022-2024;
- Projekt-buxhetin e miratuar për vitin 2022;
- Vendimet e KB "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Peqin" për vitin 2022;
- Vendime të tjera të KB, në lidhje me ndryshimet buxhetore;
- Situacioni i shpenzimeve për vitin 2022 i rakorduar me Degën e Thesarit Peqin;
- Situacioni i të ardhurave për vitin 2022 i rakorduar me Degën e Thesarit Peqin;
- Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit;
- Raportimet në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë lidhur me detyrimet e prapambetura të Bashkisë Peqin;
- Informacion shkresor i përgatitur nga subjekti bazuar në kërkesat e hartuara nga grupi i auditimit.

Baza Ligjore:

- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012, datë 7.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 02.06.2016;
- Ligji nr. 137/2020, datë 18.12.2019 "Për buxhetin e vitit 2021";
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore";
- Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore";
- Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore";
- Udhëzimi i MFE nr. 7, datë 26.02.2021 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024".



## ***1. Programimi i PBA-së 2022-2024***

Për hartimin e PBA-së 2022-2024 nga Bashkia Peqin janë ndjekur dhe zbatuar hapat e më poshtëm:

- Me shkresë nr. 230 prot., datë 08.02.2022, “Për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të riskut dhe krijimin e grupit të menaxhimit strategjik në Bashkinë Peqin”;
- VKB nr. 118, datë 29.12.2021, “Kalendari orientues për menaxhimin e shpenzimeve vendore”;
- VKB nr. 95, datë 24.06.2021, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2022-2024”;
- VKB nr. 77, datë 16.04.2021, “Mbi miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2023”;
- Shkresë dërguar MFE nr. 908, datë 31.05.2021, “Dërguar Projekt Buxheti Afatmesëm 2022-2024”, bashkëlidhur dhe relacioni.

**Nga auditimi u konstatua se,** për hartimin e PBA-së për periudhën 2021-2023, rezulton se nga strukturat e Bashkisë Peqin nuk janë ndjekur të gjithë hapat ligjore të përcaktuara në Ligjin nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 33, 34, 35, 36, 37, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/015, datë 15.10.2015, neni 12, si dhe udhëzimet e MFE nr. 23, datë 22.11.2016, nr. 22, datë 30.07.2018, nr. 7, datë 27.02.2019 dhe nr. 27 datë 10.07.2020; për të hartuar PBA-të, përkatësisht:

- Këshilli Bashkiak ka miratuar draftin e parë të programit buxhetor afatmesëm, dhe nuk ka dhënë opinionin e tij në lidhje me rekomandimet e Ministrisë së Financave;
- Kryetari i Bashkisë Peqin nuk ka miratuar udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit të bashkisë.

Në të gjithë konstatim më lart vihet re që nga Bashkia Peqin nuk janë zbatuar disa kërkesë e Ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 33, 34, 35, 36, 37, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/015, datë 15.10.2015, neni 12, si dhe udhëzimet e MFE nr. 23, datë 22.11.2016, nr. 22, datë 30.07.2018, nr. 7, datë 27.02.2019 dhe nr. 7, datë 26.02.2021 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024", kreu I, pika 13.

**Titulli i Gjetjes 1:** *Probleme në lidhje me Projekt Buxhetin Afatmesëm të vitit 2022-2024.*

**Situata:** Për hartimin e PBA-së për periudhën 2021-2023, rezulton se nga strukturat e Bashkisë Peqin nuk janë ndjekur të gjithë hapat ligjore të përcaktuara në Ligjin nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 33, 34, 35, 36, 37, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/015, datë 15.10.2015, neni 12, si dhe udhëzimet e MFE nr. 23, datë 22.11.2016, nr. 22, datë 30.07.2018, nr. 7, datë 27.02.2019 dhe nr. 27 datë 10.07.2020; për të hartuar PBA-të, përkatësisht:

- Këshilli Bashkiak ka miratuar draftin e parë të programit buxhetor afatmesëm, dhe nuk ka dhënë opinionin e tij në lidhje me rekomandimet e Ministrisë së Financave;
- Kryetari i Bashkisë Peqin nuk ka miratuar udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit të bashkisë.

**Kriteri:** Ligji nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 33, 34, 35, 36, 37, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/015, datë 15.10.2015, neni 12, si dhe udhëzimet e MFE nr. 23, datë 22.11.2016, nr. 22, datë 30.07.2018, nr. 7, datë 27.02.2019 dhe nr. 7, datë 26.02.2021 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024", kreu I, pika 13.

**Ndikimi:** Mangësi e menaxhimit për të publikuar buxhetet e institucionit që drejton, shkakton mosfunksionim e duhur të njësisë vendore.

**Shkaku:** Analizat e punës për publikimin e PBA për 2022-2024 nuk janë bërë të plota, duke mos qenë transparent.

**Rëndësia:** E ulët

**Rekomandimi:** Bashkia Peqin, Drejtoria e Financës të marrë masa që pas miratimit të programit buxhetor afatmesëm të japë opinion për rekomandimet e lëna nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

## ***2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura***

Për vitin 2022 në Bashkinë Peqin buxheti është hartuar kryesisht mbi bazën e 27 programeve, përkatësisht: Organet ekzekutive dhe legjislative, për çështjet financiare dhe fiskale, çështje të brendshme, Shërbime të huamarrjes vendore, Shërbime policore, Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri, marrëdhëniet me komunitetin, çështjet e përgjithshme ekonomike tregtare dhe të punës, Bujqësia, Pyjet, peshkimi dhe gjuetia, Transporti, Industri të tjera, Menaxhimi i mbetjeve, etj.

**Buxheti i vitit 2022**, është miratuar me VKB nr. 121, datë 29.12.2021, me shkresën nr. 1436/1, datë 10.01.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut.

Nga auditimi u konstatua se, buxheti i viteve 2022-2024 është miratuar sipas procedurave dhe kërkesave të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar.

*Tabela nr. II.1: Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2022*

<b>Planifikimi i të ardhurave 2022</b>		<b>Planifikimi i shpenzimeve 2022</b>	
Burimi i të ardhurave	Vlera në 000/ lekë	Emërtimi i zërave	Vlera në 000/ lekë
Të ardhura të planifikuara për vitin 2022.	168,135,471	Art. 600 Paga	219,304,966
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm e të planifikuara për shpenzim për vitin 2022.	6,967,224	Art. 601 Sigurime shoqërore dhe shend.	32,925,000
<b>Total të ardhurat e veta</b>	<b>175,102,695</b>	Art. 602 Shpenzime operative	127,806,705
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar.	7,782,795	Art. 604 Transferime korrente te brendshme	414,180,421
Të ardhura të trashëguara nga granti i kushtëzuar (transferua specifike 600, 601, 602 etj.).		606 Transferime te buxhetit familjar dhe individë	4,208,925
Grant i ri i çelur për llogari të vitit 2022	248,617,397	Art. 230-231 Investime	178,666,811
Transfertë specifike e çelur për llogari të vitit 2022	547,049,941	Fondi Rezervë + Kontingjencës (609)	1,460,000
<b>Total të ardhura nga transfertat e buxhetit te shtetit</b>	<b>803,450,133</b>		
<b>TOTALI TE ARDHURAVE</b>	<b>978,552,828</b>	<b>TOTALI SHPENZIMEVE</b>	<b>978,552,828</b>

*Burimi: Bashkia Peqin*

*Tabela nr. II.2: Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve me ndryshimet e buxhetit për vitin 2022*

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2022				Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2022			
Burimi i të ardhurave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB	Buxheti shtesë, miratuar me VKB	Vlera në 000/lekë	Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB	Buxheti shtesë, miratuar me VKB	Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë (në 000/lekë)
	1	2	1+2		3	4	3+4
Të ardhura të planifikuara për vitin 2022	168,135		168,135	Art. 600 Paga	284,582	-65,277	219,305
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm dhe të planifikuara për shpenzim për vitin 2022.		6,967	6,967	Art. 601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	32,585	340	32,925
<b>Total të ardhurat e veta</b>	<b>168,135</b>	<b>6,967</b>	<b>175,103</b>	Art. 602 Shpenzime operative	127,888	-81	127,807
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar		7,783	7,783	Art. 604 Transferime korrente të brendshme	10,900	1,282	12,182
Të ardhura të trashëguara nga transfertat specifike				Art. 606 Transferime të buxhetit familjar dhe individë	72,298	333,909	406,207
Transferta e pa kushtëzuar e çelur për llogari të vitit 2022	313,460	-64,843	248,617	Art. 230-231 Investime	39,006	139,661	178,667
Transferta specifike e çelur për llogari të vitit 2022	72,413	474,637	547,050	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	1,500	-40	1,460
<b>Total të ardhurat nga transfertat e buxhetit të shtetit</b>	<b>385,873</b>	<b>417,577</b>	<b>803,450</b>				
<b>TOTALI TË ARDHURAVE</b>	<b>554,008</b>	<b>424,544</b>	<b>978,553</b>	<b>TOTALI SHPENZIMEVE</b>	<b>568,759</b>	<b>409,794</b>	<b>978,553</b>

Burimi: Bashkia Peqin

### Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2022

Për vitin 2022 planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime është në vlerën **978,553** mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën **849,260** mijë lekë, ose në masën 87%. Realizimi i buxhetit sipas zërave paraqitet në mënyrë më të detajuar në tabelën në vijim.

Tabela nr. II.3: Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2022

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Peqin për vitin 2022, në mijë lekë						
Nr.	Përshkrimi i shpenzimeve	Plani 2022	Fakti 2022	Realizimi në %	Vlera e mbuluar nga të ardhurat e veta (fakti)	Vlera e mbuluar nga FZHR dhe granti (fakti)
	<b>Bashkia pa njësitë vartëse</b>					
1	Artikulli - 600 Paga	219,305	182,469	83%	31,866	150,603
2	Artikulli - 601 Sig. shoqërore & shend	32,925	30,458	93%	2,094	28,364
3	Artikulli - 602 Shpenzime operative	127,807	75,862	59%	13,608	62,254
4	Artikulli - 604 Transferita korrente të brendshme	414,180	408,162	99%	3,166	404,996
5	Artikulli - 606 Transferime tek buxhetet familjare (Ndihma ek. dhe PAK)	4,209	2,263	54%	443	1,820
6	Artikulli - 230 Projekte	1,460		0%		
7	Artikulli - 231 Investime	178,667	150,046	84%	12,699	137,346
	<b>TOTAL viti 2021</b>	<b>978,553</b>	<b>849,260</b>	<b>87%</b>	<b>63,877</b>	<b>785,383</b>

Burimi: Bashkia Peqin

Buxheti i vitit 2022, është miratuar me VKB nr. 121, datë 29.12.2021, me shkresën nr. 1436/1, datë 10.01.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut.

Nga bashkia ndarja e plan buxhetit dhe detajimi në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Në këto programe buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së pakushtëzuar sektoriale, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuara nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve. Gjatë këtij viti, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar dhe rialokimeve të kryera nga vetë bashkia, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, me VKB nr. 2, datë 19.01.2022, “Për një ndryshim në Vendimin nr. 121, datë 29.12.2021 për miratimin e buxhetit të Bashkisë Peqin për vitin 2022”, VKB nr. 33, datë 09.08.2022, “Mbi një ndryshim në Vendimin nr. 121, datë 29.12.2021”, VKB nr. 34, datë 09.08.2022, “Mbi një ndryshim në Vendimin nr. 121, datë 29.12.2021”, VKB nr. 40, datë 24.09.2022, “Mbi një ndryshim në Vendimin nr. 121, datë 29.12.2021”, VKB nr. 50, datë 25.12.2022, “Mbi një ndryshim në Vendimin nr. 121, datë 29.12.2021”, VKB nr. 53, datë 06.12.2022, “Mbi një shtesë në Vendimin nr. 121, datë 29.12.2021”.

**Nga auditimi u konstatua se,** ndryshimet e bëra në buxhetin e vitit 2022, rezulton:

- Ndryshimet nuk janë shoqëruar me relacion shpjegues lidhur me arsyet e ndryshimit;
- Nuk ka një analizë se si ndikon ky ndryshim në realizimin e objektivave të synuar të bashkisë;
- Nuk janë respektuar afatet ligjore për rishikimin e buxhetit vendor;
- Kryetari i Bashkisë Peqin për vitin 2021 nuk ka paraqitur brenda datës 31 mars të vitit pasardhës raport me shkrim pranë Këshillit Bashkiak për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 47<sup>4</sup>, ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 44<sup>5</sup>, Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore" shtojca 4, pika c, “.Si rregull ndryshimet duhet të jenë minimale. Ndryshimet duhet të jenë të papranueshme në tremujorin e parë të vitit pasi kjo periudhë është shumë afër kohës së parashikimit fillestar”.

**Titulli i Gjetjes 2:** *Probleme në lidhje me procedurat e diskutimit, planifikimit, miratimit, publikimit dhe analizës së buxheteve.*

**Situata:** nga ndryshimet e bëra në buxhetin e vitit 2022, rezulton:

- Ndryshimet nuk janë shoqëruar me relacion shpjegues lidhur me arsyet e ndryshimit;
- Nuk ka një analizë se si ndikon ky ndryshim në realizimin e objektivave të synuar të bashkisë;

---

<sup>4</sup> Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore bën një analizë të plotë të zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor të çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, edhe propozimet përkatëse për ndryshimin e vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, që ka miratuar buxhetin e vitit. Procedura e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve të vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore është e njëjtë me atë të vendimit për miratimin e buxhetit vjetor.

<sup>5</sup> Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës të paraqesë çdo vit një raport me shkrim të këshilli për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë. Ky raport i paraqitet këshillit jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës.

• Nuk janë respektuar afatet ligjore për rishikimin e buxhetit vendor;

Kryetari i Bashkisë Peqin për vitin 2021 nuk ka paraqitur brenda datës 31 mars të vitit pasardhës raport me shkrim pranë Këshillit Bashkiak për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë.

**Kriteri:** Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 47, ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 44, Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisë të vetëqeverisjes vendore" shtojca 4, pika c, ".Si rregull ndryshimet duhet të jenë minimale. Ndryshimet duhet të jenë të papranueshme në tremujorin e parë të vitit pasi kjo periudhë është shumë afër kohës së parashikimit fillestar".

**Ndikimi:** Mangësi e menaxhimit për të projektuar, miratuar, realizuar dhe analizuar buxhetet e institucionit që drejton, shkakton mosfunksionim e duhur të njësisë vendore. Planifikimi i të ardhurave të veta, zërave të shpenzimeve dhe investimeve dhe mos realizimi i tyre, më së shumti për shkak të mosrealizimit të të ardhurave, sjellin mungesa në plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës të njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve.

**Shkaku:** Analizat e punës për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në buxhetet paraardhëse nuk janë bërë të plota, duke mos nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve gjatë viteve të audituara.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandimi:** Bashkia Peqin të marrë masa për hartimin e një buxheti real, objektiv në realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, që mos të sjellë diferenca midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, të dokumentojë procesin e konsultimeve me komunitetin dhe grupet e interesit si dhe mbledhjet e strukturës dhe të institucioneve të varësi duke parashtruar dhe kërkesat e tyre buxhetore.

### ***3. Saktësia e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit***

**Treguesit e buxhetit për vitin 2022, është planifikuar në shumën 978,553 mijë lekë prej të cilit janë realizuar 849,260 mijë lekë ose i shprehur në përqindje plani është realizuar në masën 87%, nga të cilat financim me të ardhurat e veta në vlerën 63,877 mijë lekë ose në masën 8% të buxhetit faktik.**

Nga Drejtoria e Financës është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Peqin, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt rakordimet përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nën artikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar me VKB, ose të diktuar nga grandet e deleguara nga pushteti qendror. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi plan buxhetin dhe detajimin në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli u konstatua se në të gjitha rastet është respektuar disiplina buxhetore pasqyruar në anekset bashkëlidhur.

Në zbatim të detyrimeve ligjore për monitorimin e zbatimit të buxhetit, ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 44 dhe ligji nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 48, Bashkia Peqin ka përgatitur vetëm Raportin vjetor të monitorimit të buxhetit për vitin 2022 dhe e ka dërguar me shkresë në MFE nr. 371 prot., datë 27.02.2023.

Nga auditimi u konstatua se, Bashkia Peqin për vitin 2022 ka hartuar dhe dërguar në MFE vetëm Raportin vjetor të monitorimit të buxhetit për vitin 2022, 3 raportet periodike të monitorimit nuk janë hartuar nga Bashkia Peqin për vitin 2022. Kryetari i Bashkisë Peqin në asnjë rast nuk i ka paraqitur në këshill raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit, sipas përcaktimeve ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48. Kryetari i Bashkisë Peqin nuk ka miratuar rregullat specifike dhe procedurale që duhet të ndiqen në procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit. Raportet e monitorimit nuk janë hartuar në përputhje me kërkesat e Shtojcës 2 "Përmbajtja e raportit të monitorimit" dhe Shtojcës 5 "Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë", të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore". Raportet e monitorimit nuk janë të plota pasi nuk janë plotësuar të gjitha anekset sipas kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 48 dhe Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore", pika 10, 12, 28, 29, 48.

Titulli i Gjetjes 3: Mos zbatim i plotë i kuadrit ligjor për raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit.

Situata: Bashkia Peqin për vitin 2022 ka hartuar dhe dërguar në MFE vetëm Raportin vjetor të monitorimit të buxhetit për vitin 2022, ndërsa 3 raportet periodike të monitorimit nuk janë hartuar nga Bashkia Peqin për vitin 2022. Kryetari i Bashkisë Peqin në asnjë rast nuk i ka paraqitur në këshill raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit.

Kriteri: Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48, Shtojca 2 “Përmbajtja e raportit të monitorimit” dhe Shtojca 5 “Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë”, të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, Ligji nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 48 dhe Udhëzimi nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, pika 10, 12, 28, 29, 48.

Ndikimi: Zbatimi jo i plotë i kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të buxhetit të vitit 2021.

Shkaku: Mos zbatim i kuadrit ligjor dhe nënligjor për monitorimin dhe zbatimin e buxhetit.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Peqin të merren masa për hartimin e raporteve të monitorimit të zbatimit të buxhetit duke plotësuar të gjitha anekset me të dhënat përkatëse si dhe të dërgojë në institucionet përkatëse këto raporte sipas afateve të përcaktuara. Gjithashtu, të miratojë rregulla specifike dhe procedurale që duhet të ndiqen në procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit.

#### *4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve*

Vlera e detyrimeve të prapambetura deri në fund të vitit 2022 sipas rakordimit me degën e thesarit dhe raportimit në MFE me shkresën nr. 343, datë 22.02.2023 paraqitet në vlerën 104,162,356 lekë, ndërkohë që në dokumentet analitike që Bashkia Peqin disponon vlera e detyrimeve të prapambetura paraqitet në vlerën 137,497,700 lekë (për më shumë informacion shiko Aneksin nr. II.1).

Tabela nr. II.4: Detyrimet e prapambetura sipas rakordimit me Degën e Thesarit

Nr.	EMËRTIMI	VLERA NË LEKË
1	Detyrime të prapambetura për vendime gjyqësore	19,348,112
2	Detyrime të prapambetura për shërbime	33,915,120
3	Detyrime të prapambetura për mirëmbajtje	116,400
4	Detyrime të prapambetura për investime	14,364,723
5	Detyrime të prapambetura për rimbursimin e TVSh	758,305
6	Detyrime të prapambetura për mallra	4,618,203
7	Detyrime të prapambetura për paga	22,677,047
8	Detyrime të prapambetura transferta tek individët	7,579,648
9	Detyrime të prapambetura investime	784,798
<b>TOTALI</b>		<b>104,162,356</b>

Burimi: Bashkia Peqin

Në mënyrë të përmblodhur të dhënat që grupi i auditimit analizoi lidhur me detyrimet e prapambetura po i grupojmë në tabelën në vijim, referuar dokumentacionit si bilanceve, akt rakordimit me degën e thesarit, raportimeve në MFE dhe listave analitike që disponon Bashkia Peqin.

Tabela nr. II.5: Përmbledhje e detyrimeve të prapambetura në Bashkinë Peqin 2020-2021

Vlera e Detyrimeve sipas thesarit	Vlera e detyrimeve sipas raportimit në MFE	Vlera e detyrimeve nga dokumentet analitike
104,162,356	104,162,356	137,497,700

Burimi: Bashkia Peqin, përpunoi grupi i auditimit

**Nga auditimi u konstatua se,** nga ana e Bashkinë Peqin janë bërë përpjekje për të bërë saktësimin dhe evidentimin e kontratave dhe faturave të cilat nuk ishin pasqyruar më parë në tabelat e raportimeve të detyrimeve. Nga analizimi i të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme rezulton se vlera totale e detyrimeve të prapambetura që deklarohet në MFE, rakordohet me degën e thesarit për vlerën 104,162,356 lekë, por nuk përputhet me vlerën në dokumentet analitike që bashkia disponon nuk rakordon në total dhe rezulton që **detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2022 të jenë në vlerën 137,497,700 lekë.**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017 "Përfinancat e qeverisjes vendore", neni 34, pika 1, "Jo më vonë se data 31 janar, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore paraqet për shqyrtim e miratim në këshill raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për: a) dy vitet para vitit buxhetor; b) vitin buxhetor; c) tre vitet e ardhshme buxhetore.", neni 40, pika 3, "Projektbuxheti vjetor përfshin informacion mbi gjendjen/stokun e borxhit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. detyrimet kontingjente dhe mundësinë e shfaqjes së tyre si detyrime në vitin buxhetor pasardhës". Udhëzimi i MFE nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", pika 101 "Në miratimin e fondeve sipas programeve dhe zërave të shpenzimeve, më parë do të mbulohen detyrimet e papaguara nga viti i mëparshëm dhe pastaj fondet për të financuar veprimtarinë e vitit në vazhdim".

#### Vështirësia Financiare e Bashkisë Peqin

Në UMFE nr. 26, datë 27.09.2019 "Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore", trajtohet shkalla e vështirësisë financiare dhe menaxhimi i këtyre vështirësive.

Gjithashtu në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, datë 27.04.2017, kreu XI vështirësitë financiare dhe masat për zgjidhjen e tyre, neni 55 Probleme Financiare, pika 1.

Për Bashkinë Peqin, totali i shpenzimeve të miratuara nga të ardhurat e veta me VKB për vitin 2022 ka vlerën 431,502,887 lekë, ndërsa stoku i detyrimeve të prapambetura më 31.12.2022, ka vlerën 104,162,356 lekë, sipas raportimit në MFE me shkresën nr. 343 prot., datë 22.02.2023 dhe jo sipas vlerës së detyrimit të dokumenteve analitike të Bashkisë Peqin. Raporti i këtyre treguesve, pra raporti i stokut të detyrimeve të prapambetura me shpenzimeve totale të miratuara, ka vlerën 24%, shifër që e klasifikon Bashkinë Peqin në njësi të qeverisjes vendore pa probleme financiare. Por ky raport nuk është i saktë për arsye të lartpërmendura lidhur me detyrimin e prapambetur real. Marrë kjo për qindje nga dokumentet analitike që bashkia disponon detyrimi i prapambetur është në vlerë 137,497,700 lekë për vitin 2022, totali i shpenzimeve të miratuara nga të ardhurat e veta me VKB për vitin 2022 ka vlerën 431,502,887 lekë. Raporti i këtyre treguesve sjell vlerën 32%, shifër që e konsideron Bashkinë Peqin në njësi të qeverisjes vendore me probleme financiare.

**Titulli i gjetjes 4:** *Risqet buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, pasaktësi në të dhënat e paraqitura në raportimet në MFE dhe dokumentet analitike të Bashkisë Peqin dhe mos raportim në MFE periodikisht mbi detyrimet e prapambetura.*

**Situata:** Vlera e detyrimeve të prapambetura deri në fund të vitit 2022 sipas rakordimit me degën e thesarit dhe raportimit në MFE me shkresën nr. 343, datë 22.02.2023 paraqitet në vlerën 104,162,356 lekë, ndërkohë që në dokumentet analitike që Bashkia Peqin disponon vlera e detyrimeve të prapambetura paraqitet në vlerën 137,497,700 lekë. Nga ana e Bashkinë Peqin janë bërë përpjekje për të bërë saktësimin dhe evidentimin e kontratave dhe faturave të cilat nuk ishin pasqyruar më parë në tabelat e raportimeve të detyrimeve. Nga analizimi i të dhënave rezulton se vlera totale e detyrimeve të prapambetura që deklarohet në MFE, rakordohet me degën e thesarit për vlerën 104,162,356 lekë, por nuk përputhet me vlerën në dokumentet analitike që bashkia disponon nuk rakordon në total dhe rezulton që detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2022 të jenë në vlerën 137,497,700 lekë.

**Kriteri:** Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014, pika 4. Ligji nr. 68/2017 "Për financat e qeverisjes vendore", neni 34, pika 1, neni 40, pika 3, Udhëzimi i MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 101.

**Ndikimi:** Mos shlyerja në kohë të detyrimeve ndaj të tretëve krijon risk për pagesa penalitetesh të panevojshme dhe pasaktësi në vlera dhe mangësi në raportime të detyrimeve të prapambetura.

**Shkaku:** Moszbatim i kërkesave ligjore për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, vlera jo të besueshme dhe mungesë raportimesh në MFE për detyrimet e prapambetura.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Bashkia Peqin të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve, të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe të raportojë periodikisht në MFE.

*Mbi likuidimin e vendimeve gjyqësore në Bashkinë Peqin*

*Tabela nr. II.6: Likuidimet e vendimeve gjyqësore*

Nr.	Emër mbiemër i paditësit	Nr. dhe data vendimit të Gj. Apelit	Vlera në lekë e dëmshpërblimit sipas vendimit të Gjykatës së Apelit, në lekë	Pagesa e kryer gjatë vitit 2021, në lekë	Pagesa e kryer gjatë vitit 2022, në lekë	Detyrimi i ngelur në 31.12.2022 në lekë
1	K.D.	Nr. 270, datë 01.04.2021	1,118,920	150,000	494,185	474,735



2	Sh. M.	Nr. 1884, datë 16.03.2021	769,320	150,000	369,320	250,000
3	Pagese përbarimore P.SHA	Nr. 1840, datë 25.03.2021	250,000			250,000
4	Pagese përbarimore T.	Nr. 1518, datë 06.03.2020	8,228,169			8,228,169
5	Pagese përbarimore LL.	-	1,569,021			1,569,021
6	Pagese përbarimore	Datë 27.10.2022	9,536,208			9,536,208
	<b>TOTAL</b>		<b>21,471,638</b>	<b>300,000</b>	<b>863,505</b>	<b>20,308,133</b>

*Burimi: Bashkia Peqin, përpunoi grupi i auditimit*

**Nga auditimi u konstatua se:**

1. Të dhënat e paraqitura në tabelën më sipër rezultojn se vlera e detyrimeve të prapambetura për vendimet gjyqësore të prapambetura nga dokumentet analitike të bashkisë rezultojn në vlerën 21,471,638 lekë janë paguar detyrime në vlerën 1,163,505 lekë për largimin e punonjësve nga puna dhe detyrime përbarimore dhe për vitin 2022 rezultojnë **detyrime të prapambetura për vendimet gjyqësore në vlerë 20,308,133 lekë**. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017 "Përfinancat e qeverisjes vendore" neni 40, pika 3;
2. Bashkia Peqin në likuidimin e detyrimeve nuk respekton radhën e paraqitjes së tyre në njësinë shpenzuese, veprim ky në kundërshtim me Udhëzimin nr. 1, datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisë të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit", pika 5 dhe pika 8.

**Titulli i gjetjes 5:** *Mos likuidim i vendimeve gjyqësore sipas radhës së paraqitjes së tyre në Drejtorinë e Financave dhe Sektorin e Buxhetit.*

**Situata:** Bashkia Peqin për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2022 ka shpenzuar vlerën 1,163,505 lekë, e cila konsiderohet efekt financiar negativ në buxhetin e njësisë vendore. Vlera e mësipërme, i përket vendimeve gjyqësore me objekt "dëmshpërblim page" për largime nga puna të punonjësve dhe vlerë përbarimore.

Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej Tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, ndikon pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësi vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, ndihmon në evidentimin e procedurave të bëra gabim, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet, sipas tabelës nr. II. 6.

**Kriteri:** Pika nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar.

**Ndikimi:** Identifikimi, regjistrimi i vlerës së saktë të detyrimeve të prapambetura si dhe likuidimi i tyre ndikon në vlerësimin e situatës financiare të Bashkisë Peqin.

**Shkaku:** Drejtoria e Financës dhe Sektorin e Buxhetit nuk zbaton radhën e regjistrimit në bashki të vendimeve gjyqësore për likuidim.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Peqin dhe Drejtoria/Sektorin Juridik, të analizojnë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohen, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore, si dhe të dalin përgjegjës të administrative. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e

largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

### **5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre**

Për vitin 2022 planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime është në vlerën 978,553 mijë lekë prej të cilit janë realizuar 849,260 mijë lekë ose i shprehur në përqindje plani është realizuar në masën 87%, nga të cilat financim me të ardhurat e veta në vlerën 63,877 mijë lekë ose në masën 8% të buxhetit faktik, ndërkohë që nga fondet e FZHR është mbuluar në vlerën **785,383** mijë lekë ose **92%**. Nga këto, fondi i pagave (Ilogaria 600) është realizuar me 83%, sigurime shoqërore dhe shëndetësore (Ilogaria 601) është realizuar me 93%, shpenzimet operative (Ilogaria 602) është realizuar me 59%, transfertat korrente të brendshme (Ilogaria 604) është realizuar me 99%, transferime tek buxhetet familjare (Ilogaria 606) është realizuar me 54%, Ilogaria (609) është realizuar me 0% dhe fondi i investimeve (Ilogaria 231) është realizuar me 84%.

#### **Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

1. Z. L.T., Kryetar i Bashkisë Peqin;
2. Z. E. LL., Drejtor i Drejtorisë së Financës për periudhën 01.01.2022-25.08.2022;
3. Z. D.M., Drejtor i Drejtorisë së Financës për periudhën 25.08.2022–31.12.2022.

### **6. Burimi i krijimit të të ardhurave dhe vlerësimi i mbledhjes së tyre bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.**

Në zbatim të Programit të Auditimit cituar më sipër pika 2, nënpika 2.6, u auditua *burimi i krijimit të të ardhurave dhe vlerësimi i mbledhjes së tyre bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.*

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Peqin bëhet mbështetur në kuadrin ligjor si më poshtë:

- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;
- VKB-në nr. 64, datë 23.12.2022 “Për sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Peqin”.

Dokumentacioni që u analizua për të vlerësuar administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore është si vijon:

- Vendimet e Këshillit Bashkiak Peqin për miratimin e paketave fiskale të vitit 2022;
- Pasqyrat financiare në lidhje me arkëtimet, kontabilizimin dhe pasqyrimin e të ardhurave nga subjektet dhe familjarët, lidhur me taksat dhe tarifave vendore;
- Dokumentacioni i Drejtorisë së Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore, në lidhje me mënyrën e mbajtjes së regjistrave dhe dokumentacionit të tatim-paguesve;
- Kontrata, procesverbale dhe relacione në lidhje me të ardhurat;
- Regjistrat dhe mbajtja e debitorëve për bizneset, për taksat dhe tarifave vendore;
- Realizimi faktik i të ardhurave, monitorimi dhe analiza mbi performancën e realizimit të të ardhurave të planifikuara;
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore.

Dokumentacioni që u analizua për të vlerësuar pagesat e kontratave të qirave të aseteve është:

- Kontratat e aseteve të dhëna me qira;
- Dosjet përkatëse të subjekteve që kanë marrë asete me qira;
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion lidhur me monitorimet e kontratave dhe likuidimet e pagesave të qirave.

### Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve

Për vitin 2022 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Peqin është miratuar me VKB-në nr. 120, datë 29.12.2021 “Mbi miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Peqin për vitin 2022”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 1435/1 Prot. datë 07.01.2022”.

Tabela nr.II.7: Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave në Bashkinë Peqin, viti 2022

lekë

NR.	LLOJI I TAKSËS	PLANI	FAKTI	%
	<b>I. Të ardhura nga taksat vendore</b>			
1	Taksë mbi biznesin vogël	3,000,000	154,211	5%
2	Taksa mbi pasurinë ndërtesë	22,000,000	6,256,966	28%
3	Taksë kalim pronësie	1,000,000	1,891	0%
4	Taksë regj mjet .Transporti	11,000,000	10,822,229	98%
5	Taksë tablele +reklame	2,100,000	333,637	16%
6	Taksa e rentës minerale	500,000	182,729	37%
7	Taksa hapësirës publike	1,000,000	2,452,977	245%
8	Taksë ndërtime të reja	13,000,000	1,255,548	10%
9	Taksë infrastrukture	25,000,000	6,759,031	27%
10	Taksë e Tokës	19,000,000	5,211,976	27%
11	Taksë Trualli	4,000,000	610,674	15%
12	Taksë pulle	100,000	60,402	60%
13	Taksë e përkohshme	1,000,000	-	0%
14	Taksë mbi të ardhurat personale	6,000,000	8,190,698	137%
-	<b>SHUMA I</b>	<b>108,700,000</b>	<b>42,292,969</b>	<b>39%</b>
	<b>II. Të ardhura jo tatimore</b>			
1	Tarifë pastrimi	37,768,470	7,977,892	21%
2	Tarifë ndriçimi	5,000,000	1,665,626	33%
3	Tarifë parkimi	200,000	11,000	6%
4	Tarifë leje transporti+shërbime etj	-	185,400	
5	Tarifa Shërbimi administ. të bashkisë	8,000,000	417,139	5%
6	Tarifa Dhënie Licence Leje Autorizim	1,000,000	1,400,000	140%
7	Tarifa te kontrollit dhe zhvillimit territorit	1,000,000	-	
8	Tarifa shërbime shtesë nga zjarrfikësja	100,000	10,000	10%
9	Tarifa të tjera	1,167,000	-	
10	Kundërvajtje e administrative	200,000	-	
11	Takse vendore regj. e biznesit	-	6,260	
12	Tarifë për certifikatë të përkohshme	-	5,000	
13	Tarifë për regjistrimin e veprimtarive	-	845,703	
14	Tarifë për leje zhvillimi	-	62,740	
15	Tarifë vendore për Vërtetime	-	345,668	
16	Taksë vendore për varreza	-	683,334	

17	Taksë vendore përkohshme për mirëmbajtjen	-	1,184,771	
18	Të ardhura nga Qira troje	-	5,400	
19	Tarifë shërbimi për licencat radiotelevizive	-	1,000	
20	Të ardhura nga ZRP	-	1,500	
21	Të tjera mallra e shërbime	-	4,000	
	<b>SHUMA II</b>	<b>54,435,470</b>	<b>14,812,433</b>	<b>27%</b>
	<b>III. Të Ardhura nga pronat</b>			
1	Qira toke	5,000,000	1,260,734	25%
	<b>SHUMA III</b>	<b>5,000,000</b>	<b>1,260,734</b>	<b>25%</b>
	<b>SHUMA TOTALE I+II+III</b>	<b>168,135,470</b>	<b>58,366,136</b>	<b>35%</b>

*Burimi: Bashkia Peqin, përpunoi grupi i auditimit*

Referuar të dhënave të paraqitura në tabelën më sipër për periudhën nën auditim realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Peqin paraqitet në masën 35%, nga 168,135 mijë lekë të parashikuara janë realizuar në vlerën 58,366 mijë lekë (minus 109,769 mijë lekë).

**Nga auditimi konstatohet se,** ekzistojnë disa zëra për të cilat Drejtoria e të Ardhurave Lejeve dhe Licencave nuk ka bërë planifikim për vitin 2022. Përkatësisht, zërat Tarifë leje transporti plus shërbime, etj., Takse vendore e regjistrimit të biznesit, Tarifë vendore për vërtetime, etj., veprime këto në kundërshtim me VKB-në nr. 120, datë 29.12.2021 “Mbi miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Peqin për vitin 2022”, VKB nr. 121, datë 29.12.2021, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022”.

**Titulli i gjetjes 6:** Mos planifikim i taksave dhe tarifave vendore gjatë hartimit të paketës fiskale.

**Situata:** Drejtoria e të Ardhurave Lejeve dhe Licencave për disa zëra të taksave dhe tarifave nuk ka bërë planifikim për vitin 2022. Përkatësisht, zërat Tarifë leje transporti plus shërbime, etj., Takse vendore e regjistrimit të biznesit, Tarifë vendore për vërtetime, etj., duke mos respektuar kërkesat e VKB për taksat dhe tarifave vendore.

**Kriteri:** Neni 12, 13, 14 të ligjit Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, VKB-në nr. 120, datë 29.12.2021 “Mbi miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Peqin për vitin 2022”, VKB nr. 121, datë 29.12.2021, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022”.

**Ndikimi:** Mos planifikimi i saktë i të ardhurave të pritshme nga taksat dhe tarifave vendore ndikon në hartimin e buxhetit të bashkisë, në angazhimet që parashikohen të ndërmerren gjatë vitit buxhetor. Gjithashtu, nga ana tjetër të ardhurat që vijnë nga taksat dhe tarifave e pa planifikuara grumbullohen të gjitha në një zë “Të ardhura të tjera” duke mos pasqyruar qartë se cili është burimi i tyre si dhe ndikojnë në nivelin e plan-faktit të të ardhurave vjetore të Bashkisë Peqin.

**Shkaku:** Drejtoria e të Ardhurave Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Peqin nuk ka zbatuar përcaktimet e Vendimit të Këshillit Bashkiak për taksat dhe tarifave vendore që duhet të aplikohen në territorin e Bashkisë Peqin.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** Drejtoria e të Ardhurave Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Peqin të marrë masa që, në planin vjetor të të ardhurave të bashkisë të parashikojë të ardhurat që do të sigurohen nga zërat, tarifë leje transporti plus shërbime, taksë vendore e regjistrimit të biznesit, tarifë vendore për vërtetime, etj., si dhe të ardhurat nga të gjitha taksat/tarifave e tjera të parashikuara në paketën fiskale të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak.

**Nga auditimi u konstatua se**, për vitin 2022 në Bashkinë Peqin niveli i realizimit të të ardhurave është 35%, duke sjellë diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit të bashkisë për sa i takon pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve. Niveli i ulët i realizimit të të ardhurave ka ndikuar në mosrealizimin e shpenzimeve të planifikuara me burim financimi të ardhurat e veta të bashkisë dhe marrjen e angazhimeve buxhetore pa patur burime financimi reale. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e kuadrit ligjor dhe rregullator për hartimin dhe zbatimin e buxhetit, përkatësisht:

- Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;
- Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Udhëzimit të MFE nr. 7, datë 27.02.2019 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2020-2022";
- Për vitin 2022 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Peqin është miratuar me VKB-në nr. 64, datë 23.12.2022 “Për sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Peqin”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 1575/1 Prot. datë 09.01.2023”;
- VKB nr. 121, datë 29.12.2021, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022”.

**Titulli i gjetjes 7:** *Nivel i ulët i realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore referuar planit vjetor të të ardhurave.*

**Situata:** Për vitin 2022 në Bashkinë Peqin niveli i realizimit të të ardhurave është 35%, duke sjellë diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit të bashkisë për sa i takon pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve. Niveli i ulët i realizimit të të ardhurave ka ndikuar në mosrealizimin e shpenzimeve të planifikuara me burim financimi të ardhurat e veta të bashkisë dhe marrjen e angazhimeve buxhetore pa patur burime financimi reale.

**Kriteri:**

- Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Udhëzimi i MFE nr. 7, datë 27.02.2019 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2020-2022";
- Për vitin 2022 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Peqin është miratuar me VKB-në nr. 64, datë 23.12.2022 “Për sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Peqin”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 1575/1 Prot. datë 09.01.2023”;
- VKB nr. 121, datë 29.12.2021, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022”.

**Ndikimi:** Niveli i ulët i realizimit të të ardhurave ndikon në mosrealizimin e shpenzimeve të planifikuara me burim financimi të ardhurat e veta të bashkisë.

**Shkaku:** Drejtoria e të Ardhurave Lejeve dhe Licencave nuk ka qenë efektive në punën e saj për të mbledhur të ardhurat e parashikuara nga tatimpaguesit fizik/juridik si dhe ato familjarë.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** Drejtoria e të Ardhurave Lejeve dhe Licencave të angazhohet në marrjen e masave gjatë gjithë vitit me qëllim mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në nivelet më të larta sipas planifikimit.

**Taksa e ndikimit në infrastrukturë**

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet llogaritet në bazë të përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c “për

*ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit. Leja e legalizimit lëshohet vetëm pasi të jetë vërtetuar pagesa e taksës nga taksapaguesi” dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014, “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5 “Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Për zbatimin e kësaj pike, drejtoritë e ALUIZNI-t, të vënë në dispozicion të njësite të qeverisjes vendore, në momentin e dërgimit për regjistrim në ZVRPP, të dhënat e ndërtimeve që pajisen me leje legalizimi”.*

Në Bashkinë Peqin struktura që ka administruar dokumentacionin dhe ka përllogaritur vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për subjektet që pajisen me certifikatën e pronësisë për vitin 2022 ka qenë Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit. Me urdhrin nr. 58, datë 25.03.2022 përgjegjësia e plotë për menaxhimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet e reja ka kaluar te Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave.

Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me ecurinë e pagesave që kryhen nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë konstatohet se, nga legalizimet e bërë ndër vite nuk kanë paguar detyrimin për taksën e ndikimit në infrastrukturë **ndër vite 386 qytetarë në vlerën 15,910,147 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Peqin.**

**Për vitin 2022, janë legalizuar gjithsej 122 objekte me vlerë totale të detyrimit për t’u paguar 7,526,463 lekë. Nga auditimi rezulton se, kanë paguar detyrimet 34 qytetarë/individë me vlerë 1,600,529 lekë dhe janë debitorë ndaj bashkisë 88 qytetarë me vlerë totale 5,925,934 lekë, vlerë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Peqin.**

**Nga auditimi u konstatua se,** qytetarët/individët që kanë përfituar legalizimin e sipërfaqeve të caktuara nuk kanë paguar rregullisht detyrimin ndaj Bashkisë Peqin për taksën e ndikimit në infrastrukturë. Përkatësisht për vitin 2022 nuk kanë paguar detyrimin 88 qytetarë me vlerë totale 5,925,934 lekë, gjithashtu, nuk kanë paguar detyrimin 386 individë/qytetarë për sipërfaqet e legalizuara përpara vitit 2022 me vlerë totale të detyrimeve 15,910,147 lekë. **Në total vlera e detyrimeve nga mos pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet rezulton në vlerën 21,836,081 lekë për 474 objekte të legalizuara, vlerë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Peqin.** Veprime në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5 si dhe VKB-së nr. 120, datë 29.12.2021 “Mbi miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Peqin për vitin 2022”.

Lidhur me kalimin e përgjegjësisë për menaxhimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave, konstatohet se, në urdhrin nr. 58 datë 25.03.2022 është përcaktuar vetëm ndryshimi i strukturës të cilës i kalon përgjegjësia për llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet dhe nuk është parashikuar kalimi i dosjeve, dokumentacionit apo të dhënave të tjera nga Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Drejtorisë së të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave. Aktualisht, nga DPZHT është

hartuar shkresa nr. 492/1 Prot. datë 28.03.2022 për dorëzimin e dokumentacionit te Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave por rezultoi se, ende nuk është bërë marrja e dosjeve/materialeve/të dhënave për menaxhimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

DPZHT, është struktura brenda Bashkisë Peqin që ndjek procesin dhe mban gjithë korrespondencën me ASHK-në për të gjitha objektet që janë në proces legalizimi si dhe ka pjesë të saj inxhinier të fushës, si rezultat kjo strukturë nuk mund të përjashtohet nga përgjegjësia për llogaritjen e detyrimit që iu lind individëve kur përfitojnë legalizimin e objekteve të tyre. Bashkëpunimi efektiv midis këtyre dy drejtorive do të ulte mundësinë e gabimeve në llogaritjen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe do të rriste nivelin e arkëtimeve. Në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27.

Ligji nr. 95/2018 “për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c.

Ligji nr. 98/2020 “për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 1, “në nenin 27, pika 3, shkronja “c”.

VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5.

VKB nr. 120, datë 29.12.2021 “Mbi miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Peqin për vitin 2022”.

**Titulli i gjetjes 8:** *Mos arkëtim i taksës së ndërtimeve të reja që pajisen me certifikatën e pronësisë (taksa e legalizimeve).*

**Situata:** Për vitin 2022, janë legalizuar gjithsej 122 objekte me vlerë totale të detyrimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet, në vlerën 7,526,463 lekë. Rezultoi se kanë paguar detyrimet 34 qytetarë me vlerë 1,600,529 lekë dhe janë debitorë ndaj bashkisë 88 prej tyre në vlerën 5,925,934 lekë.

Gjithashtu për periudhën përpara vitit 2022, për këtë taksë u konstatua se janë debitorë 386 qytetarë për vlerën 15,910,147 lekë. Në total vlera e detyrimeve ndaj Bashkis Peqin, nga mos pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet nga 474 objekte të legalizuara, rezultoi në vlerën 21,836,081 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Peqin.

**Kriteri:** Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27.

Ligji nr. 95/2018 “për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c.

Ligji nr. 98/2020 “për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 1, “në nenin 27, pika 3, shkronja “c”.

VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5.

VKB nr. 120, datë 29.12.2021 “Mbi miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Peqin për vitin 2022”

**Ndikimi:** Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Peqin, nga mos arkëtimi i vlerës prej **21,836,081 lekë** për ndërtimet e reja që legalizohen.

**Shkaku:** Mos marrje e masave efektive nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave të bërë të mundur pagesën e taksës së legalizimeve.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** Titullari i Bashkisë Peqin të marra masa që Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të angazhohet në procesin e planifikimit të të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet. Gjithashtu, të dyja drejtoritë, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave dhe Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit duhet të bashkëpunojnë dhe të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për **474 debitorë në vlerën 21,836,081 lekë** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Nga strukturat e Bashkisë Peqin të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen si dhe për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

### Të ardhurat nga asetet e dhëna me qira

Në kuadër të auditimit të të ardhurave të Bashkisë Peqin u auditua realizimi i të ardhurave nga asetet e bashkisë të dhëna me qira. Në këtë aspekt u auditua vetëm zbatimi i kushteve të kontratave lidhur me pagesat në afat të detyrimeve të qirasë vjetore për sipërfaqen e marrë me qira dhe jo kushtet e hartimit të kontratave.

Dhënia e aseteve të bashkisë me qira bëhet bazuar në kuadrin ligjor si më poshtë:

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840;
- Ligjin nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore;
- VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar;
- VKM nr. 391 datë 21.06.2006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

Bashkia Peqin në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi<sup>6</sup> për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre ka lidhur 5 kontrata për dhënien me qira të aseteve që ka në pronësi. Këto kontrata janë lidhur bazuar në legjislacionin përkatës me subjekte të ndryshëm fizik/juridik që kanë shprehur interes. Kontratat janë lidhur për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore, për aktivitet bujqësor, objekte banimi etj.

*Tabela nr.II.8: Pagesat e kontratave të qirave për vitin 2022*

Nr.	Subjekti	Kontrata	Afati në vite	Sipërfaqja në ha	Detyrimi Vjetor në lekë	Debitor 2022
1	B. SHPK	Nr. 1148. Prot. datë 07.07.2020	10	7.7 ha	77,000	-
2	B. SHPK	Nr. 1699. Prot. datë 28.09.2020	10	8 ha	80,000	-
3	L.K.	Nr. 434. Prot. datë 26.02.2021	10	10.8 ha	108,000	-
4	B. SHPK	Nr. 930. Prot. datë 01.06.2020	10	5.8 ha	58,180	-
5	A.M.	Nr. 2054. Prot. datë 13.12.2021	10	11.61 ha	116,100	<b>116,100</b>

<sup>6</sup> Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, ligjin nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar, VKM nr. 391 datë 21.06.2006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.



*Burimi: Bashkia Peqin*

**Nga auditimi u konstatua se,** nga pagesa e kontratës së qirasë rezulton qiramarrësi “A.M.” për vlerën 116,100 lekë nuk kanë paguar detyrimet e kontratës. Detyrimi që subjekti ka ndaj Bashkisë Peqin për vitin 2022 në vlerën është **116,100 lekë përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Peqin.**

**Nga auditimi u konstatua se,** Bashkia Peqin ka lidhur edhe 1615 akt marrëveshje për dhënie sipërfaqesh toke me qira familjeve në P. njësitë e saj administrative. Nga këto akt marrëveshje priten që të arkëtohen të ardhura vjetore në vlerën 5,982,624 lekë. Nga auditimi i pagesave të qirave për këto akt marrëveshje rezultoi se, për vitin 2022 nuk është paguar asnjë detyrim dhe mbetet për t’u paguar detyrimi në vlerën 5,982,624 lekë. **Të ardhurat e munguara në buxhetin e Bashkisë Peqin më datë 31.12.2022 si rezultat i mos pagesës së detyrimit për sipërfaqet e marra me qira janë në vlerën totale 5,982,624 lekë.** Në kundërshtim me Kodin Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840. Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36. VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar. VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

VKB nr. 120 datë 29.12.2021 “Mbi miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Peqin për vitin 2022.

**Titulli i gjetjes 9:** *Të ardhura të munguara nga mos pagesa e detyrimeve për sipërfaqen e tokës së marrë me qira.*

**Situata:** nga 5 subjekte që kanë kontratë qiraje në vitin 2022 rezulton se vetëm qiramarrësi “A.M.” për vlerën 116,100 lekë nuk kanë paguar detyrimet e kontratës. Detyrimi që subjekti ka ndaj Bashkisë Peqin për vitin 2022 në vlerën është 116,100 lekë përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Peqin.

Bashkia Peqin ka lidhur edhe 1615 akt marrëveshje për dhënie sipërfaqesh toke me qira familjeve në P. njësitë e saj administrative. Nga këto akt marrëveshje priten që të arkëtohen të ardhura vjetore në vlerën 5,982,624 lekë. Nga auditimi i pagesave të qirave për këto akt marrëveshje rezultoi se, për vitin 2022 nuk është paguar asnjë detyrim dhe mbetet për t’u paguar detyrimi në vlerën 5,982,624 lekë. Të ardhurat e munguara në buxhetin e Bashkisë Peqin më datë 31.12.2022 si rezultat i mos pagesës së detyrimit për sipërfaqet e marra me qira janë në vlerën totale 5,982,624 lekë.

**Kriteri:** Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840.

Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36.

VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar.

VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

VKB nr. 120 datë 29.12.2021 “Mbi miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Peqin për vitin 2022.

**Ndikimi:** Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Peqin nga mos arkëtimi i detyrimeve nga qiramarrësit në vlerën **5,982,624 lekë.**

**Shkaku:** Strukturat e Bashkisë Peqin nuk kanë qenë efektive në mbledhjen e detyrimeve të qirave nga subjektet qiramarrëse si dhe nuk kanë respektuar përcaktimet ligjore për dhënien me qira të aseteve të tyre.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë të marrin masa dhe të ndjekin të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës **5,982,624 lekë** nga qiramarrësit që nuk kanë paguar detyrimet për tokën e marrë me qira.

### Menaxhimi i borxhit

Tabela nr.II.9: Numri i bizneseve në Bashkinë Peqin për vitin 2021

Nr.	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja Në fillim	Regjistrime të Reja	Mbyllur Aktiviteti	Gjendja
1	Biznesi Vogël	2022	423	24	12	435
2	Biznesi Madh	2022	48	2	0	50
	<b>Gjithsej</b>	<b>2022</b>	<b>471</b>	<b>26</b>	<b>12</b>	<b>485</b>

Burimi: Bashkia Peqin

Nga auditimi i dokumentacionit të Drejtorisë së të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave u konstatua se subjektet janë njoftuar periodikisht për detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, si dhe janë rinjoftuar në rastet e vonesave në pagesat e detyrimeve vendore. Gjendja e debitorëve për subjektet fizik/juridik paraqitet për vitin 2022 paraqitet në vijim.

### Taksat dhe tarifat familjare

Në Bashkinë Peqin familjarët ngarkohen me detyrime vendore për taksën e tokës, taksën e ndërtesës, taksën e truallit, tarifën e gjelbërimit, mirëmbajtjes së rrugëve dhe trotuareve, tarifën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave urbane dhe tarifën e ndriçimit. Bashkia Peqin nuk ka një akt marrëveshje me Ujësjetellës Sh.A. Peqin, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të rolit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore të përfshira në faturën e ujit të pijshëm. Në tabelën në vijim paraqiten në mënyrë të përmbledhur detyrimet e familjeve për taksat dhe tarifat vendore.

Tabela nr.II.10: Familjet debitore për taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Peqin për vitin 2022  
lekë

Nr.	Njësia Administrative	Nr. Familjeve	Shuma e debisë 31.12.2022
1	Peqin	706	2,471,000
2	Pajove	560	1,904,000
3	Përparim	227	749,100
4	Gjocaj	484	1,548,800
5	Sheze	297	656,750
6	Karine	188	545,200
	<b>Totali</b>	<b>2,462</b>	<b>7,874,850</b>

Burimi: Bashkia Peqin

**Nga auditimi u konstatua se,** vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në Bashkinë Peqin paraqitet:

**Vlera e borxhit e krijuar gjatë vitit 2022** është 16,882,981 lekë i përbërë nga:

- Detyrime nga taksat dhe tarifat e bizneseve, në vlerën totale 9,008,131 lekë

- Detyrime nga taksat dhe tarifatat vendore për familjet në vlerën 7,874,850 lekë.

*Për vitin 2022 gjendja e debitorëve progresiv në Bashkinë Peqin është:*

- Detyrimet nga taksat dhe tarifatat e bizneseve, në vlerën totale 11,590,558 lekë për 238 biznese (223 biznese të vogla dhe 15 biznese të mëdha); (Informacion më i detajuar lidhur me debitorët progresivë paraqitet në Aneksin nr. II.2 bashkëlidhur).

- Detyrime nga taksat dhe tarifatat vendore për familjet në vlerën 9,104,000 lekë.

Në fund të vitit 2022 gjendja e debitorëve progresiv për subjektet fizik/juridik është 11,590,558 lekë për 238 biznese dhe 9,104,000 lekë për taksat dhe tarifatat familjare, vlerë kjo që sjell të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Peqin në total **20,694,558 lekë**.

### Taksa mbi tokën bujqësore

Taksa mbi tokën bujqësore llogaritet në bazë të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23<sup>7</sup>.

Sipas Aneksit 2 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, Bashkia Peqin klasifikohet në kategorinë e dytë ku çmimi lekë/ha në vit për tokën bujqësore është si në tabelën më poshtë:

*Tabela nr.II.11: Vlera e taksës së tokës së tokës bujqësore në lekë/hektar/vit*

Kategoria e tokës bujqësore	Niveli i taksës së tokës bujqësore sipas VKB-ve (lekë/ha/vit)
I	4,200
II	3,500
III	2,800
IV	2,300
V	1,900
VI	1,600
VII-X	1,400

Referuar VKB-në nr. 120, datë 29.12.2021 “Mbi miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Peqin për vitin 2022”, toka bujqësore në Bashkinë Peqin klasifikohet sipas aneksit 2 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006.

*Tabela nr.II.12: Debitorët për taksën e tokës për vitin 2022*

Nr.	Njësia Administrative	Nr. Familjeve Debitore	Shuma
1	Peqin	396	673,200
2	Pajove	1,230	2,591,850
3	Përparim	981	1,962,000
4	Gjocaj	1,041	2,290,200
5	Sheze	956	1,720,800
6	Karine	326	635,700
	<b>Totali</b>	<b>4,930</b>	<b>9,873,750</b>

*Burimi: Bashkia Peqin*

Referuar të dhënave të tabelës më sipër në Bashkinë Peqin për taksën e tokës bujqësore për vitin 2022 janë debitorë 4 930 familjeve me vlerë të detyrimit 9,873,750 lekë, ndërsa vlera progresive deri me 31.12.2022, **që përbën të ardhura të munguara për Bashkinë Peqin është në vlerën 10,200,000 lekë**.

<sup>7</sup> Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23, pika 1, aneksi 2.

### **Masat e marra për uljen e borxhit**

Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Peqin është përgjegjëse për të mbledhur detyrimet e papaguara në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, hapat që duhet të ndërmerren me qëllim mbledhjen e detyrimeve të papaguara vijnë duke u përshkallëzuar si:

1. Njoftimi dhe kërkesa për të paguar;
2. Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit;
3. Masa e sigurimit të detyrimit tatimor;
4. Sekuestrimi i pasurisë.

**Nga auditimi u konstatua se,** dokumentacioni i vënë në dispozicion lidhur me hapat që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, janë njoftuar të gjithë bizneset debitorë për kalimin e afatit të pagesave të detyrimit për taksat dhe tarifatat vendore.

Pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet vendore, **nuk janë marrë masa të tjera** bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89,90,91,93. Përkatesisht, nuk janë dërguar shkresa bankave të nivelit të dytë për bllokimet e llogarive bankare të subjekteve debitorë, nuk janë dërguar kërkesa në DRT për vendosjen e barrës sigurose për mjetet dhe në ASHK për pasuritë e paluajtshme. Në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89,90,91,93.

**Titulli i gjetjes 10:** *Mbi nivelin e borxhit tatimor në Bashkinë Peqin dhe masat e marra për uljen e tij.*

**Situata:** Vlera e detyrimeve ndaj Bashkisë Peqin për taksat dhe tarifatat vendore, e krijuar vetëm gjatë vitit 2022 është 16,882,981 lekë, nga e cila vlera 9,008,131 lekë I përket detyrimeve nga debitorët private dhe 7,874,850 lekë detyrimeve nga debitorët e kategorisë familjare.

Vlera e detyrimeve progresive ndaj Bashkisë Peqin për taksat dhe tarifatat vendore, në datën 31.12.2022 është 30,568,308 lekë, nga e cila vlera prej 11,590,558 lekë është krijuar nga 238 debitorë privat, ndërsa vlera 18,977,750 lekë nga debitorët familjar (përfshirë edhe taksën e tokës bujqësore në vlerën 9,873,750 lekë nga 4 930 familjeve)

Vlera prej 30,568,308 lekë konsiderohet e ardhur e planifikuar, por e pa arkëtuar.

Për taksën e tokës bujqësore për vitin 2022 janë debitorë 4 930 familjeve me vlerë të detyrimit 9,873,750 lekë, ndërsa vlera progresive deri me 31.12.2022, që përbën të ardhura të munguara për Bashkinë Peqin është në vlerën 10,200,000 lekë.

Dokumentacioni i vënë në dispozicion lidhur me hapat që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, janë njoftuar të gjithë bizneset debitorë për kalimin e afatit të pagesave të detyrimit për taksat dhe tarifatat vendore.

Pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet vendore, **nuk janë marrë masa të tjera** bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89,90,91,93.

**Kriteri:** Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89,90,91,93.

**Ndikimi:** Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Peqin.

**Shkaku:** Mos zbatimi efektiv i kërkesave ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore nga debitorët.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Peqin, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën:

- 11,590,558 lekë për 238 biznese;

- 9,104,000 lekë nga taksat dhe tarifatat vendore për familjet;

- 10,200,000 lekë për taksën e tokës bujqësore;

a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c- Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Tatim Taksave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Sektorit të Tatim Taksave, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- Sektori i Tatim Taksave të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Peqin, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

### **Mbi realizimit e të ardhurave nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit**

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Peqin ushtron aktivitet bazuar në kuadrin ligjor si më poshtë:

- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”;
- VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”.

Nga auditimi i dokumentacionit që administron IMTV-ja në Bashkinë Peqin u konstatua se për vitin 2022 janë mbajtur në total 15 proces verbale për konstatimin e kundërvajtjes. Janë dhënë 15 masa për “Prishje të objekteve të kundërligjshëm” si dhe 15 masa “Dënim me gjobë”. Nuk ka paguar asnjë subjekt vullnetarisht me vlerë totale të gjobave prej 7,500,000 lekë të vendosura për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, paraqitur si në tabelën mëposhtë:

*Tabela nr.II.13: Gjobat e vendosura nga IMTV dhe të pa arkëtuara*

lekë

Nr.	Emër Mbiemër	Proces verbali (Nr. datë)	Penalite të pa arkëtuara
1	H.T.	Nr. 38, datë 15.03.2022	500,000
2	Xh.V.	Nr. 39, datë 15.03.2022	500,000
3	A.K.	Nr. 40, datë 15.03.2022	500,000
4	S.P.	Nr. 41, datë 28.04.2022	500,000
5	A.K.	Nr. 42, datë 26.04.2022	500,000
6	S.S.	Nr. 43, datë 10.05.2022	500,000

7	S.S.	Nr. 44, datë 10.05.2022	500,000
8	J.T.	Nr. 45, datë 20.07.2022	500,000
9	A.B.	Nr. 1, datë 27.07.2022	500,000
10	H.H.	Nr. 2, datë 07.09.2022	500,000
11	Q.M.	Nr. 3, datë 20.09.2022	500,000
12	Xh.K.	Nr. 4, datë 24.10.2022	500,000
13	Q.C.	Nr. 5, datë 24.10.2022	500,000
14	Q.M.	Nr. 6, datë 24.10.2022	500,000
15	R.K.	Nr. 7, datë 26.09.2022	500,000
	<b>Totali</b>		<b>7,500,000</b>

Burimi: Bashkia Peqin, IMTV

**Nga auditimi u konstatua se,** Drejtoria e IMTV nuk ka ndjekur hapat e nevojshëm për të dërguar në gjykatë vendimet për të nxjerrë Urdhrin e Ekzekutimit për të gjithë gjobat e vendosura të këtij viti, sipas kërkesave të Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 30, pika 4.

**Nga auditimi u konstatua se,** për vitin 2022 të ardhurat e munguara nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV janë në vlerën totale 7,500,000 lekë.

**Titulli i gjetjes 11:** Mos pagesë e gjobave të vendosura nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Bashkia Peqin.

**Situata:** Nga auditimi i dokumentacionit që administron IMTV-ja në Bashkinë Peqin u konstatua se për vitin 2022 janë mbajtur në total 15 proces verbale për konstatimin e kundërvajtjes. Janë dhënë 15 masa për “Prishje të objekteve të kundërligjshëm” si dhe 15 masa “Dënim me gjobë”. Nuk ka paguar asnjë subjekt vullnetarisht me vlerë totale të gjobave prej 7,500,000 lekë të vendosura për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, duke krijuar të ardhura të munguara në Bashkinë Peqin në vlerën totale 7,500,000 lekë.

**Kriteri:** Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme” i ndryshuar, neni 5.

Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 9, neni 22.

**Ndikimi:** Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Peqin nga mos pagesa e gjobave të vendosura nga IMTV.

**Shkaku:** Mos zbatim i legjislacionit nga IMTV për ndjekjen e hapave ligjorë për të bërë të mundur arkëtimin e gjobave.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Inspektorati i Mbrojtës Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekin me përpikmëri procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjobat e vendosura nga IMTV për vlerën totale 7,500,000 lekë. Gjithashtu, IMTV të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrit ligjor në fuqi.

**Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve**

Grupi i auditimit auditoi dokumentacionin lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për ushtrimin e aktivitetit në zbatim të legjislacionit në fuqi përkatësisht:

- Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në

ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4, neni 20/pika 2;

- VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, pika 2/9 “Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera”.

Referuar dokumentacionit të paraqitur rezulton se, në territorin e Bashkisë Peqin për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 7 subjekte të paraqitura në tabelën në vijim.

Tabela nr. II.14: Subjektet që ushtrojnë aktivitet në shitjen e lëndëve djegëse me pakicë.

lekë

Nr	Subjekti	NIPTI	Adresa	Autorizimi Bazë	Pagesa viti 2022	Debitor viti 2022
1	Shoq. “B.” SHPK	K.....B	Peqin		-	200,000
2	Shoq. “D.O.” SHPK	L.....G	Pajovë	07.10.2021-06.10.2022	46,660	153,340
3	Shoq. “J. P.” SHPK	K.....U	Përparim		-	200,000
4	Shoq. “K.” SHPK	J.....P	Karinë	11.10.2022-10.10.2023	44,450	155,550
5	Shoq. “S.G” SHPK	K.....V	Pajovë	17.12.2021-16.12.2023	200,000	0
6	Shoq. “O.” SHPK	J.....I	Përparim	10.06.2022-09.06.2023	111,667	88,333
7	Shoq. “O.” SHPK	J.....I	Përparim	10.06.2022-09.06.2027	111,667	88,333
<b>TOTAL</b>					<b>514,444</b>	<b>885,556</b>

Burimi: Bashkia Peqin, përpunoi grupi i auditimit

**Nga auditimi u konstatua se,** 2 subjekte (“B.” SHPK dhe “J. P.” SHPK) nuk janë pajisur me autorizim/licencë për ushtrimin e aktivitetit, që sjellin të ardhura të munguara në Bashkinë Peqin në vlerën 2\*200,000 lekë, në shumën 400,000 lekë. Subjekti “D.O.” SHPK, është pajisur me autorizim nga data 07.10.2021-06.10.2022, për periudhën 07.10.2022-31.12.2022 është i pajisur me autorizim duke sjellë të ardhura të munguara për 9 muaj e 6 ditë në vlerën 153,340 lekë. Subjekti “K.” SHPK, është pajisur me autorizim nga data 11.10.2022-10.10.2023, për periudhën 01.01.2022-10.10.2022 është i pajisur me autorizim duke sjellë të ardhura të munguara për 9 muaj e 10 ditë në vlerën 155,550 lekë. Subjekti “O.” SHPK për të dy pikat, është pajisur me autorizim nga data 10.06.2022-09.06.2023 dhe 10.06.2022-09.06.2027, për periudhën 01.01.2022-09.06.2022 të dy pikat janë të pajisura me autorizim duke sjellë të ardhura të munguara për 5 muaj e 9 ditë në vlerën 88,333 \* 2, në total 176,666 lekë. Ushtrimi i aktivitetit nga subjektet që tregtojnë lëndë djegëse të pajisur me autorizim/licencën përkatëse **ka sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Peqin për vitin 2022 në vlerën 885,556 lekë** dhe është në kundërshtim me përcaktimet ligjore, përkatësisht:

- Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4 “Ushtrimi i veprimtarive në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre bëhet vetëm nga persona juridikë, pasi të jenë pajisur paraprakisht me lejet dhe autorizimet përkatëse, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Në mungesë të këtyre lejeve dhe autorizimeve, veprimtaria e kryer quhet e paligjshme”, neni 15 “...Stacionet e shitjes së karburanteve lejohen të ushtrojnë veprimtarinë e

tyre vetëm pasi të jenë pajisur nga organi kompetent me autorizimin përkatës, sipas këtij ligji...”, neni 20-Autorizimet pika 2, “Autorizimet për personat juridikë, që ushtrojnë veprimtarinë e parashikuara në pikat "ç" dhe "d" të nenit 11<sup>8</sup>, jepen nga organi i pushtetit vendor për një periudhë **deri në 5 vjet me të drejtë përsëritjeje**”;

- VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, kreu II, pika 3 “*Dhënia e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, për veprimtarinë e tregtimit për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga organet e qeverisjes vendore*”.

Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave nuk ka informacion se kur kanë filluar aktivitetin subjektet që nuk janë të pajisur me autorizim/licencë për ushtrimin e aktivitetit.

**Titulli i gjetjes 12:** *Mbi pajisjen me autorizim për ushtrimin e aktivitetit të subjekteve që tregtojnë lëndë djegëse.*

**Situata:** Bashkia Peqin nga 7 subjekte që kanë aktivitet tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, 2 subjekte (“B.” SHPK dhe “J. P.” SHPK) nuk janë pajisur me autorizim/licencë për ushtrimin e aktivitetit, që sjellin të ardhura të munguara në Bashkinë Peqin në vlerën 400,000 lekë. Subjekti “D.O.” SHPK, është pajisur me autorizim nga data 07.10.2021-06.10.2022, për periudhën 07.10.2022-31.12.2022 është i pa pajisur me autorizim duke sjellë të ardhura të munguara për 9 muaj në vlerën 153,340 lekë. Subjekti “K.” SHPK, është pajisur me autorizim nga data 11.10.2022-10.10.2023, për periudhën 01.01.2022-10.10.2022 është i pa pajisur me autorizim duke sjellë të ardhura të munguara për 9 muaj në vlerën 155,550 lekë. Subjekti “O.” SHPK për të dy pikat e aktivitetit, është pajisur me autorizim nga data 10.06.2022-09.06.2023 dhe 10.06.2022-09.06.2027, për periudhën 01.01.2022-09.06.2022 të dy pikat janë të pa pajisura me autorizim duke sjellë të ardhura të munguara për 5 muaj në vlerën 176,666 lekë. Ushtrimi i aktivitetit nga subjektet që tregtojnë lëndë djegëse të pa pajisur me autorizim/licencën përkatëse ka sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Peqin për vitin 2022 në vlerën 885,556 lekë.

**Kriteri:** Ligji nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4, neni 15, neni 20. VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, kreu II, pika 3.

**Ndikimi:** Mos pagesa e detyrimeve për autorizimin ka sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Peqin për vitin 2021 në vlerën 1,200,000 lekë.

**Shkaku:** Mos zbatim i detyrimeve ligjore nga Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave për pajisjen me autorizim për ushtrimin e aktivitetit të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse.

**Rëndësia:** E lartë

---

<sup>8</sup>Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, neni 11-Personat juridikë, që i nënshtrohen këtij ligji, në përputhje me natyrën e veprimtarisë së ushtruar, klasifikohen si vijon: ç) stacionet e shitjes se karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete; d) njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë”.



**Rekomandim:** Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave të marrë masa që subjektet “B.” SHPK, “J. P.” SHPK, “K.” SHPK, “O.” SHPK, “D.O.” SHPK, “S.G” ShPK dhe “O.” SHPK të plotësojnë kriteret e nevojshme e më pas të pajisen me autorizimin përkatës për ushtrimin e aktivitetit duke paguar detyrimet ndaj Bashkisë Peqin me vlerë vjetore 200,000 lekë secili. Gjithashtu, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet me qëllim që të kryhen pagesat e plota brenda afateve.

**Konkluzion: të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë janë:**

- ◇ Nga taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet në vlerën 21,836,081 lekë;
- ◇ Nga familjet për taksat dhe tarifatat e tokës, ndërtesës, pastrimit, ndriçimit, etj., në vlerën 9,104,000 lekë;
- ◇ Nga bizneset debitore, në vlerën 11,590,558 lekë;
- ◇ Nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve në vlerën 885,556 lekë;
- ◇ Nga kontrata e qirasë në vlerën 116,100 lekë;
- ◇ Nga dhënia e sipërfaqeve të tokës me qira familjeve në vlerën 5,982,624 lekë;
- ◇ Nga Taksa mbi tokën bujqësore në vlerën 10,200,000 lekë;
- ◇ Nga gjoba të vendosura nga IMTV në vlerën totale 7,500,000 lekë.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

1. Z. L.T., me detyrë Kryetar i Bashkisë Peqin;
2. Z. K.L., me detyrë Drejtor i të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave
3. Z. D.M., me detyrë Kryeinspektor

**2.3 Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitin 2021.**

2.3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

2.3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

2.3.3. Opinioni mbi pasqyrat financiare.

**Pasqyrat Financiare të vitit 2022.**

- Për auditimin e Pasqyrave Financiare të vitit 2022 është marrë në shqyrtim dokumentacioni i mëposhtëm:
  - Pasqyrat financiare të vitit 2022;
  - Centralizatori/Libri i madh;
  - Ditari i Bankës;
  - Ditari i Arkës;
  - Ditari i Magazinës;
  - Ditari i Pagesave
  - Ditari i Veprimeve të ndryshme
  - Aktrakordimet me Degën e Thesarit Peqin.
  - Inventarët etj.
- **Kriteret e vlerësimit:**
  - Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
  - Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i shfuqizuar;
  - Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar;

- Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme".
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

**Nga auditimi ka rezultuar se:**

- Bashkia Peqin ka përgatitur dhe raportuar Pasqyrat Financiare të vitit 2022, mbështetur në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme". Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Peqin, si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestime.
- **Pjesë përbërëse të Pasqyrave Financiare të vitit 2022 janë:**
  - Pasqyra e pozicionit financiar (F1);
  - Pasyra e performancës financiare (F2);
  - Pasqyra e flukseve monetare (F3);
  - Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4);
  - Pyetësor dhe shënimet shpjeguese mbi pasyrat financiare (F5);

*Pasqyrat statistikore:*

- Investimet dhe burimi i financimit (F6);
- Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, kosto historike (F7.a);
- Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, vlera neto (F7.b);
- Numri i punonjësve dhe fondi i pagave (F8);
- Gjithashtu, Pasqyrat Financiare për nga forma janë përgatitur dhe janë plotësuar sipas kërkesave të udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, ku janë dhënë informacion mbi:
  - Emrin e njesisë ekonomike raportuese, Bashkia Peqin me NIPT K.....D;
  - Nëse pasqyrat financiare mbulojnë një njësi ekonomike raportuese individuale apo grup njësisish;
  - Periudhën kontabël të mbuluar nga pasqyrat financiare, nga 01.01.2022-31.12.2022;
  - Monedhën e paraqitjes së pasqyrave financiare, në lekë
  - Data e hartimit të Pasqyrave Financiare, 28.02.2023.
  - Përgatitur nga z.D.M.
  - Pasqyrat Financiare janë dërguar në Degën e Thesarit Peqin me shkresën nr.369, datë 28.02.2023 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Peqin z. L.T. .
  - Pjesë përbërëse e dokumentacionit mbi pasqyrat financiare dhe raportimin financiar janë Aktrakordimet mbi shpenzimet dhe të ardhurat me Degën e Thesarit Peqin të konfirmuara dhe nënshkruara nga NZ dhe NA i Bashkisë Peqin, kontabilisti dhe Përgjegjësi i Degës së Thesarit Peqin.

**Pasqyrat Financiare viti 2022 (Bashkia Peqin, Aparati).**

Paraqitja dhe raportimi i tyre është kryer në përputhje me Udhëzimin nr.8, datë 03.09.2018, Kapitulli V "Procedurat e paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore".

**Tabela nr.1 Aktivi i Bilancit Kontabël 2022 Bashkia Peqin.**

Nr. Reshti	Referenca e Logarive	EMERTIMI	Ushtrimi I Mbyllur	Ushtrimi Paraardhes.
1	A	<b>A K T I V E T</b>	<b>3 177 785 094</b>	<b>3 132 499 635</b>
2		I.Aktivet Afat shkurtra	229 156 612	199 388 829
3		I.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre	38 982 267	38 580 671

4	531	Mjrete monetare ne Arke		
5	512,56	Mjrete monetare ne Banke		
6	520	Disponibilitete ne Thesar	35 341 067	35 186 071
7	50	Letra me vlere		
8	532	Vlera te tjera	3 641 200	3 394 600
9	54	Akreditiva dhe paradhenie		
10	59	Provigjone zhvlersimi letra me vlere (-)		
11		<b>2.Gjendje Inventari qarkullues</b>	<b>20 751 477</b>	<b>14 992 542</b>
12	31	Materiale	3 729 481	1 619 076
13	32	Inventar I imet	16 853 056	13 359 131
14	33	Prodhim nre proces		
15	34	Produkte	168 940	14 335
16	35	Mallra		
17	36	Kafshe ne rritje e majmeri		
18	37	Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve		
19	38	Diferenca nga cmimet e magazinimit		
20	39	Provigjone perzhvlersimin e inventarit (-)		
21		<b>3.Llogari te Arketushme</b>	<b>169 422 868</b>	<b>145 815 616</b>
22	411	Kliente e llogari te ngjashme		
23	423,429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba		
24	431	Tatim e Taksa		
25	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
26	433	Fatkeqsi natyrore qe mbulohe nga shteti		
27	435	Sigurime Shoqerore		
28	436	Sigurime Shendetsores		
29	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
30	44	Institucione te tjera publike		
31	465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere		
32	468	Debitore te ndryshem	31 925 168	25 458 497
33	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	137 497 700	120 357 119
34	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
35	49	Shuma te parashikuara per xhvlersim(-)		
36		<b>4.Te tjera aktive afatshkurtra</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
37	409	Parapagime		
38	473	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin		
39	477	Diferenca konvertimi aktive		
40	481	Shpenzime per t'u shperndare ne disa ushtrime		
41	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme		
42		<b>II.Aktivet Afat gjata</b>	<b>2 948 628 482</b>	<b>2 933 110 806</b>
43		<b>1.Aktive Afatgjata jo materiale</b>	<b>9 980 192</b>	<b>11 741 402</b>
44	201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
45	202	Studime dhe kerkime	9 980 192	11 741 402
46	203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme		
47		<b>2.Aktive Afatgjata materiale</b>	<b>2 476 324 343</b>	<b>2 575 087 597</b>
48	210	Toka, T,roje, Terene	5 612 083	5 612 083
		Pyje, Plantacione		
49	211		10 562 345	11 118 257
50	212	Ndertesa e Konstruksione	432 589 552	454 599 528
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	2 002 064 730	2 077 656 062
52	214	Iinstalime teknike, makineri e paisje	3 822 202	2 169 880
53	215	Mjete Transporti	6 570 311	8 212 888
54	216	Rezerva Shteterore		
55	217	Kafshe pune e prodhimi		
56	218	Inventar ekonomik	15 103 120	15 718 899
57	24	Aktive afatgjata te demtuara		
58	28	Caktime te Aktiveve Afatgjata		
59		<b>3.Aktive Afatgjata Financiare</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

60		Huadhenie e Nenhuadhenie		
61		Pjesmarrje ne kapitalin e vet		
62		<b>4.Investime</b>	<b>462 323 947</b>	<b>346 281 807</b>
63	230	Per Aktive Afatgjata jo materiale		
64	231	Per Aktive Afatgjata materiale	462 323 947	346 281 807

**Burimi: Sektori i Financës.**

**Nga auditimi i pasqyrave financiare individuale rezultoi:**

**1. Pasqyra e pozicionit financiar (F1)**

- **Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet= 2 985 071 722 lekë.**
- Aktivet 3,177,785,095 lekë
- Pasivet 191,682,762 lekë
- Aktivet neto 2 985 071,722 lekë.

**I.Aktivet Afatshkurtra**

Aktivet afatshkurtra më datë 31.12.2021 paraqiten në vlerën **229,156,612 lekë** dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekujalentet e tyre” në shumën **38,982,267 lekë**;
- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën **20,751,477 lekë**;
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën **169,422,868 lekë**.
- Llogaria e Klasës 4 “Te tjera aktive afatshkurtra” në shumën **0 lekë**.

**Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre”,** përbëhet nga:

-Gjendja e llogarisë nr.520 “Disponibilitete në Thesar”, sipas mbylljes së bilancit të vitit 2022 është në vlerën prej 35,341,067 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën prej 35,186,071 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën V “Teprica në fillim të vitit ushtrimor” në vlerën 35,186,071 lekë dhe rubrikën VI “Teprica e Likuiditeve në fund të vitit ushtrimor” në vlerën 35,341,067 lekë. (sipas formatit F3 “Pasqyra e flukseve monetare”)

Rakordimi i llogarive me degën e thesarit, llogaria nr.520 “Disponibilitete në Thesar”, llogaria nr.466 “Mjete në ruajtje” dhe llogaritë e të ardhurave

**Viti 2022**

Llogaria nr.520 “Disponibilitete në Thesar”, në pasqyrat financiare të vitit 2022 paraqitet në vlerën prej 35,341,067 lekë. Referuar aktit të rakordimit me Degën e Thesarit është e analizuar si më poshtë:

**Tabela nr.2 Testimi i llogarisë nr.520 “Disponibilitete në Thesar” për vitin ushtrimor 2022**

<b>I.Të trashëguara nga viti 2022</b>	<b>Lekë</b>
Sipas aktit të rakordimit për shumën. Nga të cilat:	
<i>Granti i trashëguar</i>	7 782 795
<i>Të ardhura të trashëguara</i>	6 967 224
<i>Mjete në ruajtje të trashëguara ( llog. 466)</i>	20 436 052
<i>Fonde specifike</i>	
<i>Jashte limiti</i>	
<b>Totali</b>	<b>35 186 071</b>
<b>II.Të hyrat (Shtesat debitore) gjatë vitit</b>	<b>Lekë</b>
<i>Granti I vitit</i>	256 400 192
<i>Të ardhurat e vitit</i>	62 930 136
<i>Të hyra nga mjetet në ruajtje</i>	6 803 375
<i>Granti I kushtezuar</i>	547 049 941
<i>FZHU</i>	
<i>Jashte limiti</i>	
<b>Tot.</b>	<b>973 183 644</b>
<b>Totali I të ardhurave (I+II)</b>	<b>908 369 715</b>

<b>III.Lëvizjet kreditore të llogarisë 520</b>	Lekë
<i>Paga sigurime (600+601)</i>	212 926 893
<i>Shpenzime operative (602)</i>	75 862 015
<i>Subvencione (603)</i>	
<i>Transferime korente të brendshme (604)</i>	408 162 635
<i>Transferime korente me jashtë (605)</i>	
<i>Transferime për buxhetet familjare dhe individë (606)</i>	2 262 758
<i>Kredia (BKT) + Interesa për huamarje (651)</i>	
<i>Investime (231)</i>	150 045 611
<i>Të dala nga mjetet në ruajtje (466)</i>	3 948 923
<i>Transferime korente te brendshme + transfertat buxhetin e vet</i>	
<b>Totali</b>	<b>853 208 835</b>
<b>Gjendja debitoare (Saldi) (I+II) – III =</b>	<b>55 160 880</b>

**Tabela e përpunuar nga audituesi i Klsh-së**

Për vitin 2022 nga verifikimi për cdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës së shpenzimeve e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit duke analizuar dokumentat e nxjerrjes së llogarive nga thesari për cdo muaj, për shumat e llogarive në cdo muaj dhe në total për vitin ushtrimor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i vitit 2022 i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (celje) dhe përdorimi i fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

**Tabela nr.3: Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:**

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 2022-2021
31	Materiale	3 729 481	1 619 076	2 110 405
32	Objekte inventari	16 853 056	13 359 131	3 493 925
33	Prodhime, punime e shërbime ne proces			
34	Produkte	168 940	14 335	154 605
35	Mallra			
36	Gjë e gjalle ne rritje e majmeri			
37	Gjendje te pambritura ose pranë të treteve			
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit			
39	Shuma te parashikuara për zhvlerësim te inventarit(-)			
	<b>Totali</b>	<b>20 751 477</b>	<b>14 992 542</b>	<b>5 758 935</b>

**Përpunuar nga grupi i Klsh-së.**

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Peqin në 31.12.2022 paraqitet në vlerën 20 751 477 lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 3 729 481 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Objekte inventari” në vlerën 16 853 056 lekë gjithashtu dhe nga llogaria kontabel 34 “Produkte” ne vleren 168 940 leke .

- Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën (5 758 935) lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën (5 758 935) lekë.
- **Llogaria 327 “Objekte inventari”**, ka vlerën 16,853,056 lekë dhe përputhet me rezultatin e inventarizimit vjetor.

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Titullari i Bashkisë Peqin ka nxjerrë Urdhrin e inventarizimit nr.205 datë 14.10.2022, “Për ngritjen e komisionit te inventarizimit, komisionit te vleresimit dhe komisionit te nxjerrjes jashtë përdorimit të pasurisë së bashkisë dhe Njësave Administrative për vitin 2022, ku janë përcaktuar grupet për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve. Nga inventarizimi nuk kanë rezultuar diferenca.

-Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

**Tabela nr.4: Llogaritë Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme”&“Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:**

Llogaritë kontabël	Emertimi i llogarive	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 2022-2021
	<b>Llogari të arkëtueshme</b>			
411	Klientë e llogari te ngjashme	0	0	
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	0	0	
431	Tatime e taksa	0	0	
432	Tatime mbledhur nga shteti për llog.Pushtetit Lokal	0	0	
433	Shpenzime fatkeqësi natyrore qe mbulon shteti	0	0	
435	Sigurime Shoqërore	0	0	
436	Sigurime Shëndetësore	0	0	
437,438	Organizma te tjerë shoqërore	0	0	
44	Institucione te tjera publike	0	0	
465	Efekte per t'u arkëtuar nga shitja letra me vlere vendosjes	0	0	
468	Debitorë te ndryshëm	31,925,168	25,458,497	6 466 671
4342	Te tjera operacione me shtetin	137,497,700	120,357,119	17 140 581
45	Marrëdhënie me instit. brenda dhe jashtë sistemit	0	0	
49	Shuma te parashikuara per zhvleresim(-)	0	0	
	<b>Totali</b>	<b>169,422,868</b>	<b>145,815,616</b>	<b>23,607,252</b>
	<b>Të tjera aktive afatshkurtra</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	
409	Furnitore(Debitorë),parapagime pagesa pjesore	0	0	
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	0	0	
477	Diferenca konvertimi aktive	0	0	
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	0	0	
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	0		
	<b>Totali</b>	<b>0</b>		

**Përpunuar nga grupi i Klsh.**

**Tabela nr.5: Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”.**

Bashkia dhe NjA	Pershkrimi	Nr. Subjekte Fizik/Juridik dhe gjoba Inspektoriati	Gjendja 31.12.2022
Bashkia Peqin	Gjendja e debitoreve per taksat dhe tarifat vendore per bizneset	238	11 590 558
	Gjendja e debitoreve per taksat dhe tarifat vendore per familjaret	2845	9 104 000
	Gjendja e debitoreve per taksat dhe tarifat vendore per token bujgesore	5100	10 200 000
	Mase shperblimi demi nga KLSH per subjektin L. K. per objektin “Rikonstruksion rruges Ymer Beheluli”	1	1 030 610
	<b>Shuma</b>	<b>8183</b>	<b>31 925 168</b>

**Të dhënat të përpunuar nga audituesi i Klsh-së.**

Llogaria 468 në fund të vitit 2022 është në vlerën 31 925 168 lekë, e detajuar në tabelën e aneksit të materialit.(Pasqyruar në Kapitullin, Aneksi 1 – Pasqyrat Financiare).

➤ **Faturat e palikuiduara brenda afatit 30 ditor.**

Nga auditimi u konstatua se disa fatura janë likuiduar jashtë afatit 30 ditor.

**Tabela e fatuara të likuiduara jashtë afatit 30 ditor.**

Nr /date fature	Pershkrimi	Operatori	Shuma	Likuiduar nr/date urdher shpenzimi	Shuma e urdher shpenzimit
1 364/11.11.2021	Blerje shtypshkrime	Shtepia letrave me vlere	90 000	180/30.03.2022	90 000

2	05/02.04.2021	Blerje korrese bari	M.S.	93 000	265/12.04.2022	93 000
3	18/10.02.2022	Blerje shtypshkrime	A. 2005	115 200	307/09.05.2022	115 200
4	19/07.09.2021	Sistemim I terreneve sportive	LL. sh.p.k	714 000	99/17.02.2022	714 000
5	08/22.08.2022	Sherbim per ritarim mjete	B.E.	88 000	702/13.12.2022	88 000
6	749/04.04.2022	Blerje kompiuterash	A.C.	804 000	725/15.12.2022	804 000

**Përpunuar nga grupi i Klsh.**

**Titulli gjetjes:** Fatura të pa likuiduara brenda afatit 30 ditor përgjatë vitit 2022, duke krijuar në fund të vitit buxhetor detyrime të prapambetura, si dhe mosrespektimi i rradhës në likuidimin e tyre.

**Situata:** Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit **30 ditor** të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqëruar në Degën e Thesarit Peqin, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për periudhën 2022, ky afat nuk është respektuar në 68 raste për vlerën 62,523,048 lekë.

-Sa i përket likuidimit të detyrimeve të prapambetura për investime, mallra dhe shërbime, konstatohet se nuk respektohet rradha e likuidimit të tyre, pra fatura e parë likuidohet më parë, ilustruar me disa raste.

**Kriteri:** Pikat 8 dhe 184 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

**Shkaku:** Likuidim me vonesë i faturave në tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh dhe mos likuidimi i vlerës së plotë të faturës, në pjesën më të madhe të rasteve ka rezultuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh, mosrealizim të ardhurash, si dhe mosrespektim i rradhës në likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

**Efekti:** Mos likuidim në kohë i shpenzimeve sjell akumulim të borxhit të institucionit për fatura të palikuiduara.

**Rëndësia:** I Lartë

**Rekomandimi:** Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, të marrë masa për likuidimin në kohë të të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, duke paraqitur pranë degës së thesarit, të gjithë dokumentacionin përkatës brenda afatit 30 ditor nga momenti i prerjes së faturës.

-Planifikimin e grafikut të likuidimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

Nga grupi i auditimit u konstatua se llog.486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” **është në vlerën 0**, ku në rakordimet me thesarin rezulton se llog.486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është në vlerën 104,162,356 lekë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga subjekti vihet re se në dokumentat, letrat e veta llogaria nr.486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është në vlerën 137,497,700 lekë. *Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin 68/2012 “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 34, pika 1, neni 40 pika 3. urdhërit nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” dhe Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.8 “Të ardhurat”, pika 8 e standartit ku përcaktohet njohja fillestare e të ardhurës, Udhëzimi i MFE-së, nr.2 datë, 06.02.2012, pika101, Kodi i Punës, neni 95, neni 101 pika 283, neni 119 pika 2.*

U konstatua se në Bashkinë Peqin ndër arsyt e rritjes së detyrimeve nga viti në vit ka ardhur dhe si pasojë e mos shlyerjes së pagave të punonjësve. Për të cilat vlera totale është 36,552,054 lekë, nga ku rakordimi me thesarin për vitin 2022 është në vlerën 22,677,047 lekë.

<b>Titulli Gjetjes:</b>	Mospasqyrim i saktë në kontabilitetin e institucionit të llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”
<b>Situata:</b>	Nga grupi i auditimit u konstatua se llog. 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është në vlerën 0, ku në rakordimet me thesarin rezulton se llog.486“Shpenzime të periudhave të ardhshme” është në vlerën 104,162,356 lekë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga subjekti vihet re se në dokumentat, letrat e veta llogaria nr.486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është në vlerën 137,497,700 lekë.
<b>Kriteri:</b>	Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin 68/2012 “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 34, pika 1, neni 40 pika 3. urdhërit nr.64 datë 22.07.2014 “ Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” dhe Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.8 “Të ardhurat”, pika 8 e standartit ku përcaktohet njohja fillestare e të ardhurës.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mosparaqitje e saktë e llogarisë së shpenzimeve të prapambetura.
<b>Shkaku:</b>	Përgjegjësi e strukturave përgjegjëse.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	Drejtoria e Financës së Bashksë Peqin të marrë masa për sistemimin e llogarisë 486, e cila është njohur me vlerën 0 në pasqyrat financiare, si dhe kryerja e rakordimit në mënyrë të saktë me thesarin, për vlerën 137,497,700 lekë.

<b>Titulli Gjetjes:</b>	Mos shlyerje e pagave të punonjësve duke sjell mospasqyrim të saktë në kontabilitetin e institucionit të llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”.
<b>Situata:</b>	U konstatua se në Bashkinë Peqin ndër arsyet e rritjes së detyrimeve nga viti ne vit ka ardhur dhe si pasoje e mos shlyerjes së pagave të punonjësve. Për të cilat vlera totale është 36,552,054 lekë, nga ku rakordimi me thesarin për vitin 2022 është në vlerën 22,677,047 lekë.
<b>Kriteri:</b>	Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin 68/2012 “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 34, pika 1, neni 40 pika 3, Udhëzimi i MFE-së, nr.2 datë, 06.02.2012, pika101, Kodi i Punës, neni 95, neni 101 pika 283, neni 119 pika 2.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mosparaqitje e saktë e llogarisë së shpenzimeve të prapambetura.
<b>Shkaku:</b>	Përgjegjësi e strukturave përgjegjëse.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandimi:</b>	Kryetari i Bashkisë Peqin dhe Drejtoria e Financës së Bashksë Peqin të marrin masa të menjëherëshme për shlyerjen e pagesave të punonjësve, duke respektuar të drejtën themelore të njeriut, aspektin social dhe shoqëror.

Shuma totale e debitorëve të Bashkisë Peqin në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën **192,713,372 lekë**. Duke përfshirë në këtë shumë detyrimet e prapambetura në vlerën 137,497,700 lekë + garancitë e punimeve në vlerën 137,497,700 lekë + debitorët në shumën 137,497,700 lekë. Vlera e kësaj llogarie duhet të përfaqësojë detyrime për shpenzime të kryera, por jo të financuara në vitin ushtrimor. Tabela e detajuar e shpenzimeve përkatëse, janë të paraqitura me detaje në anekset e materialit.(Pasqyruar në Kapitullin, Aneksi 2 – Pasqyrat Financiare).



## **AKTIVET AFATGJATA MATERIALE (AAM)**

**Llogaritë e Klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale”,** AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2022, vlera kontabël neto paraqitet në shumën 2,476,324,343 lekë. Në vitin paraardhës 2021, vlera kontabël neto e AAM-ve paraqitet në shumën 2,575,087,597 lekë, me një zbritje të AAM-ve në shumën 98,763,254 lekë.

**Tabela nr.7 :Llogaria e Klasës 21.**

Llog.Kontabel	Përshkrimi i llogarive	Çelje 2022	Shtesa 2022	Pakësime 2022	Gjendje në fund
	<b>AAGJM</b>	<b>2 575 087 597</b>	<b>33 734 263</b>	<b>-132 497 517</b>	<b>2 476 324 343</b>
210	Toka ,troje, Terrene	5 612 083			5 612 083
211	Pyje, Kullota Plantacione	11 118 257		-555 912	11 118 257
212	Ndërtesa e Konstruksione	454 599 528	720 000	-22 729 976	454 599 528
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	2 077 656 062	28 291 471	-103 882 803	2 077 656 062
214	Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune	2 169 880	2 194 792	-542 470	2 169 880
215	Mjete transporti	8 212 888		-1 642 577	8 212 888
216	Rezerva shtetërore	0			0
217	Kafshe pune e prodhimi	0			0
218	Inventar ekonomik	15 718 899	2 528 000	-3 143 779	15 718 899
<b>219</b>	<b>Amortizimi i AAGJM (-)</b>	<b>789 951 768</b>	<b>132 497 517</b>	<b>-</b>	<b>922 449 285</b>

*Burimi:Sektori i financës.*

Ndërsa sipas formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbylljen e vitit ushtrimor 2022 në vlerën 3,398,773,628 lekë dhe në fund të vitit ushtrimor 2021 në vlerën 3,365,039,365 lekë. Llogaritë do të analizohen si më poshtë:

**-Llogaria nr.210 “Toka, troje, terrene”** paraqitet me vlerë neto 5,612,083 lekë, në vitet ushtrimore 2022 dhe në vitin 2021 në vlerën neto 5,612,083 lekë, pra nuk ka pësuar ndryshime.

**-Llogaria nr.211 “Pyje, Kullota, Plantacione”** paraqitet me vlerë neto 11,118,257 lekë, në vitet ushtrimore 2021 dhe ne 2022 në vlerën neto 10,562,345 lekë, ka pesuar ulje vlera per shkak te amortizimit.

Nga auditimi i llogarive më sipër konstaohet se është përgatitur regjistri i pronave si dhe është bërë regjistrimi i disa aktiveve në pronësi të Bashkisë Peqin.

**-Llogaria nr.212 “Ndërtesa dhe Konstruksione”,** në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto 432,589,552 lekë dhe në fund të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën prej 454,599,528 lekë. Gjatë vitit ushtrimor 2022 ka pasur futje të reja gjithashtu dhe amortizimi vjetor , pra vlera në fund të vitit ushtrimor vjen në ulje.

**Tabela nr.8: Përmbledhëse e llogarisë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione”(Vlera Historike)**

Emertimi	Llog.212	
	2022	
	Nr. Aktiveve	Vlera
Bashkia Peqin	11	224 796 316
Njesia Gjocaj	7	158,319,931
Njesia Pajove	15	110 674 345
Njesia Sheze	9	29 700 334
Njesia Karine	12	41 547 728
Njesia Perparim	11	76 516 463
<b>Shuma</b>	<b>65</b>	<b>641 555 117</b>

Përpunuar nga grupi i K1sh-së.

Analitiku i llogarisë nr.212 “Ndërtesa dhe Konstruksiione” përbëhet nga 65 ndërtesa dhe konstruksiione, ku për Bashkinë Peqin janë 11 në vlerën 224 796 316 lekë, për NJA Gjocaj janë 7 aktive në vlerën 158319931 lekë, për NJA Pajove 15 aktive në vlerën 110674345 lekë, NJA Sheze 9 aktive në vlerën 29700334lekë dhe NJA Karine 12 aktive me vlerë 41547728 NJA Perparim 11 aktive në vlerën prej 76516463 lekë.

Për këto aktive ndodhet një regjistër kontabël ku të specifikohen të dhënat për secilin aktiv në përputhje me Udhëzimin nr.30,datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”,pika 26 ku citohet:“Cdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Rregjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar”, pika 30 ku citohet: “Formati i rregjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë rregjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Analitiku i llogarisë nr.212 “Ndërtesa dhe Konstruksiione” janë të paraqitura me detaje në anekset e materialit.(Pasqyruar në Kapitullin, Aneksi 3 – Pasqyrat Financiare).

**-Llogaria nr.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”**, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto 2,002,064,730 lekë dhe në fund të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën neto prej 2,077,656,062 lekë. Referuar formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike), në fund të vitit 2021 paraqitet në koston historike prej 2,609,976,758 lekë, gjendje per vitin 2022 është shtuar me vlerën 28,291,471 lekë në mbyllje të vitit 2022 gjendja është 2,638,268,229.

**Tabela nr.10: Përmbledhëse e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”(Vlera Historike)**

Emertimi	llog.213	
	2020 dhe 2021	
	Nr. Aktiveve	Vlera
Bashkia Peqin	45	1711561429
Njesia Gjocaj	14	228,288,165
Njesia Pajove	20	252263529
Njesia Sheze	15	91084937
Njesia Karine	18	105904450
Njesia Perparim	23	249165719
<b>Shuma</b>	<b>135</b>	<b>2638268229</b>

**Tabela përpunuar nga grupi i auditimit.**

Analitiku i llogarisë nr.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” përbëhet nga 135objekte, në vlerën totale 2,638,268,229 ku për Bashkinë Peqin janë 45 në vlerën 1,711,561,429 lekë, për NJA Gjocaj janë 14 objekte në vlerën 228,288,165 lekë, për NJA Pajove 20 objekte në vlerën 252,263,529 lekë, NJA Sheze 15 objekte në vlerën 91,084,937 lekë dhe NJA Karine 18 objekte në vlerën prej 105,904,450 lekë, NJA Përparim 23 objekte në vlerën 249,165,719 lekë. Për këto aktive ka një regjistër kontabël ku të specifikohen të dhënat për secilin aktiv në përputhje me Udhëzimin nr.30,datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”,pika 26 ku citohet:“Cdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Rregjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar”, pika 30 ku citohet: “Formati i rregjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si

dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë rregjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Tabela analitike e llogarisë nr.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” e paraqitur me detaje në anekset e materialit.(Pasqyruar në Kapitullin, Aneksi 4 – Pasqyrat Financiare).

- **Llogaria nr.214** “Instalime teknike,makineri,paisje,vegla pune”, në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto 3,822,202 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën neto 2,169,880 lekë. Ndërsa referuar formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, në fund të vitit 2021 paraqitet në koston historike prej 21,548,360 lekë dhe në fund të vitit 2022 në vlerën 23,743,152 lekë.

-**Llogaria nr.215 “Mjete transporti”**, në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto 8,212,888 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën neto 6,570,311 lekë. Ndërsa referuar formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, në fund të vitit 2021 paraqitet në koston historike prej 20,203,600 lekë dhe në fund të vitit 2022 në vlerën 20,203,600 lekë.

**Tabela nr.12: Analitiku i llogarisë nr.215 “Mjete transporti”**

Nr	Ilog	Përshkrimi	Viti 2020	Shtesa (Blerje)	Pakesime	Viti 2021
1	215	Benx"Avangart ,,	2040000	-	0	2040000
2	215	Mercedes benz E 220	2484000	-	0	2484000
3	215	Makine Benz	1510800	-	0	1510800
4	215	Kamion me vinç	2400000	-	0	2400000
5	215	Fadrom cot 4280	3600000	-	0	3600000
6	215	BMW x 6	3360000		0	3360000
7	215	Fadrom cot 4280	2308800	-	0	2308800
8	215	Zjarrfikësja	2500000	-	0	2500000
<b>Shuma Bashkia Peqin</b>			<b>20,203,600</b>			<b>20,203,600</b>
<b>Total 215</b>			<b>20,203,600</b>			<b>20,203,600</b>

*Burimi: Sektori i Financës.*

- **Llogaria nr.218 “Inventar ekonomik”**, në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto 15,103,120 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën neto 15,718,899 lekë. Ndërsa referuar formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, në fund të vitit 2021 paraqitet në koston historike prej 52,934,570 lekë dhe në fund të vitit 2022 në vlerën 55,462,570 lekë.

- **Gjendja e llogarisë nr.219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM:** Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Peqin në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën (928,675,282) lekë.

**Tabela nr.13: Pasqyra statistikore nr. 7.b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerën neto të tyre”**

Nr. Reference	Teprica Neto	Shtesat gjate vitit		Pakësimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
		Kosto	Amortizim	Kosto	Amortizim	Kosto	Amortizim	Teprica
Llogarie		Historike		Historike		Historike	Akumuluar	Neto

B	3	4	5	6	7	8	9	10
20	11 741 402	0	1761210			16 206 189	6,225,997	9,980,192
201								
202	11 741 402	0	1761210			16,206,189	6,225,997	9,980,192
203						0	0	0
<b>21- 28</b>	<b>2 575 087 597</b>	<b>33734263</b>	<b>132,497,517</b>			<b>3,398,773,628</b>	<b>922,449,285</b>	<b>2,476,324,343</b>
210	5 612 083					5,612,083	0	5,612,083
211	11 118 257		555,912			13,928,877	3,366,532	10,562,345
212	454 599 528	720000	22,729,976			641,555,117	208,965,565	432,589,552
213	2 077 656 062	28291471	103,882,803			2,638,268,229	636,203,499	2,002,064,730
214	2 169 880	2194792	542,470			23,743,152	19,920,950	3,822,202
215	8 212 888		1,642,577			20,203,600	13,633,289	6,570,311
216	0					0	0	0
217	0					0	0	0
218	15 718 899		3,143,779			55,462,570	40,359,450	15,103,120
24	0					0	0	0
28								
Totali	2,586,828,999	33,734,263	134,258,727	0	0	3,414,979,817	928,675,282	2,486,304,535

**Burimi: Sektori i Financës.**

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë sipas normave të amortizimit sipas llojit të aktivitetit të përcaktuar në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 36.

Përlllogaritja është bërë mbi vlerën neto në celje të periudhës ushtrimore për cdo grup aktivesh. Referuar tabelës formati 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata, vlera neto”, totali i amortizimit për vitin 2022 për klasat e aktiveve është përlllogaritur në vlerën prej (922,449,285) lekë, duke debituar llogarinë nr.1013 “Nga konsumi i AAGJ” (formati 4 “Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto”), në kredi të llogarive nr.2191 “, Pyje ,Kullota Plantacione” ne vleren 3,366,532 lekë,llog. nr.2192 “Amortizimi ndërtesa dhe konstruksione” në vlerën 208,965,565 lekë, llogarisë nr.213 “Rruge , rrjete , vepra ujore” në vlerën 636,203,499 lekë, llogarisë nr.214 “Amortizim makineri dhe paisje” në vlerën 19,920,950 lekë, llogarisë nr.215 “Amortizim mjete transporti” në vlerën 13,633,289 lekë, llogarisë nr.2198 “Amortizim inventar ekonomik” në vlerën 40,359,450 lekë.

**-Inventarizimi i aktiveve për vitin ushtrimore 2022, Bashkia Peqin.**

Në bazë të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve në fund të vitin 2022 për Bashkinë Peqin dhe Njësitë Administrative.

**Për vitin 2022**

Është kryer inventarizimi i aktiveve afatshkurtra, bazuar në urdhërat e Kryetarit të Bashkisë Peqin nr.205 datë 14.10.2022, “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit, komisionit të vlerësimit dhe komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit të pasurisë së bashkisë dhe Njësive Administrative për vitin 2022. Nga Procesi i kryerjes së inventarizimit nuk ka patur mungesa apo teprica si dhe materiale për nxjerrje jashtë përdorimit.

➤ **AKTIVET AFATGJATA FINANCIARE**

**Gjendja e llogarisë nr.231 “Investime në proces”**

Gjendja e llogarisë nr.231 “Shpenzime për rritjen e Aktiveve Afatgjata të Trupëzuara” në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën prej 346,281,807 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën prej 462,323,947 lekë.

Sipas analitikëve të paraqitur nga Drejtori e Ekonomisë për vitin 2021 paraqiten 21 Investime në proces,.

**Tabela nr.14: e Investimeve llog. 230&231**

Investime 230 & 231			
Kodi projektit	Operatori	Objekti	Shpenzime per vitin 2021
19AG601	P.V.	Reabilitim I stacionit te pompave Peqin	12 816 995
19AG602	E. M , N. Studio	Mbikqyrje" Reabilitim stacionit te pompave Peqin"	700 000
19AF803	B. B	Ndertim ujesjellesit Gjocaj, Celhakaj dhe Hosmashaj	15 000 000
19AF804	Arena Mk	Mbikqyrje objektit "Ndertim ujesjellesit Gjocaj, Celhakaj dhe Hosmashaj"	200 000
19AF809	B. B	Rikonstruksion sektori I depove Peqin	31 896 815
19AF810	N. Studio	Mbikqyrje punimesh " Rikonstruksion sektori I depove Peqin"	308 280
19AF807	B. B	Ndertim rrjeti ujesjellesi fshatin Bicaj dhe Caushaj	57 415 500
19AF808	Ersi M	Mbikqyrje " Ndertim rrjeti ujesjellesi fshatin Bicaj dhe Caushaj"	450 000
18BQ523	B. B	Ndertim I kanalizimeve te ujerave te zeza te qytetit Peqin	12 054 284
18BQ524	M.Ch.	Mbikqyrje" Ndertim I kanalizimeve te ujerave te zeza te qytetit Peqin"	227 190
1340062	2ED	Mbikqyrje objektit Ndertim dhe sistemim me gabion I peroit teRrushtes Nj.Adm.Karine	471 585
1340062	G&L sh.p.k	Kolaudim Rik godine banimi I-kateshe per familje ne nevoje	6 960
1340062	N. M.	Mbikqyrje objektit " Rikonstruksion godine banimi I-kateshe per familjet ne nevoje	148 802
18BD034	P.V.	Rikostruksion shkolles Mustafa Kemal Ataturku	52 799 227
18BQ625	B. B	Transformimi I stacionit te pompave Peqin	23 658 728
19AG601	P.V.	Reabilitim I stacionit te pompave Peqin	59 632 837
M112756	P.V.	Rik. I terr. te jashtme sportive ne shkollen Demir Godelli	3 032 370
19AF803	B. B	Ndertim I ujesjellesit Gjocaj , Celhakaj dhe Hosmashaj	59 921 311
18AZ901	LL. sh.p.k	Ndertim I pritave lumore dhe perforcim I kembeve te ures ne shtratin e lumit Shkumbin	495919
<b>Totali</b>			<b>462,323,947</b>

**Burimi: Sektori i Financës.**

-Gjatë vitit 2022 është bërë kreditimi i llogarisë nr.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, për 8 operatorë në vlerën prej 3 948 923 lekë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë sipas kontratave dhe është bërë zhbllokimi i fondeve të ngurtësuar. Objektet janë marrë në dorëzim nga ana e Bashkisë Peqin. Nga verifikimi rezultoi se pjesa tjetër e projekteve nuk janë marrë në dorëzim, për arsye mos likuidimi të plotë të kontratave 3-vjecare të tyre, kontrata këto të lidhura ne vitin 2021 dhe 2022.

➤ **PASIVET (DETYRIMET)**

**Tabela nr. 15: Pasivi i Bilancit Kontabël 2022 Bashkia Peqin**

Nr	Referenca e llogarive	Emertimi	Viti 2022	Viti 2021
65	B	<b>PASIVET</b>	<b>192,713,372</b>	<b>166,251,668</b>
66		<b>I.Pasivet Afat shkurtra</b>	<b>192,713,372</b>	<b>166,251,668</b>
67		<b>1. Llogari te Pagushme</b>	<b>192,713,372</b>	<b>166,251,668</b>
68	401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	32,688,248	36,477,692
69	42	Dedyrime ndaj personelit	36,915,482	34,840,568
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhenes		
72	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	963,808	927,826
73	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqerore	3,875,925	3,491,310
76	436	Sigurime Shendetsores	531,189	479,243
77	437,438,	Organizma te tjere shtetore		
78	44	Institucione te tjera publike		
79	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		

80	464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere		
81	466	Kreditore per mjete ne ruajtje	23,290,504	20,436,052
82	467	Kreditore te ndryshem	94,448,216	69,598,977
83	4341	Operacione me shtetin( detyrime		
84	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
85		<b>2.Te tjera pasive afatshkurtra</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
86	419	Kreditore, Parapagime		
87	475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese		
88	478	Diferenca konvertimi pasive		
89	480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		
90	487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se titullit		
91		<b>II.Pasivet Afat Gjata</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
92	Klase 4	Llogari te pagushme		
93	16.17,18	Huate Afat gjata		
94		Provizjonet afatgjata		
95	Klasa 4	Te tjera		
96	<b>C</b>	<b>AKTIVET NETO/ FONDET NETO (A-B)</b>	<b>2,985,071,722</b>	<b>2,966,247,967</b>
97		<b>FONDET NETO PERBEHEN NGA :</b>	<b>2,985,071,722</b>	<b>2,966,247,967</b>
98	101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	2,507,056,012	2,601,821,541
99	12	Rezultatet e mbartura		
100	85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	12,050,563	14,750,019
101	111	Rezerva		
102	105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshme		
103	106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja		
104	107	Vlera e mjeëteve te caktuara ne perdorim	462,323,947	346,281,807
105	109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata		
106		Nga faktore te tjere		
108	<b>E</b>	<b>TOTALI I PASIVEVE(B+C)</b>	<b>3,177,785,094</b>	<b>3,132,499,635</b>

**Burimi: Sektori i Financës.**

### **Pasivet Afatshkurtra**

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagushme, ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Peqin më 31.12.2022, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2022, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2022, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

### **Tabelanr. 16: Klasa 4**

Llogaritë	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca/ndryshimi
401-403 Furnituror e llogari te lidhura me to	32,688,248	36,477,692	-3,789,444
42 Detyrime ndaj personelit	36,915,482	34,840,568	2,074,914
431 Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	963,808	927,826	35,982
435 Sigurime shoqërore	3,875,925	3,491,310	384,615
436 Sigurime shëndetësore	531,189	479,243	51,946
466 Kreditorë për mjete në ruajtje	23,290,504	20,436,052	2,854,452
467 Kreditorë të ndryshëm	94,448,216	69,598,977	24,849,239
<b>Gjendja më fund të periudhës</b>	<b>192,713,372</b>	<b>166,251,668</b>	<b>26,461,704</b>

**Përpunuar nga grupi i Klsh.**

- **Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”,** paraqitet në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 në vlerën prej 93,417,606 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 në vlerën prej 69,598,977 lekë, vlera që përfaqësojnë detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime operative dhe kreditorët për shkak të mungesës së fondeve. (Analitiku i kësaj llogarie për vitet 2022 në Aneksin nr.4)

**Tabela nr.17: I.Verifikimi i detyrimeve që rrjedhin për shpenzimet për investimet (llog.230 dhe llog.231)**

Test substancial i llogarisë nr.467 për vitin 2021 si më poshtë:

Subjekti	Emërtimi i Objektivit	Fatura nr.dt.	231	602	Totali 31.12.2021
<b>Detyrimet per vitin 2021 "Bashkia Peqin"</b>					
P.V.	Rikonstruksion palestre gjimnazi pajove	31 date 07.04.2020	1224240		1224240
IMES-D	Mbikqyrje rruges Ymer beheluli	33 date 15.12.2017	31600		31600
B93II	Rikonstruksion godinave I kateshe per familjen ne nevoje	08 date 22.11.2019	4754662		4754662
B93II	Rikonstruksion rruges "Kodra Ullirit"	49 date 07.05.2018	3908414		3908414
P.V.	Rikonstruksion terreneve te jashtme sportive te shkolles Demir Godelli	41 date 17.12.2020	143023		143023
Fatbardha Goxhaj	Mbikqyrje rik.shkolla e mesme pajove	24 date 24.09.2020	784798		784798
Imes-D	Mbikqyrje rehabilitim kanalet sekondare peqin -kavaje	34 date 15.12.2017	43200		43200
P.V.	Rehabilitim stacioni pompave	2 date 04.05.2021	655165		655165
B. B	Ndertim ujesjelles Gjocaj,Celhakaj	24 date 12.10.2020	470758		470758
LL.	Sistemim rruge Ali Ceka	01.11.2019 1555	1182657		1182657
Leon kostrukcion	Rik. Rruge "Ymer Beheluli"	150 date 06.06.2017	2680169		2680169
2 ED	Mbikq.tregu frutave -perimeve	24 date 20.12.2022	297058		297058
	Mbikqyrje stacioni pompave	26.12.2022	75538		75538
Dionis Menekshaj	Pageze permbarimore	27.10.2022	9536208		9536208
	<b>Shuma</b>				<b>25 787 490</b>

**Burimi:Sektori i Financës.**

**Tabela nr.18: e detyrimeve llog.467**

		<b>Vlera kontabël e cila nuk është përfshirë te llogaritë e pagueshme llog.467 "Kreditorë të ndryshëm" në 31.12.2022</b>
<b>Nr</b>	<b>Detyrimet</b>	
1	Detyrimet e prapambetura nga shpenzimet operative	52 001 123
2	Detyrimet nga Vendimet Gjyqësore	10 521 925
3	Kreditorë të ndryshëm	30 894 558
<b>Totali</b>		<b>93 417 606</b>

**Burimi:Përpunuar nga grupi i Klsh-së.**

Për vitin ushtrimor 2022, gjendja e llogarisë nr.467 "Kreditorë të ndryshëm" prej **93 417 606** lekë rakordon me vlerën reale të detyrimeve që rrjedhin nga faturat e palikuiduara për shpenzime operative, debitorët e ndryshëm dhe detyrime nga vendimet gjyqësore të pa paguara dhe duke u paraqitur në analitikun e llogarisë nr.467 "Kreditorë të ndryshëm". Tabela analitike në aneksin e materialit. (Pasqyruar në Kapitullin, Aneksi 5– Pasqyrat Financiare).

**Llogaria 42, "Detyrime ndaj personelit"**, sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë Bashkisë Peqin, paraqitet në vlerën 36 915 482 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor për t'u paguar në periudhat e të vitit pasardhës.

**Llogaria 431, "Detyrime ndaj shteti për tatim taksa"**, paraqitet në vlerën 963 808 lekë dhe përfaqëson vlerën për t'u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor.

**Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor 2022 që paguhen në muajin janar 2023 dhe janë përkatsisht në vlerat ,3 875 925 lekë dhe 531 189 lekë.

**-Llogaria nr.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”**, nga pasqyra e pozicionit financiar për vitin 2022 kjo llogari paraqitet në vlerën kontabël prej 23 290 504 lekë, vlerë kjo e cila është e rakorduar me degën e thesarit Peqin. Nga analiza e kësaj llogarie përbëhet nga 27 objekte nga të cilat për 1 është e trashëguar nga ish-komunat në vlerën totale 53 182 lekë, sipas Tabelës 19 “Procedura thelbësore për llogarinë 466 “Mjete në ruajtje”.

Nga auditimi i llogarisë nr.466 në bashkinë Peqin, u konstatua se nuk janë likuiduar garancitë (llog.466), në kundërshtim me Udhëzimit të MF nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10. Garancitë e krijuara në vitin 2022 janë në vlerën 6,803,375 lekë, janë likuiduar në vitin 2022 në vlerën 3,948,923 dhe garancitë qe trashëgohet në vitin 2023 janë në vlerën 23,290,504 lekë.

<b>Titulli Gjetjes:</b>	Mbi mangësitë e konstatuara në llogarinë 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje” në pasqyrat financiare është për vlerën kontabël 23,290,504 lekë.
<b>Situata:</b>	Në fund të vitit 2022, llogaria 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje” në pasqyrat financiare është për vlerën kontabël 23,290,504 lekë e rakorduar me Degën e Thesarit. Bashkia Peqin nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për likuidimin e garancive të punimeve të cilët kan përmbushur afatin kohor në vlerën 3,229,135 lekë, për 5 objekte që Bashkia Peqin nuk i ka marrë në dorëzim.Garancitë e krijuara në vitin 2022 janë në vlerën 6,803,375 lekë, janë likuiduar në vitin 2022 në vlerën 3,948,923 dhe garancitë qe trashëgohen në vitin 2023 janë në vlerën 23,290,504 lekë.
<b>Kriteri:</b>	Udhëzimit të MF nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10. 35
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Pasqyrim jo i saktë i kësaj llogarie.
<b>Shkaku:</b>	Përgjegjësi e strukturave përgjegjëse.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandimi:</b>	Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës në Bashkinë Peqin, të marrin masa për likuidimin e garancive të punimeve, të cilat e kanë mbushur afatin, në vlerën 3,229,135 lekë për 5 objektet.

➤ **Formati nr.2 “Pasqyra e Performancës Financiare”**

Paraqet llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara për vitet ushtrimore 2022 si më poshtë:

**Tabela nr.20: Pasqyra e Performancës Financiare.**

Nr.	Nr.		VITI	VITI
rresh	Reference	P E R S H K R I M I I O P E R A C I O N E V E	U S H T R I M O R	I M E P A R S H E M
ti	Llogarite			
a	b	c	1	2
1	A	TE ARDHURAT	753,388,032	712 388 748



2	70	<b>I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET</b>	<b>40,118,644</b>	<b>37 998 424</b>
3	700	<b>1.Tatimi mbi te Ardhurat</b>	<b>154,211</b>	<b>260 678</b>
4	7000	Tatim mbi te ardhurat personale		
5	7001	Tatim mbi Fitimin		
6	7002	Tatim mbi Biznesin e vogel	154,211	260 678
7	7009	<i>Te tjera Tatime mbi te ardhurat</i>		
8	702	<b>2.Tatimi mbi Pasurine</b>	<b>11,470,833</b>	<b>15 190 773</b>
9	7020	Tatim mbi Pasurine e palujtshme	11,468,942	14 959 487
10	7021	Tatim mbi shitjen e pasurise se palujtshme		
11	7029	Te tjera tatime mbi Pasurine	1,891	231 286
12	703	<b>3.Tatime mbi mallrat e sherbimet brenda vendit</b>	<b>28,433,198</b>	<b>22 438 573</b>
13	7030	Tatim mbi vleren e shtuar(TVSH)		
14	7031	Akciza		
15	7032	Takse mbi sherbimet specifike		
16	7033	Takse mbi perdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie	10,822,229	9 970 260
17	7035	Taksa vendore mbi perdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	17,610,969	12 468 313
18	704	<b>4.Takse mbi tregtine dhe transakcionet nderkombtare</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
19	7040	Takse doganore per mallrat e importit		
20	7041	Takse doganore per mallrat e eksportit		
21	7042	Tarife sherbimi doganor e kaliposte		
22	7049	Te tjera taksa mbi tregtine e transakcionet nderkombtare		
23	705	<b>5.Takse e rruges</b>		
24	708	<b>6.Te tjera Tatime e Taksa kombtare</b>	<b>60,402</b>	<b>108 400</b>
25	709	<b>7.Gjoha e Kamat vonesa</b>		
26	75	<b>II.KONTRIBUTE SIGURIME SHOQERORE E SHENDETESORE</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
27	750	NGA TE PUNESUARIT		
28	751	NGA PUNEDHENESI		
29	752	NGA TE VETPUNESUARIT		
30	753	NGA FERMERET		
31	754	NGA SIGURIMET VULLNETARE		
32	755	KONTRIBUTE NGA BUXHETI PER SIGURIME SHOQERORE		
33	756	KONTRIBUTE NGA BUXHETI PER SIGURIME SHENDETESORE		
34	71	<b>III.TE ARDHURA JO TATIMORE</b>	<b>9,874,065</b>	<b>10 580 514</b>
35	710	<b>1.Nga ndermarrjet dhe pronesia</b>	<b>1,266,134</b>	<b>1 532 830</b>
36	7100	Nga Ndermarrjet publike jo financiare		
37	7101	Nga Ndermarrjet publike financiare		
38	7109	Te tjera nga ndermarrjet dhe pronesia	1,266,134	1 532 830
39	711	<b>2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare</b>	<b>8,607,931</b>	<b>9 047 684</b>
40	7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	8,581,431	8 863 665
41	7111	Te ardhura sekondare e pagesa sherbimesh	11,000	22 000
42	7112	Takse per veprime gjyqsore e noteriale	1,500	
43	7113	Te ardhura nga shitja e mallrave e sherbimeve	14,000	8 000
44	7114	Te ardhura nga biletat		0
45	7115	Gjoha, kamatvonesa, sekuestrime e zhdemtime		154 019
46	7116	Te ardhura nga transferimi prones,Legalizimi i ndertimeve pa leje		
47	719	<b>3.Te tjera te ardhura jo tatimore</b>		
48	76	<b>IV.TE ARDHURA FINANCIARE</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
49	760	Nga interesat e huadhenies se brendshme		
50	761	Nga interesat e huadhenies se Huaj		
51	765	Nga interesat e depozitave		

52	766	Nga kembimet valutore		
53	72	<b>V.GRANTE KORENTE</b>	<b>703,395,323</b>	<b>663 809 810</b>
54	720	<b>1.Grant korent I Brendshem</b>	<b>703,395,323</b>	<b>663 809 810</b>
55	7200	Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)	4,000,000	
56	7201	Nga Buxheti per NJQP(Vendore)	552,960,196	536 032 309
57	7202	Nga Buxheti per pagesa te posacme te ISSH		
58	7203	Nga Buxheti per mbulim deficiti(ISSH E ISKSH)		
59	7204	Pjesmarrje e institucioneve ne tatime nacionale	8,373,427	7 420 382
60	7205	Financim shtese per te ardhurat e krijuara brenda sistemit		
61	7206	Financim I pritshe nga buxheti	137,497,700	120 357 119
62	7207	Sponsorizime te brendshme( nga te trete)	564,000	
63	7209	Te tjera grante korente te brendshme		
64	721	<b>2.Grant korent I Huaj</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
65		Nga Qeveri te Huaja		
66		Nga Organizata Nderkombetare		
67		<b>VI.TE ARDHURA TE TJERA</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
68	781	Te ardhura nga investimet ne ekonomi		
69	782	Rimarrje Shumash te parashikuara per aktive afatshkurtra		
70	783	Rimarrje Shumash te parashikuara per aktive afatgjata		
71	784	Rimarrje Shumash per shpenzime te viteve ardhshme		
72	787	Terheqje nga seksioni I investimeve		
73	73	<b>VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE</b>		
74	<b>B</b>	<b>SHPENZIMET</b>	<b>741,337,469</b>	<b>697 638 729</b>
75	<b>600</b>	<b>LPAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE</b>	<b>184,864,734</b>	<b>172 173 230</b>
76	6001	Paga, personel I perhershem	183,583,944	170 868 538
77	6002	Paga personel I Perkohshem	81,000	373 432
78	6003	Shperblime	1,199,790	931 260
79	6009	Shpenzime te tjera per personelin		
80	<b>601</b>	<b>II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE</b>	<b>30,559,891</b>	<b>28 101 405</b>
81	6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqerore	27,372,655	25 227 524
82	6011	Kontributi I Sigurimeve Shendetesore	3,187,236	2 873 881
83	<b>602</b>	<b>III.BLERJE MALLRA E SHERBIME</b>	<b>118,326,387</b>	<b>95 383 280</b>
84	602	Mallra dhe sherbime te tjera		
85	6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	9,332,618	4 682 568
86	6021	Materiale dhe sherbime speciale	315,200	90 000
87	6022	Sherbime nga te trete	76,854,083	62 375 888
88	6023	Shpenzime transporti	6,442,149	6 571 996
89	6024	Shpenzime udhetimi	494,832	564 996
90	6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	2,049,438	1 013 100
91	6026	Shpenzime per qeramarrje	600,000	652 000
92	6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale	14,118,537	11 290 203
93	6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua		
94	6029	Shpenzime te tjera operative	8,119,530	8 142 529
95	<b>603</b>	<b>IV.SUBVECIONE</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
96	6030	Subvecione per diference cmimi		
97	6031	Subvecione per te nxitur punesimin		
98	6032	Subvecione per te mbuluar humbjet		
99	6033	Subvecione per sipermarrjet individuale		
100	6039	Subvecione te tjera		
101		<b>V.TRANSFERIME KORENTE</b>	<b>413,345,392</b>	<b>399 944 107</b>

102	604	<b>1.Transferime korente te brendshme</b>	<b>8,243,562</b>	<b>5 978 000</b>
103	6040	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise	6,343,562	
104	6041	Transferime korente tek institucione qeveritare te ndryshme		
105	6042	Transferime korente tek Sigurimet Shoqerore e Shendetsore		
106	6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurse	1,900,000	5 978 000
107	605	<b>2.Transferime korente me jashte</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
108	6051	Transferime Per Organizatat Nderkombetare		
109	6052	Transferime Per Qeverite e Huaja		
110	6053	Transferime Per institucionet jo fitimprurse te huaja		
111	6059	Transferime Te tjera korrente me jashte shtetit		
112	606	<b>3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe</b>	<b>405,101,830</b>	<b>393 966 107</b>
113	6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH		
114	6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	405,101,830	393 966 107
115		<b>VI.SHPENZIME FINANCIARE</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
116	65	<b>1.Shpenzime Financiare te brendshme</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
117	650	Interesa per bono thesarit dhe kredi direkte		
118	651	Interesa per huamarrje te tj. Brendshme		
119	652	Interesa Letra tjera vlere Qeverise		
120	656	Shpenz.nga kembimet valutore		
121	66	<b>2.Shpenzime Financiare te jashtme</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
122	660	Interesa per huamarrje nga Qeveri.te Huaja		
123	661	Interesa per financime nga Institucionet.nderkomb		
124	662	Interesa per huamarrje te tjera jashtme		
125		<b>VII.KUOTA AMORTIZIMI DHE SHUMA TE PARASHIKUARA</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
126	681	Kuotat e amortizimit te AAGJ, te shfrytezimit		
127	682	Vlera e mbetur e AAGJ, te nxjerra jashte perdorimit e te shitura		
128	683	Shuma te parashikuara te shfrytezimit		
129	686	Shuma te parashikuara per aktivet financiare		
130	63	<b>VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT</b>	<b>-5,758,935</b>	<b>2 036 707</b>
131		<b>IX.SHPENZIME TE TJERA</b>	<b>0</b>	
132	C	<b>TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDES</b> <i>(Rezultati I Veprimtarise se vititUshtrimor)</i>	<b>12,050,563</b>	<b>14 750 019</b>

**Burimi:Sektori i Financës.**

Nga analizimi i Pasqyrës së Performancës Financiare përsa i përket të ardhurave:

Llogaritë e financimit nga buxheti i shtetit për vitin 2022 (grant) paraqitet në shumën prej 690,457,896 lekë.Të ardhurat e realizuara nga Bashkia Peqin për vitin 2022 janë 62,930,136 lekë.

**-Llogaria nr.7002 “Tatim mbi Biznesin e vogël”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 154 211 lekë e cila referuar dhe aktrakordimit me thesarin. me një zbritje prej 106,467 lekë nga viti 2021.

**-Llogaria nr.7020 “Tatim mbi pasurinë e palujtshme”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 11,468,942 lekë me një zbritje prej 3,490,545 lekë nga viti 2021.

**-Llogaria nr.7035 “Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën **17,610,969** lekë, me një rritje prej (5,142,656) lekë nga viti 2021,ku sipas aktrakordimit me thesarin në të përfshihen:

**Tabela nr.21 Analitike e llogarisë nr.7035.**

Nr	Artikulli	Përshkrimi i Taksës	Vlera
1	7035001	Takse vendore per regjistrimin e biznesit	6 260
2	7035002	Zenie e hapësires publike	2 452 977
3	7035003	Taksa mbi ndikimin ne infrastrukture	6 759 031

4	7035008	Takse vendore e reklames	289 417
5	7035009	Takse vendore e tabelës	44 220
6	7035023	Takse vendore ndricimi	1 665 626
7	7035025	Takse Vendore per truallin	610 674
8	7035029	Tarife per certificate e perkohshme	5 000
9	7035030	Tarife per regjistrimin e veprimtarive te ndrshme	845 703
10	7035032	Tarifë vendore për shqyrtim leje zhvillimi	62 740
11	7035033	Tarife vendore per vertetime	345 668
12	7035039	Tarife vendore per leje shfrytezim karburantesh	1 400 000
13	7035040	Tarifë vendore për leje ndërtimi	1 255 548
14	7035045	Takse vendore per varreza	683 334
15	7035048	Takse vendore e perkohshme per mirembajtje	1 184 771
	<b>Llogaria nr.7035 “Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie”</b>		<b>17 610 969</b>

**Përpunuar nga grupi i Klsh-së.**

**-Llogaria nr.7109 “Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndermarrjet dhe pronesia”** paraqitet në bilancin e vitit 2022 në vlerën 1 266 134 lekë, me një zbritje prej (266 696) lekë nga viti 2021.

**-Llogaria nr.711 “Të ardhurat nga shërbimet administrative dhe të ardhura sekondare”** pasqyrohet në bilancin e vitit 2022 për vlerën kontabël 8 607 931 lekë me një rritje prej (439753) lekë nga viti 2021.

Llogaritë e shpenzimeve të konstatuara sipas Pasqyrë së Performancës Financiare, sipas natyrës dhe klasifikimit të këtij formati rakordojnë me shumatat e rezultuar në llogaritë e shpenzimeve sipas klasifikimit buxhetor me akt rakordimet e thesarit.

➤ **Në analizë Kontratat për investime**

Për vitet 2022 janë kryer investime me burim financimi nga fondet e siguruar nga transfertat e pakushtëzuar, nga të ardhurat e veta dhe nga fondet e alokuara nga ministratë e linjës. Në analizë këto investime paraqiten në tabelën nr. 22 “Kontratat” të Projektraportit të Auditimit.

**Konkluzion:** Për vitin 2022 janë lidhur dhe zbatuar 17 kontrata në vlerën **150,045,611** lekë për blerje aktive materiale dhe jo materiale, si mallra apo projekte investimesh, të financuara nga buxheti i Bashkisë, Ministratë linjës. Për këto kontrata është kryer kontabilizimi i veprimeve ekonomike as në momentin e celjes së fondeve dhe në momentin e mbërritjes së faturave. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve ekonomike të kryera janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, si dhe kur është bërë pagesa, Janë kryer veprimet kontabël në kohën e lindjes të detyrimit për t'u paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin pagesa, dhe që kanë sjellë për ushtrimin e dhënë shpenzime. Po kështu janë kryer veprimet përkatëse kontabël në lidhje me fondet buxhetore të përdorura për investime deri në momentin e kapitalizimit të aktivitetit.

**a) Paga, shpërblime e të tjera personeli (llog. 600) dhe sigurimet shoqërore (llog 601)**

-Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicionit nga zyra e personelit dhe zyrës së financës në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore, që rregullojnë pagat dhe shpërblimet u konstatua se:

-Me vendimet e Këshillit të Bashkisë përkatësisht Vendimin nr.119, datë 29.12.2021 “Mbi miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave për vitin 2022”, për vitin 2022, janë miratuar struktura,organika dhe numri i punonjësve për funksionimin dhe ushtrimin e aktivitetit të administratës së Bashkisë dhe shërbimeve mbështetëse. të cilat janë paraqitur dhe konfirmuar brenda afateve ligjore nga Prefekti Qarkut Elbasan.

-Organika për vitin 2022 në total është 320 (treqind e njëzet) punonjës,nga këto për administratën e aparatit të Bashkisë 128 (njëqind e njëzetë e tetë) punonjës, dhe Gjendja Civile 5 (P.) punonjës, Drejtoria e shërbimeve bujqësore, veterinare e pyjore 27 (njëzetë e shtatë), Agjensia e shërbimeve komunitare dhe administrative 58 (P.dhjetë e tetë), Drejtoria e arsimit,kulturës, rinisë, sportit dhe

trashëgimisë kulturore 79 (shtatëdhjetë e nëntë), Policia Bashkiake 9 (nëntë) punonjës, si dhe Sektori i Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri 14 (katërmëdhjetë) punonjës.

**Tabela nr.23: Organika e Bashkisë Peqin.**

Emërtimi	Viti 2022	
	Plan	Fakt
Aparati i Bashkisë.	160	160
Gjendje Civile	5	5
Komunale	26	26
Sporti	10	10
Kultura	11	11
Mirembajtje rruges	32	32
Mbrojtje nga zjarri	14	14
Shërbimi pyjor	2	2
Kullimi	2	2
Arsimi baze	53	53
Arsimi mesem	5	5
Gjithsej :	<b>320</b>	<b>320</b>

-Për të gjithë periudhën e audituar janë respektuar struktura dhe organika.

-Për vitin 2022 nga 320 (treqind e njëzetë) punonjës, 48 (dyzetë e tete) pozicione janë të shërbimit civil, ku marrdhëniet e punës e të cilëve rregullohen me ligjin nr.152/2013 datë 30.05.2013 “Për Nëpunësin Civil”, ndërsa 272 (dyqind e shtatëdhjetë e dy) punonjës janë me kontratë pune, marrdhëniet e punës të cilëve rregullohen me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

-Përcaktimi i nivelit të pagave për të dy vitet është bërë në përputhje me kërkesat e VKM nr. Nr. 165, datë 2.3.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar me VKM nr.177 datë 08.03.2017 V.K.M. nr.625 datë 28.09.2022 “Per grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” të ndryshuar. Në hartimin e këtyre strukturave janë zbatuar kriteret e klasifikimit të vendeve të punës për organet e qeverisjes vendore në lidhjen nr.5, duke përshtatur dhe respektuar kufijt e niveleve të pagave në përputhje me kategorinë e kësaj njësie vendore (20.001-50.000 mbas zbatimit të Reformës Teritoriale).

Realizimi i fondit të pagave, sigurimeve shoqërore dhe numrit të punonjësve për Aparatin e Bashkisë, jepet nga pasqyra në vijim:

Tabela e llog.600 dhe llog.601

nr	Emërtimi viti	Njësi matje	Viti 2022		
			P	R	%
1	Pagat (llog 600)	000 L	219305	182469	83
2	Sig. Shoq (Llog 601)	“	32925	30458	92.5

Burimi: Sektori i financës.

Nga pasqyra konstatohet se pagat dhe sigurimet shoqërore rezultojnë me mos realizim për të dy vitet, i cili është efekt kryesisht i mos realizimit të të ardhurave të planifikuara.

- Është mbajtur dhe azhurnuar libri i pagave e ditari i pagave.

-Nga auditimi i listë-pagesave u konstatua se listë-pagesat hartoheshin sipas standarteve të kontabilitetit, ku plotësoheshin pagat me të gjithë elementet dhe shtesa të ndryshme të përfituara deri tek shuma bruto. Po kështu pasqyroheshin llojet e ndalesave deri tek paga neto. Përmbledhëset

janë të kuadruara me listë pagesat dhe me urdhër pagesat respektive, të nënshkruara nga punonjësi i financës dhe titullari.

Në dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për paga rezultoi se listëpagesat janë nënshkruar nga punonjësi caktuar për menaxhimin e burimeve njerëzore, në zbatim me UMF nr. 30 dt. 27.12.2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, pika 69.

-Nga verifikimi me zgjedhje i ushtruar në listë pagesat e muajve dhe nentor 2022 rezultoi se pagat, shtesat dhe ndalesat janë përlogaritur drejtë sipas tabelës së pagave si dhe kanë përputhje me nivelin e arsimit. Nga ky sondazh u verifikuan përcaktimi i niveleve të pagave dhe pagesa e tyre, ku rezultoi se: ato ishin në përputhje me nivelet e përcaktuar për shtesat e pozicionit si dhe shtesat e pagës së grupit përputheshin me nivelin e arsimit sipas përcaktimeve të lidhjes nr.5 të VKM të pagave dhe sipas kategorisë 3 së kësaj njësie vendore. Gjithashtu listëpagesat janë të shoqëruara dhe në përputhje me listëprezencat përkatëse.

Përmbledhëset janë të kuadruara me listë pagesat dhe me urdhër pagesat respektive, të nënshkruara nga punonjësi i financës dhe titullari.

-Për të gjithë periudhën e kontrolluar, janë përlogaritur, ndaluar dhe xhiruar detyrimet për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe tatimin mbi të ardhurat.

-Janë respektuar drejtë dispozitat ligjore për kohëzgjatjen e punës.

- Nga verifikimi rezultoi se në çdo rast shpenzimet e paraqitur në llogarinë 606 janë të mbështetura në dispozitat ligjore përkatëse dhe të shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm justifikues.

Nga testi kontrollit për vitet 2022në lidhje me veprimet me bankë:

Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve. Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

Nga testi kontrollit për vitet 2022në lidhje me veprimet me bankë:

Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë.

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe

nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve. Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

## **2.4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.**

2.4.1. Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

2.4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

2.4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.

2.4.4. Auditim mbi hartimin e zbatimit të projekteve, zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomike fitues.

### **2.4.1. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve**

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimor. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, të cilat janë miratuar me Vendimet përkatëse të KB.

Në zbatim të drejtimit 4, të programit të auditimit nr. 429/1 Prot, datë 19.05.2023, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë;

- 1) Regjistri i realizimeve të prokurimeve për periudhën 01.01.2021-31.12.2022.
- 2) Dosjet e procedurave të prokurimit të realizuara për periudhën objekt auditimi.
- 3) Shpenzimet e kryera për procedurat e realizuara dhe marrja në dorëzim sipas rastit.

### **2.4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara**

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i SEP, u konstatuan disa shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, *si vijon:*

-Nga Autoriteti Kontraktor (AK) Bashkia Peqin, në disa raste nuk është bërë e mundur që përpara fillimit të një procedure prokurimi, një apo shumëvjeçare, të merret konfirmim nga Ministria përgjegjëse për Financat, në strukturat e degëve të thesarit, që fondet të cilat synohen të prokurohen, janë brenda limitit të miratuar për angazhime, në kundërshtim me pikën 81 të UMF nr. 9, datë 20.07.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

-Nga Autoriteti Kontraktor (AK) Bashkia Peqin, në disa rast nuk është bërë e mundur që urdhër prokurimet të konfirmohen në Degën e Thesarit, për të siguruar garancinë e fondeve dhe mos

krijimin e vlerave të papaguara në përfundim të kontratës, veprime në kundërshtim me udhëzimin plotësues nr. 02, datë 19.01.2018 të MF “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2018”, i ndryshuar. Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Peqin (regjistrat e parashikimit dhe realizimit), për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Procedura 01.01.2021 – 31.12.2021	Nr. i procedurave	Vl. Fond limit në lekë	Vl.Kontrate në lekë
<b>Gjithsej</b>	<b>8</b>	<b>150,809,159</b>	<b>147,435,484</b>
E hapur	1	116,864,360	114,345,663
E hapur e thjeshtuar	2	4,583,904	4,552,809
Kërkesë për Propozim	4	14,114,948	13,747,762
Negociim pa Shpallje	1	15,114,948	14,789,250
Procedura 01.01.2022 – 31.12.2022	Nr. i procedurave	Vl. Fond limit në lekë	Vl.Kontrate në lekë
<b>Gjithsej</b>	<b>6</b>	<b>89,286,239</b>	<b>85,497,695</b>
E hapur	2	68,961,745	66,799,486
E hapur e thjeshtuar	4	20,324,494	18,698,209

*Burimi: Hartuar nga grupi i KLSH, sipas të dhënave të regjistrave të subjektit Bashkia Peqin*

Në lidhje me këtë pikë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se;

Për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2021-31.12.2022, Bashkia Peqin ka realizuar **32** procedura prokurimi (tender) me vlerë të fondit limit në shumën **240,095,398** lekë dhe me vlerë kontrate të lidhur në shumën **232,933,179** lekë nga të cilat:

Për vitin 2021 janë realizuar 8 procedura me fond limit në shumën **150,809,159** lekë dhe vlerë kontrate të lidhur në shumën **147,435,484** lekë pa TVSH.

Për vitin 2022 janë realizuar 6 procedura me fond limit në shumën **89,286,239** lekë dhe vlerë kontrate të lidhur në shumën **85,497,695** lekë pa TVSH.

Gjithashtu për të njëjtën periudhë objekt auditimi, ka realizuar 18 procedura blerje me vlera të vogla me fond limit në shumën **10,955,141** lekë dhe vlerë kontrate në shumën **8,919,909** lekë. Nga këto, për vitin 2021 janë realizuar 8 procedura me fond limit në shumën **4,115,978** lekë dhe vlerë kontrate të lidhur në shumën **3,315,481**lekë. Për vitin 2022 janë realizuar 10 procedura me fond limit në shumën **6,839,163** lekë dhe vlerë kontrate të lidhur në shumën **5,604,428** lekë. Konkretisht të dhënat e procedurave të prokurimit të realizuara paraqiten si më poshtë;

(Bashkëlidhur Projektraportit paraqitet aneksi nr. 1 dhe Aneksin nr. 2, pika 4, “Mbi realizimin e procedurave të prokurimit për periudhën 01.01.2021-31.12.2022”).

#### **2.4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.**

Më poshtë trajtohen disa nga procedurat e prokurimit të audituara në Bashkia Peqin, e konkretisht si vijon:

1. Procedura e prokurimit me objekt “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellsit fshati Bicaj dhe Caushaj” me të dhënat si më poshtë:

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtim i rrjetit Ujësjellësit te fshatit Bicaj dhe Caushaj”.</b>			
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> “Procedure e Hapur” REF-86648-02-10-2021 Urdhri nr.200 prot 310., datë 08.02.2021	<b>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit</b> Urdhri nr.200 prot 310., datë 08.02.2021	<b>2 Njësia e Prokurimit</b>  Urdhri nr.200 prot 310., datë 08.02.2021	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b>  Urdhri nr.201 prot 311., datë 08.02.2021. 1.M.S. 2.Xh.S. 3.F.Rr.



	1.G.N. 2.H.M. 3.A.D.	1.G.N. 2.H.M. 3.A.D.	
<b>4. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 116,684,360 lekë pa TVSh	<b>5. Oferta fituese, vlera fituese:</b> Bashkimi Operatoreve Fitues: BOE "B." B SHPK & "P.V." SHPK & "B.-N" SHPK & "D.C." SHPK Vlera: 114,345,663 lekë pa TVSh		<b>6. Diferenca me fondin limit</b> 2,518,697 lekë pa TVSh
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data .12.02.2021	<b>8. Burimi Financimit</b> Grant Buxheti i Shtetit, vlera e financimit per vitin 2021, do te jete, njezet e shtate milion,pjesa tjetere do te financohet ne vitet 2022,2023,2024.		<b>9. Operatoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender, <b>1.BOE:</b> "B." B SHPK & "P.V." SHPK & "B.-N" SHPK & "D.C." SHPK <b>2.O.E "I."</b> 2020 SHPK b) Kualifikuar ; <b>1.BOE:</b> "B." B SHPK & "P.V." SHPK & "B.-N" SHPK & "D.C." SHPK <b>2.O.E "I."</b> 2020 SHPK
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 7 muaj</b>			
<b>10. Ankimime</b> AK-s'ka/ APP-s'ka KPP-s'ka/	<b>11. Data e lidhjes të kontratës:</b> Nr. Prot 704., datë 19.04.2021		<b>12. Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK Nuk ka</b>

Nga titullari i Autoritetit Kontraktor z, L.T., me urdhrin nr. 09prot., datë 06.01.2021, është caktuar z. M.S. me detyrë zv/Kryetar i Bashkisë Peqin, në cilësinë e personit përgjegjës për prokurimet. Gjithashtu me urdhrin nr. 604 prot, datë 02.02.2021, është caktuar përsëri z. M.S. me detyrë zv/Kryetar i Bashkisë Peqin, në cilësinë e personit përgjegjës për prokurimet i cili ka funksionuar gjatë gjithë vitit 2021 e në vazhdim dhe për vitin 2022.

***a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.***

Nga auditimi i dokumentacionit dosjes së procedurës së prokurimit me objekt "Ndertim i rrjetit Ujësjellësit te fshatit Bicaj dhe Caushaj", me fond limit në shumën 116,684,360 ( njëqind e gjashtembedhjetë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e kater mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate në shumën 114,345,663 (njëqind e katermedhjetë milion e treqind e dyzet e pesëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSh, kanë marrë pjesë BOE "B." B SHPK & "P.V." SHPK & "B.-N" SHPK & "D.C." SHPK dhe OE "I." 2020 SHPK, nga të cilët BOE "B." B SHPK & "P.V." SHPK & "B.-N" SHPK & "D.C." SHPK dhe OE "I." 2020 SHPK, janë kualifikuar, nuk ka operatore ekonomike të s'kualifikuar, ku është shpallur fitues BOE "B." B SHPK & "P.V." SHPK & "B.-N" SHPK & "D.C." SHPK me vlere 114,345,663 lekë pa TVSh, konstatohet se:

***AK në lidhje me "Hartimin e Specifikimeve Teknike" dhe "Përlllogaritjen e Fondit Limit";***

**Titulli i gjegjes:** Nuk argumentohet dhe dokumentohet llogaritja e fondit limit dhe përzgjedhja e procedurës.

**Situata:** Nga ana e titullarit të AK, nuk ka urdhër për caktimin e një personi apo ngritjen e një komisioni për llogaritjen e vlerës së fondit limit të procedurës së prokurimit. Nisja e kësaj procedure referuar dhe inventarizit të dosjes, ka filluar me urdhrin e prokurimit nr. 310prot, datë 08.02.2021. Sipas Vkm nr.914, datë 29.12.2014, Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, në nenin 60, përcaktohet se; "Pas përlllogaritjes së fondit limit sipas nenit 59 të këtyre

*rregullave, titullari i autoritetit kontraktor, nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit.”. Pra nuk argumentohet dhe dokumentohet mënyra e llogaritjes së si është nxjerrë kjo vlerë limit e kontratës, veprim jo në përputhje me nenin 59, pika 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Gjithashtu rezulton se nuk është bërë një përshkrim i punëve të cilat do të kryhen dhe arsyeja e përzgjedhjes së kësaj pprocedure prokurimi “E hapur punë”, veprim për të cilin mban përgjegjësi *titullari i AK Z. L.T., anëtarët e njësisë së prokurimit, zj. G.N., z. H.M. e z. A.D., si dhe z. M.S. në cilësinë e personit përgjegjës për prokurimet.**

**Kriteri:** VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, me 59, pika 2, ku citohet se:

*Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.*

**Ndikimi/Efekti:** Nuk dokumentohet përlllogaritja e vlerës limit të kontratës dhe zgjedhja e procedurës së prokurimit.

**Shkaku:** Mosrespektimi i kuadrit ligjor të PP.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandim:** Titullari i Autoritetit Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimit, të marrin masat që, në procedurat e prokurimit në vijim, përpara hartimit të urdhrin të prokurimit të aplikojë mënyrën dhe përlllogaritjen e vlerës së kontratës me qëllim dokumentimin dhe argumentimin e saj në përputhje me fondet buxhetore të miratuara. Gjithashtu të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e përzgjedhjes së procedurës së prokurimit.

-Nga ana e titullari i AK, në zbatim të LPP-së, me urdhrin nr.310 datë 08.02.2021 është ngritur grupi i punës “Për hartimin e specifikimeve teknike”, i përbërë prej, 1.G.N.(juriste), 2. H.M.(ekonomist) dhe 3.A.D. (Inxhinierë) specialist i fushës. Për hartimin e specifikimeve teknike nuk është mbajtur procesverbal apo dokumentacion për argumentimin tekniko/ligjor të tyre.

### ***Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Krieteve”:***

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej 1.G.N., 2.H.M. 3.A.D. emrat e komisionit dhe profilet e fushës së secilit anëtar, janë evidentuar në procesverbalin e datës 08.02.2021, disa prej të cilave janë si më poshtë;

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. Kapaciteti Ligjor i operatorëve ekonomikë:

- Ofertuesi duhet të tregojë, në objektin e veprimtarisë së tij, se është në gjendje të realizojë objektin e prokurimit.
- Sipas përcaktimeve të bëra në pikën 1 “Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit” të kësaj shtojce (Shtojca 12).
- Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim nga administratori i subjektit, shoqëruar me dokumentacion që vërteton se nuk ka detyrime të pashlyera për taksat vendore pranë njësisë të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitet sipas ekstraktit të regjistrit, për vitet 2018,2019 dhe 2020. Vërtetimi duhet detyrimisht të jetë

përshkruar, ndër të tjera, edhe NIPT-in e subjektit. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga Njësit e Qeverisjes Vendore.

***Ky kriter nuk është i argumentuar ligjërisht se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës.***

2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- Operatori ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm. Operatori ekonomik duhet nuk duhet të jetë me humbje për të tre vitet e fundit. Për këtë duhet të paraqes kopje të vërtetuar të pasqyrave financiare për periudhën 2017, 2018 dhe 2019, të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse të konfirmuar nga ky autoritet me nënshkrim dhe vulë në c'do faqe të dokumentit, të shoqëruar me Raport të Ekspertit Kontabël. Nuk është e detyrueshme paraqitja e Raportit të Ekspertit Kontabël për ato subjekte që nuk plotësojnë kushtet ligjore.
- Xhiro mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjatë tre viteve të fundit 2017, 2018 dhe 2019, duhet të mos jetë më e vogël se 50% vleres se fondit limit të tenderit. Për këtë të paraqitet Vërtetim nga organet Tatimore për xhiron vjetore gjatë tre viteve të fundit.

***Ky kriter nuk është i argumentuar ligjërisht se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës.***

### **3. Kapaciteti teknik**

Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

**3.1.** Punë të ngjashme për një kontratë të vetme të së njëjtës natyrë me objektin që prokurohet në një vlerë jo më pak se **50%** të fondit limit, të realizuar gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit, ku zerat e punimeve respektive plotësojnë kriteret minimale të preventivit të objektit në prokurim (konkretisht depo ujësjellësi jo më pak se 300 m<sup>3</sup> të ndërtuar brenda 3 viteve të fundit)

ose

**3.2.** Punë të ngjashme ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit të jetë jo më pak se 100% i fondit limit, ku zerat e punimeve respektive plotësojnë kriteret minimale të preventivit të objektit në prokurim.

Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bënë ofertën të kualifikueshme.

Si referencë për llogaritjen e afateve do të merret data e kolaudimit të objektit.

**Për të vërtetuar pikën 1 ose 2 duhet të paraqitet:**

- a-Kontratë/kontratata nënshkruar nga palët.
- b-Situacioni i përfundimtar të punimeve.
- c-Aktin e kolaudimit të punimeve.
- d-Aktin e marrjes në dorëzim të punimeve nga investitori.
- e-Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës 8.

Për objektet me financime private:

- a.i. Leje ndertimi
- a.ii. Kontratën e Sipërmarrjes,
- a.iii. Situacion përfundimtar të objektit,
- a.iv. Aktin e Kolaudimi përfundimtar të objektit,
- a.v. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës përkatëse, vlerësuar me notën 10 ose e shprehur në fjalë "shumë mirë".
- a.vi. Faturen/at tatimore.

Për objektet me vetëfinancim (nga Operatori Ekonomik):

- a.i. Leje ndertimi
- a.ii. Situacion përfundimtar të objektit,

- a.iii. Aktin e Kolaudimi përfundimar të objektit,
- a.iv. Faturen/at tatimore.

***Ky kriter nuk është i argumentuar ligjërisht se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës, për më tepër kur një prej kërkesave të mësipërme është që OE duhet të ketë ndërrtuar depo Uji jo më pak se 300m3, e bën konfuze si kriter dhe nuk ka asnjë argumentim pasi depo e cila është kërkuar për tu ndërrtuar nga AK referuar preventivit është 200m3.***

#### **4. Licenca profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.**

Ofertuesi duhet të jetë i pajisur me licencë profesionale të shoqërisë, me kategoritë:

- N.P – 1 D Punime gërmimi në tokë.
- N.P – 2 A Ndërtime civile dhe industrial.
- N.P - 3 A Rikonstruksione dhe mirëmbajtje godinash.
- N.P – 5 C Punime nëntokesore, ura e vepra arti.
- N.P – 7 F Ujësjetlla, gazësjellësa, vajësjetlla,
- N.P – 12 D Punime të inxhinierisë së mjedisit.
- N.S - 1 B Punime për prishjen e ndërtimeve.
- N.S - 4 E Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to
- N.S – 18 B Punime topogjeodezike.
- N.S – 20 A Shpime gjeologjike-inxhinierike.

Për Operatorët e huaj të bëhet njëhësimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

***Ky kriter nuk është i argumentuar ligjërisht se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës. Gjithashtu kategoria e kërkuar për licencat e mësipërme referuar niveleve për çdo kategoritë punimesh zbatimi, nuk është në përputhje me natyrën dhe volumin e tyre pasi, gjithë vlera e kontratës është në shumën 116,684,360 lekë. Referuar zërave të preventivit të punimeve, asnjë nga zërat nuk e tejkalon vlerën prej 50 milionë lekë që do të thotë se licencat e kërkuara duhet të jenë brenda kategorisë A të lidhjes 4 përcaktuar në VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Këto kërkesa ndikojnë në kufizimin e pjesëmarrjes së tyre çka sjell për pasojë mundësinë e OE favorizues për lidhjen e kontratës në fjalë.***

5. Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatën: Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me:

- **EN-ISO 9001** mbi ( Sistemi i menaxhimit të cilësisë).
- **EN-ISO 14001** mbi (Sistemi i menaxhimit të mjedisit).
- **BS OHSAS 18001/2007 ose ISO 45001/2018** (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë).
- **BS PAS 99** (Sistemi i menaxhimit të integruar).
- **ISO 50001** (Sistemin i menaxhimit të energjisë).
- **ISO 39001** (Certifikatë për sistemin e menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor).
- **ISO EN 3834-2:2006** “(Sistemi i cilësisë për saldimitin e materialeve metalike).
- **SA 8000** (Sistemi i menaxhimit të përgjegjësive shoqërore)
- **ISO 1452-1** (Sistemi i tubacioneve plastike)
- **DS CEN 15128** (Sistemi i standardeve europiane për riparimin e sistemeve të kanalizimeve dhe kullimit).
- **BS EN 13331-1 2002** ( Sistemet për veshjen e kanaleve)

*Ky kriter për paraqitjen e licencave nuk është i argumentuar ligjërisht se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës, gjithashtu janë kërkuar licenca të cilat nuk janë në përputhje dhe të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet dhe ndikon në kufizimin e pjesëmarrjes së tyre çka sjell për pasojë mundësinë e OE favorizues për lidhjen e kontratës në fjalë.*

- 4 (kater) inxhinier të certifikuar për përgjegjes për sigurin dhe mbrojtjen e shendetit në punë të punësuar si drejtues teknik pranë subjektit ofertues.

Certifikatat të jenëlëshuar në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara.

6. Deklaratë e disponueshmërisë së makinerive, sipas shtojcës 10, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Nr	LLOJI I MAKINERIVE	DISPONIMI	SASIA
1.	Autovinç	Në pronësi ose me qira	Copë 2
2.	Grejder	Në pronësi ose me qira	Copë 1
3.	Eskavator me zinxhir	Në pronësi ose me qira	copë 3
4.	Autobetoniere	Në pronësi ose me qira	Copë 5
5.	Autopompë/Presë betoni	Në pronësi ose me qira	Copë 4
6.	Sonde Shpimi për pilota	Ne pronesi ose me qira	Copë 1
7.	Sonde shpimi material shkëmbor	Ne pronesi ose me qira	Copë 1
8.	Sonde Shpimi vertikal	Ne pronesi ose me qira	Copë 1
9.	Prerese Asfalti	Në pronësi ose me qira	Copë 1
10.	Kaskë pune sigurie/kafele minatori	Në pronësi ose me qira	Copë 150
11.	Rrip sigurimi	Në pronësi ose me qira	Copë 150
12.	Aparat Saldimi tubash nën presion	Ne pronesi ose me qira	Copë 1
13.	Aparat saldimi tubo celiku	Në pronësi ose me qira	Copë 2
14.	Grejder	Ne pronesi ose me qira	Copë 2
15.	Asfalt-shtruese	Ne pronesi ose me qira	Copë 2

Makineritë – pajisjet në pronësi të vërtetohen me anë të aktit të pronësisë (kontrata e blerjes apo dhurimi, fature çdoganimit, fatura tatimore perkatese, etj). Ato të marra me qera të shoqërohen me aktin e pronësisë së qiradhënësit (kontrata e blerjes apo dhurimi, fature çdoganimit, fatura tatimore perkatese, etj), e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në perfundimin e plote të punimeve. Për mjetet që shënohen në rregjistra publikë duhet të paraqitet edhe: leje qarkullimi, certifikatë e kontrollit teknik, policën e sigurimit të mjeteve, çertifikate për transport material dhe foto të mjeteve ku të jetë e dukshme edhe targa e mjetit. Në rastë se operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurë është i rregjistruar në një vënd të huaj, atëherë mjetet dhe makineritë duhet të jenë të vendosura në Republikën e Shqipërisë me rregjim të përkohshëm, e cila vërtetohet nëpërmjet dokumentit hyrës dhe një deklaratë ku të jetë e shënuar saktë adresa e këtyre mjeteve dhe makinerive.

Ofertuesi duhet të paraqes një deklaratë me shkrim të administratorit të shoqërisë ku deklaron se të gjitha mjetet e sipërcituara nuk janë në angazhim në asnjë objekt tjetër. Makinerite me qera, duhet të jene dhene me qera nga ana e pronarit të makinerise në vetem një subjekt. Në rast se makinerite do të rezultojnë të angazhuara në subjekte të tjera do të jete kusht skualifikimi. Deklaratë me shkrim nga administrator i shoqërisë që, AK rezervon të drejtën të kryejë në cdo kohë verifikimin fizikë të disponueshmërisë së mjeteve me apo pa paralajmërim paraprak (në rastë verifikimi në fjalë do të hartohet një procesverbal që do të nënshkruhet nga përfaqësuesi i AK dhe përfaqësuesi i shoqërisë ofertuese). Në këtë deklaratë ofertuesi duhet të bëjë deklarinimin e adresës së saktë të vendëndodhjes së mjeteve, me qëllim verifikimin e tyre. Mosparaqitja në formën e kërkuar përbën kushtë për skualifikim.

*Ky kriter përveç se nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish, konsiderohet diskrimues pasi sjell pabarazi ndërmejt OE. Referuar listës së mjeteve dhe makinerive të kërkuara, rezulton se janë kërkuar mjete të cilat nuk janë të lidhura ngushtë me natyrën dhe përmasat e objektit të kontratës si psh, grejder copë-2, asfalt-shtruese copë 2, ndërkohë që natyra dhe përmasa e objektit janë më të vogla krahasuar me preventivin e punimeve. Gjithashtu janë kërkuar mjete e makineri të cilat nuk janë në përputhje me preventivin e punimeve pasi nuk ka asnjë zë që lidhet me nevojën e përdorimit të tyre si psh; sondat e shpimit të pilotave, sondë shpimi për material shkëmbor, aparatet e saldimit, prerëse asfalti etj. Këto kërkesa ndikojnë në kufizimin e pjesmarrjes së tyre çka sjell për pasojë mundësinë e OE favorizues për lidhjen e kontratës në fjalë.*

7. Për efekt të kryerjes së punimeve në tërësi, ofertuesi duhet të ketë një staf bashkë me punonjës të siguruar mesatar **200 punonjës** per gjashte muajt e fundit. Për të vërtetuar këtë ofertuesi të paraqesë vërtetim lëshuar nga organet tatimore dhe listëpagesat te konfirmuara nga administrata tatimore perkatese me nenshkrim dhe vulë. Shkeljet e akteve ligjore apo akteve nënligjore në deklarinimin e listëpagesave për pagën dhe kontributet e punonjësve do të jenë kusht për skualifikimi.

*Ky kriter përveç se nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish, konsiderohet diskrimues pasi sjell pabarazi ndërmejt OE. Referuar listës së punonjësve të kërkuar, janë reth 84 duke filluar nga Drejtues Teknik dhe punonjës të natyrave të ndryshme për të përmbushur detyrimet kontraktuale, ndërkohë që një numër prej mesatarisht 200 punonjës për gjashtë muajt e fundit që i është kërkuar pjesëmarrësve ndikon në kufizimin e pjesmarrjes së tyre çka sjell për pasojë mundësinë e OE favorizues për lidhjen e kontratës në fjalë.*

8. Subjekti duhet të ketë staf të kualifikuar me inxhinier / specialistë me kontrate pune te lidhur para noterit .

- Drejtues Teknik inxhinier ndërtimi, 2 të punësuar. Kontratë individuale të punës me kohe te plote të lidhur para noterit, diplomë, me certifikatë të lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, CV si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë .

- Drejtues Teknik inxhinier hidroteknik, 2 të punësuar. Kontratë individuale të punës me kohe te plote të lidhur para noterit, diplomë, me certifikatë të lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, CV si dhe të figuroj në listëpagesat e shoqërisë.

- Drejtues Teknik inxhinier mekanik 2 të punësuar. Kontratë individuale të punës me kohe te plote të lidhur para noterit, diplomë, me certifikatë të lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, CV si dhe të figuroj në listëpagesat e shoqërisë.

- Drejtues Teknik inxhinier topograf/gjeodet/markshajder, 2 të punësuar. Kontratë individuale të punës me kohe te plote të lidhur para noterit, diplomë, me certifikatë të lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, CV si dhe të figuroj në listëpagesat e shoqërisë.

- Drejtues Teknik inxhinier mjedisi, 1 të punësuar. Kontratë individuale të punës me kohe te plote të lidhur para noterit, diplomë, me certifikatë të lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, CV si dhe të figuroj në listëpagesat e shoqërisë. Inxhinireri i mjedisit duhet te jete i paisur me certifikate per ndikimin ne Mjedis dhe Auditim Mjedisor, i pajisur me Licence Kodi II.1.A si dhe te jete i kualifikuar si "Pergjegjes per demet ne mjedis".

-Drejtues Teknik inxhinier ndertimit profili Gjeoteknike, 1 të punësuar. Kontratë individuale të punës me kohe te plote të lidhur para noterit, diplomë, me certifikatë të lëshuar nga IQT ose të

lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, CV si dhe të figuroj në listëpagesat e shoqërisë.

-Drejtues Teknik inxhinier Strukturist, 1 të punësuar. Kontratë individuale të punës me kohe te plote të lidhur para noterit, diplomë, me certifikatë të lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, CV si dhe të figuroj në listëpagesat e shoqërisë.

-Drejtues Teknik inxhinier Urbanist, 1 të punësuar. Kontratë individuale të punës me kohe te plote të lidhur para noterit, diplomë, me certifikatë të lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, CV si dhe të figuroj në listëpagesat e shoqërisë.

**Staf mbeshtetes:**

- 1 drejtues teknik, i punësuar të operatorit ekonomik, të jete i certifikuar për ushtrimin e profesionit "Ekspert privat zjarrefikës", për këtë duhet të paraqes certifikatë për ushtrimin e profesionit.

-1 drejtues teknik, i punesuar i operatorit ekonomik duhet te jete specialist per dhenien e ndihmes se pare, per kete duhet te paraqese Certifikaten e Ndhimes se pare te leshuar nga organet kompetente.

-1 inxhinier elektrik, i punesuar i operatorit ekonomik, Ekspert per ndihmen e pare dhe nderhyrjes ndaj emergjencave.

- 1 inxhinier ndërtimi, drejtues teknik i specializuar per Montim Cmontim, Modifikim Skelash.

-1 inxhinier ndertimi drejtues teknik, "Pergjegjes per mbrojtjen dhe menaxhimin e demeve ne mjedis".

Shoqëria duhet të paraqesë një deklaratë, nga administratori i shoqërisë, ku të percaktoj drejtuesin/t teknik të shoqërisëi/të cili/ët do të jetë/në i/të pranishëm gjatë të gjithë kohës që do të kryhen punime në objekt. Gjithashtu në këtë deklaratë administratori i shoqërisë duhet të deklarojë se autorizon Autoritetin Kontraktor për verifikimin e informacionit të dhënë për drejtuesin teknik. Mosparaqitja në formën e kërkuar përbën kusht për skualifikim.

9. Mjekë, 1 të punësuar., me kontrate individuale pune te lidhur para noterit i cili të jetë i pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë referuar VKM Nr.742, datë 6.11.2003 "Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë",shoqëruar me kontratë noteriale pune, diplomë dhe licensë. Në rast bashkim operatorësh të paktën njëri duhet ta plotësoj këtë kriter.

10. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar dhe te pasqyruar ne listepagesat e shoqerise, punonjesit e meposhtem:

- Hidraulik, shoqëruar me: kontratë idividuale te punes dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 5 të punësuar.

- Hekurkthyes, shoqëruar me: kontratë individuale te punes dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 3 të punësuar.

- Karpentjer, shoqëruar me: kontratë individuale te dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht3 të punësuar.

- Manovrator për makineritë e rënda, shoqëruar me: kontratë individuale te punes dhe leje manovrimi, minimalisht 10 të punësuar.

- Automakinist shoqeruar me kontrate individuale te punes dhe leje manovrimi minimalisht 4 të punësuar.

-Buldozerist shoqeruar me kontrate individuale te punes dhe leje manovrimi minimalisht 1 të punësuar.

- Murator, shoqëruar me: kontratë individuale te punes te lidhur para noterit dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 8 të punësuar.
- Mekanik, shoqëruar me: kontratë individuale te punes, dëftesë (diplomë)/ certifikate dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 5 të punësuar.
- Saldator, shoqëruar me: kontratë individuale dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 1 të punësuar.
- Montator, shoqëruar me: kontratë individuale te punes te lidhur para noterit dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 1 të punësuar.
- Specialist ndertimi, shoqëruar me: kontratë individuale te punes te lidhur para noterit dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 3 të punësuar.
- Shofer për drejtimin e mjeteve kamiona, shoqëruar me: kontratë individuale te punes te lidhur para noterit me afat jo me pak se 4 vjecar dhe leje drejtimi me kategorine "C" dhe/ose "CE" dhe/ose "D" dhe/ose "DE", minimalisht 11 të punësuar.
- Suvatues, shoqëruar me: kontratë individuale te punes te lidhur para noterit dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 2 të punësuar.
- Teknik ndërtimi, shoqëruar me: kontratë individuale te punes te lidhur para rnoterit me dëftesë (diplomë) dhe me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 3 të punësuar.

***Ky kriter nuk është i argumentuar ligjërisht se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës, i cili të jetë i argumentuar në përputhje me volumet dhe grafikun e punimeve.***

11. Grafiku i punimeve në përputhje me zërat e punës dhe me afatin kohor në dokumentet e tenderit.

12. Operatori ekonomik pjesëmarrës në tender së bashku me preventivin duhet të dorëzoj analizat teknike për secilin cmim të preventivit të ofertës. Bazuar ne VKM Nr.514, datë 15.8.2007 për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit pika 10.

Asnjë ofertues nuk mund të marrë pjesë në ofertën e dikujt tjetër për të njëjtën kontratë, në çfarëdo kapaciteti. Pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se një ofertë, tek e tek ose me një ofertues tjetër do të rezultojë në përjashtimin nga procesi i të gjithë ofertave, në të cilat është përfshirë ofertuesi.

Operatorët e huaj ekonomik, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe (si gjuhë e ofertës), për të gjithë përmbajtjen e dokumentit, të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe të jenë të certifikuara "Apostille". Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventen e Hagës, datë 5 tetor 1961, "për heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentëve zyrtare të huaja", duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. (mosparaqitja në këtë formë është kushtë skualifikues).

***Ky kriter nuk është i argumentuar ligjërisht se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës.***



**b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.**

Me urdhrin nr. 201 datë 08.02.2021, të titullarit të AK, nr.311 prot., datë 08.02.2021 është ngritur “Komisioni i vlerësimit të ofertave”, i përbërë prej, 1.M.S., 2.Xh.Ll., 3.F.Rr. emrat dhe profilet e personave të caktuar, kush është specialist i fushës. Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2 B/ OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. XX, të datës 23.03.2021, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/ S’kualifikuar
1	BOE “B.” B SHPK & “P.V.” SHPK & “B.-N” SHPK & “D.C.” SHPK	114,345,663	Kualifikuar
2	O.E “I.” 2020 SHPK	116,827,296	Kualifikuar

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 23.03.2021, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas verifikimit të dokumentacionit nga grupi i auditimit, Raportit përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, rezulton se kanë marrë pjesë dhe janë kualifikuar 2 OE, konkretisht 1. BOE “B.” B SHPK & “P.V.” SHPK & “B.-N” SHPK & “D.C.” dhe 2. O.E “I.” 2020 SHPK. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 23.03.2021 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë, BOE “B.” B SHPK & “P.V.” SHPK & “B.-N” SHPK & “D.C.” SHPK për të cilën është lidhur kontrata datë 19.04.2021 për vlerën 114,345,663 lekë me TVSH, dhe me afat **7 muaj** nga data e lidhjes së kontratës.

**Titulli i gjetjes:** Kriteret e kualifikimit të pa argumentuara, diskriminuese dhe të panevojshme për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, gjithashtu specifikimet teknike nuk kanë asnjë argumentim tekniko/ligjor.

**Situata:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt Nga Bashkia Peqin, Njësia e hartimit të kriterëve të kualifikimit, miratuar nga titullari i AK, rezulton se në mënyrë krejtësisht të paargumentuar dhe justifikuar, kanë hartuar dhe miratuar kriteret diskriminuese duke ulur ndjeshëm edhe efektivitetin, eficientën dhe ekonomikitetin e procedurës së prokurimit përmes vendosjes së kriterëve për një OE thuasje të paracaktuar. Vendosja e të gjitha kërkesave të veçanta për kualifikimin e operatorëve ofertues, nuk janë të sqaruara në mënyrë teknike dhe ligjore pasi; nuk argumentohet arsyeja e vendosjes së tyre, liçencat, certifikatat e kërkuara, mjetet e punës, numri i fuqisë punëtore etj. **Këto kriteret nuk duhet të vendosen pasi referuar LPP vendosja e tyre, ndikon në një ngushtim të konkurrencës së lirë, duke kufizuar pjesëmarrjen, dhe mostrajtim të barabartë ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, pasi nuk janë të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet. Veprime të cilat bien ndesh me qëllimin dhe parimet e kuadrit ligjor për prokurimin publik.**

Referuar grafikut të punimeve, specifikimeve teknike të projektit dhe relacionit teknik, nuk shpjegohet në asnjë moment përllogaritja e orëve të punës dhe argumentimi i stafit të kërkuar se si rezultat i kujt llogaritjeve është kërkuar një numër i tillë punonjësish. Për hartimin e specifikimeve teknike nuk është mbajtur procesverbali apo dokumentacion për argumentimin tekniko/ligjor të tyre. **Veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi titullari i AK z. L.T. dhe z. G.N., z. H.M. e zj. A.D. në cilësinë e anëtarëve të NjP.**

**Kriteri:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 ku citohet se;

Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

nenin 2, parimet e përgjithshme në të cialt citohet se;

Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme:

- a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve;
- b) transparencë në procedurat e prokurimit;
- c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve.

neni 12, Përgjegjësia e autoritetit kontraktor, pikat 1 dhe 5 ku përcaktohet se;

Autoriteti kontraktor është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij.

VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27, pika 3 e cila citon se;

*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

neni 61, pika 2, paragrafi dytë i cili citon se;

*.Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.*

**Ndikimi/Efekti:** Nuk nxit konkurrencën, mungesë pjesëmarrje, diskriminim dhe trajtim i pabarabartë i ofertuesve në procedurat e prokurimit.

**Shkaku:** Vendosja e kriterëve jo në përputhje me kuadrin ligjor të PP.

**Rëndësia:** I lartë.

**Rekomandimi:** Autoritetit Kontraktor Bashkia Peqin, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysht kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kriterëve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese, ndaj operatorëve ekonomikë.

## 2. Procedura e prokurimit me objekt “Ndertim i pritave lumore dhe perforcim i kembeve te Ures ne shtratin e Lumit Shkumbin, Bashkia Peqin” me të dhënat si më poshtë:

**a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt:** “Ndertim i pritave lumore dhe perforcim i kembeve te ures ne shtartin e Lumit Shkumbin, Bashkia Peqin”.

<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> “Procedure e Hapur REF-40726-09-06-2022 Urdhri nr. prot ., datë 06.09.2022	<b>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit</b> Urdhri nr.171 prot 1378., datë 06.09.2022 1.Xh.L. 2.Xh.S. 3.E.H.	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr.171 prot 1378., datë 06.09.2022 1.Xh.L. 2.Xh.S. 3.E.H.	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr.172 prot 1379., datë 06.09.2022. 1.F.Rr. 2.A.D. 3.D.M.
<b>4. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 47,213,352 (dyzet e shtatemilion e dyqinde trembedhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSh	<b>5. Oferta fituese, vlera fituese:</b> Bashkimi Operatoreve Fitues: BOE “LL.” SHPK & “V. K.” SHPK & “B. N” SHPK. Vlera: 46,186,995		<b>6. Diferenca me fondin limit</b> 1,026,357 ( nje milion e njezet e gjashte mijë e treqind e pesëdhjetë e shtate presje shtatedhjet e pese) lekë pa TVSh
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data .23.09.2022	<b>8. Burimi Financimit</b> Buxhet i Shtetit		<b>9. Operatoret Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender, <b>1.BO.E</b> : “LL.” SHPK & “V.K.” SHPK & “B. N”SHPK <b>2.O.E</b> “B. B” SHPK b) S’kualifikuar <b>O.E</b> “B. B” SHPK c) Kualifikuar ; <b>1.BO.E</b> : “LL.” SHPK & “V.K.” SHPK & “B. N”SHPK
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 3 muaj</b>			
<b>10.Ankimime</b> AK-s’ka/ APP-s’ka KPP-s’ka/	<b>11. Data e lidhjes të kontratës:</b> Nr. Prot 1613., datë 13.10.2022		<b>12.Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK Nuk ka</b>

***a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.***

Nga auditimi i dokumentacionit dosjes së procedurës së prokurimit me objekt “*Ndertim i Pritave lumore dhe perforcim i kembave te Ures ne shtratin e Lumit Shkumbin, Bashkia Peqin*”, me fond limit në shumën 47,213,352 (dyzet e shtatemilion e dyqinde trembedhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë e dy) ) lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate në shumën 46,186,995 (dyzet e gjashte milion e njeqind e tetëdhjetë e gjashte mijë e nentëqind e nentëdhjetë e pese presje shtatedhjetë e pese) lekë pa TVSh, kanë marrë pjesë BOE “LL.” SHPK & “V.K.” SHPK & “B. N” SHPK OE “B. B” SHPK nga të cilët BOE “LL.” SHPK & “V.K.” SHPK & “B. N” SHPK OE “B. B” SHPK është kualifikuar ka operatore ekonomike të s’kualifikuar OE “B. B” është skulifikuar per shkak se oferta ekonomike e paraqitur nga operatori ekonomik është mbi fondin limit te prokuruar nga Autoriteti Kontraktor, ku është shpallur fitues BOE “LL.” SHPK & “V.K.” SHPK & “B. N” SHPK me vlere 46 186 995,75 (dyzet e gjashte milion e njeqind e tetëdhjetë e gjashte mijë e nentëqind e nentëdhjetë e pese presje shtatedhjetë e pese) lekë pa TVSh, konstatohet se:

***AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogaritjen e Fondit Limit” ;***

-Nga ana e titullari i AK, në zbatim të LPP-së, me urdhrin nr.171 datë 06.09.2022 është ngritur grupi i punës “Për hartimin e specifikimeve teknike”, i përbërë prej, 1.Xh.L. (Ekonomist), 2. Xh.S. (Juriste) 3.E.H. (Inxhinier). Për hartimin e specifikimeve teknike është mbajtur procesverbali, datë 06.09.2022.

Për hartimin e specifikimeve teknike nga komisioni i krijuar për këtë qëllim, nuk është mbajtur asnjë akt apo dokumentacion mbi hartimin dhe argumentimin tekniko ligjor tyre. *Sipas personave të cilët kanë marrë pjesë në këtë procedurë, në mënyrë verbale shprehen se perlllogaritja e fondit limit është bazuar ne preventivin e pergatitur nga projektuesi , i cili është bazuar ne VKM NR.629*

DATE 15.07.2015 e cila rezulton të jetë 47,213,352 (dyzet e shtatë milion e dyqindë trembedhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSh.

**Titulli i gjegjes:** Nuk argumentohet dhe dokumentohet llogaritja e fondit limit dhe përzgjedhja e procedurës.

**Situata:** Nga ana e titullarit të AK, nuk ka urdhër për caktimin e një personi apo ngritjen e një komisioni për llogaritjen e vlerës së fondit limit të procedurës së prokurimit. Nisja e kësaj procedure referuar dhe inventarizit të dosjes, ka filluar me urdhrin e prokurimit nr. 171prot, datë 06.09.2022. Sipas Vkm nr.285, datë 19.05.2021, Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në nenin 77, përcaktohet se; “*Pas përllogaritjes së fondit limit sipas nenit 76 të këtyre rregullave, titullari i autoritetit kontraktor, nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit.*”. Pra nuk argumentohet dhe dokumentohet mënyra e llogaritjes së si është nxjerrë kjo vlerë limit e kontratës, veprim jo në përputhje me nenin 76, pika 2. Gjithashtu rezulton se nuk është bërë një përshkrim i punëve të cilat do të kryhen dhe arsyeja e përzgjedhjes së kësaj procedure prokurimi “E hapur punë”, veprim për të cilin mban përgjegjësi titullari i AK Z. L.T., anëtarët e njësisë së prokurimit, z. Xh.L., zj. Xh.S. dhe z. E.H., si dhe z. M.S. në cilësinë e personit përgjegjës për prokurimet.

**Kriteri:** VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, me 12, pika 4, ku citohet se:

*Autoriteti/enti kontraktor, në fazën e hartimit të nevojave për mallra, punë ose shërbime mban në konsideratë, metodat e përllogaritjes së vlerës së prokurimit. Vlera e përllogaritur e prokurimit duhet të jetë vlerë reale e përllogaritur përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit.*

Nenin 76, pika 2 ku citohet se;

*Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.*

**Ndikimi/Efekti:** Nuk dokumentohet përllogaritja e vlerës limit të kontratës dhe zgjedhja e procedurës së prokurimit.

**Shkaku:** Mosrespektimi i kuadrit ligjor të PP.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandim:** Titullari i Autoritetit Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimit, të marrin masat që, në procedurat e prokurimit në vijim, përpara hartimit të urdhrin të prokurimit të aplikojë mënyrën dhe përllogaritjen e vlerës së kontratës me qëllim dokumentimin dhe argumentimin e saj në përputhje me fondet buxhetore të miratuara. Gjithashtu të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e përzgjedhjes së procedurës së prokurimit.

**Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve”:**

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej 1. Xh.L., (Ekonomiste) 2.Xh.S. (Juriste) 3.E.H. (Inxhinier), janë evidentuar në procesverbalin e datës 06.09.2022 , të cilat janë si më poshtë;

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:**

**Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme**

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

*Ky kriter përveç se nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish, konsiderohet diskrimues pasi sjell pabarazi ndërmejt OE, pasi vlera e kërkuar e cila të jetë jo më e vogël se dyfishi i fondit limit, nuk është në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.*

**Plotesimi i njerit prej dy kushteve të siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.**

**2.3.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi". Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

#### **PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI**

- NP-1 A
- NP-5 B
- NP-8 A
- NP-12 B

#### **PUNIME SPECIALE NDERTIMI**

- NS-18 A

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukurës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). **Mosparaqitja në këto forme është kusht skualifikues.**

*Ky kriter për paraqitjen e licencave nuk është i argumentuar ligjërish se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës, gjithashtu janë kërkuar licenca të cilat nuk janë në përputhje dhe të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet dhe ndikon në kufizimin e pjesëmarrjes së tyre çka sjell për pasojë mundësinë e OE favorizues për lidhjen e kontratës në fjalë.*

**2.3.4** - Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht **51 persona**. Si dëshmi për fuqinë punëtore do të dorëzohen dokumentet si më poshtë;

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **Maj 2022- Korrik 2022**.

- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Maj 2022- Korrik 2022**.

- **2.3.5**-Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë**, si më poshtë:

- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi profile Strukturist
- **1 (një) Inxhinier Mekanik**
- 1 (nje) Inxhinier Gjeolog
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik profile Rruge Ura

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

Për sejcilin pjestar te stafit teknik te mesiperm duhet te paraqese, Kontrate pune e vlefshme, diplome , Libreze pune dhe CV (Drejtuesit teknik te jene te siguruar sipas legjislacionit ne fuqi për periudhën **Maj 2022- Korrik 2022**.

**Shënim: Në fazën e dytë operatori ekonomik duhet te deklaroje me shkrim se inxhinieret e kerkuar ne piken 2.3.5 jane te paangazhuar ne kontrata te tjera.**

**2.3.8-** Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm: diplome, libreze pune dhe kontrate pune të vlefshme

**2.3.9-** Operatori Ekonomik duhet te disponoje Staf Mbeshtetes si me poshte i cili duhet te figuroj ne listpagesat e shoqerise per periudhen **Maj 2022- Korrik 2022**.

- 2 (dy) Teknik Ndërtimi
- 2 (dy) Teknik Topograf
- 1 (nje) Teknik Mekanik
- 3 (tre) Murator
- 3 (tre) Saldator
- 4 (kater) Karpentier
- 4 (kater) Hekurkthyes
- Kontratat e punës individuale të vlefshme.
- Per stafin e mesiperm, Deshmia e kualifikimit/ certifikate dhe/ose diploma duhet te jene te leshuara nga institucione publike/private te licensuara sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne R.Sh.”, i ndryshuar.

**2.3.6** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar minimumi **3** (tre) manovratore me DAP, **2** (dy) Automaknist me DAP dhe **3** (tre) shofer kamionash, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë të punësuar për periudhën e kërkuar në pikën **2.3.4, dhe për secilin të paraqiten:**

- Kontratë pune të vlefshme.
- Dëshmi kualifikimi nga organet përkatëse sipas ligjit te transportit rrugore.
- Te paraqiten ne listepagesat perkatese minimalisht Maj 2022- Korrik 2022.

**2.3.10** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 15 ton	në pronësi ose me qira	Copë 4
2	Kamion vetëshkarkues kapacitet mbajtës min. 20 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
3	Kamioncine 3 deri ne 5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
4	Kamion me Vinc me kapacitet mbajtës 5-10 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Fadrome me Goma	në pronësi ose me qira	Copë 2

6	Eskavator me goma	në pronësi ose me qira	Copë 2
7	Eskavatore me Zinxhira	në pronësi ose me qira	Copë 2
10	Kamion me vinc me kapacitet ngrites 3.5 t dhe gjatesi krahu min 10 m	në pronësi ose me qira	Copë 2
11	Autobot uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
12	Betoniere kantieri	në pronësi ose me qira	Copë 2
13	Autopompe betoni	në pronësi ose me qira	Copë 2
14	Kulle ndricimi	në pronësi ose me qira	Cope 1
15	Autobetoniere	në pronësi ose me qira	Copë 2
16	Elektrosaldatrice	në pronësi ose me qira	Copë 2
16	Aparat topogjeodezik GPS	në pronësi ose me qira	Copë 1
17	Minieskavator	në pronësi ose me qira	Copë 1
18	Impiant prodhim Betoni me QKL	në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi	Cope 1
19	Nyje prodhim inertesh me QKL	në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi	Cope 1
20	Eskavator me kavo me krah min 30 m per germim dhe mbushje	në pronësi ose me qira	Cope 1
21	Vinc kapacitet mbajtes min 90 t	në pronësi ose me qira	Copë 1
22	Vibrator per ngulje palankole mbi 5t	në pronësi ose me qira	Cope 1
23	Palankola	në pronësi ose me qira	M2 15
24	Eskavator me Nofulla per Demolim ( prishje)	në pronësi ose me qira	Cope 1
25	Gjenerator	në pronësi ose me qira	Copë 1
26	Rimorkiator	në pronësi ose me qira	Copë 1
27	Ëellpoint/sistem drenazhimi i levizshem	në pronësi ose me qira	Copë 1
28	Gjenerator 50 kva	në pronësi ose me qira	Copë 1
29	Kontenier stacioner per zyre	në pronësi ose me qira	Copë 1
30	Rrul gome /hekur mbi 18 ton	Ne pronesi ose me qira	Cope 1
31	Rrul hekur/hekur	Ne pronesi ose me qira	Cope 1

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet ; -leja e qarkullimit; -çertifikaten e kontrollit teknik; siguracionin; certifikate transporti, fotot perkatese ku te duket qarte targa;
- Ndersa per mjete te marra me qira krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata noteriale e qirase, -leja e qarkullimit; -çertifikaten e kontrollit teknik; siguracionin; certifikate transporti me trete dhe me qera ose ne emer te kompanis qera marrese, fotot perkatese ku te duket qarte targa.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore perkatese, fotot ku te duket qarte dhe sherbimi i tij, ndersa per mjete te marra me qira krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata noteriale e qirase, e cila duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen deri ne perfundimin e plote te punimeve

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

-Për impiantin e prodhimit të inerteve dhe prodhimit të betonit të paraqiten dokumentat e pronësise ose kontratën e qerasë/kontrata e furnizimit shoqeruar me leje mjedisore te leshuar nga QKL si meposhte:

- QKL - Leje Mjedisi te tipit B, Kodi: III.1.B “Per impiant betoni, prodhimin e produkteve te betonit, shoqeruar me planvendosjen per Impiantin.

- QKL - Leje Mjedisi te tipit B, Kodi: III.1.B “Per impiant inertesh, shoqeruar me planvendosjen per Impiantin dhe leje shfrytezimi.

***Ky kriter për makineritë nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish, se për çfarë u janë kërkuar OE pjesëmarrës. Këto kërkesa të pa argumentuara mund të ndikojnë në kufizimin e pjesmarrjes së tyre.***

Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera. Për këtë të paraqitet një deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese se makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë deklaruar në një procedurë tjetër tenderimi në të cilën nuk është shpallur ende fituesi.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

### **2.3.11.Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

a-Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin çertifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:

ISO 9001:2015 Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë

ISO 14001:2015 Sistemet e Menaxhimit Mjedisor

OHSAS 18001-2007 ose ISO 45001-2018Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë

Të gjitha çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

***-Operatori ekonomik të disponojë Licencë QKL III.2.B, Grumbullim, Transportim, Ruajtje e mbetjeve jo të rrezikshme.***

***-Operatori ekonomik të këtë Licençe për Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis (Auditim mjedisor ndikim në mjedis) Kodi III.2.A (1+2).***

**2.3.11** Operatori ekonomik në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit përketes të publikuar në SPE, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontrate bashkepunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë si më poshtë:

- Hekur

Operatori ekonomik duhet të jetë pajisur dhe të paraqesin ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë “ e vlefshme ose ekuivalente për prodhimin ose furnizimin e materialeve që dote përdoren në ndërtimin e objektit të prokurimit .në rast paraqitje të autorizimit nga distributor duhet të paraqitet dokumentacioni që vrteton lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit të autorizuar.

*Ne kuader të realizimit të procedurës së prokurimit publik me nr. REF-40726-09-06-2022, me objekt “Ndërtim i pritave lumore dhe forçimi i kembeve të ures në shtratin e Lumit Shkumbin”, me fond limit 47.213.352.00 lekë pa TVSH dhe sugjerimeve në formën e asistencës të dërguara*



*nga ana e Agjencise se Prokurimit Publik ne lidhje me hartimin e kriterëve te prokurimit ,njesia e prokurimit prane Bashkise Peqin ka hartuar ndryshimet kriterëve te prokurimit sic po paraqesim si me poshte:*

**1.Pika 2.3.4**, të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar (**Ishte**):

“Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht **51 persona**.

Si dëshmi për fuqinë punëtore do të dorëzohen dokumentet si më poshtë;

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën Maj 2022- Korrik 2022.

- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Maj 2022- Korrik 2022”.

**1.Pika 2.3.4**, të kapacitetit teknik,

“Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht 51 persona.

Si dëshmi për fuqinë punëtore do të dorëzohen dokumentet si më poshtë;

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën \_\_Qershor 2022- Gusht 2022.

- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Maj 2022- Korrik 2022”.

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

### 3. 2.3.11 Kërkesa te tjera te vecanta per kualifikim

Operatori ekonomik ne perputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates te publikuar ne SPE, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontrate bashkepunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë si më poshtë materialin:

- Hekur

Operatori ekonomik ofertues duhet disponoje punonjës të specializuar/ kualifikuar dhe duhet te figuroj ne listpagesat e shoqerise per periudhen **Qershor 2022- Gusht 2022** si më poshtë:

- Operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre **1 (një)** inxhinier të pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M-së Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Për këtë duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë”, e dhënë nga një organizem i licencuar, shqiptar ose i huaj dhe kontrate pune.
- Operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre **1 (nje)** punonjës të pajisur me çertifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëritë e akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Për këtë duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit, e dhënë nga një organizem i licencuar, shqiptar ose i huaj dhe kontrate pune.

- Operatorët ekonomik të kenë 1 (një) mjek të përgjithshëm i cili të jetë i licensuar për ushtrim profesional sipas urdherit të mjekut shoqëruar me diplomë përkatëse, Licensë ushtrim profesionali përkatëse dhe kontrate pune.
- Operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre **1 (një)** punonjës të pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për dëmet në mjedis”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjes e mjedisit”, i ndryshuar. Për këtë duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit e dhënë nga një organizem i licensuar, shqiptar ose i huaj dhe kontrate pune.
- Operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre **1 (një)** inxhinier të pajisur me çertifikatë për “Auditues Energjie” certifikuar nga Agjencia për Eficencën e energjisë. Për këtë duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit e dhënë nga një organizem i licensuar, shqiptar ose i huaj dhe kontrate pune.
- Operatorët ekonomik të kenë minimuni **1 (një) person** që përmbush kriteret për të qenë “**Ekspert Zjarrfikës i pajisur me Licence I.2.A ose kompania të jete e pajisur me Licence I.2.A** në përputhje me pikën 4, të nenit 49, të Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”. Për këtë duhet të paraqitet Certifikatë/deshmi për ekspert zjarrfikës të leshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, diploma dhe kontrate pune.
- Operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre **1 (një)** inxhinier të pajisur me çertifikatë për “Ekspert për vlerësimin e ndikimit në mjedis”. Për këtë duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit e dhënë nga një organizem i licensuar, shqiptar ose i huaj dhe kontrate pune.

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

**Shënim: Në fazën e dytë operatori ekonomik duhet të deklarojë me shkrim se inxhinieret e kërkuar në pikën 2.3.5 janë të paangazhuar në kontrata të tjera**

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

Për secilin pjestar të stafit teknik të mesiperm duhet të paraqesë, Kontrate pune e vlefshme, diplome, Libreze pune dhe CV (Drejtuesit teknik të jete të siguruar sipas legjislacionit në fuqi për periudhën **Maj 2022- Korrik 2022**.

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit, dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë të paktën 6-muajt e fundit.

***Kriteret për stafin mbështetës dhe për punonjësit e kërkuar, përveç se nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish, konsiderohet diskrimues pasi sjell pabarazi ndërmejt OE. Referuar listës së punonjësve të kërkuar, janë reth 32 punonjës ku 1-“Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, 1-“Përgjegjës për dëmet në mjedis”, 1-“Ekspert Zjarrfikës i pajisur me Licence I.2.A ose kompania të jete e pajisur me Licence I.2.A, 1- “Ekspert për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, 1 (një) Inxhinier Mekanik, si dhe një numër prej mesatarisht 51 punonjës, që i është kërkuar ofertuesve, ndikon në kufizimin e pjesëmarrjes së tyre çka sjell për pasojë mundësinë e OE favorizues për lidhjen e kontratës në fjalë.***

***b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Me urdhrin nr.172 datë 06.09.2022, të titullarit të AK, nr.1379 prot., datë 06.09.2022 është ngritur “Komisioni i vlerësimit të ofertave”, i përbërë prej, 1. F.Rr. (Jurist), 2.A.D., (Inxhinierë) 3.D.M.

(Ekonomist). Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2 (dy) B/ OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. XX, të datës 13.04.2022, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	BOE "BOE "LL." SHPK & "V.K." SHPK & "B. N" SHPK	46,186,995	Kualifikuar
2	O.E "B. B" SHPK	49,365,964	S'kualifikuar;

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 28.09.2022, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas verifikimit të dokumentacionit nga grupi i auditimit, Raportit përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, rezulton se kanë dorëzuar oferta dy OE e konkretisht **BOE "LL." SHPK & "V.K." SHPK & "B. N" SHPK**. Është s'kualifikuar OE "B. B" SHPK për mungesë dokumentacioni, është kualifikuar BOE "LL." SHPK & "V.K." SHPK & "B. N" SHPK i cili plotëson kërkesat e vendosura të AK. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 28.09.2022 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë, **BOE "LL." SHPK & "V.K." SHPK & "B. N" SHPK** për të cilën është lidhur kontrata datë 13.10.2022 për vlerën 46 186 995,75 (dyzet e gjashte milion e njeqind e tetedhete e gjashte mije e nentëqind e nentëdhete e pese pesje shtatedhete e pese) lekë pa TVSh dhe me afat **3 muaj** nga data e lidhjes së kontratës.

**Titulli i gjetjes:** Kriteret e kualifikimit të pa argumentuara, diskriminuese dhe të panevojshme për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, gjithashtu specifikimet teknike nuk kanë asnjë argumentim tekniko/ligjor.

**Situata:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt Nga Bashkia Peqin, Njësia e hartimit të kriterëve të kualifikimit, miratuar nga titullari i AK, rezulton se në mënyrë krejtësisht të paargumentuar dhe justifikuar, kanë hartuar dhe miratuar kriteret diskriminuese duke ulur ndjeshëm edhe efektivitetin, eficientësinë dhe ekonomikitetin e procedurës së prokurimit përmes vendosjes së kriterëve për një OE thuasje të paracaktuar. Vendosja e të gjitha kërkesave të veçanta për kualifikimin e operatorëve ofertues, nuk janë të sqaruara në mënyrë teknike dhe ligjore pasi; nuk argumentohet arsyeja e vendosjes së tyre, Punë të ngjashme me vlerë jo më pak se dyfishi i fondit limit, liçencat, certifikatat e kërkuara, mjetet e punës, numri i fuqisë punëtore etj. **Këto kriteret nuk duhet të vendosen pasi referuar LPP vendosja e tyre, ndikon në një ngushtim të konkurrencës së lirë, duke kufizuar pjesëmarrjen, dhe mostrajtim të barabartë ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, pasi nuk janë të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet. Veprime të cilat bien ndesh me qëllimin dhe parimet e kuadrit ligjor për prokurimin publik.**

Referuar grafikut të punimeve, specifikimeve teknike të projektit dhe relacionit teknik, nuk shpjegohet në asnjë moment përllogaritja e orëve të punës dhe argumentimi i stafit të kërkuar se si rezultat i kujt llogaritjeve është kërkuar një numër i tillë punonjësish. Për hartimin e specifikimeve teknike nuk është mbajtur procesverbal apo dokumentacion për argumentimin tekniko/ligjor të tyre. ***Veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi titullari i AK z. L.T., z. Xh.L., zj. Xh.S. dhe z. E.H. në cilësinë e anëtarëve të NjP.***

**Kriteri:** Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 2 ku citohet se;

Qëllimi i këtij ligji është:

a) të rrisë eficientësinë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;  
c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;  
ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;  
d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;  
dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

nenin 3, parimet e përgjithshme në të cialt citohet se;

Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme:

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

neni 21, Autoriteti ose enti kontraktor, ku përcaktohet se;

*Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në kuptim të këtij ligji, është personi përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike.*

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39, pika 3 e cila citon se;

*Kërkesat e të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

neni 78, pika 2, paragrafi dytë i cili citon se;

*.Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.*

**Ndikimi/Efekti:** Nuk nxit konkurrencën, mungesë pjesëmarrje, diskriminim dhe trajtim i pabarabartë i ofertuesve në procedurat e prokurimit.

**Shkaku:** Vendosja e kriterëve jo në përputhje me kuadrin ligjor të PP.

**Rëndësia:** I lartë.

**Rekomandimi:** Autoritetit Kontraktor Bashkia Peqin, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kriterëve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese, ndaj operatorëve ekonomikë.

- 3.** Procedura e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i rruges Demir G. Peqin” me të dhënat si më poshtë:

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstrukcion i rruges Demir G. Peqin”.</b>			
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> “Procedure e Hapur e thjeshtuar” (pune) REF-Urdhri nr.198 date 03.10.2022	<b>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit</b> Urdhri nr.198 prot 1557., datë 03.10.2022 1.Xh.L. 2.Xh.S. 3.A.D.	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr.198 prot 1557., datë 03.10.2022 1.Xh.L. 2.Xh.S. 3.A.D.	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr.199 prot 1558., datë 03.10.2022. 1.M.S. 2.Xh.D. 3.D.M.
<b>4. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 21,748,393 lekë pa TVSh	<b>5. Oferta fituese, vlera fituese:</b> Bashkimi Operatoreve Fitues: BOE “LL.” ShPK & “G. C.” ShPK Vlera: 20,612,490 lekë pa TVSh	<b>6. Diferenca me fondin limit</b> 1,135,903 lekë pa TVSh	
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data.18.11.2022	<b>8. Burimi Financimit</b> Buxheti i Bashkise Peqin	<b>9. Operatorët Ekonomike</b> <b>a) Pjesëmarrës në tender,</b> <b>1.BOE</b> : “LL.” ShPK & “G.” C. ShPK <b>2.O.E</b> “D.” ShPK <b>3.O.E.P.GROUP</b> ShPK <b>4.BOE</b> “Sh.” ShPK & B. ShPK <b>b) S’kualifikuar</b> <b>1.O.E</b> “D.” ShPK <b>2.O.E.P.GROUP</b> ShPK <b>3.BOE</b> “Sh.” ShPK & B. ShPK <b>c) Kualifikuar ;</b> <b>1.BOE</b> : “LL.” ShPK & “G.” C. ShPK	
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 4 muaj</b>			
<b>10.Ankimime</b> AK-s’ka/ APP-s’ka KPP-s’ka/	<b>11. Data e lidhjes të kontratës:</b> Nr. Prot 2037, datë 23.12.2022	<b>12.Përgjigje</b> Ankesës nga APP, AK apo KKP: <b>AK Nuk ka</b>	

**a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.**

Nga auditimi i dokumentacionit dosjes së procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstrukcion i rruges Demir G. Peqin”, me fond limit në shumën 21,748,393 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate në shumën 20 612 490 (njetzet milion e gjashtëqind e dymbëdhjet e katerqind e nentedhjetë) lekë pa TVSh, kanë marrë pjesë **1.BOE** : “LL.” ShPK & “G.” C. ShPK **2.O.E** “D.” ShPK **3.O.E.P.GROUP** ShPK **4.BOE** “Sh.” ShPK & B. ShPK nga të cilët BOE “LL.” ShPK & “G.” C. ShPK është kualifikuar, ka operatore ekonomike të s’kualifikuar **1.O.E** “D.” ShPK, **2.O.E.P.GROUP** ShPK, **3.BOE** “Sh.” ShPK & B. ShPK, ku është shpallur fitues BOE “LL.” ShPK & “G. C.” ShPK me Vlere: 20,612,490 lekë pa TVSh konstatohet se:

**AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogaritjen e Fondit Limit”;**

-Nga ana e titullari i AK, në zbatim të LPP-së, me urdhrin nr.198 datë 03.10.2022 është ngritur grupi i punës “Për hartimin e specifikimeve teknike”, i përbërë prej, 1.Xh.L. (Ekonomist), 2. Xh.S. (Juriste) 3.A.D. (Inxhinier mjedisi). Për hartimin e specifikimeve teknike është mbajtur procesverbali, datë 16.11.2022.

Për hartimin e specifikimeve teknike nga komisioni i krijuar për këtë qëllim, nuk është mbajtur asnjë akt apo dokumentacion mbi hartimin dhe argumentimin tekniko ligjor tyre. *Sipas personave të cilët kanë marrë pjesë në këtë procedurë, në mënyrë verbale shprehen se përlllogaritja e fondit limit është bazuar ne preventivin e pergatitur nga projektuesi, i cili është bazuar ne VKM nr.629 DATE 15.07.2015 e cila rezulton të jetë 21,748,393 lekë pa TVSh.*

**Titulli i gjegjes:** Nuk argumentohet dhe dokumentohet llogaritja e fondit limit dhe përzgjedhja e procedurës.

**Situata:** Nga ana e titullarit të AK, nuk ka urdhër për caktimin e një personi apo ngritjen e një komisioni për llogaritjen e vlerës së fondit limit të procedurës së prokurimit. Nisja e kësaj procedure referuar dhe inventarizit të dosjes, ka filluar me urdhrin e prokurimit nr. 198prot, datë 03.10.2022. Sipas Vkm nr.285, datë 19.05.2021, Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në nenin 77, përcaktohet se; “.Pas përlllogaritjes së fondit limit sipas nenit 76 të këtyre rregullave, titullari i autoritetit kontraktor, nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit.”. Pra nuk argumentohet dhe dokumentohet mënyra e llogaritjes së si është nxjerrë kjo vlerë limit e kontratës, veprim jo në përputhje me nenin 76, pika 2. Gjithashtu rezultoi se nuk është bërë një përshkrim i punëve të cilat do të kryhen dhe arsyeja e përzgjedhjes së kësaj procedure prokurimi “E hapur punë”, veprim për të cilin mban përgjegjësi titullari i AK Z. L.T., anëtarët e njësisë së prokurimit, z. Xh.L., zj. Xh.S. dhe zj. A.D., si dhe z. M.S. në cilësinë e personit përgjegjës për prokurimet.

**Kriteri:** VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, me 12, pika 4 dhe Nenin 76, pika 2.

**Ndikimi/Efekti:** Nuk dokumentohet përlllogaritja e vlerës limit të kontratës dhe zgjedhja e llojit të procedurës së prokurimit.

**Shkaku:** Mosrespektimi i kuadrit ligjor të PP.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandim:** Titullari i Autoritetit Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimit, të marrin masat që, në procedurat e prokurimit në vijim, përpara hartimit të urdhrin të prokurimit të aplikojë mënyrën dhe përlllogaritjen e vlerës së kontratës me qëllim dokumentimin dhe argumentimin e saj në përputhje me fondet buxhetore të miratuara. Gjithashtu të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e përzgjedhjes së procedurës së prokurimit.

### ***Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Krieteve”:***

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej 1. Xh.L. (Ekonomiste), 2.Xh.S. (Juriste) 3.A.D. (Inxhinierë), janë evidentuar në procesverbalin e datës 16.11.2022, ku disa prej tyre nuk argumentohen se për çfarë janë kërkuar, të cilat janë si më poshtë;

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **Kapaciteti teknik:**

**Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:**

#### **1. Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:**

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- N.P-1 A (Punime gërmimi në tokë)
- N.P-4 A (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale)
- N.S-1 A (Punime për prishjen e ndertimeve)
- N.S-6 A (Sinjalistika rrugore jo ndricuese)

***Ky kriter për paraqitjen e licencave nuk është i argumentuar ligjërisht se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës, gjithashtu janë kërkuar licenca të cilat nuk janë në përputhje dhe të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet dhe ndikon në kufizimin e pjesëmarrjes së tyre çka sjell për pasojë mundësinë e OE favorizues për lidhjen e kontratës në fjalë.***

2. Një punësim mesatar i të paktën **30 (tridhjetë)** personave, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore per periudhen e fundit të deklaruar.

b. Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen e fundit të deklaruar, shoqëruar me formularet e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

3. Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë").*

4. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar me kontratë punë të vlefshme, diplome lëshuar nga autoritetet pergjegjese shteterore, mbështetur ne Ligjin Nr. 15/2017 "PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve), si dhe të figurojnë ne listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- 1 (nje) Teknik ndertimi
- 2 (dy) punonjes elektrikiste;
- 1 (nje) punonjes mekanik
- 1 (nje) punonjes hekurkthyes
- 1 (nje) punonjes bojaxhi
- 1 (nje) punonjes saldator

5. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 4 (kater) punonjës manovrator, për të cilët duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, Dëshmi e Aftësisë Profesionale (të vlefshme) lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin kur punonjësit Manovrator janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

***Kriteret për stafin mbështetës dhe për punonjësit e kërkuar, përveç se nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish, konsiderohet diskrimues pasi sjell pabarazi ndërmejt OE. Referuar listës së punonjësve të kërkuar, janë reth 15 punonjës dhe një numër prej mesatarisht 30 punonjës, që i është kërkuar ofertuesve, ndikon në kufizimin e pjesmarrjes së tyre çka sjell për pasojë mundësinë e OE favorizues për lidhjen e kontratës në fjalë.***

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e

Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).

**b)** Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 14001-2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).

**c)** Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).

**d)** *Çertifikatën e menaxhimit te energjise ISO 50001-2011* (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit do të marrë përsipër realizimin e zërave elektrikë të Preventivit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

**7.** Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1.	Vinç me Kosh	Copë	1	Në pronësi ose me qera
2.	Vibrator thellesie	Copë	2	Në pronësi ose me qera
3.	Autobetoniere	Copë	1	Në pronësi ose me qera
4.	Rul me vibrim	Copë	2	Në pronësi ose me qera
5.	Autobot Uji	Copë	1	Në pronësi ose me qera
6.	Eskavator me goma 0.25 m3	Copë	2	Në pronësi ose me qera
7.	Sperkates boje	Copë	1	Në pronësi ose me qera
8.	Makineri per skarifikim asfalti	Copë	2	Në pronësi ose me qera
9.	Grejder	Copë	1	Në pronësi ose me qera
10.	Rul me Kompresor	Copë	2	Në pronësi ose me qera
11.	Autobitumatrice	Copë	1	Në pronësi ose me qera
12.	Asfaltoshtruese	Copë	1	Në pronësi ose me qera
13.	Betoniere 500l	Copë	2	Në pronësi ose me qera
14.	Minieskavator	Copë	2	Në pronësi ose me qera
15.	Fadrome me goma	Copë	2	Në pronësi ose me qera
16.	Skeleri	m2	2000	Në pronësi ose me qera
17.	Kamion vetshkarkues mbi 20 Ton	Copë	2	Në pronësi ose me qera
18.	Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes 10-20 Ton	Copë	1	Në pronësi ose me qera
19.	Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes 3.5-10 Ton	Copë	1	Në pronësi ose me qera

**a.** Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit: (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

**b.** Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).



c. Për mjetet e deklaruara që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).

d. Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

e. Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatorit ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme ne nje foto te vetme mjeteve dhe targa e tij.

f. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

g. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

***Ky kriter për makineritë nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish, se për çfarë u janë kërkuar OE pjesëmarrës. Këto kërkesa të pa argumentuara mund të ndikojnë në kufizimin e pjesëmarrjes së tyre.***

*Ka pasur ndryshime te DST pas rekomandimeve nga APP te pasqyruara ne shtojcen 27.03.2022 Për ndryshimin e kërkesave të Proçedures se Prokurimit me objekt: “Ndertimi i tregut te te fruta perimeve”.*

Pas dergimit te disa rekomandimeve nga ana e Njesise se Kordinimit te APP, te ardhura ne adrese te emailit te personit pergjegjes per kete procedure prokurimi, Njesia e prokurimit vendosi te beje ndyshimet e meposhtme:

1. Pika 4.1 e kapacitetit teknik behet:

. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, te perfshire ne licensen e shoqerise ne cilesine e drejtuesit teknik, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi;
- 1 (një) inxhinier Elektrik;
- 1 (një) inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder;

**Bazuar ne neni 75 te ligjit nr.162, date 23.12.2020:**

***b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Me urdhrin nr.199 datë 03.10.2022, të titullarit të AK, nr.1558 prot., datë 03.10.2022 është ngritur “Komisioni i vlerësimit të ofertave”, i përbërë prej, 1.M.S. (Ekonomist), 2.Xh.D. (Juriste) 3.D.M. (Ekonomist). Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 4 (kater) B/ OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. XX, të datës 30.11.2022, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	BOE “LL.” ShPK & “G. C.” ShPK	20,612,490	Kualifikuar
2	O.E “D.” ShPK	17,674,716	S'kualifikuar;

3	BOE "Sh." ShPK & "B 93" II ShPK	18,507,520	S'kualifikuar;
4	P.Group" ShPK	17,007,800	S'kualifikuar;

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 12.12.2022, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas verifikimit të dokumentacionit nga grupi i auditimit, Raportit përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, **BOE "LL." ShPK & "G. C." ShPK** operatorë pjesëmarrës. Ka të s'kualifikuar **1.O.E "D." ShPK, 2.O.E.P.GROUP ShPK, 3.BOE "Sh." ShPK & B. ShPK**, për mungesë të dokumentacionit dhe kriterëve të kërkuara nga AK Referuar raportit të vlerësimit të ofertave është kualifikuar **BOE 1. "LL." ShPK & "G. C." ShPK**. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 12.12.2022 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë, **BOE "LL." ShPK & "G. C." ShPK**, i cili plotëson dokumentacionin e kërkuar, për të cilën është lidhur kontrata datë 23.12.2022 për vlerën 20,612,490 (njetzet milion e gjashtëqind e dymbëdhjet e katerqind e nentëdhjetë) lekë pa TVSh dhe me afat **4 muaj** nga data e lidhjes së kontratës.

**Titulli i gjetjes:** Kriteret e kualifikimit të pa argumentuara, diskriminuese dhe të panevojshme për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, gjithashtu specifikimet teknike nuk kanë asnjë argumentim tekniko/ligjor.

**Situata:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt Nga Bashkia Peqin, Njësia e hartimit të kriterëve të kualifikimit, miratuar nga titullari i AK, rezulton se në mënyrë krejtësisht të paargumentuar dhe justifikuar, kanë hartuar dhe miratuar kriteret diskriminuese duke ulur ndjeshëm edhe efektivitetin, eficiencën dhe ekonomikitetin e procedurës së prokurimit përmes vendosjes së kriterëve për një OE thuasje të paracaktuar. Vendosja e të gjitha kërkesave të veçanta për kualifikimin e operatorëve ofertues, nuk janë të sqaruara në mënyrë teknike dhe ligjore pasi; nuk argumentohet arsyeja e vendosjes së tyre, Punë të ngjashme me vlerë jo më pak se dyfishi i fondit limit, liçencat, certifikatat e kërkuara, mjetet e punës, numri i fuqisë punëtore etj. **Këto kriteret nuk duhet të vendosen pasi referuar LPP vendosja e tyre, ndikon në një ngushtim të konkurrencës së lirë, duke kufizuar pjesëmarrjen, dhe mostrajtim të barabartë ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, pasi nuk janë të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet. Veprime të cilat bien ndesh me qëllimin dhe parimet e kuadrit ligjor për prokurimin publik.**

Referuar grafikut të punimeve, specifikimeve teknike të projektit dhe relacionit teknik, nuk shpjegohet në asnjë moment përllogaritja e orëve të punës dhe argumentimi i stafit të kërkuar se si rezultat i kujt llogaritjeve është kërkuar një numër i tillë punonjësish. Për hartimin e specifikimeve teknike nuk është mbajtur procesverbali apo dokumentacion për argumentimin tekniko/ligjor të tyre. ***Veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi titullari i AK z. L.T., z. Xh.L., zj. Xh.S. dhe zj. A.D. në cilësinë e anëtarëve të NjP.***

**Kriteri:** Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 2, nenin 3, neni 21, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, neni 39, pika 3, neni 78, pika 2, paragrafi dytë.

**Ndikimi/Efekt:** Nuk nxit konkurrencën, mungesë pjesëmarrje, diskriminim dhe trajtim i pabarabartë i ofertuesve në procedurat e prokurimit.

**Shkaku:** Vendosja e kriterëve jo në përputhje me kuadrin ligjor të PP.

**Rëndësia:** I lartë.

**Rekomandimi:** Autoritetit Kontraktor Bashkia Peqin, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kriterëve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me

procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuuese, ndaj operatorëve ekonomikë.

**4.** Procedura e prokurimit me objekt “*Ndertim dhe sistemim gabioni i perroit te Rrushtes, Nj.ADM Karine, Bashkia Peqin*” me të dhënat si më poshtë:

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt:</b> “ <i>Ndertim dhe sistemim gabioni i perroit te Rrushtes,Nj.ADM Karine, Bashkia Peqin</i> ”.			
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> “Negocim pa shpallje paraprake te njoftimit te kontrates (pune)” REF-89980-03-15-2021 Urdhri nr.58 prot 517., datë 12.03.2021	<b>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit</b> Urdhri nr. 46 prot 409., datë 23.02.2021  1.G.N. 2.H.M. 3.A.D.	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. 46 prot 409., datë 23.02.2021  1.G.N. 2.H.M. 3.A.D.	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b>  Urdhri nr.59 prot 410., datë 23.02.2021.  1.M.S. 2.Xh.LI. 3.F.Rr.
<b>4. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 15,114, 948 lekë pa tvsh	<b>5. Oferta fituese, vlera fituese:</b> Operatori Fitues: BOE LL. ShPK & M. ShPK 14,789,250 lekë pa tvsh		<b>6. Diferenca me fondin limit</b> 325 698 (treqind e njezet e pesemije e gjashteqind e nentehjete e tete)
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data.19.03.2021	<b>8. Burimi Financimit</b> Buxheti i Shtetit		<b>9. Operatorët Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender, <b>OE 1.BOE LI. ShPK &amp; M. ShPK</b> <b>2.OE “B. B”</b> b) S’kualifikuar <b>NUK KA</b> c) Kualifikuar “ <b>1.BOE LI. ShPK &amp; M. ShPK</b> <b>2.OE “B. B”</b>
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 2 muaj nga data e lidhjes se kontrates</b>			
<b>10.Ankimime</b> AK-s’ka/ APP-s’ka KPP-s’ka/	<b>11. Data e lidhjes të kontratës:</b> <b>Nr. Prot 692, datë 15.04.2021</b>		<b>12.Përgjigje</b> Ankesës nga APP, AK apo <b>KKP: AK Nuk ka</b>

**a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.**

Nga auditimi i dokumentacionit dosjes së procedurës së prokurimit me objekt “*Ndertim dhe sistemim gabioni i perroit te Rrushtes, Nj.ADM Karine, Bashkia Peqin*”, me fond limit në shumën 15,114,948 (pesëmbëdhjetë milion e njëqind e katërmbëdhjetë mijë e nentëqind e dyzet e tete ) lekë pa tvsh, dhe vlerë kontrate në shumën 14 789 250 lekë pa tvsh, kanë marrë pjesë **BOE LI. ShPK & M. ShPK dhe 2.OE “B. B”**, nga të cilët **BOE LI. Boshnjaku ShPK & M. ShPK dhe OE “B. B** janë kualifikuar nuk ka operatore ekonomike të s’kualifikuar, ku është shpallur fitues **BOE LI. ShPK & M. ShPK** me vlerë oferte në shumën 14,789,250,lekë pa tvsh konstatohet se: **AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogaritjen e Fondit Limit”;**  
-Nga ana e titullarit të AK, z. L.T., nuk janë marrë masat e duhura për krijimin e komisioneve përkatëse për hartimin e fondit limit të procedurës së prokurimit. Nga ana e titullari i AK, në zbatim të LPP-së, me urdhrin nr. 46 datë 23.02.2021 është ngritur grupi i punës “Për hartimin e specifikimeve teknike”, i përbërë prej, 1.G.N., 2. H.M. 3.A.D. Për hartimin e specifikimeve teknike nga komisioni i krijuar për këtë qëllim, nuk është mbajtur asnjë akt apo dokumentacion mbi hartimin dhe argumentimin tekniko ligjor tyre. *Sipas personave të cilët kanë marrë pjesë në këtë procedurë, në mënyrë verbale shprehen se përlllogaritja e fondit limit eshte bazuar ne*

*preventivin e pergatitur nga projektuesi, i cili eshte bazuar ne VKM NR.629 DATE 15.07.2015 e cila rezulton të jetë 15,114,948 lekë pa tvsh, por kjo e pa dokumentuar.*

**Titulli i gjegjes:** Nuk argumentohet dhe dokumentohet llogaritja e fondit limit dhe përzgjedhja e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të kontratës.

**Situata:** Nga ana e titullarit të AK, nuk ka urdhër për caktimin e një personi apo ngritjen e një komisioni për llogaritjen e vlerës së fondit limit të procedurës së prokurimit. Nisja e kësaj procedure referuar dhe inventarizit të dosjes, ka filluar me urdhrin e prokurimit nr. 310 prot, datë 08.02.2021. Sipas Vkm nr.914, datë 29.12.2014, Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në nenin 60, përcaktohet se; “*.Pas përlllogaritjes së fondit limit sipas nenit 59 të këtyre rregullave, titullari i autoritetit kontraktor, nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit.*”. Pra nuk argumentohet dhe dokumentohet mënyra e llogaritjes së si është nxjerrë kjo vlerë limit e kontratës, veprim jo në përputhje me nenin 59, pika 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Gjithashtu rezulton se nuk është bërë një përshkrim i punëve të cilat do të kryhen dhe arsyeja e përzgjedhjes së kësaj procedure prokurimi “Negociim pa shpallje paraprake të kontratës”. Referuar dokumentacionit të dosjes së procedurës, nuk argumentohet në asnjë rast kushtet e përzgjedhjes së kësaj procedurë ku, edhe në rast nevojë ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikuara, AK, duhet të plotësohen kushtet për përzgjedhjen e procedurës sipas nenit 33 të LPP. Veprime për të cilat mban përgjegjësi *titullari i AK Z. L.T., anëtarët e njësisë së prokurimit, zj. G.N., z. H.M. e z. A.D., si dhe z. M.S. në cilësinë e personit përgjegjës për prokurimet.*

**Kriteri:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, nenin 2, neni 12, Përgjegjësia e autoritetit kontraktor, pikat 1 dhe 5, Neni 33, pikat 1 e 2, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenin 36, pika 2, me nenin 59, pika 2.

**Ndikimi/Efekti:** Nuk dokumentohet përlllogaritja e vlerës limit të kontratës, nuk argumentohet nevoja emergjente e kësaj procedure.

**Shkaku:** Mosrespektimi i kuadrit ligjor të PP.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Titullari i Autoritetit Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimit, të marrin masat që, në procedurat e prokurimit në vijim, përpara hartimit të urdhrin të prokurimit të aplikojë mënyrën dhe përlllogaritjen e vlerës së kontratës me qëllim dokumentimin dhe argumentimin e saj në përputhje me fondet buxhetore të miratuara. Gjithashtu të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e përzgjedhjes së procedurës së prokurimit.

### ***Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Krieteve”:***

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej 1.G.N., 2.H.M., 3.A.D. emrat e komisionit dhe profilet e fushës së secilit anëtar, janë hartuar kriteret e kualifikimit, të reflektuara në Dokumentet e Tenderit, por disa prej tyre nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht, të cilat janë si më poshtë;

### **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

#### **3. Për kapacitetin teknik:**

Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

**3.1.** Punë të ngjashme për një kontratë të vetme të së njëjtës natyrë me objektin që prokurohet në një vlerë jo më pak se **30%** të fondit limit, të realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e

zhvillimit te tenderit, ku zerat e punimeve respektive plotesojne kriteret minimale te preventivit te objektit ne prokurim; ose

**3.2.** Punë të ngjashme ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit të jetë jo më pak se **200% i fondit limit**, ku zerat e punimeve respektive plotesojne kriteret minimale te preventivit te objektit ne prokurim.

*Ky kriter përveç se nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjrisht, konsiderohet diskrimues pasi sjell pabarazi ndërmejt OE, pasi vlera e kërkuar e cila të jetë jo më e vogël se dyfishi i fondit limit, nuk është në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

Plotësimi i njërës prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bënë ofertën të kualifikueshme.

### **Licenca profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.**

Ofertuesi duhet të jetë i pajisur me licencë profesionale të shoqërisë, me kategoritë:

N.P - 1 A Punime gërmimi në tokë.

**N.P - 4 A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha,**

N.S - 7 A Barriera dhe mbrojtje rrugore.

*Ky kriter për paraqitjen e licencave nuk është i argumentuar ligjrisht se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës, gjithashtu janë kërkuar licenca të cilat nuk janë në përputhje dhe të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet dhe ndikon në kufizimin e pjesmarrjes së tyre çka sjell për pasojë mundësinë e OE favorizues për lidhjen e kontratës në fjalë.*

Për Operatorët e huaj të bëhet njëhësimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës. Deklaratë e disponueshmërisë së makinerive, sipas shtojcës 9, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Nr	LLOJI I MAKINERIVE	DISPONIMI	SASIA
1	Kamion, mbi 18 ton	Në pronësi ose me qira	Copë 1
2	Kamion, nga 7.5 deri 18 ton	Në pronësi ose me qira	Copë 1
3	Kamion me vinç	Në pronësi ose me qira	Cope 1
4	Skrep me goma	Në pronësi ose me qira	cope 1
5	Eskavator me zinxhir	Në pronësi ose me qira	cope 2
6	Fadrome	Në pronësi ose me qira	Cope 1
7	Betoniere	Në pronësi ose me qira	Cope 5
8	Vibrator betoni	Në pronësi ose me qira	Cope 2
9	Armaturë (dërrase ose panele)	Në pronësi ose me qira	m2 200
10	Flesibel	Në pronësi ose me qira	Cope 2
11	Fikëse zjarri	Në pronësi ose me qira	Cope 5
12	Kuti e ndihmës së shpejte	Në pronësi ose me qira	Cope 10
13	Kaskë pune sigurie/kapele minatori	Në pronësi ose me qira	Cope 10
14	Rrip sigurimi	Në pronësi ose me qira	Cope 10
15	Jelekë fosforeshent	Në pronësi ose me qira	Cope 10
16	Tabela sigurie	Në pronësi ose me qira	Cope 5
17	Nyje fraksionimi inertesh, shoqëruar me dokumente që vërtetojnë pronësinë, planin e vendosjes dhe lejen mjedisore Kodi: III.1.A, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit ose leja mjedisore të lëshuar nga Ministria e Mjedisit	Në pronësi, qira ose kontratë noteriale furnizimi.	Cope 1

a) Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme), foto te mjetit.

b) Për mjetet e siguruara me qira, dokumenti që verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, fotografi të mjetit, (te vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën perkatese noteriale të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes dhe fotografi të mjetit.

c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij, fotografi të tyre.

d) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).

e) Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e pershkruara në pikën 2.3.5 të Kapcitetit Teknik do të jenë të angazhuara vetëm në këto kontrate. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet pergjate afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.

Makineritë – pajisjet në pronësi të vërtetohen me anë të aktit të pronësisë (kontrata e blerjes apo dhurimi, fature çdoganimit, fatura tatimore perkatese, etj). Ato të marra me qera të shoqërohen me aktin e pronësisë së qiradhënësit (kontrata e blerjes apo dhurimi, fature çdoganimit, fatura tatimore perkatese, etj), me kontratë noteriale qiraje (ose formë tjetër huaje) e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në përfundimin e plotë të punimeve. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqiten edhe: leje qarkullimi, certifikatë e kontrollit teknik, policën e sigurimit të mjeteve, certifikatë për transport material dhe foto të mjeteve ku të jetë e dukshme edhe targa e mjetit. Në rast se operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurë është i regjistruar në një vënd të huaj, atëherë mjetet dhe makineritë duhet të jenë të vendosura në Republikën e Shqipërisë me rregjim të përkohshëm, e cila vërtetohet nëpërmjet dokumentit hyrës dhe një deklaratë ku të jetë e shënuar saktë adresa e këtyre mjeteve dhe makinerive.

***Ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish, se për çfarë u janë kërkuar OE pjesëmarrës. Këto kërkesa të pa argumentuara mund të ndikojnë në kufizimin e pjesëmarrjes së tyre.***

Ofertuesi duhet të paraqes një deklaratë me shkrim të administratorit të shoqërisë ku deklaron se të gjitha mjetet e sipërcituara nuk janë në angazhim në asnjë objekt tjetër. Deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë që, Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizikë të disponueshmërisë së mjeteve me apo pa paralajmërim paraprak që nga momenti i hapjes së ofertave (në rastë verifikimi në fjalë do të hartohet një procesverbal që do të nënshkruhet nga përfaqësuesi i AK dhe përfaqësuesi i shoqërisë ofertuese). Në këtë deklaratë ofertuesi duhet të bëjë deklarinë e adresës së saktë të vendndodhjes së mjeteve, me qëllim verifikimin e tyre. Mosparaqitja në formën e kërkuar përbën kushtë për skualifikim.

89. Për efekt të kryerjes së punimeve në tërësi, ofertuesi duhet të ketë një staf bashkë me punonjës të siguar mesatar **25 punonjës** (me kohe të plotë) për periudhën **dhjetor 2020–janar 2021**. Për të vërtetuar këtë ofertuesi të paraqesë vërtetim lëshuar nga organet tatimore dhe listëpagesat të konfirmuara nga administrata tatimore perkatese me nënshkrim dhe vulë. Shkeljet e akteve ligjore apo akteve nënligjore në deklarinë e listëpagesave për pagën dhe kontributet e punonjësve do të

jenë kusht për skualifikimi. Të gjithë të punësuarit duhet të jenë të deklaruar në listëpagesat e shoqërisë sipas kushteve të përcaktuar në kontratë punës.

**90. Staf kryesor e mbështetes, punonjesit, certifikimet**

a. Operatori/et ekonomike ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga administratori) stafin teknik të shoqërisë, si më poshtë:

Numri	Pozicioni	Vitet e punës pranë shoqërisë
<b>Stafi Kryesor</b>		
1 (nje)	Inxhinier Ndertimi – si Drejtues Projekti gjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës te perfshire ne licencen e shoqerise si drejtues teknik	3 vjet

*Kriteret për stafin mbështetës dhe për punonjësit e kërkuar, përveç se nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjrisht, konsiderohet diskrimues pasi sjell pabarazi ndërmejt OE. Referuar listës së punonjësve të kërkuar, janë reth 9 duke filluar nga Drejtues projekti me licencën e shoqërisë si drejtues teknik dhe punonjës të natyrave të ndryshme për të përmbushur detyrimet kontraktuale, ndërkohë që një numër prej mesatarisht 25 punonjës me kohë të plotë për 13 muaj, që i është kërkuar ofertuesve, ndikon në kufizimin e pjesmarrjes së tyre çka sjell për pasojë mundësinë e OE favorizues për lidhjen e kontratës në fjalë.*

Përvoja e punës pranë shoqërisë është tregues i aftësive organizative, reputacionit dhe besueshmërisë së një operatori ekonomik. Marrëdhëniet e stafit teknik me shoqërinë rregullohen sipas kontratës së punës dhe në stafin teknik të shoqërisë nuk mund të jenë persona që janë të angazhuar në çdo punëmarrje publike. Paqëndrueshmëria e stafit teknik në vecanti dhe e punonjësve në përgjithësi është tregues i paqëndrueshmërisë i vetë shoqërisë. Përvoja e punës dhe eksperiencia ndikon në efencën dhe zbatimin e kontratës. Largimi i shpeshtë dhe brenda afateve të shkurtra i stafit teknik të shoqërisë, përveç paqëndrueshmërisë së strukturës organizative të shoqërisë pengon po ashtu rritjen e ekspertizës dhe eksperiencës së këtij stafi.

**Për stafin e mësipërm të paraqiten:**

- Kontratë punë e noterizuar
- Diploma/certifikata
- **Stafi kryesor** të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë për periudhën e përcaktuar si staf i shoqërisë

*Operatori Ekonomik duhet te deklaroje me shkrim se inxhinieret dhe punonjesit e kerkuar ne piken 2.3.3/a, jane te paangazhuar ne kontrata te tjera. Konstatimi i dypunesimit te stafit teknik perben shkak per skualifikim te menjerhershem dhe deklarate te rreme sipas nenit 13 te ligjit nr.9643 date 20.11.2009 “Per prokurimin publik”.*

-Per drejtuesit teknik, inxhinieret, stafi teknik i mesem, manovraret, specialistat dhe punetoret e ofertuesit, duhet te jene te punesuar me kontrate pune me kohe te plote jo me pak se 8 ore pune ne dite, vlere e pages e deklaruar ne listepagese, vlere e pages e kaluar ne llogarin bankare te punonjesit te jete e barabarte me vleren e përcaktuar ne kontraten e punes. Per kete duhet te paraqitet ekstrakti i llogarise bankare, listepagesat dhe kontrat e punes.

91. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar dhe te pasqyruar ne listepagesat e shoqerise, nga muaji dhjetor 2020 e ne vijim, punonjesit e meposhtem:

- Manovrator për makineritë e rënda, shoqëruar me: kontratë pune dhe leje manovrimi, minimalisht **2 të punësuar**.

- Murator, shoqëruar me: kontratë pune dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht **1 të punësuar**.

- Mekanik, shoqëruar me: kontratë pune, dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht **1 të punësuar**.
- Shofer për drejtimin e mjeteve kamiona, shoqëruar me: kontratë pune dhe leje drejtimi me kategorine "C" dhe/ose "CE" dhe/ose "D" dhe/ose "DE", minimalisht **4 të punësuar**.

**b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.**

Me urdhrin nr. 59 datë 12.03.2021, të titullarit të AK, nr.518 prot., datë 12.03.2021 është ngritur "Komisioni i vlerësimit të ofertave", i përbërë prej, 1.M.S., 2.Xh.S., 3.F.Rr. emrat dhe profilet e personave të caktuar, kush është specialist i fushës. Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2 OE, për të cilët, referuar procesverbalit të datës 28.03.2021 KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	BOE LL. ShPK & M. ShPK	14,789,250	Kualifikuar
2	OE "B. B"	15,104,517	Kualifikuar

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 28.03.2021, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas verifikimit të dokumentacionit nga grupi i auditimit, Raportit përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, "BOE LL. ShPK & M. ShPK operatorë pjesëmarrës konstatohet se nuk ka të s'kualifikuar OE, janë kualifikuar BOE LL. ShPK & M. ShPK dhe OE "B. B". Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 28.03.2021 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë "BOE LL. ShPK & M. ShPK për të cilën është lidhur kontrata datë 15.04.2021 për vlerën 14,789,250 lekë pa tvsh, me afat 2 muaj nga data e lidhjes së kontrates.

**Titulli i gjetjes:** Kriteret e kualifikimit të pa argumentuara, diskriminuese dhe të panevojshme për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, gjithashtu specififikimet teknike nuk kanë asnjë argumentim tekniko/ligjor.

**Situata:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt Nga Bashkia Peqin, Njësia e hartimit të kriterëve të kualifikimit, miratuar nga titullari i AK, rezulton se në mënyrë krejtësisht të paargumentuar dhe justifikuar, kanë hartuar dhe miratuar kriteret diskriminuese duke ulur ndjeshëm edhe efektivitetin, eficiencën dhe ekonomikitetin e procedurës së prokurimit përmes vendosjes së kriterëve për një OE thuasje të paracaktuar. Vendosja e të gjitha kërkesave të veçanta për kualifikimin e operatorëve ofertues, nuk janë të sqaruara në mënyrë teknike dhe ligjore pasi; nuk argumentohet arsyeja e vendosjes së tyre, Punë të ngjashme me vlerë jo më pak se 200% i fondit limit, liçencat, certifikatat e kërkuara, mjetet e punës, numri i fuqisë punëtore etj. **Këto kriteret nuk duhet të vendosen pasi referuar LPP vendosja e tyre, ndikon në një ngushtim të konkurrencës së lirë, duke kufizuar pjesëmarrjen, dhe mostrajtim të barabartë ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, pasi nuk janë të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet. Veprime të cilat bien ndesh me qëllimin dhe parimet e kuadrit ligjor për prokurimin publik.**

Referuar grafikut të punimeve, specifikimeve teknike të projektit dhe relacionit teknik, nuk shpjegohet në asnjë moment përllogaritja e orëve të punës dhe argumentimi i stafit të kërkuar se si rezultat i kujt llogaritjeve është kërkuar një numër i tillë punonjësish. Për hartimin e specifikimeve teknike nuk është mbajtur procesverbali apo dokumentacion për argumentimin tekniko/ligjor të tyre. ***Veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi titullari i AK z. L.T. dhe z. G.N., z. H.M. e zj. A.D. në cilësinë e anëtarëve të NjP.***



**Kriteri:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, nenin 2, neni 12, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27, pika 3, neni 61, pika 2, paragrafi dytë.

**Ndikimi/Efekti:** Nuk nxit konkurrencën, mungesë pjesëmarje, diskriminim dhe trajtim i pabarabartë i ofertuesve në procedurat e prokurimit.

**Shkaku:** Vendosja e kriterëve jo në përputhje me kuadrin ligjor të PP.

**Rëndësia:** I lartë.

**Rekomandimi:** Autoritetit Kontraktor Bashkia Peqin, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kriterëve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese, ndaj operatorëve ekonomikë.

**5.** Procedura e prokurimit me objekt “*Ndertim i tregut te frutave perimeve Peqin*” me të dhënat si më poshtë:

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndertim i tregut te Frutave perimeve Peqin”.</b>			
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> “Procedure e Hapur e thjeshtuar” (pune) REF-22002-03-15-2022 Urdhri nr.54 prot 422., datë 10.03.2022	<b>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit</b> Urdhri nr.54 prot 422., datë 10.03.2022 1.A.K. 2.Xh.S. 3.E.H.	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr.54 prot 422., datë 10.03.2022 1.A.K. 2.Xh.S. 3.E.H.	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr.55 prot 423., datë 10.03.2021. 1.M.S. 2.Xh.D. 3.F.Rr.
<b>4. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 8.430.044 (tetemilion e katerqinde tridhjetë mijë e dyzet e kater) lekë pa tvsh	<b>5. Oferta fituese, vlera fituese:</b> Bashkimi Operatoreve Fitues: BOE “LL.” ShPK & “M.” ShPK Vlera: 8.000.370 (tete milion e treqind e shtatedhjetë) lekë pa tvsh		<b>6. Diferenca me fondin limit</b> 429 674 (katerqind e njetzet e nentemije e gjashteqind e shtatedhjetë e kater ) lekë pa tvsh
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data .05.04.2022	<b>8. Burimi Financimit</b> Keshilli i Qarkut Elbasan + Buxheti i Bashkise Peqin		<b>9. Operoret Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender, <b>1.BOE :</b> “LL.” ShPK & “M.” ShPK <b>2.O.E</b> “SH.” ShPK b) S’kualifikuar <b>NUK KA B/OE,</b> c) Kualifikuar ; <b>1.BOE :</b> LL.” ShPK & “M.” ShPK <b>2.O.E</b> “SH.” ShPK
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 1 muaj</b>			
<b>10.Ankimime</b> AK-s’ka/ APP-s’ka KPP-s’ka/	<b>11. Data e lidhjes të kontratës:</b> Nr. Prot 704., datë 04.05.2022		<b>12.Përgjigje</b> Ankesës nga APP, AK apo <b>KKP: AK Nuk ka</b>

**a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.**

Nga auditimi i dokumentacionit dosjes së procedurës së prokurimit me objekt “*Ndertim i Tregut te frutave perimeve Peqin*”, me fond limit në shumën 8.430.044 lekë pa tvsh dhe vlerë kontrate në shumën 8.000.370 lekë pa tvsh, kanë marrë pjesë BOE “LL.” ShPK & “M.” ShPK dhe OE “SH.” ShPK nga të cilët BOE “LL.” ShPK & “M.” ShPK dhe OE “SH.” ShPK jane kualifikuar

nuk ka operatore ekonomike të s'kualifikuar, ku është shpallur fitues BOE "LL." ShPK & "M." ShPK me vlerë 8.000.370 lekë pa tvsh, konstatohet se:

***AK në lidhje me "Hartimin e Specifikimeve Teknike" dhe "Përlllogaritjen e Fondit Limit";***

-Nga ana e titullari i AK, në zbatim të LPP-së, me urdhrin nr.54 datë 10.03.2021 është ngritur grupi i punës "Për hartimin e specifikimeve teknike", i përbërë prej, 1.A.K. (Ekonomist), 2. Xh.S. (Juriste) 3.E.H. (Inxhinier). Për hartimin e specifikimeve teknike është mbajtur procesverbali datë 15.03.2022.

Për hartimin e specifikimeve teknike nga komisioni i krijuar për këtë qëllim, nuk është mbajtur asnjë akt apo dokumentacion mbi hartimin dhe argumentimin tekniko ligjor tyre. *Sipas personave të cilët kanë marrë pjesë në këtë procedurë, në mënyrë verbale shprehen se përlllogaritja e fondit limit është bazuar në preventivin e përgatitur nga projektuesi, pa e dokumentuar se kush është projektuesi, i cili është bazuar në VKM NR.629 DATE 15.07.2015 e cila rezulton të jetë 8,430,044 lekë pa TVSh.*

**Titulli i gjegjes:** Nuk argumentohet dhe dokumentohet llogaritja e fondit limit dhe përzgjedhja e procedurës.

**Situata:** Nga ana e titullarit të AK, nuk ka urdhër për caktimin e një personi apo ngritjen e një komisioni për llogaritjen e vlerës së fondit limit të procedurës së prokurimit. Nisja e kësaj procedure referuar dhe inventarizit të dosjes, ka filluar me urdhrin e prokurimit nr. 54 prot, datë 10.03.2022. Sipas Vkm nr.285, datë 19.05.2021, Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, në nenin 77, përcaktohet se; *"Pas përlllogaritjes së fondit limit sipas nenit 76 të këtyre rregullave, titullari i autoritetit kontraktor, nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit."* Pra nuk argumentohet dhe dokumentohet mënyra e llogaritjes së si është nxjerrë kjo vlerë limit e kontratës, veprim jo në përputhje me nenin 76, pika 2. Gjithashtu rezulton se nuk është bërë një përshkrim i punëve të cilat do të kryhen dhe arsyeja e përzgjedhjes së kësaj pprocedure prokurimi "E hapur punë", veprim për të cilin mban përgjegjësi *titullari i AK Z. L.T., anëtarët e njësisë së prokurimit, z. A.K., zj. Xh.S. dhe z. E.H., si dhe z. M.S. në cilësinë e personit përgjegjës për prokurimet.*

**Kriteri:** VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, me 12, pika 4 dhe Nenin 76, pika 2.

**Ndikimi/Efekti:** Nuk dokumentohet përlllogaritja e vlerës limit të kontratës dhe zgjedhja e procedurës.

**Shkaku:** Mosrespektimi i kuadrit ligjor të PP.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandim:** Titullari i Autoritetit Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimit, të marrin masat që, në procedurat e prokurimit në vijim, përpara hartimit të urdhrin të prokurimit të aplikojë mënyrën dhe përlllogaritjen e vlerës së kontratës me qëllim dokumentimin dhe argumentimin e saj në përputhje me fondet buxhetore të miratuara. Gjithashtu të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e përzgjedhjes së procedurës së prokurimit.

***Në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve":***

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej 1. A.K., (Ekonomist) 2. Xh.S. (Juriste) 3.E.H. (Inxhinier), janë evidentuar në procesverbalin e datës 15.03.2021 , të cilat janë si më poshtë;

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

**a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8,**

**b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;**

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

**2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

**a.** Operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë prokurim duhet që të plotësojnë kapacitetet ligjore, teknike dhe profesionale për kryerjen e këtij prokurimi.

**b.** Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licencën shoqërisë, sipas formatit të miratuar me VKM.

**c.** Licenca profesionale e Operatorëve Ekonomikë të lidhur me ekzekutimin e punës të kontratës objekt prokurimi, duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Nr	Kategoria	Klasifikimi	Emertimi i kategorise
1	NP - 1	A	Punime germimi në toke
2	NP- 2	A	<b>Ndertime Civile dhe Industriale</b>
3	NS- 1	A	Punime për prishjen e ndertimeve
4	NS-4	A	Punime rifiniture të muratës dhe të lidhura me to, rifiniture me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndertuese
5	NS-8	A	Ndertime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri

*Ne rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, licencat profesionale duhet t'i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë persipër punimet në të cilat kërkohet pika e Licencës përkatëse.*

*Ky kriter për paraqitjen e licencave nuk është i argumentuar ligjërisht se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës, gjithashtu janë kërkuar licenca të cilat nuk janë në përputhje dhe të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet dhe ndikon në kufizimin e pjesëmarrjes së tyre çka sjell për pasojë mundësinë e OE favorizues për lidhjen e kontratës në fjalë.*

***Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme***

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

**2. Një punësim mesatar i të paktën 25 (njetzet e pesë) punonjësve për muajin e fundit, të vërtetuar me;**

**i.** Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ose Instituti i Sigurimeve Shoqërore, ku të specifikohet numri i punonjësve për këtë muaj për periudhën e mesipërme.

*Disponimi i punonjësve të kërkuar do të deshmohet nga ofertuesit nepermjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës së DST, dhe dokumentet e mesipërme do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe të nisjes së afateve të ankimit, sipas përcaktimeve të Nenit 26, të VKM Nr.285, dt.19.05.2021 (i ndryshuar)*

**3.** Operatorët Ekonomikë duhet të ketë pjesë të stafit të tij të punës si drejtues teknik, për periudhën tetor 2021 – janar 2022 stafin e mëposhtem:

- Inxhinier Ndertimi 1 (nje)
- Inxhinier Topograf 1(nje)
- Inxhinier Elektrik 1(nje)
- Inxhinier Mekanik 1(nje)

Per inxhinieret pjese e stafit, duhet detyrimisht te jene te pasqyruar ne listepagesat e shoqerise per periudhen e mesiperme, duhet te paraqitet:

- kontrate pune e noterizuar, e vlefshme pergjate periudhes se zbatimit te kontrates
- cv
- diplome profesionale

4. Operoret Ekonomik duhet te kete pjese te stafit te tij mbeshtetes, per periudhen Janar 2022 dhe ne vazhdim stafin e meposhtem:

- Inxhinier agrar profile arkitekture peisazhi 1 (nje)
- Teknik ndertimi me diploma te shkolles se meseme 1 + IQT 1(nje)
- Topograf me shkolle te mesme 1 (Teknik topograf) 1 (nje)
- Elektracist me deshmi te aftesimit profesinal 2 (dy)
- Murator me deshmi te aftesimit profesinal 2 (dy)
- Saldator me deshmi te aftesimit profesinal 2 (dy)
- Manovrator me deshmi te aftesimit profesinal 2 (dy)
- Shofere me lejedrejtimi 3 (tre)

**Kriteret për stafin mbështetës dhe për punonjësit e kërkuar, përveç se nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish, konsiderohet diskrimues pasi sjell pabarazi ndërmejt OE. Referuar listës së punonjësve të kërkuar, janë reth 18 punonjës si dhe një numër prej mesatarisht 25 punonjës, që i është kërkuar ofertuesve, ndikon në kufizimin e pjesmarrjes së tyre çka sjell për pasojë mundësinë e OE favorizues për lidhjen e kontratës në fjalë.**

**6. Operatori ekonomik duhet te paraqese automjetet dhe makinerite (sipas tabelës) te cilat duhet te jene ne pronesi te tij ose me qera te vertetuara keto me dokumentacionin perkates:**

**a). Ne funksion te zbatimit te kontrates, kerkohet te jene ne dispozicion keto mjete/makineri dhe pajisje pune:**

Nr.	Emertimi	Sasia
1.	<p>Kamioncine me kapacitet mbajtes 1-1.5 ton</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrate qeraje nenshkruar para noterit nese mjete eshte me qera</li> <li>• Certificate pronesie</li> <li>• Leje qarkullimi</li> <li>• Certificate e kontrollit teknik</li> <li>• Siguracionin e mjetit</li> </ul>	1 cope
2.	<p>Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 15-18 ton</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrate qeraje nenshkruar para noterit nese mjete eshte me qera</li> <li>• Certificate pronesie</li> <li>• Leje qarkullimi</li> <li>• Certificate e kontrollit teknik</li> <li>• Siguracionin e mjetit</li> </ul>	2 cope
3	<p>Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 14-15 ton</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrate qeraje nenshkruar para noterit nese mjete eshte me qera</li> <li>• Certificate pronesie</li> <li>• Leje qarkullimi</li> <li>• Certificate e kontrollit teknik</li> <li>• Siguracionin e mjetit</li> </ul>	1 cope
	<p>Kamion veteshkarkues 3.5 deri 7.5 ton</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrate qeraje nenshkruar para noterit nese mjete eshte me qera</li> <li>• Certificate pronesie</li> <li>• Leje qarkullimi</li> <li>• Certificate e kontrollit teknik</li> </ul>	1 cope

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Siguracionin e mjetit</li> </ul>	
4	<p>Autobot Uji</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrate qeraje nenshkuar para noterit nese mjeti eshte me qera</li> <li>• Certificate pronesie</li> <li>• Leje qarkullimi</li> <li>• Certificate e kontrollit teknik</li> <li>• Siguracionin e mjetit</li> </ul>	1 Cope
5	<p>Minieskavator</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrate qeraje nenshkuar para noterit nese mjeti eshte me qera</li> <li>• Certificate pronesie</li> <li>• Leje qarkullimi</li> <li>• Certificate e kontrollit teknik</li> <li>• Siguracionin e mjetit</li> </ul>	1 Cope
6	<p>Minifadrom</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrate qeraje nenshkuar para noterit nese mjeti eshte me qera</li> <li>• Certificate pronesie</li> <li>• Leje qarkullimi</li> <li>• Certificate e kontrollit teknik</li> <li>• Siguracionin e mjetit</li> </ul>	1 Cope
7	<p>Kamion me vinc</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrate qeraje nenshkuar para noterit nese mjeti eshte me qera</li> <li>• Certificate pronesie</li> <li>• Leje qarkullimi</li> <li>• Certificate e kontrollit teknik</li> <li>• Siguracionin e mjetit</li> </ul>	1 Cope
8	<p>Prerese betoni Deklarate zhdoganimi Fature tatimore Kontrate qeraje nenshkuar para noterit nese pajisja eshte me qera</p>	1 Cope
9	<p>Matrapik Deklarate zhdoganimi Fature t Kontrate qeraje nenshkuar para noterit nese mjeti eshte me qera tatimore</p>	1 Cope
10	<p>Karroca Dore Deklarate zhdoganimi Fature tatimore Kontrate qeraje nenshkuar para noterit nese mjeti eshte me qera</p>	1 Cope
11	<p>Lopata dore Deklarate zhdoganimi Fature tatimore Kontrate qeraje nenshkuar para noterit nese mjeti eshte me qera</p>	10 cope
12	<p>Gjenerator Deklarate zhdoganimi Fature tatimore Kontrate qeraje nenshkuar para noterit nese mjeti eshte me qera</p>	1 cope
13	<p>Aparat Saldimi Deklarate zhdoganimi Fature tatimore Kontrate qeraje nenshkuar para noterit nese mjeti eshte me qera</p>	1 Cope
14	<p>Doreza pune Deklarate zhdoganimi Fature tatimore Kontrate qeraje nenshkuar para noterit nese mjeti eshte me qera</p>	1 cope
15	<p>Shkalle Deklarate zhdoganimi Fature tatimore Kontrate qeraje nenshkuar para noterit nese mjeti eshte me qera</p>	1 cope
16	<p>Depozite uji me kapacitet jo me te vogel se 1000 L</p>	1 cope

	<i>Deklarate zhdoganimi</i> <i>Fature tatimore</i> <i>Kontrate qeraje nenshkruar para noterit nese mjete eshte me qera</i>	
17	<i>Meter Lazer</i> <i>Deklarate zhdoganimi</i> <i>Fature tatimore</i> <i>Kontrate qeraje nenshkruar para noterit nese mjete eshte me qera</i>	<i>1 Cope</i>
18	<i>Betoniere</i> <i>Deklarate zhdoganimi</i> <i>Fature tatimore</i> <i>Kontrate qeraje nenshkruar para noterit nese pajisja eshte me qera</i>	<i>1 cope</i>
19.	<i>Prozhektore per ndricim</i> <i>Deklarate zhdoganimi</i> <i>Fature tatimore</i> <i>Kontrate qeraje nenshkruar para noterit nese pajisja eshte me qera</i>	<i>3 cope</i>
20.	<i>Tabela sinjalistike</i> <i>Deklarate zhdoganimi</i> <i>Fature tatimore</i> <i>Kontrate qeraje nenshkruar para noterit nese pajisja eshte me qera</i>	<i>5 cope</i>
21	<i>Kuti e ndihmes se shpejte</i> <i>Deklarate zhdoganimi</i> <i>Fature tatimore</i> <i>Kontrate qeraje nenshkruar para noterit nese pajisja eshte me qera</i>	<i>1 Cope</i>
22	<i>Kaske Pune</i> <i>Deklarate zhdoganimi</i> <i>Fature tatimore</i> <i>Kontrate qeraje nenshkruar para noterit nese pajija eshte me qera</i>	<i>1 Cope</i>
23	<i>Flesibel</i> <i>Deklarate zhdoganimi</i> <i>Fature tatimore</i> <i>Kontrate qeraje nenshkruar para noterit nese pajisja eshte me qera</i>	<i>1 Cope</i>

• *Per plotesimin e kriterit te mesiperme eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates sipas shtojces Nr.8 (Formulari permblodhes i vetedeklarimit).*

*-Ne lidhje me momentin e paraqitjes se dokumentacionit deshmues per kerkesat qe perfshihen ne formularin permblodhes te vetedeklarimit, mbajme ne konsiderate percaktimet e nenit 26, pika 6, te VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar , ku parashikohet qe “Perpara publikimit te njoftimit t e fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjar “a”, “b”, ”d”, “dh”, “e”, “h”, ”i”, “j”, te pikes 2 te ketij neni , si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike. Keto dokumente duhet te paraqiten ne original ose ne kopje te njehsuara me origjinalin .*

***Ky kriter për makineritë nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish, se për çfarë u janë kërkuar OE pjesëmarrës. Këto kërkesa të pa argumentuara mund të ndikojnë në kufizimin e pjesëmarrjes së tyre.***

*Ka pasur ndryshime te DST pas rekomandimeve nga APP te pasqyruara ne shtojcen 27.03.2022 Për ndryshimin e kërkesave të Proçedures se Prokurimit me objekt: “Ndertimi i tregut te te fruta perimeve”.*

*Pas dergimit te disa rekomandimeve nga ana e Njesise se Kordinimit te APP, te ardhura ne adrese te emailit te personit pergjegjes per kete procedure prokurimi, Njesia e prokurimit vendosi te beje ndyshimet e meposhtme:*

1. Pika 2.3.2 Operatoret Ekonomik duhet te kete pjese te stafit te tij te punes si drejtues teknik, per periudhen nentor 2021 – shkurt 2022 stafin e meposhtem:

- Inxhinier Ndertimi 1 (nje), · Inxhinier Topograf 1(nje), · Inxhinier Elektrik 1(nje)
- Inxhinier Mekanik 1(nje)

Per inxhinieret pjese e stafit, duhet detyrimisht te jene te pasqyruar ne listepagesat e shoqerise per periudhen e mesiperme, duhet te paraqitet, · kontrate pune e noterizuar, e vlefshme pergjate periudhes se zbatimit te kontrates, · cv, · diplome profesionale

**2. Në pikën 2.3.4. Operatoret Ekonomik duhet te kete pjese te stafit te tij mbeshtetes , per periudhen Janar 2022 dhe ne vazhdim stafin e meposhtem:**

- -Inxhinier agrar profile arkitekture peisazhi 1 (nje)
- Teknik ndertimi me diploma te shkolles se meseme 1 +IQT 1(nje)
- Topograf me shkolle te mesme 1 (Teknik topograf) 1 (nje)
- Elektracist me deshmi te aftesimit profesinal 1 (nje)
- Murator me deshmi te aftesimit profesinal 2 (dy)
- Saldator me deshmi te aftesimit profesinal 2 (dy)
- Manovrator me deshmi te aftesimit profesinal 2 (dy)
- Shofere me lejedrejtimi 3 (tre)

Per shoferet dhe manovratoret ne rastet kur mjetet jane marre me qera mjafton qe ne kontraten e qirase se mjetit te jene percaktuar dhe emrat e shoferve dhe manovratoreve qe do te drejtojne mjetet me kusht qe keto punonjes te figurojne ne listepagesen e qiradhenesit ne muajin shkurt - 2022.

- Per plotesimin e kriterit te mesiperme eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates sipas shtojces Nr.8 (Formulari permbledhes i vetedeklarimit).

-Ne lidhje me momentin e paraqitjes se dokumentacionit deshmues per kerkesat qe perfshihen ne formularin permbledhes te vetedeklarimit, mbajme ne konsiderate percaktimet e nenit 26, pika 6, te VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar , ku parashikohet qe “Perpara publikimit te njoftimit t e fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjar “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, te pikes 2 te ketij neni , si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike. Keto dokumente duhet te paraqiten ne original ose ne kopje te njehsuara me origjinalin.

***b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Me urdhrin nr.54 datë 10.03.2022, të titullarit të AK, nr.423 prot., datë 10.03.2022 është ngritur “Komisioni i vlerësimit të ofertave”, i përbërë prej, 1.M.S. (Ekonomist) 2.Xh.D., (Juriste) 3.F.Rr. (Jurist ) .Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2 (dy) B/ OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. XX, të datës 13.04.2022, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S’kualifikuar
1	BOE “LL.” ShPK & “M.” ShPK	8,000,370 lekë pa tvsh	Kualifikuar
2	O.E “Sh.” ShPK	8,270,860 lekë pa tvsh	Kualifikuar

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 21.04.2021, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas verifikimit të dokumentacionit nga grupi i auditimit, Raportit përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, BOE “LL.” ShPK & “M.” ShPK operatorë pjesëmarrës konstatohet se nuk ka te s’kualifikuar OE, janë kualifikuar

BOE 1. “LL.” ShPK & “M.” ShPK dhe 2. O.E “Sh.” ShPK. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 21.04.2022 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë , **BOE** “LL.” ShPK & “M.” ShPK për të cilën është lidhur kontrata datë 04.05.2022 për vlerën 8,000,370 lekë pa tvsh lekë me TVSH, dhe me afat **1 muaj** nga data e lidhjes së kontratës.

**Titulli i gjetjes:** Kriteret e kualifikimit të pa argumentuara, diskriminuese dhe të panevojshme për pjesmarrjen e operatorëve ekonomikë, gjithashtu specifikimet teknike nuk kanë asnjë argumentim tekniko/ligjor.

**Situata:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt Nga Bashkia Peqin, Njësia e hartimit të kriterëve të kualifikimit, miratuar nga titullari i AK, rezulton se në mënyrë krejtësisht të paargumentuar dhe justifikuar, kanë hartuar dhe miratuar kriteret diskriminuese duke ulur ndjeshëm edhe efektivitetin, eficiencën dhe ekonomikitetin e procedurës së prokurimit përmes vendosjes së kriterëve për një OE thuasje të paracaktuar. Vendosja e të gjitha kërkesave të veçanta për kualifikimin e operatorëve ofertues, nuk janë të sqaruara në mënyrë teknike dhe ligjore pasi; nuk argumentohet arsyeja e vendosjes së tyre, Punë të ngjashme me vlerë jo më pak se dyfishi i fondit limit, liçencat, certifikatat e kërkuara, mjetet e punës, numri i fuqisë punëtore etj. **Këto kriteret nuk duhet të vendosen pasi referuar LPP vendosja e tyre, ndikon në një ngushtim të konkurrencës së lirë, duke kufizuar pjesëmarrjen, dhe mostrajtim të barabartë ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, pasi nuk janë të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet. Veprime të cilat bien ndesh me qëllimin dhe parimet e kuadrit ligjor për prokurimin publik.**

Referuar grafikut të punimeve, specifikimeve teknike të projektit dhe relacionit teknik, nuk shpjegohet në asnjë moment përllogaritja e orëve të punës dhe argumentimi i stafit të kërkuar se si rezultat i kujt llogaritjeve është kërkuar një numër i tillë punonjësish. Për hartimin e specifikimeve teknike nuk është mbajtur procesverbali apo dokumentacion për argumentimin tekniko/ligjor të tyre. **Veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi titullari i AK z. L.T., zj. Xh.S., z. E.H. dhe z. A.K. në cilësinë e anëtarëve të NjP.**

**Kriteri:** Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2, nenin 3, neni 21, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39, pika 3, neni 78, pika 2, paragrafi dytë.

**Ndikimi/Efekti:** Nuk nxit konkurrencën, mungesë pjesëmarrje, diskriminim dhe trajtim i pabarabartë i ofertuesve në procedurat e prokurimit.

**Shkaku:** Vendosja e kriterëve jo në përputhje me kuadrin ligjor të PP.

**Rëndësia:** I lartë.

**Rekomandimi:** Autoritetit Kontraktor Bashkia Peqin, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kriterëve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese, ndaj operatorëve ekonomikë.

**6.** Procedura e prokurimit me objekt “Blerje Automjeti per Bashkinë Peqin” me të dhënat si më poshtë:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje Automjeti per Bashkinë Peqin”.			
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> “Kërkesë për Propozim” REF-85304-01-31-2021	<b>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit</b> Urdhri nr. 40 prot 222.,datë 29.01.2021 1.G.N.	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. 40 prot 222., datë 29.01.2021 1.G.N. 2.H.M.	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr.41prot 221., datë 29.01.2021. 1.M.S. 2.G.C.



Urdhri nr. 40 prot 222., datë 29.01.2021	2.H.M. 3.E.H.  Urdher Nr.27 prot 196. Date29.01.2021 1.A.K. 2.A.T. 3.K.L.	3.E.H.	3.E. LL.
<b>4. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 3.000.000 (tremilion) lekë pa tvsh	<b>5. Oferta fituese, vlera fituese:</b> Operatori Fitues: ( E. SHPK ) 2.800.000 (dy milion e teteqindmije) lekë pa tvsh.		<b>6. Diferenca me fondin limit</b> 200 000 (dyqind mije) lekë pa tvsh
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data .12.02.2021	<b>8. Burimi Financimit</b> Buxheti i Bashkise Peqin		<b>9. Operoret Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender, E. <b>OE</b> b) S’kualifikuar <b>NUK KA B/OE,</b> c) Kualifikuar “E.” <b>SHPK B/OE</b>
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 20 ditë</b>			
<b>10. Ankimime</b> AK-s’ka/ APP-s’ka KPP-s’ka/	<b>11. Data e lidhjes të kontratës:</b> Nr. Prot 4457., datë 05.03.2021		<b>12. Përgjigje</b> Ankesës nga APP, AK apo <b>KKP: AK</b>

***a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.***

Nga auditimi i dokumentacionit dosjes së procedurës së prokurimit me objekt “*Blerje Automjeti per Bashkinë Peqin*”, me fond limit në shumën 3,000,000 (tremilion) lekë pa tvsh, dhe vlerë kontrate në shumën 2,800,000 (dy milion e teteqind mije) lekë pa tvsh, kanë marrë pjesë 1-OE “E. SHPK”, nga të cilët E. është kualifikuar nuk ka operatore ekonomike të s’kualifikuar, ku është shpallur fitues OE/BOE “E. SHPK” me vlerë oferte në shumën 2,800,000 (dy milion e tetqind mije) lekë pa tvsh konstatohet se:

***AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogaritjen e Fondit Limit” ;***

-Nga ana e titullarit të AK, me urdhrin nr. 27 datë 29.01.2021 është ngritur grupi i punës “Për llogaritjen e fondit limit”, i përbërë nga 1.A.K. 2.A.T. 3.K.L.

Sipas procesverbalit të datës 29.01.2021, të mbajtur për efekt të pasqyrimit të veprimtarisë, konstatohet se komisioni për përlllogaritjen e fondit limit ka përdorur mënyrën e “*studimit të tregut*”, pasi janë përgatitur specifikimet teknike në lidhje me objektin e prokurimit, ka studiuar ofertat e tregut nga 3 OE të ndryshëm duke përlllogaritur si fond limit vlerën mesatare të këtyre të fundit e cila rezulton të jetë 3,000,000 lekë pa tvsh.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes së procedurës rezulton se specifikimet teknike të vendosura nga AK nuk rezulton të jenë të argumetuara teknikisht dhe ligjërish, përzgjedhja e modelit, fuqisë së automjetit, paketa e kamios, etj., veprime jo në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2, paragrafi dytë.

-Nga ana e titullari i AK, në zbatim të LPP-së, me urdhrin nr. 40 datë 29.01.2021 është ngritur grupi i punës “Për hartimin e specifikimeve teknike”, i përbërë prej, 1.G.N. (Juriste) 2.H.M. (Ekonomist) 3.E.H. (Inxhinier). Për hartimin e specifikimeve teknike është mbajtur procesverbali datë 01.02.2021 nga komisioni i krijuar për këtë qëllim.

### ***Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Krieteve”:***

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej 1.G.N., 2.H.M. 3.E.H. emrat e komisionit dhe profilet e fushës së secilit anëtar, janë evidentuar në procesverbalin e datës 01.02.2021, të cilat nuk janë të argumetuara teknikisht, që janë si më poshtë;

#### **2. Kriteret e vecanta te kualifikimit**

##### **2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Kopje të deklaratave të xhiros mesatare vjetore të realizuar gjatë tre viteve të fundit (2017, 2018, 2019), duhet të ketë një vlerë minimalisht jo me te vogel se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet. ***Ky kriter përveç se nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish, konsiderohet diskrimues pasi sjell pabarazi ndërmejt OE, pasi vlera e kërkuar e cila të jetë jo më e vogël se fondi limit, nuk është në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.***

**2.2.2** Kopje të vertetuara të bilanceve per vitin 2019, të paraqitura pranë drejtorise rajonale tatimore përkatëse dhe të konfirmuara nga ky autoritet.

##### **2.3 Për kapacitetin teknik:**

**2.3.1** Per te provuar pervojen e meparshme operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi per, Furnizime te ngjashme ne nje vlere jo me te vogël se 40% te fondit limit pa TVSH-, te realizuara ne tri vitet e fundit nga data e zhvillimit te tenderit.

Per te vertetuar pervojen e meparshme duhet te paraqitet kontrata dhe vertetimi nga institucioni shteteror per realizimin e kontrates, te lidhur me marresin e mallrave ose/dhe faturave tatimore te shitjes ku shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuar.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet te paraqese Katalloget origjinale perkates, ku te tregohen karakteristikat teknike te automjetit te ofruar, te cilat duhet te permbushin specifikimet teknike te kerkuara nga autoriteti kontraktor dhe te ofruara nga operatori ekonomik ne momentin e dorezimit te ofertes.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku garanton kryerjen e shërbimeve për riparimin e automjeteve, gjate periudhës se garancisë.

**2.3.4** Operatori Ekonomik duhet te kete numrin e nevojshem prej 5 (P.) punonjës te siguar per zbatimin e kontrates.

***Ky kriter përveç se nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish, konsiderohet diskrimues pasi sjell pabarazi ndërmejt OE, pasi mund të sjellë ngushtim të konkurrencës dhe pjesëmarrje të gjerë të OE, pra nuk është në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.***

Kjo te deshmohe me vertetim te leshuar nga Administrata Tatimore per numrin e punonjesve te siguar per periudhen Janar – Dhjetor 2020.

### ***b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Me urdhrin nr. 41 datë 29.01.2021, të titullarit të AK, nr.221 prot., datë 29.01.2021 është ngritur “Komisioni i vlerësimit të ofertave”, i përbërë prej, 1.M.S. (Ekonomist) 2.G.C. (Jurist) 3.E. LL. (Ekonomist). Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 1 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. XX, të datës 12.02.2021, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

<b>Nr</b>	<b>Operatori ekonomi</b>	<b>Oferta lekë pa TVSh</b>	<b>Kualifikuar/S’kualifikuar</b>
1	E. SHPK	2.800.000	Kualifikuar

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 12.02.2021, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas verifikimit të dokumentacionit nga grupi i auditimit, raportit përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, “E.” SHPK operatorë pjesëmarrës konstatohet se ka marrë pjesë vetëm një OE, nuk ka të s’kualifikuar, është kualifikuar OE E. SHPK. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 12.02.2021 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë OE “E. SHPK” për të cilën është lidhur kontrata datë 05.03.2021 për vlerën 2.800.000 (dy milion e teteqind) lekë pa TVSH dhe vlera 3.360.000 (tremilion e treqind e gjashtedhjetë mijë) lekë me TVSH, dhe me afat 20 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

**Titulli i gjetjes:** Kriteret e kualifikimit të pa argumentuara, diskriminuese dhe të panevojshme për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, gjithashtu specifikimet teknike nuk kanë asnjë argumentim tekniko/ligjor.

**Situata:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt Nga Bashkia Peqin, Njësia e hartimit të kriterëve të kualifikimit, miratuar nga titullari i AK, rezulton se në mënyrë krejtësisht të paargumentuar dhe justifikuar, kanë hartuar dhe miratuar kriteret diskriminuese duke ulur ndjeshëm edhe efektivitetin, eficiencën dhe ekonomikitetin e procedurës së prokurimit përmes vendosjes së kriterëve për një OE thuasje të paracaktuar. Vendosja e të gjitha kërkesave të veçanta për kualifikimin e operatorëve ofertues, nuk janë të sqaruara në mënyrë teknike dhe ligjore. **Këto kriteret nuk duhet të vendosen pasi referuar LPP vendosja e tyre, ndikon në një ngushtim të konkurrencës së lirë, duke kufizuar pjesëmarrjen, dhe mostrajtim të barabartë ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, pasi nuk janë të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet. Veprime të cilat bien ndesh me qëllimin dhe parimet e kuadrit ligjor për prokurimin publik.**

Referuar grafikut të punimeve, specifikimeve teknike të projektit dhe relacionit teknik, nuk shpjegohet në asnjë moment përllogaritja e orëve të punës dhe argumentimi i stafit të kërkuar se si rezultat i kujt llogaritjeve është kërkuar një numër i tillë punonjësish. Për hartimin e specifikimeve teknike nuk është mbajtur procesverbali apo dokumentacion për argumentimin tekniko/ligjor të tyre. ***Veprime për të cilat mban përgjegjësi titullari i AK z. L.T. dhe Njësia e Prokurimit zj. G.N., z. H.M. dhe z. E.H.***

**Kriteri:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, nenin 2, neni 12, pikat 1 dhe 5, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27, pika 3, neni 61, pika 2, paragrafi dytë.

**Ndikimi/Efekti:** Nuk nxit konkurrencën, mungesë pjesëmarrje, diskriminim dhe trajtim i pabarabartë i ofertuesve në procedurat e prokurimit.

**Shkaku:** Vendosja e kriterëve jo në përputhje me kuadrin ligjor të PP.

**Rëndësia:** I lartë.

**Rekomandimi:** Autoritetit Kontraktor Bashkia Peqin, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kriterëve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese, ndaj operatorëve ekonomikë.

**Titulli i gjetjes:** Ftesë për ofertë dërguar nga AK në Operatorë Ekonomikë të cilët nuk kanë si veprimtari objektin e kontratës që prokurohet.

**Situata:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Automjeti per Bashkinë Peqin”, në lidhje me ftesën të cilën AK nëpërmjet NjP, ka dërguar ftesë për odertë 5 Operatorëve

ekonomikë për pjesëmarrje në tender. Referuar verifikimit të OE të ftuar rezulton se një prej OE të ftuar nuk ka në fushë veprimtarinë e ekstraktit të QKB, objektin e prokurimit dhe konkretisht OE “G. G.” me objekt Veprimtarie “Tregti me pakice materiale ndertimi, bojra,artikuj elektroshtepiake, elektrike,vegla pune, hidraulike, rrjeta teli.” Pra nga NJP nuk u është derguar ftesë për ofertë OE të cilët kanë në veprimtarinë e ekstraktit të tyre objektin e prokurimit. Gjithashtu nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes së procedurës së prokurimit rezulton se nuk është argumentuar dhe dokumentuar përzgjedhja e OE të ftuar. *Veprime për të cilat mban përgjegjësi Njësia e Prokurimi G.N., H.M. dhe E.H.*

**Kriteri:** VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39, pika 4 e cila citon se;

*Pavarësisht nga publikimi i njoftimit të kontratës, sipas pikës 2, të këtij neni, autoriteti kontraktor fton për të marrë pjesë dhe të paktën 5 (P.) operatorë ekonomikë.*

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë që do të ftojë.**

**Ndikimi/Efekti:** Nuk nxit konkurrencën, mungesë pjesëmarrje në procedurën e prokurimit.

**Shkaku:** Mos respektim i kuadrit ligjor të PP.

**Rëndësia:** I mesëm.

**Rekomandimi:** Autoriteti Kontraktor Bashkia Peqin, Përgjegjësi i Prokurimeve dhe Njësia e Prokurimit të marrin masat e duhura që, në procedurat e prokurimit “Kërkesë për propozim”, në vijim, të kryejnë verifikimin e OE të cilët do t’u dërgojnë ftesën për ofertë, me qëllim që veprimtaria e tyre në ekstraktin e QKB të jetë në përputhje me objektin e kontratës që do të prokurohet.

#### **Në lidhje me zbatimin e kontratës;**

**Titulli i gjetjes:** Mos garantim i mallrave të kërkuar në përputhje me kërkesat e AK, nuk është raportuar në APP për ecurinë e zbatimit të kontratës të furnizimit të automjetit.

**Situata:** Nga auditimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me zbatimin e kontratës me objekt furnizim me “Blerje Automjeti per Bashkinë Peqin” rezulton se: Është likuiduar me urdhër shpenzimit nr. 152, datë 15.03.2022, në vlerën 3,360,000 lekë ndaj “E. SHPK”, vlera e kontratës së lidhur me objekt “Blerje Audotmjeti. Malli është bërë hyrje me Fh nr. 8, datë 23.03.2021, nga magazinieri i Institucionit të Bashkia Peqin. Titullari i AK me shkresën nr. 532, datë 15.03.2021 ka krijuar urdhrin me përbërje A.K., Sh.M. dhe V.M., për ngritjen e komisionit për verifikimin e përmbushjes së cilësisve teknike dhe marrjen në dorëzim të automjetit. Në këtë akt titullari nuk ka caktuar personat përgjegjës apo specialist të fushës si strukturë për ecurinë e zbatimit të kontratës. Për tu siguruar nëse cilësia e mallrave të furnizuar është në përputhje me ato të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor, konstatohet se nga titullari i AK, nuk janë marrë masat e duhura për caktimin e personave për mbikëqyrjen e zbatimit të kontratës, hartimin e planit për zbatimin e kontratës. Nga komisioni i krijuar për marrjen në dorëzim të automjetit, është mbajtur procesverbali nr. 532/1prot., datë 15.03.2021, në të cilin citohet ndër të tjera se verifikimi i automjetit është kryer pranë një Autoservisi në emër të F.K. Me këtë subjekt AK nuk ka asnjë marrëdhënie kontraktuale apo dokumentacion mbi të cilin komisioni ti drejtohej për të garantuar cilësinë e mallit të kërkuar nëse është në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktor apo jo. Këtë veprim komisioni e ka kryer pa autorizim nga titullari i AK dhe pa asnjë marrëveshje midis palëve (Autoservisit dhe AK). Pavarësisht se nga Autoservisi është lëshuar një dokument si Çertifikatë e kontrollit teknik të automjetit, në këtë dokument nuk përshkruhen të gjitha cilësitë për të cilat janë hartuar specifikimet teknike të mjetit në Dokumentet e Tenderit. Pra marrja në

dorëzim e mjetit nuk është bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe vlera e likuiduar në shumën 3,360,000 lekë është në papajtueshmëri me kushtet e kontratës. Gjithashtu nuk është raportuar pranë APP sipas formularit përkatës për ecurinë e zbatimit të kontratës. *Veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi titullari i AK z.L.T., komisioni i marrjes në dorëzim A.K., Sh.M. dhe V.M. dhe përgjegjësi i prokurimeve z. M.S.*

**Kriteri:** VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 77, ku ndër të tjera citohet se;

*Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penaltitetet e parashikuara në kontratë. “Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi”.*

*“Personi/at përgjegjës për prokurimin merr/marrin informacion në mënyrë të vazhdueshme mbi ecurinë e zbatimit të kontratës dhe në rast të konstatimit të problematikave në këtë proces, ia raporton/raportojnë APP-së.*

*Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti. Një kopje e këtij raporti i dërgohet APP-së, si dhe mund t’i vihet në dispozicion kontraktorit, me kërkesë të tij, nga personi/at përgjegjës për prokurimin.*

**Ndikimi/Efekt:** Nuk sigurohet se marrja në dorëzim e mallit është në përputhje me specifikimet e kërkuara.

**Shkaku:** Mosrespektimi i kuadrit rregullator ligjor për Prokurimin Publik për mbikëqyrjen e kontratës dhe akteve ligjore për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandimi:** Titullari i Autoritetit Kontraktor të marrë masat që në të gjitha kontratat e furnizimit të mallrave, të caktojë personat përgjegjës për mbikëqyrjen e kontratës me qëllim garantimin e cilësisë së aktiveve të furnizuara në përputhje me kriteret dhe specifikimet e kërkuara. Gjithashtu të raportohet në APP për cdo rast mbi ecurinë e zbatimit të kontratës.

### **Observacion:**

*Për sa më sipër subjekti i audituar nëpërmjet shkresave nr 1525, datë 29.08.2023, administruar nga KLSH me nr. 429/4, datë 31.08.2023, ka paraqitur komente dhe shpjegime për konstatimet në lidhje me procedurat e prokurimit e konkretisht, nga z. L.T., z. H.M., zj. A.D., zj. G.N., z. A.K., z. E.H., zj. Xh.L. e zj. Xh.S. është paraqitur observacion lidhur me;*

### **Pretendimi i subjektit:**

*-Në procedurën e prokurimit me objekt “Ndertim i rrjetit Ujësjetës të fshatit Bicaj dhe Caushaj” pretendohet nga observuesit se nuk ka përse të ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e Njësisë së Prokurimit, pasi sqarohen argumentimet e vendosjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit.*

*-Në procedurën e prokurimit me objekt “Ndertim i pritave lumore dhe perforcim i kembeve të Ures ne shtratin e Lumit Shkumbin, Bashkia Peqin” nga observuesit paraqiten të gjitha kriteret e kualifikimit të cilat janë pjesë e dokumenteve të tenderit për të cilat pretendohet se janë të argumentuara.*

*-Në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i rruges Demir G. Peqin” nga observuesit paraqiten të gjitha kriteret e kualifikimit të cilat janë pjesë e dokumenteve të tenderit për të cilat pretendohet se janë të argumentuara.*

*-Në procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtimi i tregut të fruta perimeve Bashkia Peqin”, pretendohet nga observuesit se sqarohen argumentimet e vendosjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit.*

*-Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje automjeti për Bashkinë Peqin” pretendohet nga observuesit se nuk ka përse të ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e Njësisë së Prokurimit, pasi sqarohen argumentimet e vendosjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

*Në lidhje me observacionet e dërguara nga Bashkia Peqin, grupi i auditimit sqaron se; Nga shqyrtimi i materialeve të paraqitura rezulton se nuk është dërguar asnjë dokumentacion shtesë, fakte, prova apo referencë ligjore, të reja nga ato që janë paraqitur gjatë fazës së auditimit në terren dhe observacionet e paraqitura për Projektraportin janë thuajse të njëjta nga observacionet e paraqitura për akt konstatimet. Për këto pretendime, grupi është shprehur në fazën e hartimit të Projekt raportit të auditimit. Nga sa më sipër grupi i auditimit nuk i merr në konsideratë observacionet e paraqitura duke vijuar me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**Mbi auditimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël:**

Për sa më sipër u kërkua nga grupi i auditimit dokumentet si më poshtë:

- 1.Regjistri i Realizimeve për Prokurimet me Vlerë të Vogël për vitin 2021-2022
- 2.Dosjet fizike të procedurave me vlerë të vogël për vitin 2021- 2022
- 3.Urdhëri i titullarit të Bashkisë Peqin për ngritjen KPVV.

Nga dokumentacioni dhe të dhënat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit, si dhe nga verifikimi i procedurave me zgjedhje në Sistemin e Prokurimit Elektronik(SPE) u konstatua si më poshtë vijon:

**Titulli i gjetjes:** Copëzim i fondeve dhe shmangie nga procedurat standard të prokurimit.

Për periudhën objekt auditimi, Bashkia Peqin ka realizuar 18 procedura blerje me vlera të vogla me fond limit në shumën **10,955,141** lekë dhe vlerë kontrate në shumën **8,919,909** lekë. Nga këto, për vitin 2021 janë realizuar 8 procedura me fond limit në shumën **4,115,978** lekë dhe vlerë kontrate të lidhur në shumën **3,315,481**lekë. Për vitin 2022 janë realizuar 10 procedura me fond limit në shumën **6,839,163** lekë dhe vlerë kontrate të lidhur në shumën **5,604,428** lekë. Konkretisht të dhënat e procedurave të prokurimit të realizuara paraqiten në aneksin përkatës mbi prokurimet publike bashkëlidhur Projektraportit të auditimit.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se; për vitin 2021 janë kryer 2 procedura blerje me vlera të vogla duke copëzuar fondin dhe duke shmangur procedurat standarde të prokurimit, konkretisht; Në 2 procedura në shumën totale të fondit limit në vlerën 957 827 leke lekë pa TVSH, procedura duhet të kryheshin tenderim, pasi pasi kanë objekt të njëjtë procedurë; është kryer procedura me objekt “Ndertim bazamenti Qendra Shendetesore Shez”, në muajin prill me fond limit në shumën 512,500 lekë pa tvsh, procedura me objekt “Ndertim bazamenti Qendra Shendetesore Shez , me fond limit në shumën 783,761 lekë pa tvsh e zhvilluar në muajin shtator, procedura me objekt “Ndertim i bazamentit Qendra Shendetesore Karine”, me fond limit në shumën 795.689 lekë pa TVSh, e zhvilluar në muajin shtator, dhe procedura me objekt “Ndertim i bazamentit Qendra Shendetesore Karine)” me fond limit në shumën 795.689 lekë pa TVSh zhvilluar në muajin mars.

Këto veprime nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 2, në të cilën citohet se;

*Nuk lejohet pjesëtimi apo ndarja e vlerës së kontratës publike për shmangien nga dispozitat e parashikuara në këtë ligj.*

Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenin 40, pika 1, paragrafi dytë në të cilën citohet se;

*Për përcaktimin e kufirit monetar për këtë procedurë llogariten grup – mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe, në asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure.*

pika 8 në të cilën citohet se;

*Në asnjë rast, procedura e prokurimit me vlerë të vogël nuk duhet të përdoret si mundësi për të pjesëtuar vlerën e kontratës për shmangien nga procedurat konkurruese të prokurimit.*

Udhëzimin nr.3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar, pika 3, në të cilën citohet se;

*Kjo lloj procedure do të përdoret për blerjen e një grupi mallrash, kryerjen e shërbimeve apo punëve të ngjashme, që kanë të njëjtin funksion kryesor apo që kanë të njëjtin emërtim në planin e shpenzimeve. Përdorimi i kësaj procedure nuk duhet parë si mundësi për shmangien e procedurave konkurruese të prokurimit. Në asnjë rast, autoritetet kontraktore nuk duhet të prokurojnë veçmas mallra, shërbime apo punë që përfshihen në një grup për shkak të ngjashmërisë së tyre, apo për shkak të funksionit kryesor.*

**Kriteret Ligjore:** Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 2, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenin 40, pika 1, Udhëzimin nr.3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar, pika 3.

**Ndikimi/Efekti:** Procedurat e prokurimit paraqesin një shmangie apo neglizhencë, duke mos respektuar rregullat e procedurave të Prokurimit Publik.

**Shkaku:** Mosrespektimi i kuadrit rregullator ligjor për Prokurimin Publik.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandimi:** Autoriteti kontraktor Bashkia Peqin, të marrin masat që, gjatë hartimit të regjistrave të prokurimit të analizojnë dhe grupojnë emërtimin e procedurave, me qëllim shmangien e copëzimit të fondeve buxhetore.

#### **2.4.4. Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomik fitues.**

1. Mbi auditimin e zbatimit të kontratës me objekt “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit fshati Bicaj dhe Caushaj”:

<b>Titulli i Gjetjes 1:</b>	Pagesa punimesh për volume zërash të pa kryer gjatë zbatimit të kontratës.
	Nga kontrolli i punimeve në terren për zbatimin e kontratës së punës publike “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit fshati Bicaj dhe Caushaj” me vlerë kontrate në shumën 114,345,663 lekë me TVSh, me OE sipërmarës BOE “B.” B SHPK & “P.V.” SHPK & “B.-N” SHPK & “D.C.” SHPK”, u konstatua se punimet e mëposhtme nuk ishin kryer. Janë paguar volume punimesh të cilat gjatë verifikimit rezultuan punë të pa kryera. Këto punime evidentohen si më poshtë;

<p><b>Situata:</b></p>	<p>Zëri me nr.3.352 Mbushje e ngjeshje me gurë kave me sasi 1057 m<sup>3</sup> dhe vlerë 2,238,726 lekë nuk ishte realizuar ende në terren.</p> <p>Zëri me nr.3.212/d Shtresë stabilizanti t=20cm me sasi 5533 m<sup>3</sup> dhe vlerë 4,614,522 lekë nuk ishte realizuar ende në terren.</p> <p>Zëri me nr.3.222 /2Shtresë binder me granil gur kave 6cm me makineri me sasi 1476 m<sup>3</sup> dhe vlerë 2,637,612 lekë nuk ishte realizuar ende në terren.</p> <p>Zëri me nr.Shtresë asfaltobetoni me granil gur kave 4cm me makineri me sasi 1476 m<sup>3</sup> dhe vlerë 11,969,364 lekë.</p> <p>Në total për rubrikën “Sistemin i sheshit të objekteve ne vendburim” të situacionit nr.11 ka vlerën 11,696,364 lekë.</p> <p>Pëe rubrikën “Punime sistemimi i sheshit të objekteve në depo Kodras” nga kontrolli në terren u konstatua se:</p> <p>Zëri i punës 3.352 Mbushje ngjeshje me gur kave me sasi 482 m<sup>3</sup> dhe vlerë 1,020,876 lekë nuk ishte realizuar ende në terren.</p> <p>Shtresë stabilizanti t=20cm me sasi 1190 m<sup>3</sup> dhe vlerë 992,460 lekë nuk ishte realizuar ende në terren.</p> <p>Zëri i punës Shtresë binderi me granil e gur kave 6 cm me makineri me sasi 1190 m<sup>3</sup> dhe vlerë 2,126,530 lekë nuk ishte realizuar edhe në terren.</p> <p>Zëri i punës 3.226/1 Shtresë asfaltobetoni me granil e gur kave 4 cm me makineri me sasi 1190 m<sup>3</sup> dhe vlerë 1,769,530 lekë.</p> <p>Në total për rubrikën “Punime sistemimi i sheshit të objekteve në depo Kodras” sipas situacionit 11 ka vlerën 5,909,396 lekë.</p> <p>Zëri i punës “Mbushje me zhavorr pas mureve” në titullin “Punime sistemimi i sheshit të objekteve në depo Kodras” me sasi 750 m<sup>3</sup> dhe vlerë 885,000 lekë nuk ishte realizuar ende në terren.</p> <p>Duke u bazuar situacionit nr.11 i cili nuk është situacioni përfundimtar dhe verifikimin në terren për punimet e kryera shuma <b>18,763,760</b> lekë është vlere e punimeve ende të pakryera. Në lidhje me këto konstatime të grupit të auditimit, nga subjekti kontraktor por edhe nga Bashkia Peqin janë paraqitur observacione dhe dokumentacion shtesë nga ai i paraqitur gjatë fazës së auditimit në terren. Në lidhje me këto pretendime grupi i auditimit nuk mund të dalë në përfundime nëse volumet e zëravë të punimeve të mësipërme janë në përputhje si nga ana sasiore si ajo cilësore me projektin e miratuar pasi e ka ezauruar verifikimin dhe auditimin ne terren. Në lidhje me ecurinë e zbatimit të kontratës lind e nevojshme ngritja e një grupi pune nga Bashkia Peqin për të verifikuar dhe rakorduar kryerjen e punimeve dhe ecurinë e tyre sipas pagesave përkatëse.</p>
<p><b>Kriteri:</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.</li> <li>- Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, pika 3.</li> <li>-Kontrata e lidhur midis sipërmarrësit dhe investitorit me Nr.704 Prot, datë 19.04.2021 dhe me afat përfundimi 7 muaj nga lidhja e kontratës.</li> </ul>



<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Shumë prej <b>18,763,760</b> lekë përbën dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të bashkisë Peqin, konstatuar gjatë fazës së auditimit në terren.
<b>Shkaku:</b>	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrës të punimeve.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandime:</b>	Për arsye se gjatë vazës së verifikimit në teren të investimit nga ana e grupit të auditimit, punimet nuk kanë qenë tërësisht të përfunduara, nga Bashkia Peqin të ngrihet një grup pune me inxhinierë specialistë të fushës të cilët kryejnë verifikimet e punimeve, referuar konstatimeve të bëra nga grupi i auditimit të KLSH. Bazuar në verifikimet e kryera të bëhen rakordimet në situacionin përfundimtar. Grupi i punës të mbajë një proces-verbal për atë çfarë do konstatojë në terren, të cilin t’ja paraqes për veprime të mëtejshme Kryetarit të Bashkisë. Për ato zëra punimesh të cilat do të konstatohen të pa kryera, të kërkohet prej kontraktorit realizimi i tyre dhe, në rast mospranimi, të kërkohet shlyerja e dëmit në vlerën e punimeve të pa kryera të cilin ta vendosë në dispozicion grupit të auditimit radhës nga KLSH që do jetë në vijim në Bashkinë Peqin.

***Pretendimi i subjektit:***

*Nga ana e subjektit të audituar është vënë në dispozicion të grupit të auditimit librezat e masave për zërat e punës “Ndërtim i sheshit të objekteve në vendburim”, “Ndërtim rrugë hyrëse në stacionin e pompave L=334 m”, “Punime sistemimi i sheshit të objekteve në depo Kodras”, “Ndërtim rrugë hyrëse depo L=100 m”, “Sistemim i sheshit të objekteve”, “Rrjeti shpërndarës fshati Caushaj, rruga kryesore”.*

*Gjithashtu janë vënë në dispozicion dhe imazhe(foto) nga punimet e kryera në terren si dhe planimetritë e rrugëve.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Grupi i auditimit e ka përfunduar fazën e kontrollit në terren dhe për këto punimeqë ju pretendoni se janë kryer nuk mund të shprehet nëse janë realizuar apo jo sipas projektit të miratuar. Grupi i KLSH-së nuk mund të dalë në përfundime nëse volumet e zëravë të punimeve të mësipërme janë në përputhje si nga ana sasiore si ajo cilësore me projektin e miratuar prandaj rekomandojmë:

Nga ana e bashkisë Peqin të ngrihet një grup pune me inxhinierë specialistë të kryej verifikimet e duhura bazuar mbi aktin e konstatimit të lenë nga KLSH dhe pretendimet e subjektit se ato zëra pune janë realizuar. Grupi i punës i ngritur nga bashkia Peqin të mbajë një proces-verbal ku për atë çfarë do konstatojë në terren dhe tja vëjë në dispozicion grupit të radhës nga KLSH që do jetë në vijim.

**2.** Mbi auditimin e zbatimit të kontratës me objekt “Ndërtimi i pritave lumore dhe përforcimi i këmbëve të urës në shtratin e Lumit Shkumbin”.

<b>Titulli i Gjetjes 1:</b>	<b>Nga kontrolli i punimeve në terren për zbatimin e kontratës me objekt “Ndërtimi i pritave lumore dhe përforcimi i këmbëve të urës në shtratin e Lumit Shkumbin” u konstatua:</b>
<b>Situata:</b>	-Zëri i punës An.164/1b “Mbushje me çakëll e gur gurore në trupin e rrugës ,përhapur e ngjeshur me makineri(për krijimin e trasesë së aksesit) nuk u identifikua në terren. Janë situacionuar 7376.4 m <sup>3</sup> mbushje me një.

	<p>-Zëri i punës 3.333 “Gabione me rrjetë teli të zinguar e gurë kave” 1x1x2m dhe Zëri i punës 3.331 Gabione me rrjetë teli të zinguar e gurë kave 1x1x1m.</p> <p>Janë situacionuar 68 m<sup>3</sup> gabione me rrjetë teli 1x1x2 m dhe 34 m<sup>3</sup> gabione me rrjetë teli 1x1x1m.Në total janë 102 m<sup>3</sup> .Sipas librezës së masave gjatësia e gabionit është 17 metër. Gjatësia faktike e matur në terren është 15.3 metër linear. Diferenca prej 1.7 metër linear e konvertuar në sasi lekësh është <b>102,000 lekë</b></p> <p>Në njërën nga këmbët e urës pjesa e poshtme e përforcimit ishte gërryer nga rrjedha e lumit.</p> <p>-Zëri i punës 2.262/4 Shtresë betoni C -16/20,t=10 cm për nënshtresë. Janë gjithsej 9 këmbë tek ura e përforcuar. Përmasa e shtresës së betonit 10 cm poshtë këmbës së urës është 8 metër me 5 metër. Duke llogaritur volumin <math>9 \times 8 \text{ m} \times 5 \text{ m} \times 0.1 \text{ m} = 36 \text{ m}^3</math> .Janë situacionuar 132 m<sup>3</sup> shtresë betoni t=100 cm.<math>132 \text{ m}^3 - 36 \text{ m}^3 = 96 \text{ m}^3 \times 14,000 \text{ lekë/ m}^3 = \mathbf{1,344,000 \text{ lekë}}</math>.</p> <p>-Zëri i punës struktura monolite betoni me cakëll C-30/37.Nga matjet në terren rezulton se këmisha e 5 m x 2 m x 2 m prizmi sipër dhe 7 m x 4 m X 1.7 m prizmi posht. Këto përmasa janë pranuar nga grupi i auditimit duke krahasuar matjet e realizuara në terren me ato të cilat janë pasqyruar në libërën e masave që janë ilustruar në tabelën e mëposhtme.Nga llogaritja e vëllimeve të betonit për të dy prizmat rezulton 20 m<sup>3</sup> dhe 47.6 m<sup>3</sup> në total 67.6 m<sup>3</sup> .Këtij volumi duhet ti zbritet volumi që zë kolona me seksion të prerjes tërthore rrethore dhe me diametër 1.6 metër .Volumi i 1 kolone do të jetë <math>3.14 \times 0.8^2 \times 3.7 = 8.05 \text{ m}^3</math> është vëllimi që zë një kollonë në këmishën e betonit.Cdo këmbë e urës përbëhet nga 2 kolona,që do të thotë se vëllimi që duhet ti zbritet një këmbë është 16.1 m<sup>3</sup></p> <p>Nga veprimet rezulton se <math>67.6 \text{ m}^3 - 16.1 \text{ m}^3 = 51.5 \text{ m}^3</math> rezulton vëllimi i bëtonit për përforcim i një këmbë.Në total janë 463.5m<sup>3</sup> beton për 9 këmbët.Janë situacionuar 510 m<sup>3</sup> beton-<math>463.5 \text{ m}^3 = 46.5 \text{ m}^3 \times 19000 \text{ lekë/ m}^3 = \mathbf{883,500 \text{ lekë}}</math>.</p>
<b>Kriteri:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.</li> <li>- Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, pika 3.</li> <li>- Kontrata midis sipërmarrësit dhe investitorit me Nr.1613 Prot, datë 13.10.2022</li> </ul>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Vlera prej <b>102,000</b> lekë përbën <b>dëm ekonomik</b> shkaktuar Bashkisë Peqin.
<b>Shkaku:</b>	Neglizhencë nga ana e investitorit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandime:</b>	Bashkia Peqin të marrë masa për arkëtimin e vlerës 102,000 lekë nga BOE “LL.” ShPK , “V.K.” dhe “B. N” ShPK., për mos vendosjen në punimet e kontratës me objekt “Ndërtimi i pritave lumore dhe përforcimi i këmbëve të urës në shtratin e Lumit Shkumbin”, të gabionit me rrjet teli në gjatësinë 1.7 m linear.

*Pretendimi i subjektit:*

*Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve është dërguara observacioni me fakte dhe prova konkretisht:*

*-Për zërin e punës “Mbushje me çakëll e gur gurore në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri” është një proces pune i realizuar në fakt siç është parashikuar edhe në projekt për efekt se gërryerjet mëdha të skarpatës nga ana e lumit e bënin të pamundur lëvizshmërinë e mjeteve të rënda për ndërtimin e katër pritave lumore pasi dhe lartësia e skarpatës ishte mbi 5 m. Këtë zë pune e ilustron me pamjen e mëposhtme.*



*Për zërin e punës “Shtresë betoni C-16/20” t=10 cm për nënshtresë mbikqyrsi i punimeve citon:*

*-Zbatimi i punimeve ka gjithmon problematikat e veta në raport me zgjidhjet e dhena në projekt sikundër dhe rasti në fjalë ku gjatë gëmimeve përreth këmbëve të urës për krijimin e hapsirës së nevojshme për betonim ku është pranuar përmasa 8 m x 5 m në disa raste edhe më shumë për arsye të levizjës së dherave dhe qëndrueshmërisë së terrenit. Ky problem vazhdon edhe më nënshtresën e cila nuk është 10 cm por e ndrshyshme për shkak të vështirsisë së terrenit.*

*Zëri i punës Strukturë betoni me çakëll C-30/37. Në lidhje me rrezen e këmbëve të urës ku është 0.6 metër dhe jo 0.8m madje në shumë pjesë kjo rreze shkon edhe më pak për shkak të dëmtimit nga gërryerja.*

*Prizmi lart:  $9\text{ m} \times 5\text{ m} \times 2\text{ m} \times 2\text{ m} = 180\text{ m}^3$*

*Prizmi posht :  $9\text{ m} \times 7\text{ m} \times 1.7\text{ m} \times 4\text{ m} = 428.4\text{ m}^3$*

*Volumi cilindrit:  $3.14 \times 0.6^2\text{ m} \times 3.7\text{ m} \times 9 \times 2 = 75.3\text{ m}^3$*

*Volumi total :  $180\text{ m}^3 + 428.4\text{ m}^3 - 75.3\text{ m}^3 = 533.1\text{ m}^3$*

*Qëndrimi i grupit të auditimit:*

*Grupi i auditimit merr në konsideratë këto komente.*

**3. Mbi auditimin e zbatimit të kontratës me objekt “Ndërtimi dhe sistemimi me gabion i përroit të Rushtës njësia administrative Karinë”:**

<b>Titulli i Gjetjes 1:</b>	<b>Nga kontrolli i punimeve në terren për zbatimin e kontratës me objekt</b> “Ndërtimi dhe sistemimi me gabion i përroit të Rrushtës njësia administrative Karinë”, u konstatua
<b>Situata:</b>	Për zërin e punës “Mbushje me argjil pas mureve” nga kontrolli në terren nuk u konstatua të jetë kryer dhe as imazhet e vëna në dispozicion nuk e dëshmojnë këtë fakt. Sipas situacionit përfundimtar është situacionuar volumi 1091 m <sup>3</sup> me çmimi prej 981,900 lekë buxhetit të shkaktuar bashkisë Peqin. -Zëri i punës shtresë betoni. Nga matjet në terren rezulton se muret të cilët janë betonuar mbi kallëpet e gabioneve kanë në gjerësi 1 metër dhe lartësi 0.5 m. Gjatësia e murit me 4 shkallë gabionesh është 44.2 metër dhe 35.3 metër. Nga llogaritjet rezulton $(44.2m+35.3m) \times 1m \times 0.5m = 39.8m^3$ beton. Shtojmë dhe 10 m <sup>3</sup> beton që është përdor për të shtruar një pjesë të rrugës afër murit. Në total janë 49.8m <sup>3</sup> beton. Janë situacionuar 99m <sup>3</sup> beton- $49.8m^3 = 49.2m^3 \times 10000 = 492,000$ lekë.
<b>Kriteri:</b>	- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, pika 3. - Kontrata mes sipërmarrësit dhe investitorit me Nr.692 Prot, datë 15.04.2021
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Vlera prej <b>55,000</b> lekë përbën <b>dëm ekonomik</b> shkaktuar Bashkisë Peqin.
<b>Shkaku:</b>	Neglizhencë nga ana e investitorit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandime:</b>	Bashkia Peqin të marrë masa për arkëtimin e vlerës 55,000 lekë nga BOE LL. ShPK” dhe ”M. ShPK, për mos realizimin në teren të sasisë së betonit prej 5.5. m <sup>3</sup> , në kontratën me objekt “Ndërtimi dhe sistemimi me gabion i përroit të Rrushtës njësia administrative Karinë”.

*Pretendimi i subjektit:*

*Subjekti pretendon se për zërin e punës “Mbushje me argjil pas mureve” sipërfaqja ë plan e rrëshqitjes së skarpatës deri në distancën e parashikuar për skajin e mureve gabion arrin në rreth 384 m<sup>2</sup> ndërkohë që lartësia deri në kuotën zero të mureve arrin 4.6m -4.8 m(duke zbritur dhe kuotën e rrugës  $20+10+6+4=40cm$ ,  $H\ mes=4.7-0.4=4.3\ m$ )*

*$V=S \times H=384\ m^2 \times 4.3\ m =1651.2\ m^3$  (argjil + zhavorr)*

*Janë situacionuar 1635 m<sup>3</sup> mbushje totale. Më poshtë jepet e ilustruar me imazh.*



Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit merr në konsideratë këtë koment.

*Pretendimi i subjektit:*

*Nisur nga matjet faktike volumi i përdorimit të betonit është si më poshtë:*

*Muret e gabionit me katër kate me gjatësi  $L=35.3$  m gjerësi  $B=1$  m dhe trashësi  $h=0.5$  m*

$$35.3 \times 1 \times 0.5 = 17.5 \text{ m}^3$$

*Muret e gabionit me tre kate  $44.2 \times 1 \times 0.65 = 28.7 \text{ m}^3$*

*Sipërfaqja e trajtuar është  $384 \text{ m}^2$ . Hiqet  $150 \text{ m}^2$  sipërfaqe e cila është e shtruar me asfalt.  $384 \text{ m}^2 - 150 \text{ m}^2 = 234 \text{ m}^2$ . Betoni ka një trashësi  $20 \text{ cm}$ .  $234 \text{ m}^2 \times 0.2 = 46.8 \text{ m}^3$*

*Gjithashtu është përdorur  $0.3 \text{ m}^3$  beton për të lidhur murin ekzistues prej betoni me murin e gabionit. Në total kemi:  $17.5 \text{ m}^3 + 28.7 \text{ m}^3 + 46.8 \text{ m}^3 + 0.3 \text{ m}^3 = 93.5 \text{ m}^3$*

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit merr pjesërisht në konsideratë observacionin e mësipërm pasi edhe me faktet dhe llogaritjet e vëna në dispozicion volumi total i betonit i cili është  $93.5 \text{ m}^3$  është më i vogël se ai i situacionuar që është  $99 \text{ m}^3$ . Diferenca  $99 \text{ m}^3 - 93.5 \text{ m}^3 = 5.5 \text{ m}^3 \times 10000 \text{ lekë/m}^3 = 55,000$  lekë shumë e cila përbën **dëm ekonomik** shkaktuar Bashkisë Peqin.

## 2.5 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Në zbatim të pikës 5 të Programit të Auditimit me nr. 429/1 prot; datë 19.05.2023, me objekt: “**Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit**”, prej datës 01.01.2021 deri më 31.12.2022, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Dokumentacioni në sistemin “E leje”;
- Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë e urbanistikës;
- Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë e financës;
- Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë juridike;
- Dokumente të tjera nga arkiva, etj
- Bashkia Peqin ka të miratuar **Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregulloren e Planit të Përgjithshëm të Territorit** të miratuar me Vendim e **Këshillit Bashkiak** Nr. 127, datë

16.12.2020, si dhe me Vendimin e **Këshillit Kombëtar të Territorit**, Nr. 3, datë 28.12.2020.

- 
- Auditimi konsiston në këto fusha:
- 1. Dhënia e Lejes së Zhvillimit, krahasimi i dokumentacionit me kriteret e vendosura.
- 2. Dhënia e Lejes së Ndërtimit, dokumentacioni, krahasimi dhe zbatimi i treguesve parametrik.
- 3. Saktësia e llogaritjes së Taksës së Ndikimit në Infrastrukture.
- 4. Dhënia e Çertifikatës së Përdorimit

**LEJET E NDËRTIMIT DHE ZHVILLIMIT PËR PERIUdhËN 01.01.2021 - 31.12.2022**

- Duke ju referuar sistemit *e-leje* të lejeve të ndërtimit dhe në bazë informacioneve që janë vendosur në dispozicion nga Bashkia Peqin, gjatë periudhës 01.01.2021 deri më 31.12.2022 është aplikuar nga subjekte të ndryshme për leje ndërtimore në **77 raste**, të evidentuara në tabelën përmbledhëse në **Aneksin 1**.

<b>APLIKIME NË SISTEMIN E-LEJET PËR PERIUdhËN 01.01.2021-31.12.2022</b>			
<b>Lloji i lejes</b>	<b>Total</b>	<b>Miratuar</b>	<b>Refuzuar</b>
Leje zhvillimi	13	10	3
Leje ndërtimi mbi 250m <sup>2</sup>	5	5	0
Leje ndërtimi deri 250m <sup>2</sup>	11	11	0
Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	22	18	4
Rikonstrukcion	1	1	0
Çertifikatë përdorimi	9	7	2
Shtesë në objekt ekzistues deri në 250 m <sup>2</sup>	2	2	
Ndryshim projekti gjatë zbatimit	0	0	0
Ndryshim funksioni	1	1	-
Njoftim fillim punimesh	8	7	1
Shtyrje afati leje ndërtimi	1	1	
Leje infrastrukture	4	3	1

- *Aneksi 1 Përpunoi: Grupi i auditimit*
- 

- Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga zyra e Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (në vijim DPKZHT) e Bashkisë Peqin, leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m<sup>2</sup> janë miratuar **5 leje**, leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të vogël se 250 m<sup>2</sup> janë miratuar **11 leje**, ndërsa çertifikata përdorimi janë miratuar **7 certifikata**, të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:

- Në bazë të analizës së riskut dhe me shqyrtimin rast pas rasti të tipologjive të ndryshme të ndërtimit janë përzgjedhur për t'u audituar rastet e mëposhtme të lejeve të ndërtimit për ndërtime me sipërfaqe deri ose më të madhe se 250 m<sup>2</sup>, si dhe çertifikatave të përdorimit:

<b>Nr</b>	<b>Objekti</b>	<b>Zhvilluesi</b>	<b>Data e lëshimit të lejes</b>	<b>Preventivi</b>
1	Leje ndërtimi për kabanon frigoriferik 1 kat	R. SH.P.K	26/11/2021	42,799,403
2	Leje ndërtimi për rikonstrukcion I ish-repartit ushtarak nr. 5012, në Peqin, Godina 3, 4 dhe sistemimet përreth tyre	A. SH.P.K	24/08/2022	15,079,321
3	Leje ndërtimi për magazinim i inputeve bujqësore	R. SH.P.K	14.10.2022	15,079,321
4	Çertifikatë përdorimi për podrum dhe banesë 2 kate	S. M.	27.10.2022	

5	Çertifikatë përdorimi për punishte vaji 1 kat	K.T.	17.11.2022
---	---	------	------------

- Aneksi 2 Përpunoi: Grupi i auditimit

-

- Në lidhje auditimin e procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit, vërehen parregullsitë si më poshtë:

<b>Titulli i gjetjes 1:</b>	Projekti ndërtimor nuk është i plotë, si dhe mungon dokumentacioni shoqërues.
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në tre raste të audituara, projekti ndërtimor nuk është i plotë, si dhe mungon dokumentacioni shoqërues, më konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Për objektin “Leje ndërtimi për kabanon frigoriferik 1 kat”, konstatohet se kartelat e pasurisë së paluajtshme nuk janë ngarkuar të azhornuara gjatë 3 muajve të fundit, kjo në kundërshtim me Ligjin nr.111/2018 “Për kadastrën”, Neni 17 “Certifikatat”, pika 4 dhe 6, Vendimin nr. 457, datë 29.6.2022, Neni 18 dhe 21, si dhe VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, Neni 45, pika c). Gjithashtu, për këtë objekt mungon studimi sizmik dhe gjeologjik, në kundërshtim me VKM-në nr. 1162, datë 24.12.2020.</li> <li>- Për objektin “Leje ndërtimi për rikonstruksion i ish-repartit ushtarak nr. 5012, në Peqin, Godina 3, 4 dhe sistemimet përreth tyre”, konstatohet se mungon projekti elektrik, hidraulik, i ngrohje – ftohjes, i mbrojtjes ndaj zjarrit, relacioni i gjendjes ekzistuese, rilevimi topografik dhe auditimi i efikasitetit energjetic, këto në kundërshtime me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, Neni 15, pika 1, nënpika ç), e), ë), f), g), pika 1/1, nënpika ii, iii, iv, v.</li> <li>- Për objektin “Leje ndërtimi për magazinim i inpueteve bujqësore”, konstatohet se mungon projekti i ngrohje – ftohjes, studimi sizmik dhe gjeologjik, licenca profesionale për hartuesin e projektit konstruktiv, si dhe deklarata e përgjegjësisë profesionale për hartuesin e projektit të mbrojtjes ndaj zjarrit. Gjithashtu për këtë objekt konstatohet se raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, nuk është i objektit që është pajisur me leje ndërtimi, por i një objekti tjetër. Gjetjet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.5.2015, i ndryshuar, Neni 15, pika 1, nënpika ç), e), ë), g); pika 1/1, nënpika iii, v; në kundërshtim me Nenin 16 të Ligjit nr. 124/2015, pika 5, nënpika b), në kundërshtim me VKM-në nr. 1162, datë 24.12.2020.</li> </ul>
<b>Kriteri:</b>	<p>Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <b>Ligji nr.111/2018</b>, Neni 17, pika 4 dhe 6;</li> <li>- <b>Vendimi nr. 457</b>, datë 29.6.2022, Neni 18 dhe 21;</li> <li>- <b>VKM nr. 408</b>, datë 13.05.2015, i ndryshuar, Neni 45, pika c).</li> </ul>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mangësitë në projektin ndërtimor, ndikojnë në cilësinë dhe garatimin e ndërtimeve sipas standarteve, kushteve higjieno-sanitare dhe të sigurisë, nga subjekte të cilat duhet të plotësojnë kriteret e ushtrimit të profesionit, sipas legjislacionit në fuqi.
<b>Shkaku:</b>	Neglizhencë nga ana e DPKZHT Peqin
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandime:</b>	Nga DPKZHT dhe Bashkia Peqin, të merren masa për të kërkuar në çdo rast që aplikohet për t’u pajisur me leje ndërtimi, të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, sipas legjislacionit dhe rregulloreve në fuqi, si dhe të mos miratojnë asnjë leje ndërtimi me mangësi në projektin ndërtimor dhe dokumentacionit shoqërues të tij. Gjithashtu, DPKZHT të kontrollojë vërtetësinë, saktësinë dhe orgjinalitetin e

dokumentacionit të dorëzuar nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, si dhe të shmangë miratimin e lejeve të ndërtimit, deri në plotësimin e dokumentacionit sipas kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi.

- 
- Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:
  - - **Z. L.T.**, me detyrë Kryetar i Bashkisë Peqin;
  - - **Z. E.J.**, në funksionin e drejtorit të DPKZHT;
  - - **Z. J.S.**, në funksionin e drejtorit të DPKZHT;
  - - **Z. E.H.**, në funksionin e specialistit pranë DPKZHT;
  - - **Znj. A.D.**, në funksionin e specialistes pranë DPKZHT;
  - - **Znj. Xh.S.**, në funksionin e juristes pranë DPKZHT;
  - - **Znj. B.T.**, në funksionin e specialistes pranë DPKZHT;
  - - **Z. K.S.**, në funksionin e specialistit pranë DPKZHT;
  - - **Z. A.Ç.**, në funksionin e specialistit pranë DPKZHT.
- 

- Lidhur me objektet dhe gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 429/2 prot., datë 07.07.2023, është observuar nga ana e përfaqësuesve të Bashkisë Peqin, z. E.J., z. J.S., z. E.H., znj. A.D., znj. B.T., znj. Xh.S., z. K.S., z. A.Ç., si dhe z. L.T., me detyrë Kryetar i Bashkisë Peqin, me anë të shkresës nr. 113/1 prot., datë 04.07.2023, si më poshtë vijon:

- **1.1 Pretendimi i subjektit:**

- Në lidhje me gjetjet e konstatuara për “**Kapanon frigoriferik 1 kat**”, miratuar me Vendim nr. 120, nr. 148 prot., datë 26.12.2021, me zhvillues R. SHPK, në Peqin, shprehen se:  
- “*Kartelat e pasurisë së paluajtshme janë të azhornuara gjatë 3-muajve të fundit referuar Lejes së Zhvillimit, datë 19.10.2021, dhe aplikimi për Leje Ndërtimi është bërë në datë 05.11.2021.*”

- **1.2 Opinioni i grupit të auditimit:**

- Në lidhje me observacionin tuaj, shprehemi se kërkesat e Ligjit nr. 111/2018 dhe Vendimit nr. 457, duhen respektuar me qëllimin që Bashkia të ketë të gjitha garancitë e nevojshme se mbi pasuritë e paluajtshme nuk janë kryer transaksione apo tjetërsime. Kartelat e pasurisë së paluajtshme të përditësuara gjatë tre muajve të fundit, është dokumentacion që kërkohet përpara çdo procedura, edhe jo vetëm përpara pajisjes me leje zhvillimi. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

- **2.1 Pretendimi i subjektit:**

- Në lidhje me gjetjet e konstatuara për “**Magazinim i Inputeve Bujqësore**”, miratuar me Vendim nr. 158, nr. 194 prot., datë 14.10.2022, me zhvillues R. SHPK, në Peqin, shprehen se:

- “*Në lidhje me mangësitë e projektit ndërtimor dhe dokumentave shoqëruese, bashkëngjitur janë të gjitha materialet që nuk janë arritur të gjenden në sistemin e-lejet duke qenë se ndodhen në folderin “Të tjera”*”.

- **2.2 Opinioni i grupit të auditimit:**

- Në lidhje me observacionin tuaj, shprehemi se nga verifikimi i kryer mbi informacionin e dërguar nëpërmjet observacioneve, rezulton se dokumentat të cilat do të merren në konsideratë janë rilevimi topografik, licenca profesionale dhe polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesin e projektit konstruktiv. Në lidhje me raportin e



Vlerësimi të Ndikimit në Mjedis, shprehemi se edhe pse ky raport është dërguar fizikisht, si pjesë e observacioneve, që prej 01.09.2016, çdo dokument në lidhje me aplikimin për pajisje me leje ndërtimi, duhet të kalojë përmes sistemit e-lejet. Pjesa tjetër e dokumentacionit që mungon, nuk është arritur të vendoset në dispozicion nga Bashkia Peqin. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

<b>Titulli i gjetjes 2:</b>	Informacioni i dokumentacionit të aplikimit për leje ndërtimi nuk është i saktë.
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në një rast informacioni i dokumentacionit të aplikimit për leje ndërtimi nuk është i saktë në të gjitha rastet, më konkretisht:</p> <p>- Për objektin <u>“Leje ndërtimi për kapanon frigoriferik 1 kat”</u>, konstatohet se plani i rilevimit nuk është i plotësuar me të gjitha të dhënat e nevojshme dhe të domosdoshme, gjithashtu polica e sigurimit të përgjegjësive profesionale për subjektin në rolin e aplikantit, i cili ka hartuar gjithashtu projektin arkitektonik, konstruktiv, elektrik, hidraulik, të instalimeve të ngrohje – ftohjes, si dhe të mbrojtjes ndaj zjarrit, nuk është brenda afatit të vlefshmërisë. Gjithashtu, informacioni i vendosur në planvendosjen e miratuar, nuk është i saktë, pasi objekti zhvillohet vetëm mbi pasurinë 1/95, ZK 1112, me sipërfaqe totale 4350 m<sup>2</sup>, dhe jo mbi pasuritë e tjera nën pronësinë e zhvilluesit, më konkretisht pasuria 2/15, ZK 1112, me sipërfaqe totale 2400 m<sup>2</sup>; pasuria 2/19, ZK 1112, me sipërfaqe totale 3500 m<sup>2</sup>; pasuria 2/28, ZK 1112, me sipërfaqe totale 1200 m<sup>2</sup>. Informacioni që marrim nga planvendosja e miratuar është: <i>“Sipërfaqja e përgjithshme e truallit – 7950 m<sup>2</sup>”</i>, informacioni i cili është i gabuar, pasi siç duket dhe nga mbivendosja në fragmetin e hartës treguese, objekti shtrihet vetëm mbi pasurinë 1/95, pasuritë e tjera nuk kanë lidhje fizike me njëra - tjetrën, edhe pse ndodhen në afërsi. Rritja fiktive e sipërfaqes së truallit të ndërtueshëm, ka ndikuar në zvogëlimin e parametrave urban, siç janë intensiteti (I) dhe koeficienti i shfrytëzimit të territorit (KSHT).</p>
<b>Kriteri:</b>	<p>Anomali të mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:</p> <p>- <b>VKM nr. 408, datë 13.5.2015</b>, i ndryshuar, Neni 10; Neni 15, pika 1, nënpika g).</p>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mangësitë në informacionin e dokumentacionit të aplikimit për leje ndërtimi, çënojnë garancinë që objektet e miratuara duhet të kenë në lidhje me standartet e sigurisë, qëndrueshmërisë, kushtet higjieno-sanitare dhe mjedisore.
<b>Shkaku:</b>	Neglizhencë nga ana e DPKZHT Peqin
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandime:</b>	Nga DPKZHT dhe Bashkia Peqin të merren të gjitha masat që të mos miratojnë asnjë leje ndërtimi në kushtet e mungesës së dokumentacionit, informacioni duhet të jetë i saktë përgjatë gjithë procedurës, si dhe brenda afateve të parashikuara në ligj.

- Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:
  - - **Z. L.T.**, me detyrë Kryetar i Bashkisë Peqin;
  - - **Z. E.J.**, në funksionin e drejtorit të DPKZHT;
  - - **Z. E.H.**, në funksionin e specialistit pranë DPKZHT;
  - - **Znj. A.D.**, në funksionin e specialistes pranë DPKZHT;

- **Z. K.S.**, në funksionin e specialistit pranë DPKZHT;
- **Z. A.Ç.**, në funksionin e specialistit pranë DPKZHT.

- Lidhur me objektet dhe gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 429/2 prot., datë 07.07.2023, është observuar nga ana e përfaqësuesve të Bashkisë Peqin, z. E.J., z. J.S., z. E.H., znj. A.D., znj. B.T., znj. Xh.S., z. K.S., z. A.Ç., si dhe z. L.T., me detyrë Kryetar i Bashkisë Peqin, me anë të shkresës nr. 113/1 prot., datë 04.07.2023, si më poshtë vijon:

- **1.1 Pretendimi i subjektit:**

- Në lidhje me gjetjet e konstatuara për lejen e ndërtimit të miratar, cituar më sipër, shprehen se:

- *“Përsa i përket përmbajtjes së planit të rilevimit ,projektuesi përkatës, bashkë me planin, ka ngarkuar edhe licencën shoqëruar me deklaratën e përgjegjësisë profesionale. Këto dokumenta i gjeni bashkëngjitur materialit”.*

- **1.2 Opinioni i grupit të auditimit:**

- Në lidhje me observacionin tuaj, shprehem se gjetja ka të bëjë me mangësitë e planit të rilevimit, dhe jo me dokumentat shoqëruese të planit të rilevimit. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

- **2.1 Pretendimi i subjektit:**

- Në lidhje me gjetjet e konstatuara për lejen e ndërtimit të miratar, cituar më sipër, shprehen se:

- *“Referuar projekteve të hartuar nga projektuesi në fjalë si ai elektrik, konstruktiv, MNZ etj, rezulton që këto projekte janë brenda afatit kohor të policës së sigurimit të përgjegjësisë profesionale për subjektin I. R.”*

- **2.2 Opinioni i grupit të auditimit:**

- Në lidhje me observacionin tuaj, shprehem se grupi i auditimit nuk ka informacion në lidhje me afatet kohore të hartimit të projekteve ndërtimore, gjithsesi, polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale duhet të jetë brenda afatit të vlefshmërisë përkundrejt datës së aplikimit dhe jo hartimit të projektit ndërtimor. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

- **3.1 Pretendimi i subjektit:**

- Në lidhje me gjetjet e konstatuara për lejen e ndërtimit të miratar, cituar më sipër, shprehen se:

- *“Përsa i përket lidhjes fizike të pasurive me njëra-tjetrën ,para miratimit të Lejes së Ndërtimit, kemi marrë konfirmim nga ASHK Vendore mbi rrugën që lidh këto dy pasuri. Bashkëngjitur shkresa e konfirmimit.”*

- **3.2 Opinioni i grupit të auditimit:**

- Në lidhje me observacionin tuaj, shprehem se, referuar shkresës me nr. 205 prot., datë 23.04.2021, ASHK Vendore ka informuar Bashkinë Peqin, se pasuria nr. 1/40, vol. 1, fq. 40, ZK 1112, është tokë shtet. Referuar hartës treguese të pasurive, identifikohet se kjo pasuri ndodhet midis pasurive 1/95 dhe 2/15; 2/19, pra këto pasuri nuk janë kufitare dhe si të tilla nuk do të duhej të konsideroheshin si pjesë përbërëse të të njëjtës parcelë. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

<b>Titulli i gjetjes 3:</b>	Nuk është kërkuar mendimi i të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në tre raste nuk është kërkuar mendimi i asnjë prej autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, më konkretisht: - Për objektin <u>“Leje ndërtimi për kapanon frigoriferik 1 kat”</u> ; - Për objektin <u>“Leje ndërtimi për rikonstruksion i ish-repartit ushtarak nr. 5012, në Peqin, Godina 3, 4 dhe sistemimet përreth tyre”</u> ; - Për objektin <u>“Leje ndërtimi për magazinim i inpueteve bujqësore”</u> ;
<b>Kriteri:</b>	Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon: - <b>VKM nr. 408, datë 13.05.2015</b> , i ndryshuar, Neni 10/1, pika 6.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Miratimi i lejeve të ndërtimit në mungesë të mendimit të të autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, duke mos respektuar mendimin e tyre, krijon kushte të favorshme për një zhvillim të pakontrolluar, duke cenuar zhvillimin e kontrolluar urban, standardet higjeno-sanitare, mjedisore dhe sigurinë.
<b>Shkaku:</b>	Neglizhencë nga ana e DPKZHT Peqin
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandime:</b>	Nga DPKZHT Peqin të merren të gjitha masat për marrjen dhe respektimin e mendimit dhe vendimeve të të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit.

- 
- Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:
  - - **Z. L.T.**, me detyrë Kryetar i Bashkisë Peqin;
  - - **Z. E.J.**, në funksionin e drejtorit të DPKZHT;
  - - **Z. J.S.**, në funksionin e drejtorit të DPKZHT;
  - - **Z. E.H.**, në funksionin e specialistit pranë DPKZHT;
  - - **Znj. A.D.**, në funksionin e specialistes pranë DPKZHT;
  - - **Znj. Xh.S.**, në funksionin e juristes pranë DPKZHT;
  - - **Znj. B.T.**, në funksionin e specialistes pranë DPKZHT;
  - - **Z. K.S.**, në funksionin e specialistit pranë DPKZHT;
  - - **Z. A.Ç.**, në funksionin e specialistit pranë DPKZHT.
- 

- Lidhur me objektet dhe gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 429/2 prot., datë 07.07.2023, është observuar nga ana e përfaqësuesve të Bashkisë Peqin, z. E.J., z. J.S., z. E.H., znj. A.D., znj. B.T., znj. Xh.S., z. K.S., z. A.Ç., si dhe z. L.T., me detyrë Kryetar i Bashkisë Peqin, me anë të shkresës nr. 113/1 prot, datë 04.07.2023, si më poshtë vijon:
    - **1.1 Pretendimi i subjektit:**
    - Në lidhje me gjetjet e konstatuara për lejet e ndërtimit të miratuar, cituar më sipër, shprehen se:
    - *“Bashkëngjitur është mendimi i ARRSH, marrë në aplikimin për leje zhvillimi dhe si rrjedhojë, nuk ridërgohet për mendim në aplikimin për leje ndërtimi.”*

- **1.2 Opinioni i grupit të auditimit:**
- Në lidhje me observacionin tuaj, shprehemi se marrja e mendimit të autoriteteve që duhet të shprehen paraprakisht nuk duhet të kufizohet vetëm në lejen e zhvillimit, por, siç parashikohet edhe në VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, duhet kërkuar mendimi i këtyre autoriteteve edhe në fazën e aplikimit për leje ndërtimi. Gjithsesi, për rastin në fjalë, ARRSH është shprehur negativisht, me anë të shkresës me lëndë: “*Aplikim për lloj leje ‘Leje Zhvillimi’, nr. regjistri/prot; 135*”, nr. 7513 prot., datë 19.08.2021. Edhe pse në këto kushte, Bashkia Peqin ka vazhduar me miratimin e lejes së zhvillimit, dhe më tej, lejes së ndërtimit. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.
- **2.1 Pretendimi i subjektit:**
- Në lidhje me gjetjet e konstatuara për lejet e ndërtimit të miratuara, cituar më sipër, shprehen se:
  - “*Nuk është parë e arsyeshme, referuar PPV-së, marrja e mendimeve të institucioneve për aplikimin në fjalë.*”
- **2.2 Opinioni i grupit të auditimit:**
- Në lidhje me observacionin tuaj, shprehemi se marrja e mendimit nga autoritetet të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit është një procedurë, e cila është përfshirë në rregullore, për të krijuar të gjitha siguritë e nevojshme, që objekti i ri do të respektojë të gjitha standartet e zhvillimit të kontrolluar. Bashkia Peqin nuk e ka kompetencën që të miratojë leje ndërtimi duke mos kërkuar mendimin e këtyre institucioneve. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

<b>Titulli i gjetjes 4:</b>	Në asnjë rast, objektet e miratuara me leje ndërtimi, nuk janë pajisur me vërtetim për riskun nga organi kompetent që lëshon lejen.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në asnjë rast, objektet e miratuara me leje ndërtimi, nuk janë pajisur me vërtetim për riskun nga organi kompetent që lëshon lejen, kjo në kundërshtim me <b>VKM-në nr. 1162, datë 24.12.2020</b> , “ <i>Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi / ndërtimi</i> ”, më konkretisht: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Për objektin “<u>Leje ndërtimi për kapanon frigoriferik 1 kat</u>”;</li> <li>- Për objektin “<u>Leje ndërtimi për rikonstruksion i ish-repartit ushtarak nr. 5012, në Peqin, Godina 3, 4 dhe sistemimet përreth tyre</u>”;</li> <li>- Për objektin “<u>Leje ndërtimi për magazinim i inputeve bujqësore</u>”;</li> </ul>
<b>Kriteri:</b>	Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon: <b>VKM nr. 1162, datë 24.12.2020</b> , “ <i>Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi / ndërtimi</i> ”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mosrespektimi i përcaktimeve ligjore në lidhje me detyrimin e subjekteve zhvilluese për të përpiluar dhe dorëzuar pranë DPKZHT, nëpërmjet sistemit e-lejet, dokumentacionin e nevojshëm për pajisje me vërtetim risku, ndikon në garantimin e qëndrueshmërisë së strukturës dhe bazamentit ku do të mbështetet.
<b>Shkaku:</b>	Neglizhencë nga ana e DPKZHT Peqin
<b>Rëndësia:</b>	E lartë

<b>Rekomandime:</b>	DPKZHT të ndërpresë praktikën e miratimit të lejeve të ndërtimit, për objekte të cilat nuk janë të pajisura me vërtetim për riskun nga organi kompetent që lëshon lejen. Në çdo rast, DPKZHT të kërkojë dokumentacionin e detyrueshëm sipas legjislacionit në fuqi, deri në krijimin e hapsirës së nevojshme në sistemin elektronik të lejeve për pajisje me vërtetim për riskun.
---------------------	---

- 
- Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:
  - - **Z. L.T.**, me detyrë Kryetar i Bashkisë Peqin;
  - - **Z. E.J.**, në funksionin e drejtorit të DPKZHT;
  - - **Z. J.S.**, në funksionin e drejtorit të DPKZHT;
  - - **Z. E.H.**, në funksionin e specialistit pranë DPKZHT;
  - - **Znj. A.D.**, në funksionin e specialistes pranë DPKZHT;
  - - **Znj. Xh.S.**, në funksionin e juristes pranë DPKZHT;
  - - **Znj. B.T.**, në funksionin e specialistes pranë DPKZHT;
  - - **Z. K.S.**, në funksionin e specialistit pranë DPKZHT;
  - - **Z. A.Ç.**, në funksionin e specialistit pranë DPKZHT.
- 

- Lidhur me objektet dhe gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 429/2 prot., datë 07.07.2023, është observuar nga ana e përfaqësuesve të Bashkisë Peqin, z. E.J., z. J.S., z. E.H., znj. A.D., znj. B.T., znj. Xh.S., z. K.S., z. A.Ç., si dhe z. L.T., me detyrë Kryetar i Bashkisë Peqin, me anë të shkresës nr. 113/1 prot, datë 04.07.2023, si më poshtë vijon:
  - **Pretendimi i subjektit:**
  - Në lidhje me gjetjet e konstatuara për lejet e ndërtimit të miratauara, cituar më sipër, shprehen se: *“Në data bazën e E-lejet, ku gjenden të gjitha institucionet përkatëse nuk është shfaqur në asnjë nga aplikimet organi kompetent për vërtetimin e riskut, siç edhe citohet në VKM-në nr.1162, datë 24.12.2020, "Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi / ndërtimi", që prej datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi, subjektet të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi / ndërtimi, duhet të hartojnë relacionin përkatës për riskun, si dhe të pajisen me vërtetim të riskut nga organi kompetent që lëshon lejen.”*
  - **Opinionin e grupit të auditimit:**
  - Në lidhje me observacionin tuaj, shprehemi se organi kompetent që lëshon lejen është vet Bashkia Peqin. Vërtetimi për riskun jepet vetëm pasi aplikanti ka ngarkuar në sistemin e-lejet, dokumentacionin e kërkuar në VKM-në e sipërcituar. Bashkia Peqin dhe DPKZHT kanë të gjitha mundësitë për t'i kërkuar subjekteve zhvilluese, nëpërmjet kërkesave për plotësim dokumentacioni, përfshirjen në dokumentacionin e dorëzuar, të të gjithë zërave të parashikuar në VKM-në nr. 1162, datë 24.12.2020. Duke marrë shkasë nga ndodhitë e vitit 2019, si dhe duke vendosur në dukje qëllimin kryesor të funksionimit të DPKZHT, që është mbrojtja e territorit dhe zhvillimi i kontrolluar dhe i qëndrueshëm i tij, shprehemi se kjo strukturë dhe Bashkia Peqin nuk i kanë marrë të gjitha masat e nevojshme, për të krijuar mundësitë e garantimit të qëndrueshmërisë së objekteve në zhvillim. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

<b>Titulli i gjetjes 5:</b>	Mosrespektimi i kondicioneve urbane.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në një rast, nuk janë respektuar kondicionet urbane, më konkretisht: - Për objektin “ <u>Leje ndërtimi për kapanon frigoriferik 1 kat</u> ”; Në funksion të faktit se objekti i miratuar zhvillohet vetëm mbi pasurinë 1/95, ZK 1112, me sipërfaqe totale 4350 m <sup>2</sup> , dhe jo mbi pasuritë e tjera nën pronësinë e zhvilluesit, më konkretisht pasuria 2/15, ZK 1112, me sipërfaqe totale 2400 m <sup>2</sup> ; pasuria 2/19, ZK 1112, me sipërfaqe totale 3500 m <sup>2</sup> ; pasuria 2/28, ZK 1112, me sipërfaqe totale 1200 m <sup>2</sup> (pasuri të cilat janë shënuar në vendimin e lejes së ndërtimit si parcela mbi të cilat mbështet objekti në zhvillim, por që nuk do të duhej të merreshin në konsideratë pasi pasuritë janë fizikisht të ndara), si dhe referuar <b>Vendimit nr. 283, datë 01.04.2015</b> , “Për përcaktimet e tipave, rregullave, kriterëve.”, paragrafi I, “objektet për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore e blegtorale, përfshirë dhe ato frigoriferike”, shprehemi se objekti i miratuar nuk respekton Intensitetin maksimal të lejuar, pasi $I_{max} = 1 \text{ m}^3/\text{m}^2$ , ndërsa $I_{miratuar} = 1.22 \text{ m}^3/\text{m}^2$ ( $\text{Sip.} * H/\text{Sip}_{\text{trualli}} = 1240 \text{ m}^2 * 4.3\text{m} / 4350 \text{ m}^2 = 1.22 \text{ m}^3/\text{m}^2$ ).
<b>Kriteri:</b>	Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon: - <b>VKM nr. 283, datë 01.04.2015</b> , paragrafi I.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mosrespektimi i kondicioneve urbane të parashikuara në legjislacion dhe në rregulloret mbi të cilat DPKZHT dhe Bashkia Peqin funksionojnë, çënojnë standartet e zhvillimit të kontrolluar, çënojnë kushtet higjieno – sanitare, ato mjedisore dhe të sigurisë.
<b>Shkaku:</b>	Neglizhencë nga ana e DPKZHT Peqin
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandime:</b>	Nga DPKZHT Peqin të merren masa për të mos miratuar leje ndërtimi për objekte të cilat nuk respektojnë të gjitha kondicionet urbane, DPKZHT të verifikojë situatën e parcelave mbi të cilat mbështetet objekti në zhvillim, si dhe në çdo rast të kërkojë mendimin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) për të marrë verifikimin mbi ndërlidhjen e parcelave, kur objekti zhvillohet në më shumë se një pasuri.

- 
- Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:
  - - **Z. L.T.**, me detyrë Kryetar i Bashkisë Peqin;
  - - **Z. E.J.**, në funksionin e drejtorit të DPKZHT;
  - - **Z. E.H.**, në funksionin e specialistit pranë DPKZHT;
  - - **Znj. A.D.**, në funksionin e specialistes pranë DPKZHT;
  - - **Z. K.S.**, në funksionin e specialistit pranë DPKZHT;
  - - **Z. A.Ç.**, në funksionin e specialistit pranë DPKZHT.
- 

- Lidhur me objektet dhe gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 429/2 prot., datë 07.07.2023, është observuar nga ana e përfaqësuesve të Bashkisë Peqin, z. E.J., z. J.S., z. E.H., znj. A.D., znj. B.T., znj. Xh.S., z. K.S., z. A.Ç., si dhe z. L.T., me detyrë Kryetar i Bashkisë Peqin, me anë të shkresës nr. 113/1 prot, datë 04.07.2023, si më poshtë vijon:

- **Pretendimi i subjektit:**
- Në lidhje me gjetjet e konstatuara për lejet e ndërtimit të miratuar, cituar më sipër, shprehen se: “Objekti i miratuar respekton Intensitetin maksimal të lejuar, pasi  $I_{max}=1m^3/m^2$ , ndërsa  $I$  miratur= $0.96 m^3/m^2$  (Sip. \*  $L/Sip.trualli=1240m^2*4.3m/ 5550 m^2=0.96 m^3/m^2$ ), kjo referuar bashkimit të dy pasurive me Nr.1/95 dhe 2/28, ngarkuar në sistem nga aplikuesi.”
- **Opinionimi i grupit të auditimit:**
- Në lidhje me observacionin tuaj, shprehemi se në sistemin e-lejet nuk ka asnjë dokument që të vërtetojë se është kryer procedura e bashkimit të dy pasurive. Pasuritë nr. 1/95 dhe nr. 2/28 ndahen fizikisht nga pasuria nr. 1/40, e cila është pasuri shtet, kjo e vërtetuar edhe nga shkresa me lëndë: “Kthim përgjigje”, nr. 205 prot., datë 23.04.2021, nga ASHK, drejtuar Bashkisë Peqin, ku citohet se pasuria 1/40 është me pronar shtet. Referuar këtij fakti, shprehemi se pasuritë nr. 1/95 dhe nr. 2/28 ndahen fizikisht nga njëra-tjetra, dhe si të tilla, nuk do të duhej të konsideroheshin si një e vetme, duke zvogëluar fiktivisht Intensitetin e ndërtimit. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

<b>Titulli i gjetjes 6:</b>	Lloji i ndërhyrjes që parashikohet të kryhet nuk i përshtatet kategorisë së lejes së ndërtimit për të cilën është aplikuar.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në një rast të audituar, lloji i ndërhyrjes që parashikohet të kryhet nuk i përshtatet kategorisë së lejes së ndërtimit për të cilën është aplikuar, më konkretisht: - Për objektin “ <u>Leje ndërtimi për rikonstrukcion i ish-repartit ushtarak nr. 5012, në Peqin, Godina 3, 4 dhe sistemimet përreth tyre</u> ”; Nga këqyrja e procedurës së aplikimit për pajisje me leje ndërtimi, konstatohet se objekti i cili do të rikonstruktohet, është i degraduar, nuk ka qenë në funksion më përpara, për këtë arsye shprehemi se mbi objektin nuk mund të ushtrohet rikonstrukcion pa ndryshim funksioni, por kategoria e duhur për këtë rast do të ishte: “ <u>Leje ndërtimi për rikonstrukcion me ndryshim funksioni</u> ”, kategori për të cilën kërkohet dokumentacion i ndryshëm nga ai për të cilin është aplikuar.
<b>Kriteri:</b>	Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon: - <b>VKM nr. 408, datë 13.5.2015</b> , Neni 12.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Miratimi i lejeve të ndërtimit për të gjitha ato raste kur lloji i ndërhyrjes që parashikohet të kryhet nuk i përshtatet kategorisë së lejes së ndërtimit për të cilën është aplikuar, ndikon në listën e plotë të dokumentacionit që duhet dorëzuar, si rjedhojë në standartet e zhvillimit të kontrolluar, çënojnë kushtet higjieno – sanitare, ato mjedisore dhe të sigurisë.
<b>Shkaku:</b>	Neglizhencë nga ana e DPKZHT Peqin
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandime:</b>	Bashkia Peqin dhe DPKZHT të marrë masa të miratojë vetëm ato aplikime, për të cilat lloji i ndërhyrjes i përshtatet kategorisë së lejes së ndërtimit për të cilën është aplikuar.

- Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:
- **Z. L.T.**, me detyrë Kryetar i Bashkisë Peqin;

- - **Z. E.J.**, në funksionin e drejtorit të DPKZHT;
- - **Z. E.H.**, në funksionin e specialistit pranë DPKZHT;
- - **Znj. A.D.**, në funksionin e specialistes pranë DPKZHT;
- - **Znj. Xh.S.**, në funksionin e juristes pranë DPKZHT.

- Lidhur me objektet dhe gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 429/2 prot., datë 07.07.2023, është observuar nga ana e përfaqësuesve të Bashkisë Peqin, z. E.J., z. J.S., z. E.H., znj. A.D., znj. B.T., znj. Xh.S., z. K.S., z. A.Ç., si dhe z. L.T., me detyrë Kryetar i Bashkisë Peqin, me anë të shkresës nr. 113/1 prot, datë 04.07.2023, si më poshtë vijon:

- **Pretendimi i subjektit:**

- Në lidhje me gjetjet e konstatuara për lejet e ndërtimit të miratauara, cituar më sipër, shprehen se: *“Gjatë miratimit të lejes së ndërtimit është marrë parasysh kërkesa e aplikuesit pa ndryshim funksioni të objektit dhe miratimi është bërë bazuar në këtë kërkesë, pa verifikuar në detaje gjendjen faktike të objekteve në fjalë.”*

- **Opinion i grupit të auditimit:**

- Në lidhje me observacionin tuaj, shprehemi se leja e ndërtimit për rikonstrukcion pa ndryshim funksioni është e ndryshme nga ajo me ndryshim funksioni, po ashtu, edhe dokumentacioni i detyrueshëm është i ndryshëm. Përsa më sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

<b>Titulli i gjetjes 7:</b>	Dokumentacioni i nevojshëm për pajisje me çertifikatë përdorimi nuk është i plotë.
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi i procedurave të miratimit të çertifikatave të përdorimit u konstatua se në dy raste, dokumentacioni i nevojshëm për pajisje me çertifikatë përdorimi nuk është i plotë, më konkretisht:</p> <p>a). Për objektin “Podrum dhe banesë 2 kate”, mungon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kërkesa për çertifikatë përdorimi, sipas formatit të aplikimit të përcaktuar (<i>bashkëlidhur observacionit</i>);</li> <li>- Mungon polica e sigurimit të përgjegjësisë së ndërtuesit për dëmtime të objektit të përfunduar (<i>bashkëlidhur observacionit, por e pafirmosur elektronikisht</i>);</li> <li>- Aktet përkatëse nga , OSHEE, PMNZSH, menaxhimi i mbetjeve urbane;</li> <li>- Preventivi i punimeve (<i>bashkëlidhur observacionit</i>);</li> <li>- Planvendosja e objektit të miratuar (<i>bashkëlidhur observacionit</i>);</li> <li>- Kontrata midis zhvilluesit dhe shoqërisë ndërtuese (<i>bashkëlidhur observacionit, por e pafirmosur elektronikisht</i>);</li> <li>- Projekti për mirëmbajtjen e objektit;</li> <li>- Çertifikata përfundimtare e auditimit të efikasitetit energjétique.</li> </ul> <p>b). Për objektin “Punishte Vaji 1 kat”, mungon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Aktet e kontrollit sipas fazave të ndërtimit, nuk janë ngarkuar të plota;</li> <li>- Deklarata e përputhshmërisë nga subjekti zhvillues (<i>bashkëlidhur observacionit, por e pafirmosur elektronikisht</i>);</li> <li>- Relacioni i supervizorit (mbikqyrësi i punimeve) i licencuar;</li> <li>- Aktet përkatëse nga UK-P, menaxhimi i mbetjeve urbane;</li> <li>- Licencat e shoqërisë ndërtuese (<i>bashkëlidhur observacionit, por e pafirmosur elektronikisht</i>);</li> <li>- Kontrata midis zhvilluesit dhe mbikëqyrësit të punimeve;</li> </ul>



	- Projekti për mirëmbajtjen e objektit; - Çertifikata përfundimtare e auditimit të efikasitetit energjétique.
<b>Kriteri:</b>	Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon: - <b>VKM nr. 408, datë 01.04.2015</b> , 13.05.2015, i ndryshuar, Neni 27/1, pika 1. - <b>VKM nr. 408, datë 01.04.2015</b> , 13.05.2015, i ndryshuar, Neni 27/2, pika 1, nënpika ç), d), i), ë), k), gj). - <b>Ligji nr.124/2015 “Për efikasitetin e energjisë”</b> , pika 5, nënpika b).
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mangësitë në dokumentacionin e nevojshëm për pajisje me çertifikatë përdorimi, ndikojnë në mosdhënien e sigurisë së plotë se objekti është ndërtuar sipas kriterëve ligjore, duke cenuar standartet e zhvillimit të kontrolluar, ato të mjedisit, sigurisë dhe higjieno-sanitare.
<b>Shkaku:</b>	Neglizhencë nga ana e DPKZHT Peqin
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandime:</b>	Bashkia Peqin dhe DPKZHT të marrë masa të mos miratojë asnjë çertifikatë përdorimi deri në plotësimin e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm. Gjithashtu, Bashkia Peqin duhet të marrë të gjitha masat që i gjithë dokumentacioni i detyrueshëm për pajisje me leje ndërtimi ose çertifikatë përdorimi, duhet të kalojë nëpërmjet sistemit e-lejet dhe jo dorazi.

- Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:
  1. **Z. L.T.**, me detyrë Kryetar i Bashkisë Peqin;
  2. **Z. E.J.**, në funksionin e drejtorit të DPKZHT;
  3. **Z. J.S.**, në funksionin e drejtorit të DPKZHT;
  4. **Z. E.H.**, në funksionin e specialistit pranë DPKZHT;
  5. **Znj. A.D.**, në funksionin e specialistes pranë DPKZHT;
  6. **Znj. Xh.S.**, në funksionin e juristes pranë DPKZHT;
  7. **Znj. B.T.**, në funksionin e specialistes pranë DPKZHT;

- |  |
|--|
| <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lidhur me objektet dhe gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 429/2 prot., datë 07.07.2023, është observuar nga ana e përfaqësuesve të Bashkisë Peqin, z. E.J., z. J.S., z. E.H., znj. A.D., znj. B.T., znj. Xh.S., z. K.S., z. A.Ç., si dhe z. L.T., me detyrë Kryetar i Bashkisë Peqin, me anë të shkresës nr. 113/1 prot., datë 04.07.2023, si më poshtë vijon: <ul style="list-style-type: none"> <li>- <b><u>1.1 Pretendimi i subjektit:</u></b></li> <li>- Në lidhje me gjetjet e konstatuara për lejet e ndërtimit të miratuar, cituar më sipër, shprehen se: <i>“Dokumentat e sipërcituar gjenden bashkëngjitur këtij materiali ,të cilit janë kërkuar në një fazë të mëtejshme të shqyrtimit të dokumentacionit pasi është vënë re mungesa e tyre dhe ndodhen në folderin ‘Të tjera’”.</i></li> <li>- <b><u>1.2 Opinioni i grupit të auditimit:</u></b></li> <li>- Në lidhje me observacionin tuaj, shprehem se një pjesë e materialit është marrë në konsideratë. Një pjesë tjetër merret pjesërisht në konsideratë, pasi nuk janë të firmosura elektronikisht. Gjithsesi, në çdo rast, i gjithë dokumentacioni për aplikim për pajisje me leje ndërtimi ose çertifikatë përdorimi duhet të jetë i vulosur elektronikisht, si dhe duhet të</li> </ul> </li> </ul> |
|--|

kalorë nëpërmjet sistemit e-lejet dhe jo dorazi. Përsa më sipër, ky pretendim merret pjesërisht në konsideratë.

## 2.6 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Territorit të Njësisë Vendore.

Në zbatim të pikës 6 të Programit të Auditimit me nr. 429/1 prot., datë 19.05.2023, me objekt: **“Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV), prej datës 01.01.2021 deri më 31.12.2022**, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Auditim mbi plotësimi i kriterëve arsimore për punonjësit e IMTV, sipas përcaktimeve të Nenin 11 të **Ligjit nr. 183/2014 datë 24.12.2014**, *“Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit në ndërtimet e kundërligjshme”* etj.
- Auditimi mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi.
- Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV, për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV.
- Auditimi mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatimin në terren të kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të Bashkisë etj, sipas dispozitave ligjore në fuqi (Neni 81- *Inspektimi*, pika 3, të **Ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009**, *“Për planifikimin e territorit”*, i ndryshuar, etj.).

**Titulli i gjetjes 1:** Mosplotësimi i kriterëve arsimore i punonjësve të IMTV-së.

**Situata:** Në bazë të të dhënave të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Peqin, punonjësit e tanishëm nuk plotësojnë kriteret e arsimit, sipas përcaktimeve të Nenit 11 të **Ligjit nr.9780 datë 16.07.2007**. Asnjë prej profileve të arsimit të punonjësve aktual ose atyre që janë larguar nga detyra nuk klasifikohet në profilet e parashikuara në ligj, pra mungojnë punonjës me profil arsimimi teknik si ing. ndërtimi, arkitekturë, urbanistik, teknologjisë së materialeve, etj., si pasqyrohet edhe në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni	Lloji i Diplomimit	Data e fillimit	Data e largimit
1	D.T.	K/Inspektor	Edukatë qytetare	11.09.2019	01.02.2022
2	D.M.	K/Inspektor	Edukim fizik dhe sporte	01.02.2022	08.11.2022
3	K.S.	K/Inspektor	Ekonomik	01.02.2022	Në vazhdim
4	L. K.	Inspektor	Punonjës social	16.03.2017	Në vazhdim
5	I. B.	Inspektor	I mesëm	01.12.2007	Në vazhdim
6	H.T.	Inspektor	I mesëm	21.01.2020	29.04.2022
7	S. M.	Inspektor	Ekonomik	20.09.2019	Në vazhdim
8	T. B.	Inspektor	Histori-Gjeografi	01.09.2022	Në vazhdim
9	Z. S.	Inspektor	I mesëm	11.01.2022	Në vazhdim

Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

**Kriteri:** Ligji nr. 9780, datë 16.7.2007, i ndryshuar, Neni 11, *“Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit”*, ku përcaktohet se:

*“Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjeje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit”.*

**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e formimit profesional të nevojshëm për pozicionin e punës, ndikon në zbatimin e detyrës si inspektor në Inspektoratin Vendor të Mbrojtjes së Territorit.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e Bashkisë Peqin.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** Kryetari i Bashkisë Peqin dhe Njësia e Burimeve Njerzore, të marrin masa që struktura e IMTV-së të përbëhet nga punonjës të cilët të jenë me arsim të lartë në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit, sipas parashikimeve ligjore.

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***

1. **Z. L.T.**, me detyrë Kryetari i Bashkisë Peqin.

**Titulli i gjetjes 2:** IMTV nuk ka ndjekur të gjitha procedurat dhe nuk ka marrë të gjitha masat për ndëshkimin e kundërvajtësve, sipas parashikimeve ligjore.

**Situata:** IMTV Bashkia Peqin nuk ka respektuar procedurat e parashikuara në ligj në lidhje me mbajtjen e akteve përkatëse, në rastet e konstatimit të shkeljeve. IMTV nuk ka mbajtur në asnjë rast proces verbalin e pezullimit të punimeve, kjo në kundërshtim me Nenin 5 të **Ligjit nr.9780 datë 16.07.2007**, pika ç), si dhe me Nenin 13, të po këtij ligji. IMTV i ka mohuar subjekteve të interesuara të drejtën për t'u pajisur me dokumentacion e nevojshëm për ndërtimet e kryera, brenda afatit 60 ditor që ligji parashikon. Gjithashtu IMTV nuk ka ndërmarrë të gjitha masat për prishjen e objekteve pa leje. Edhe pse në mungesë të makinerive për prishjen e këtyre objekteve, IMTV ka detyrimin të kërkojë asistencë nga IKMT për kthimin në gjendjen fillestare të këtyre shkeljeve. IMTV nuk ka kallëzuar penalisht në asnjë rast kundërvajtësit, duku mos përdorur të gjitha masat ndëshkuese dhe shtrënguese për të parandaluar shkelje të tilla. IMTV nuk ka kërkuar në asnjë rast heqje e licencës profesionale për zhvilluesin, subjektin ndërtues, mbikëqyrësin e punimeve ose kolaudatorin. Gjithashtu në asnjë rast nuk është faktuar se vlera e masës administrative është e barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, si parashikohet në **Ligjin 107/2014**, i ndryshuar, Neni 52, pika 1, nënpika e) dhe ë), si dhe pika 2 e po këtij neni, kjo me qëllim maksimizimin e të ardhurave nga vjelja e gjobave.

Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

**Kriteri:** Ligji nr. 9780, datë 16.7.2007, i ndryshuar, Neni 5, pika c), ç), d), dh), ; Nenin 13; Ligji 107/2014, i ndryshuar, Neni 52, pika 1, nënpika e).

**Ndikimi/Efekti:** Mos mbajtja e të gjitha procedurave për ndëshkimin dhe parandalimin e kundërvajtjeve, sipas parashikimeve ligjore, cënon zhvillimin e kontrolluar, ndikon në kushtet e sigurisë, ato higjieno – sanitare dhe të mjedisit, si dhe ndikon ndëshkimin jo të drejtë, në raport me shkeljet e konstatuara.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e Bashkisë Peqin.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** Nga ana e IMTV Bashkia Peqin të merren masa që për çdo rast, të respektohen procedurat sipas parashikimeve ligjore, në varësi të shkeljes së konstatuar, të aplikohen të gjitha masat ndëshkuese ndaj kundërvajtësve, si dhe të kërkohet e gjithë asistenca e nevojshme për ekzekutimin e vendimeve të prishjes.

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***

1. **z. D.T.** / ish - Kryeinspektor

2. **z. D.M.** / ish – Kryeinspektor

3. **z. K.S.** / ish – Kryeinspektor

**Titulli i gjetjes 3:** IMTV nuk ka marrë të gjitha masat për vjeljen e gjobave, si dhe përlllogaritjen e kamat-vonesave, sipas parashikimeve ligjore.

**Situata:** Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me ekzekutimin, kontabilizimin dhe vjeljen e gjobave, konstatohet se nga struktura e Inspektoratit të Mbrojtjes së Teritorit, për periudhën objekt auditimi, janë vendosur 23 gjoba me vlerë 11,500,000 lekë, të cilat nuk janë arkëtuar. Për 14 vendime për gjobë në vlerën 7,000,000 lekë, IMTV i është drejtuar Gjykatës Administrative, duke i kërkuar nxjerrjen e titullit ekzekutiv, nuk është vendosur në dispozicion asnjë dokumentacion që të vërtetojë nxjerrjen e këtij titulli, duke pretenduar se IMTV dhe Bashkia Peqin nuk janë informuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Peqin, mbi vendimet e marra për këto raste, nëse për këto vendime gjykata e ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit. Bashkia Peqin, IMTV, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Financës nuk kanë përdorur mënyrat e parashikuara në Ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010, “*Për kundërvajtjet administrative*”, Neni 31, pika 5, për arkëtimin e këtyre masave administrative, siç janë vjelja e gjobës nëpërmjet pagës ose vendosje sekuestro mbi pasuri deri në pagimin e gjobës. Në asnjë rast nuk është faktuar se vlera e masës administrative është e barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, si parashikohet në Ligjin 107/2014, “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, i ndryshuar, Neni 52, “*Kundërvajtjet administrative*”, pika 1, nënpika e) dhe ë), si dhe pika 2 e po këtij neni, kjo me qëllim maksimizimin e të ardhurave nga vjelja e gjobave. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

**Kriteri:** Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010, Neni 30, pika 4; Neni 31, pika 5.

**Ndikimi/Efekti:** Mangësitë në ndërmarrjet e hapave që ligji parashikon për vjeljen e gjobave të pa-arkëtuara, ndikojnë negativisht në buxhetin e Bashkisë Peqin, gjithashtu zvogëlohet efekti ndëshkues ndaj shkelësve të ligjit.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e Bashkisë Peqin.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** Nga Bashkia Peqin, Drejtoria e Financës, Drejtoria Juridike, në bashkëpunim me IMTV, të marrin masa për kryerjen e të gjitha procedurave që ligji parashikon, siç janë vjelja e gjobës nëpërmjet pagës ose vendosje sekuestro mbi pasurinë e të dënuarit, për të bërë të mundur arkëtimin vlerave financiare në gjobat e aplikuara, si dhe përlllogaritjen e kamat-vonesave, sipas afateve dhe kriterëve ligjore.

**Rekomandim:** Nga ana e IMTV Bashkia Peqin, të merren masa për ndëshkimin e kundërvajtësve, në raport të drejtë me llojin e shkeljes së konstatuar, duke përdorur mënyrat e parashikuara në ligj për përlllogaritjen e vlerës së masës administrative në varësi të investimit të kryer pa leje të miratuar ose në shkelje të saj.

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***

**1. z. D.T.** / ish - Kryeinspektor

**2. z. D.M.** / ish – Kryeinspektor

**3. z. K.S.** / ish – Kryeinspektor

**Titulli i gjetjes 4:** Mungesa në planet mujore të punës, si dhe në raportimin periodik në IKMT.

**Situata:** Nga auditimi i dokumentave të paraqitura nga IMTV Peqin për periudhën objekt auditimi, u konstatua se kjo strukturë ka hartuar plane mujore të punës vetëm për periudhën nëntor-dhjetor 2022, ndërsa për periudhën tjetër janar-dhjetor 2021 dhe janar-tetor 2022, nuk janë hartuar plane pune mujor, kjo në kundërshtim me VKM-në nr. 894, datë 04.11.2015 “*Për unifikimin e*

*procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”, pika 1/b/ii. Gjithashtu u konstatua se Kryeinspektori i IMTV nuk ka përgatitur informacion periodik dhe nuk ka raportuar pranë Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit. Këto raportime duhet të jenë çdo tre muaj, mbi aktivitetin e IMTV, kryesisht mbi gjobat e vendosura sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, mbi vendimet për pezullimin e punimeve, mbi vendimet për prishjen e ndërtimeve të kundër-ligjshëm, etj. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9780, datë 06.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundraligjshme”, i ndryshuar, Neni 5, pika f. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:*

**Kriteri:** VKM nr. 894, datë 04.11.2015, pika 1/b/ii; Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007, i ndryshuar, Neni 5, pika f.

**Ndikimi/Efekti:** Miratimi i planeve mujore nga kryeinspektori në mënyrë jo-periodike cenon efektivitetin e kontrollit të territorit nga ndërhyrjet abuzive. Gjithashtu, mungesa e raportimit pranë IKMT në mënyrë periodike çdo tre muaj cenon bashkërendimin ndërinstitucional, nuk respekton detyrimin e raportimit të institucioneve të linjës, si dhe efektivitetin e kontrollit të territorit nga këto struktura.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e Bashkisë Peqin.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** Nga Bashkia Peqin dhe IMTV të merren masa për të inspektuar territorin dhe garantuar zhvillimin e kontrolluar të tij, duke organizuar punën inspektuese mbi planet mujore të punës të miratuara nga kryeinspektori. Gjithashtu, të merren masa për kryerjen e raportimit çdo tre muaj mbi aktivitetin e IMTV, pranë IKMT, me qëllim rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe efektivitetit.

Lidhur me gjetjet e mësipërme, nuk është observuar nga ana e IMTV dhe Bashkisë Peqin.

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***

**1. z. D.T. / ish - Kryeinspektor**

**2. z. D.M. / ish – Kryeinspektor**

## **2.7 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.**

Në zbatim të programit të auditimit nr. 429/1 Prot, datë 19.05.2023, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, me objekt auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë në Bashkinë Peqin, referuar drejtimit të auditimit nr. 7, mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

*1. Dokumentacioni i vënë në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve, planet e veprimit, shkresën brenda 20 ditëve për planin e masave mbi zbatimin e rekomandimeve;*

*2. Urdhërin për njohjen dhe zbatimin me planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve;*

*3. Dokumentacion mbështetës për realizimin e rekomandimeve;*

*4. Pyetësori i dërguar ndaj subjektit Bashkia Peqin mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve;*

*Për sa më sipër konstatohet se:*

### **2.7.1 Hartimi i programit (Plan veprimet) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.**

Me shkresën e KLSH nr. 690/7prot., datë 25.10.2022 është dërguar Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin e Përputhshmërisë të ushtruar në Bashkinë Peqin, sipas Programit të Auditimit me nr. 690/1 prot. datë 13.07.2022.

Nga Bashkia Peqin në lidhje me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nuk ka patur kundërshtime për rekomandimet e dërguar nga KLSH, si dhe janë përcaktuar strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve dhe afatet përkatëse, **pra janë pranuar të gjitha rekomandimet me përjashtim të një rasti për masë administrative i cili nuk është pranuar nga Bashkia Peqin.** Bashkia Peqin ka përgatitur programin e masave që do të merren dhe realizohen për zbatimin e rekomandimeve ku janë përcaktuar afatet, personat apo drejtoritë përgjegjëse si dhe janë nxjerrë shkresat përkatëse për zbatim. Ky program masash është dërguar në KLSH me shkresën nr. 1104/17 prot, datë 07.10.2022.

### **2.7.2 Realizimi i programit (Plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor.**

Nga Bashkia Peqin, në zbatim të afatit ligjor të përcaktuar në pikën nr. 2, neni 30, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, e cila citon: “*Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna*” rezulton se nga, **nuk është dërguar raporti mbi realizimin e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor për zbatimin e rekomandimeve veprim jo në përputhje me përcaktimet e ligjit funksional për KLSH-në,** veprim jo në përputhje me përcaktimet e ligjit funksional për KLSH-në.

**Titulli i gjetjes:** *Mos raportim brenda 6-muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit dhe mos raportim në KB mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së.*

**Situata:** Nga auditimi konstatohet se, Bashkia Peqin ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën me shkresën nr. 1683/1, datë 15.11.2022, por nuk ka dërguar raport brenda 6-muajve për realizimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna. Gjithashtu rezulton se Bashkia Peqin nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak mbi rezultat e zbatimit të këtyre rekomandimeve, veprime këto jo në përputhje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5, “*Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit., kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij*”. Veprime për të cilin mban përgjegjësi titullari i Bashkisë z. L.T. dhe zj. Xh.D.

**Kriteri:** Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5.

**Ndikimi:** Mos zbatim i rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e fundit sjell që disa aktivitete në Bashkinë Peqin të kryhen në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe të kenë ndikime financiare në vijimësi.

**Shkaku:** Mos angazhim sa duhet i strukturave të Bashkisë Peqin me qëllim zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandim:** Bashkia Peqin të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi. Gjithashtu të raportohet në auditimet në vijim brenda afatit të përcaktuar për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

### **2.7.3 Statusi i rekomandimeve të lëna në Auditimin e mëparshëm.**

Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 15 masa organizative, 5 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me

ekonomicitet, efience dhe efektivitet të fondeve publike-të ardhura të munguara. Gjithashtu i është rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Peqin t'i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, masa Disiplinore për punonjësit e atakuar në material.

Nga auditimi rezulton se: nga 15 masa organizative janë pranuar 15 masa nga të cilat është realizuar 1 masa, janë zbatuar pjesërisht 3 masa dhe nuk janë zbatuar 11 masa.

Nga 5 për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia - të ardhura të munguara, janë pranuar për zbatim 5 masa, nuk janë zbatuar të 5 masat.

Në lidhje me masat disiplinore në kompetencë të Bashkisë Peqin, për punonjësit e saj konstatohet se nga ana e Bashkia Peqin nuk janë marrë masat e duhura për dhënien e masave disiplinore për punonjësit e konstatuar me shkelje dhe me përgjegjësi në Raportin e auditimit të mëparshëm.

**Titulli i gjetjes:** Bashkia Peqin nuk ka marrë masat e duhura për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

**Situata:** Për zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, nga titullari i Bashkisë Peqin është ngritur grupi i punës dhe është hartuar plani i veprimit me nr. 1683/2prot, dhe datë 15.11.2022, me përbërje z. L.T. me detyrë Kryetar i Bashkisë, z. M.S. me detyrë zv.kryetar i Bashkisë, zj. G.N. Drejtore e Drejtorisë Juridike, z. A.D. Përgjegjës i Sektorit të Auditit të Brendshëm, z. E. LL. dhe z. Denis Manehasa Drejtor i Drejtorisë së Financës, z. J.S. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit të Territori, z. K.L. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave, z. B.K., Përgjegjës i të Ardhurave, zj. Xh.D. N/Kryetare, të cili ka hartuar Programin e Punës për zbatimin e rekomandimeve të KLSH. Koordinatorin e veprimeve të këtij planveprimi është caktuar zj. Xh.D. me detyrë zv.kryetar i Bashkisë, për ndjekjen dhe raportimin nga personat përgjegjës të caktuar në planin e vepimit.

Në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit”, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 690/7prot., datë 25.10.2022 i ka dërguar Bashkinë Peqin Raportin Përfundimtar të Auditimit në të cilin, për përmirësimin e gjendjes, është kërkuar zbatimin i rekomandimeve në rubrikat Masa organizative, Masa për për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia - të ardhura të munguara si dhe Masat Disiplinore të detajuara në plan veprimin e hartuar për këtë qëllim, për të cilat rezulton si më poshtë:

-Nga 15 masa organizative janë pranuar 15 masa nga të cilat është realizuar 1 masa, janë zbatuar pjesërisht 3 masa dhe nuk janë zbatuar 11 masa.

-Nga 5 për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia - të ardhura të munguara, janë pranuar për zbatim 5 masa, nuk janë zbatuar të 5 masat.

-Në lidhje me masat disiplinore në kompetencë të Bashkisë Peqin, për punonjësit e saj konstatohet se nga ana e Bashkia Peqin nuk janë marrë masat e duhura për dhënien e masave disiplinore për punonjësit e konstatuar me shkelje dhe me përgjegjësi në Raportin e auditimit të mëparshëm.

*Veprime e mosveprime për të cilat mban përgjegjësi z. L.T. me detyrë Kryetar i Bashkisë, z. M.S. me detyrë zv.kryetar i Bashkisë, zj. G.N. Drejtore e Drejtorisë Juridike, z. A.D. Përgjegjës i Sektorit të Auditit të Brendshëm, z. E. LL. dhe z. D. M. Drejtor i Drejtorisë së Financës, z. J.S. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit të Territori, z. K.L. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave, z. B.K., Përgjegjës i të Ardhurave, zj. Xh.D. N/Kryetare dhe zj. Xh.D. me detyrë zv.kryetar i Bashkisë.*

**Kriteri:** Ligji Nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, germa j), ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin” me ndryshime.

**Shkaku:** Mos ndjekja e gjitha procedurave për zbatimin e rekomandimeve për 11 masat organizative, për arkëtimin e të ardhurave të munguara të vlerës 42,332,552 lekë si dhe masat disiplinore për punonjësit të konstatuar me shkelje nga auditimi i mëparshëm.

**Ndikimi/Efekti:** Ndikon në përmirësimin e proceseve të veprimtarisë së Bashkisë Peqin, mosmbledhjen e të ardhurave, si rezultat i së cilës punonjësit kanë dhe 6 muaj pa marrë pagat e tyre.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Peqin të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Rikërkojmë zbatimin e rekomandimeve që janë të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht dhe përsheptimin e zbatimit të atyre në proces zbatimi si vijon:

*Në mënyrë të detajuar po i paraqesim më poshtë:*

### **MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, në Bashkinë Peqin për periudhën objekt auditimi, përsa i takon komponentit të veprimtarisë së kontrollit vihet re mungesa e dokumentacionit shkresor që pasqyron minutat e takimit dhe marrjen e vendimeve për mbledhjet që realizon GMS dhe si rrjedhojë e kësaj nuk është hartuar plani i veprimit për arritjen e objektivave dhe plani për kontrollin e brendshëm. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 14-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1 Rekomandim:** Bashkia Peqin, me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së, të marrë masat në mënyrë që:

- Temat më problematike që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, të diskutohen gjatë takimeve periodike ndërmjet menaxherëve të niveleve të ndryshme në njësinë e sektorit publik dhe të dokumentohen takimet e realizuara nga GMS dhe vendimet e marra për diskutimet përkatëse.
- Të hartohet në mënyrë periodike plani i veprimit për kontrollin e brendshëm, i cili ndihmon në organizimin e aktiviteteve të kontrollit me qëllim menaxhimin e risqeve kryesore dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme se objektivat dhe qëllimet do të arrihen.
- Të hartohet në mënyrë periodike plani i veprimit për arritjen e objektivave, duke bërë të mundur realizimin dhe përmbushjen e objektivave duke siguruar minimizimin e risqeve.

***Deri më datë 31.12.2022***

**Nga verifikimi rezultoi se:** Bashkia Peqin nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi. **Ky rekomandim është pa zbatuar.**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi procedurën e ngritjes dhe funksionimit të NJAB u konstatua se një specialist nuk ka certifikatë të audituesit të brendshëm dhe nuk ka ndjekur trajnime të vijueshme profesionale. Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015, për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik, Neni 11, pika 2 ç). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 14-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*



**2.1 Rekomandim:** Bashkia Peqin duhet të marrë masa në mënyrë që Njësia e Auditit të Brendshëm, të funksionojë me punonjës të certifikuar dhe kualifikuar, kërkesë e cila bazohet në kriteret për krijimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Nga verifikimi rezultoi se:** Bashkia Peqin nga 3 punonjës të Auditit të Brendshëm, ka të certifikatë Përgjegjësi i Sektorit dhe dy specialistët janë në proces trajnimi, të pa pajisur me certifikatë. **Ky rekomandim është zbatuar pjesërisht.**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi procesin e hartimit të PBA-së për periudhën 2021-2023, rezulton se nga strukturat e Bashkisë Peqin nuk janë ndjekur të gjithë hapat ligjore, përkatësisht:

- Këshilli Bashkiak ka miratuar draftin e parë të programit buxhetor afatmesëm, dhe nuk ka dhënë opinionin e tij në lidhje me rekomandimet e Ministrisë së Financave;
- Nga Kryetari i Bashkisë Peqin nuk janë marrë masat e nevojshme për publikimin e dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm të miratuar, brenda datës 5 korrik;
- Kryetari i Bashkisë Peqin nuk ka miratuar udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit të bashkisë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 33, 34, 35, 36, 37, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/015, datë 15.10.2015, neni 12, si dhe udhëzimet e MFE nr. 23, datë 22.11.2016, nr. 22, datë 30.07.2018, nr. 7, datë 27.02.2019 dhe nr. 27 datë 10.07.2020; për të hartuar PBA-në 2021-2023. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 24-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1 Rekomandim:** Bashkia Peqin, Drejtoria e Financës të marrë masa që pas miratimit të programit buxhetor afatmesëm të japë opinion për rekomandimet e lëna nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë si dhe PBA-ja të publikohet brenda afatit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Nga verifikimi rezultoi se:** Bashkia për vitin 2022, ka publikuar dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm të miratuar, brenda datës 5 korrik, por nuk ka miratuar udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit të bashkisë dhe Titullari nuk ka dhënë opinionin e tij në lidhje me rekomandimet e Ministrisë së Financave. **Ky rekomandim është zbatuar pjesërisht.**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të vitit 2021 rezulton se:

- Ndryshimet e bëra në buxhet nuk janë shoqëruar me relacion shpjegues lidhur me arsyet e ndryshimit;
- Nuk ka një analizë se si ndikojnë këto ndryshime në realizimin e objektivave të synuar të bashkisë;
- Nuk janë respektuar afatet ligjore për rishikimin e buxhetit vendor;
- Kryetari i Bashkisë Peqin për vitin 2021 nuk ka paraqitur brenda datës 31 mars të vitit pasardhës raport me shkrim pranë Këshillit Bashkiak për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 47, ligjin 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 44, Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore" shtojca 4, pika c. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 24-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1 Rekomandim:** Bashkia Peqin të ndjekë hapat dhe të marrë masa për hartimin e një buxheti real, objektiv në realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, për të mos krijuar diferenca midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, të dokumentojë procesin e konsultimeve me komunitetin dhe grupet e interesit si dhe mbledhjet e strukturës dhe të institucioneve të varësi duke parashtruar dhe kërkesat e tyre buxhetore.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Nga verifikimi rezultoi se:** Bashkia për vitin 2022, ka shoqëruar me relacion shpjegues lidhur me arsyet e ndryshimit, por nuk ka analizuar se si ndikojnë këto ndryshime në realizimin e objektivave të synuar të bashkisë dhe nuk ka paraqitur brenda datës 31 mars të vitit pasardhës raport me shkrim pranë Këshillit Bashkiak për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë. **Ky rekomandim është zbatuar pjesërisht.**

**5. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Peqin për vitin 2021 ka hartuar dhe dërguar në MFE vetëm Raportin vjetor të monitorimit të zbatimit të buxhetit, ndërsa 3 raportet periodike të monitorimit nuk janë hartuar. Kryetari i Bashkisë Peqin në asnjë rast nuk i ka paraqitur në këshill raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit, sipas përcaktimeve ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48. Kryetari i Bashkisë Peqin nuk ka miratuar rregullat specifike dhe procedurale që duhet të ndiqen në procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit. Raportet e monitorimit nuk janë hartuar në përputhje me kërkesat e Shtojcës 2 “Përmbajtja e raportit të monitorimit” dhe Shtojcës 5 “Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë”, të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisë të vetëqeverisjes vendore”. Raportet e monitorimit nuk janë të plota pasi nuk janë plotësuar të gjitha anekset sipas kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48, Shtojca 2 “Përmbajtja e raportit të monitorimit” dhe Shtojca 5 “Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë”, të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, Ligji nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 48 dhe Udhëzimin nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisë të vetëqeverisjes vendore”, pika 10, 12, 28, 29, 48. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 24-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1 Rekomandim:** Nga ana e Bashkisë Peqin të merren masa për hartimin e raporteve të monitorimit të zbatimit të buxhetit duke plotësuar të gjitha anekset me të dhënat përkatëse si dhe të dërgojë në institucionet përkatëse këto raporte sipas afateve të përcaktuara. Gjithashtu, të miratojë rregulla specifike dhe procedurale që duhet të ndiqen në procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Nga verifikimi rezultoi se:** Bashkia Peqin nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi. **Ky rekomandim është pa zbatuar.**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura nga dokumentet analitike të Bashkisë Peqin rezulton se, vlera e detyrimeve të prapambetura deri në fund të vitit 2021 paraqitet 120,357,119 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014, pika 4. Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 34, pika

1, neni 40, pika 3, Udhëzimi i MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 101.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 24-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1 Rekomandim:** Bashkia Peqin të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve të reja, të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe të raportojë periodikisht në MFE.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Nga verifikimi rezultoi se:** Bashkia Peqin nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi, detyrimet e prapambetura për vitin 2022 rezultojnë në vlerën 137,497,700 lekë.

**Ky rekomandim është pa zbatuar.**

**7. Gjetje nga auditimi:** Vlera e detyrimeve të prapambetura për vendimet gjyqësore referuar dokumenteve analitike të bashkisë rezulton 13,738,224 lekë. Për vitin 2021 janë paguar detyrime në vlerën 2,976,320 lekë dhe rezultojnë ende për t’u paguar vendimet gjyqësore në vlerën 10,761,904 lekë. Bashkia Peqin në likuidimin e detyrimeve nuk respekton radhën e paraqitjes së tyre në njësinë shpenzuese. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 “Përfinancat e qeverisjes vendore” neni 40, pika 3 dhe Udhëzimin e MFE nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”, pika 5 dhe pika 8. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 24-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**7.1 Rekomandim:** Drejtoria e Financës dhe Sektori i Buxhetit të hartojnë grafikun e shlyerjes së vendimeve gjyqësore dhe të zbatojnë me rigorozitet radhën e regjistrimit të vendimeve në bashki kur të kryejnë likuidimet.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Nga verifikimi rezultoi se:** Bashkia Peqin nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi. **Ky rekomandim është pa zbatuar.**

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhura sipas zërave rezultoi se ekzistojnë disa zëra për të cilat Drejtoria e të Ardhurave Lejeve dhe Licencave nuk ka bërë planifikim për vitin 2021. Përkatësisht, zërat Taksë vendore e përkohshme, Tarifë e regjistrimit të veprimtarive të ndryshme, Tarifë për leje zhvillimi, Taksë vendore për mirëmbajtje, Të ardhura nga qira e tokës bujqësore, Të ardhura nga qira troje, Tarifë licence radiotelevizive, nuk janë llogaritur në planifikim. Këto veprime janë në kundërshtim me VKB-në nr. 131 datë 16.12.2020 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë e Peqinit”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 24-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.1 Rekomandim:** Drejtoria e të Ardhurave Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Peqin të marrë masa që, në planin vjetor të të ardhurave të bashkisë të parashikojë të ardhurat që do të sigurohen nga zërat, taksë vendore e përkohshme, tarifë e regjistrimit të veprimtarive të ndryshme, tarifë për leje zhvillimi, taksë vendore për mirëmbajtje, të ardhura nga qira e tokës bujqësore, të ardhura nga qira troje, tarifë licence radiotelevizive, si dhe të ardhurat nga të gjitha taksat/tarifat e tjera të parashikuara në paketën fiskale të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Nga verifikimi rezultoi se:** Bashkia Peqin nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi. **Ky rekomandim është pa zbatuar.**

**9. Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2021 në Bashkinë Peqin niveli i realizimit të të ardhurave është 41%, duke sjellë diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit të bashkisë për sa i takon pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve. Me nivel të ulët realizimi

paraqiten, taksa mbi ndërtesat në masën 32%, taksa mbi tokën bujqësore në masën 42%, taksa për hapësirat publike në masën 41%, tarifë parkimi në masën 31%, tarifa e pastrimit në masën 50%, tarifa e ndriçimit në masën 36%, etj. Niveli i ulët i realizimit të të ardhurave ka ndikuar në mosrealizimin e shpenzimeve të planifikuara me burim financimi të ardhurat e veta të bashkisë dhe marrjen e angazhimeve buxhetore pa patur burime financimi reale. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e kuadrit ligjor dhe rregullator për hartimin dhe zbatimin e buxhetit, përkatësisht:

- Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;
- Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- VKB nr. 131 datë 16.12.2020 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë e Peqinit”;
- VKB nr. 134, datë 16.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2021”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 24-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1 Rekomandim:** Drejtoria e të Ardhurave Lejeve dhe Licencave të angazhohet në marrjen e masave në terren gjatë gjithë vitit me qëllim mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifavat vendore në nivelet më të larta sipas planifikimit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Nga verifikimi rezultoi se:** Niveli i mbledhjes së të ardhurave për vitin 2022 është 35%, pra me i ulët se në vitin paraardhës. **Ky rekomandim është pa zbatuar.**

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarisë nr. 468 “Debitorë të ndryshëm” të pasqyrave financiare të Bashkisë Peqin për vitin 2021, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson të drejtat e Bashkisë Peqin për arkëtim ndaj të tretëve, është kontabilizuar më pak për vlerën 14,425,665 lekë duke mos përfshirë në mënyrë të plotë këto të drejta, si vijon:

- Gjobat e vendosura nga IMTV përgjatë periudhës 2019-2021 në vlerën 7,500,000 lekë;
- “Debitorët e lënë nga KLSH” ndër vite, në vlerën 6,925,665 lekë.

Veprime dhe mosveprime të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, shkronja “ë”, pika 3, neni 12, Ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, pika 1, neni 11, udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, rubrika 2.3, paragrafi 21, shkronja “c”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 46-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1 Rekomandim:** Drejtoria e Financës Bashkia Peqin, të marrë masat e nevojshme që të kryhet vlerësimi dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr. 468 “Debitorë të ndryshëm”.

*Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022*

**Nga verifikimi rezultoi se:** Bashkia Peqin nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi. **Ky rekomandim është pa zbatuar.**

**11. Gjetja nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua mos pasqyrim i saktë në kontabilitetin e institucionit, si vijon:

- Të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” e cila paraqitet në vlerën 120,357,119 lekë, ku sipas rakordimeve me thesarin llog. 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)” është deklaruar në vlerën 64,643,477 lekë dhe nuk kuadron me llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga

buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 120,357,119 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 46-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1 Rekomandim:** Drejtoria e Financës së Bashkisë Peqin të marrë masa për sistemimin dhe rakordimin me thesarin të llogarive si më poshtë:

-Llog 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, e cila është njohur me vlerën 0 në pasqyrat financiare dhe duhet të jetë në vlerën 120,357,119 lekë, sikurse është në rakordimet me thesarin.

-Llog. 4342 “Të tjera operacione me shtetin” e njohur me shumën 120,357,119 në bilanc, e cila i përket llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, të pasqyrohet llog.4342 “Të tjera operacione me shtetin” ku duhet të kundrojë me llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare dhe sipas rakordimeve me thesarin.

***Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022***

**Nga verifikimi rezultoi se:** Bashkia Peqin ka sistemuar llogaritë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe 4342 “Të tjera operacione me shtetin”, në bilancin e vitit 2022. **Ky rekomandim është zbatuar.**

**12. Gjetja nga auditimi:** Drejtoria e Financës nuk ka ndërmarrë veprimet e duhura për të bërë zhbllokimin e fondeve dhe përdorimin e tyre në buxhetin e vet për llog.466 “Kreditorë dhe mjete në ruajtje”, fonde që gjenden të ngurtësuar deri në vitin 2021, për të cilat është tejkaluar afati i garancisë dhe nuk është bërë zhbllokimi i tyre sipas kushteve të kontratave respektive, vlerë e trashëguar nga ish-komunat në shumën totale 53,182 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 46-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**12.1 Rekomandim:** Drejtoria e Financës, Bashkia Peqin, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë 466 “Kreditorë dhe mjete në ruajtje” si dhe të njoftojë subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe likuiduar garancitë, të cilave tashmë ju ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**Nga verifikimi rezultoi se:** Bashkia Peqin nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi. **Ky rekomandim është pa zbatuar.**

**13. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Peqin ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 866/07 datë 30.12.2021, por nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak mbi rezultatet e zbatimit të këtyre rekomandimeve, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 77-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**13.1 Rekomandim:** Bashkia Peqin të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**Nga verifikimi rezultoi se:** Bashkia Peqin nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi. **Ky rekomandim është pa zbatuar.**

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve rezultoi se, 6 masat për shpërbllim dëmi të lëna në auditimin e fundit nuk janë zbatuar, përkatësisht:

1.1 Nuk janë ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej 190,000 lekë të konsideruar dëm ekonomik, nga 9 subjekte persona fizik;

- 2.1 Nuk janë marrë masa për të ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej 650,000 lekë, nga 5 subjekte ndërtimi;
- 3.1 Nuk janë marrë masa për arkëtimin e vlerës prej 261,528 lekë pa TVSh nga BOE “B.” Shpk & “P. V.” Shpk;
- 4.1 Nuk janë marrë masa për arkëtimin e vlerës prej 744,984 lekë pa TVSh nga BOE “B.” Shpk & “P. V.” Shpk & “Z.” Shpk;
- 5.1 Nuk janë marrë masa për arkëtimin e vlerës prej 137,300 lekë pa TVSh nga BOE “L.” ShPK & “B. B” ShPK & “G.P.G” ShPK;
- 6.1 Nuk janë marrë masa për lidhjen e kontratave të qirasë me personat të cilët kanë zaptuar tokat bujqësore dhe të kërkojë arkëtimin e vlerës 4,941,853 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa j dhe neni 30 pika 2. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 77-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**14.1 Rekomandim:** Nga Bashkia Peqin të merren masa për:

- Të ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej 190,000 lekë të konsideruar dëm ekonomik, nga 9 subjekte persona fizik;
- Të ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej 650,000 lekë, nga 5 subjekte ndërtimi;
- Arkëtimin e vlerës prej 261,528 lekë pa TVSh nga BOE “B.” Shpk & “P. V.” Shpk;
- Arkëtimin e vlerës prej 744,984 lekë pa TVSh nga BOE “B.” Shpk & “P. V.” Shpk & “Z.” Shpk;
- Arkëtimin e vlerës prej 137,300 lekë pa TVSh nga BOE “L.” ShPK & “B. B” ShPK & “G.P.G” ShPK;
- Lidhjen e kontratave të qirasë me personat të cilët kanë zaptuar tokat bujqësore dhe të kërkojë arkëtimin e vlerës 4,941,853 lekë.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**Nga verifikimi rezultoi se:** Bashkia Peqin nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi. **Ky rekomandim është pa zbatuar.**

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve rezultoi se nuk janë zbatuar apo janë zbatuar pjesërisht 5 rekomandime organizative (rekomandimet 7.1, 9.1, 10.1, 11.1, 16.1) dhe 3 rekomandime për përdorim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike (rekomandimet 2.1, 3.1, 5.1) të lëna në auditimin e fundit, përkatësisht:

**7.1** Nuk janë marrë masa nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Peqin, për kryerjen e akt rakordimeve për debitorët e taksave të bizneseve dhe të familjarëve, dërgimin e tyre në Drejtorinë e Financës dhe pasqyrimin në kontabilitet, për vlerën 46,332 mijë lekë;

**9.1** Nuk janë marrë masa nga Bashkia Peqin, për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm duke hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara, për secilin sektor dhe drejtori, për përcaktimin në përputhje me strukturën organizative, të ndarjes së detyrave, përshkrimit të detyrave funksionale, si dhe përcaktimit të përgjegjësive dhe të drejtave të punonjësve të njësisë. Nuk janë marrë masa për aplikimin e programe elektronike për kontrollin dhe menaxhimin e veprimeve financiare si dhe ato për vjeljen e të ardhurave për tatim taksat lokale;

**10.1** Nuk janë marrë masa nga Bashkia Peqin, që para fillimit të punimeve, të shqyrtohen të dhënat teknike të objekteve të planifikuara për zbatim dhe të pajisen me lejen e ndërtimit, ku të përcaktohen me detaje kushtet e zbatimit të projektit;

**11.1** Nuk janë marrë masa nga Njësia e Auditimit të Brendshëm dhe Titullari i institucionit nisja e procedurës së certifikimit për të gjithë strukturën e NJAB;

**16.1** Nuk janë marrë masa nga sektori Juridik në bashkëpunim me IMTV që të kërkohet në Gjykatë, shndërrimi i vendimeve të kundërvajtjes në titull ekzekutiv dhe arkëtimi i vlerës prej 3,500,000 lekë nga 7 persona;

*Rekomandimet për përdorim pa ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike:*

**2.1** Nuk janë marrë masa nga Bashkia Peqin për, analizimin e efektit ekonomik të vlerës ekonomike prej 7,332,397 lekë pa TVSh në vit kalendarik që OE fitues “V.G.” ShPK, të përfituar si rezultat i përlogaritjes së gabuar të fondit limit, përfshirja në FL e zërit të shërbimit “Ndarja e sistemimi i mbeturinave në vend depozitim e kompostim” me vlerë ekonomike vjetore 4,560,422 lekë pa TVSh dhe përfshirja në FL e zërit të shërbimit “Mirëmbajtje e rrugëve kryesore” me vlerë ekonomike vjetore 3,979,555 lekë pa TVSh;

**3.1** Nuk janë marrë masa nga Bashkia Peqin për, analizimin e efektit që ka shkaktuar vendosja e kërkesave/kritereve të panevojshme që nuk mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e Autoritetit Kontraktor për realizimin e shërbimit;

**5.1** Nuk janë marrë masa nga Bashkia Peqin, për të analizuar performancën financiare të Shoqërisë “Klubit të Futbollit Shkumbini” ShA dhe mbi këtë bazë, nuk është përcaktuar destinacioni i fondeve për këtë subjekt, në zbatim të kërkesave ligjore.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa j dhe neni 30 pika 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 77-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**15.1 Rekomandim:** Nga Bashkia Peqin të merren masa për:

- Kryerjen e akt rakordimeve për debitorët e taksave të bizneseve dhe të familjarëve, raportimin në Drejtorinë e Financës me qëllim pasqyrimin në kontabilitet të debitorëve, në vlerën 46,332 mijë lekë;
- Përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm duke hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara, për secilin sektor dhe drejtori, për përcaktimin në përputhje me strukturën organizative, të ndarjes së detyrave, përshkrimit të detyrave funksionale, si dhe përcaktimit të përgjegjësisve dhe të drejtave të punonjësve të njësisë. Gjithashtu, të merren masa për aplikimin e programe elektronike për kontrollin dhe menaxhimin e veprimeve financiare si dhe ato për vjeljen e të ardhurave për tatim taksat lokale;
- Shqyrtimin e të dhënave teknike të objekteve të planifikuara për zbatim dhe të pajisen me lejen e ndërtimit, ku të përcaktohen me detaje kushtet e zbatimit të projektit përpara fillimit të punimeve;
- NJAB dhe Titullari i institucionit të nisin procedurën e certifikimit për të gjithë strukturën e NJAB;
- Shndërrimin e vendimeve për kundërvajtjet administrative në titull ekzekutiv. Sektori Juridik në bashkëpunim me IMTV, të marrin masa për arkëtimin i vlerës prej 3,500,000 lekë nga 7 persona;

*Mbi përdorim pa ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike:*

- Analizimin e efektit ekonomik të vlerës ekonomike prej 7,332,397 lekë pa Tvsh në vit kalendarik që OE fitues “V.G.” ShPK, ka përfituar si rezultat i përlogaritjes së gabuar të fondit limit, mos përfshirja në FL e zërit të shërbimit “Ndarja e sistemimi i mbeturinave në vend depozitim e kompostim” me vlerë ekonomike vjetore 4,560,422 lekë pa TVSh dhe përfshirja në FL e zërit të shërbimit “Mirëmbajtje e rrugëve kryesore” me vlerë ekonomike vjetore 3,979,555 lekë pa TVSh;

- Analizimin e efektit që ka shkaktuar vendosja e kërkesave/kritereve të panevojshme që nuk mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e Autoritetit Kontraktor për realizimin e shërbimit;
- Analizimin e performancës financiare të Shoqërisë “Klubi Futbollit Shkumbini” ShA dhe mbi këtë bazë, të përcaktojë për të ardhmen vlerën dhe destinacionin e fondeve për këtë subjekt.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Nga verifikimi rezultoi se:** Bashkia Peqin nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi. **Ky rekomandim është pa zbatuar.**

### **C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA - TË ARDHURA TË MUNGUARA.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i ecurisë së pagesave për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet rezulton se qytetarët që kanë përfituar legalizimin e sipërfaqeve të caktuara nuk kanë paguar rregullisht detyrimin ndaj Bashkisë Peqin për këtë taksë. Përkatësisht, për vitin 2021 nuk kanë paguar detyrimin 32 qytetarë me vlerë totale 2,512,232 lekë. Gjithashtu, nuk kanë paguar detyrimin 414 qytetarë për sipërfaqet e legalizuara përpara vitit 2021 me vlerë totale të detyrimeve 16,787,696 lekë. **Në total vlera e detyrimeve nga mos pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet rezulton 19,299,928 lekë për 446 objekte të legalizuara, vlerë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Peqin.** Kjo vlerë detyrimi nuk është dërguar në Drejtorinë e Financës për kantabilizim. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5 si dhe VKB-së nr. 131 datë 16.12.2020 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë e Peqinit”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 24-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1 Rekomandim:** Titullari i Bashkisë Peqin të marra masa që Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të angazhohet në procesin e planifikimit të të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet. Gjithashtu, të dyja drejtoritë, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave dhe Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit duhet të bashkëpunojnë dhe të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë **për 446 debitorë në vlerën 19,299,928 lekë** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Drejtoria e të Ardhurave të dërgojë informacion periodik në Drejtorinë e Financës lidhur me listën e debitorëve për taksën e ndikimit në infrastrukturë. Nga strukturat e Bashkisë Peqin të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen si dhe për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Nga verifikimi rezultoi se:** Bashkia Peqin nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi, vlera e debisë deri në 31.12.2022 është në vlerën 21,836,081 lekë. **Ky rekomandim është pa zbatuar.**



**2. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Peqin ka lidhur 1615 akt marrëveshje për dhënie sipërfaqesh toke me qira familjeve në P. njësitë e saj administrative. Nga auditimi i pagesave të qirave për këto akt marrëveshje rezultoi se për vitin 2021 nuk është paguar detyrimi në vlerën 3,211,690 lekë. Ndërsa detyrimi i pa paguar për vitet më parë është në vlerën 2,770,934 lekë. **Të ardhurat e munguara në buxhetin e Bashkisë Peqin më datë 31.12.2021 si rezultat i mos pagesës së detyrimit për sipërfaqet e marra me qira janë në vlerën totale 5,982,624 lekë.** Gjithashtu, rezultoi se kjo vlerë detyrimesh nuk është dërguar në Drejtorinë e Financës për kontabilizim. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 24-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1 Rekomandim:** Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë të marrin masa dhe të ndjekin të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës **5,982,624 lekë** nga qiramarrësit që nuk kanë paguar detyrimet për tokën e marrë me qira, si dhe të raportojnë periodikisht në Drejtorinë e Financës detyrimet që kanë qiramarrësit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Nga verifikimi rezultoi se:** Bashkia Peqin nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi, vlera vazhdon të jetë e njëjtë me një vit më parë. **Ky rekomandim është pa zbatuar.**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të dhënave lidhur me detyrimet që tatimpaguesit kanë ndaj Bashkisë Peqin rezultoi se gjatë vitit 2021 borxhi i krijuar është në shumën **8,340,000 lekë** dhe përbëhet nga detyrimet nga taksat dhe tarifatat për personat fizikë/juridikë, detyrimet nga taksat dhe tarifatat vendore për familjet dhe detyrimet nga nga taksa e tokës bujqësore.

Detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore në mënyrë progresive më datë 31.12.2021 në Bashkisë Peqin janë në vlerën **25,458,497 lekë** të përbëra nga:

- **8,202,497 lekë** detyrimet nga taksat dhe tarifatat e bizneseve, për 269 biznese;

- **7,616,000 lekë** detyrime nga taksat dhe tarifatat vendore për familjet;

- **9,640,000 lekë** detyrime për taksën e tokës bujqësore për 4820 familjeve.

Rezultoi se Bashkia Peqin nuk ka aplikuar të gjitha masat e duhura ligjore për subjektet që nuk kanë paguar detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore, në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89,90,91,93. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 24-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1 Rekomandim:** Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Peqin, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën:

- **8,202,497 lekë** për 269 biznese;

- **7,616,000 lekë** nga taksat dhe tarifatat vendore për familjet;

- **9,640,000 lekë** për taksën e tokës bujqësore për **4820 familjeve;**

*a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.*

*b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).*

*c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Tatim Taksave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.*

*d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Sektorit të Tatim Taksave, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.*

*e- Sektori i Tatim Taksave të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Peqin, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.*

f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

#### ***Menjëherë dhe në vijimësi***

**Nga verifikimi rezultoi se:** Bashkia Peqin nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi, vlera e debisë deri në 31.12.2022 është përkatësisht për bizneset në vlerën 11,590,558 lekë, për familjet debitore në vlerën 9,104,000 lekë dhe për tokën bujqësore në vlerën 10,200,000 lekë. **Ky rekomandim është pa zbatuar.**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i subjekteve që tregtojnë lëndë djegëse me pakicë lidhur me pagesën e pajisjes me autorizim për ushtrimin e aktivitetit rezultoi se 6 subjekte (“B.” SHPK, “J. P.” SHPK, “K.” SHPK, “O.” SHPK, dy adresa, “A. H. 2013 SHPK”) nuk janë pajisur me autorizim/licencë për ushtrimin e aktivitetit, ndërsa 2 subjekte (“D.O.” SHPK dhe “S.G.” SHPK) janë pajisur me autorizim në muajt Tetor dhe Dhjetor 2021. Ushtrimi i aktivitetit nga subjektet që tregtojnë lëndë djegëse gjatë vitit 2021 të pa pajisur me autorizimin/licencën përkatëse **ka sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Peqin për vitin 2021 në vlerën 1,200,000 lekë** (6 subjekte \* 200,000 pagesa e autorizimit për 1 vit = 1,200,000 lekë) dhe është në kundërshtim me përcaktimet ligjore, përkatësisht:

- Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4, neni 15, neni 20, pika 2;

- VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, kreu II, pika 3.

Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave nuk ka informacion se kur kanë filluar aktivitetin subjektet që nuk janë të pajisur me autorizim/licencë për ushtrimin e aktivitetit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 24-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1 Rekomandim:** Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave të marrë masa që subjektet “B.” SHPK, “J. P.” SHPK, “K.” SHPK, “O.” SHPK, “A. H. 2013” SHPK dhe “O.” SHPK të pajisen menjëherë me autorizimin përkatës për ushtrimin e aktivitetit duke paguar detyrimet ndaj Bashkisë Peqin me vlerë vjetore 200,000 lekë secili. Gjithashtu, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet me qëllim që të kryhen pagesat e plota brenda afateve.

#### ***Menjëherë dhe në vijimësi***

**Nga verifikimi rezultoi se:** Bashkia Peqin nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi, pasi nuk janë pajisur me autorizim subjektet që ushtrojnë aktivitet lëndë djegëse naftës bruto dhe nënprodukteve të saj, si dhe vazhdojnë të jenë debitor për vitin pasardhës. **Ky rekomandim është pa zbatuar.**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i aktivitetit të IMTV-së rezultoi se për vitin 2021 janë dhënë 8 masa “Dënim me gjobë”. **Vlera totale e gjobave të vendosura për vitin 2021 është 4,000,000 lekë.** Për gjobat e vendosura dhe që nuk janë paguar brenda afateve ligjore, IMTV ka dërguar në gjykatë vendimet për të nxjerrë Urdhrin e Ekzekutimit për secilën gjobë, në zbatim të përcaktimeve të Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 30, pika 4, por nuk ka ndjekur hapat e tjera të parashikuar në ligj si procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimit apo vendosje sekuestro mbi pasurinë, sipas nenit 9, nenit 22, pika 1, nenit 3, pika 5”.

Përveç gjobave të vendosura gjatë vitit 2021 dhe që nuk janë paguar, IMTV ka edhe gjoba të tjera të vendosura më herët (2019-2020) që nuk janë arkëtuar dhe janë në proces gjyqësor. Përkatësisht, janë në proces gjyqësor **7 gjoba me vlerë 3,500,000 lekë. Në total të ardhurat e munguara nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV janë në vlerën 7,500,000 lekë.** Gjithashtu, rezulton se për gjobat që nuk janë paguar brenda afateve ligjore nuk është llogaritur kamatëvonesa në masën 2% për çdo ditë vonesë, në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “*Për kundërvajtjet administrative*”, neni 30, pika 1 dhe pika 3.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 24-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**5.1 Rekomandim:** Inspektorati i Mbrojtës Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekin me përpikmëri procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjobat e vendosura nga IMTV për vlerën totale **7,500,000 lekë.** Gjithashtu, IMTV të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrit ligjor në fuqi.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Nga verifikimi rezultoi se:** Bashkia Peqin nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi, vlera për vitin 2022 është 7,500,000 lekë dhe për vitin 2021 nuk është arkëtuar akoma vlera 7,500,000 lekë. **Ky rekomandim është pa zbatuar.**

#### **D. MASA DISIPLINORE**

KLSH mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, neni 15 germa b, c dhe ç, ligjin nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, neni 59 “*Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore*”, pika 1 dhe pika 4 germa b, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*”, ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 “*Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë*”, neni 37, “*Masa disiplinore*”, **i rekomandon Kryetarit të Bashkisë Peqin** t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.

**Nga verifikimi rezultoi se:** Bashkia Peqin nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi. **Ky rekomandim është i pa zbatuar.**

#### **IV. GJETJE DHE REKOMANDIME**

**Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:**

##### **MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi Menaxhimin financiar dhe kontrollin, u konstatua se:

-Nuk janë hartuar hapat e proceseve të punës për burimet njerëzore .

-Në Bashkinë Peqin, për periudhën objekt auditimi, mungon dokumentacioni shkresor që pasqyron minutat e takimit dhe marrjen e vendimeve për mbledhjet që realizon GMS dhe si rrjedhojë e kësaj nuk është hartuar plani i veprimit për arritjen e objektivave dhe plani për kontrollin e brendshëm.

Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se, në Bashkinë Peqin për vitin 2022 nuk vertetohet me dokumentacion se GMS ka kryer takime pune për periudhën objekt auditimi. Në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 27, pika 1, gjithashtu dhe Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pika 3.3, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016

-Nuk janë përditësuar raportet periodike apo publikimet vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut, planifikimin dhe realizimin prokurimeve,, institucionet e varësisë, nuk përditësohet informacioni mbi ndryshimet në strukturën e bashkisë, paketat fiskale. *Këto veprime nuk janë në përputhje me Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 8, pika 8, shkronja a, neni 12, pika 3, neni 22, pika 5, neni 16, pika 2, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit, kreu III, paragrafi 3.1, pika 3.4, Udhëzimi nr 16 dt 20.07.2016 për Koordinatorin MFK dhe koordinatorin e riskut në njësinë publike, pika 3.2.5. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 19-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1. Rekomandimi:** Të hartohet dhe miratohet plani i veprimit për dokumentimin shkresor që pasqyron minutat e takimit .

**1.2. Rekomandimi:** Të hartohet dhe miratohet strategjia për të dokumentuar mbledhjet e Grupit të Menaxhimit Strategjik .

**1.3. Rekomandimi:** Të hartohet Plani i veprimit për MFK dhe të raportohet për realizimin e tyre nga sektorët përkatës .

##### **Menjëherë dhe në vijim**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit për organizimin dhe funksionimin e Auditit të Brendshëm në Bashkia Peqin rezultoi se struktura e kësaj njësie përbëhet nga 3 punonjës nga të cilët drejtuesi i njësisë është i pajisur me certifikatë të auditit, një prej tyre është në process marrje dhe certifikatës dhe një punonjës është i pa pajisur me certifikatë të auditit të brendshëm. Bazuar në pikën 3 të VKM nr.32 datë 03.02.2018 përcakton se struktura e auditit të brendshëm mund të punesohen deri në 1/3 e punonjësve të pa certifikuar si audites të brendshëm në sektorin publik .

**2.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Peqin të vazhdojë ndjekja e trajnimeve të vijueshme profesionale për specialistët e Nj.A.B.

##### **Menjëherë dhe në vijim**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi procesin e hartimit të PBA-së për periudhën 2022-2024, rezulton se nga strukturat e Bashkisë Peqin nuk janë ndjekur të gjithë hapat ligjore, përkatësisht:

• Këshilli Bashkiak ka miratuar draftin e parë të programit buxhetor afatmesëm, dhe nuk ka dhënë opinionin e tij në lidhje me rekomandimet e Ministrisë së Financave;

• Kryetari i Bashkisë Peqin nuk ka miratuar udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit të bashkisë, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 33, 34, 35, 36, 37, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/015, datë 15.10.2015, neni 12, si dhe udhëzimet e MFE nr. 23, datë 22.11.2016, nr. 22, datë 30.07.2018, nr. 7, datë 27.02.2019 dhe nr. 7, datë 26.02.2021 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024", kreu I, pika 13. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 24-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1 Rekomandim:** Bashkia Peqin, Drejtoria e Financës të marrë masa që pas miratimit të programit buxhetor afatmesëm të japë opinion për rekomandimet e lëna nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

#### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të vitit 2021 rezulton se:

- Ndryshimet nuk janë shoqëruar me relacion shpjegues lidhur me arsyet e ndryshimit;
- Nuk ka një analizë se si ndikon ky ndryshim në realizimin e objektivave të synuar të bashkisë;
- Nuk janë respektuar afatet ligjore për rishikimin e buxhetit vendor.

Për sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 47, ligjin 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 44, Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore" shtojca 4, pika c. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 24-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1 Rekomandim:** Bashkia Peqin të marrë masa për hartimin e një buxheti real, objektiv në realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, që mos të sjellë diferenca midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, të dokumentojë procesin e konsultimeve me komunitetin dhe grupet e interesit si dhe mbledhjet e strukturës dhe të institucioneve të varësi duke parashtruar dhe kërkesat e tyre buxhetore.

#### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Peqin për vitin 2022 ka hartuar dhe dërguar në MFE vetëm Raportin vjetor të monitorimit të buxhetit për vitin 2022, ndërsa 3 raportet periodike të monitorimit nuk janë hartuar nga Bashkia Peqin për vitin 2022. Kryetari i Bashkisë Peqin në asnjë rast nuk i ka paraqitur në këshill raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48, Shtojca 2 “Përmbajtja e raportit të monitorimit” dhe Shtojca 5 “Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë”, të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, Ligji nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 48 dhe Udhëzimi nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, pika 10, 12, 28, 29, 48. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 24-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1 Rekomandim:** Nga ana e Bashkisë Peqin të merren masa për hartimin e raporteve të monitorimit të zbatimit të buxhetit duke plotësuar të gjitha anekset me të dhënat përkatëse si dhe të dërgojë në ishtucionet përkatëse këto raporte sipas afateve të përcaktuara. Gjithashtu, të miratojë rregulla specifike dhe procedurale që duhet të ndiqen në procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit.

#### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura nga dokumentet analitike të Bashkisë Peqin nga fatura të pa likuiduara brenda afatit 60 ditor përgjatë vitit 2022, duke krijuar në fund të vitit buxhetor detyrime të prapambetura, si dhe mosrespektimi i radhës në likuidimin e

tyre rezulton se, vlera e detyrimeve të prapambetura deri në fund të këtij viti të paraqitet 137,497,700 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014, pika 4. Ligji nr. 68/2017 "Përfinancat e qeverisjes vendore", neni 34, pika 1, neni 40, pika 3, Udhëzimi i MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 101. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 24-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1 Rekomandim:** Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues në Bashkinë Peqin të marrë masa për likuidimin në kohë të të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, duke paraqitur pranë degës së thesarit, të gjithë dokumentacionin përkatës brenda afatit nga momenti i prerjes së faturës, si dhe të raportoje periodikisht në MFE.

#### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhura sipas zërave rezultoi se ekzistojnë disa zëra për të cilat Drejtoria e të Ardhurave Lejeve dhe Licencave nuk ka bërë planifikim për vitin 2022. Përkatësisht, zërat tarifë leje transporti plus shërbime, taksë vendore e regjistrimit të biznesit, tarifë vendore për vërtetime, etj., nuk janë llogaritur në planifikim. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 12, 13, 14 të ligjit Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 24-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**7.1 Rekomandim:** Drejtoria e të Ardhurave Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Peqin të marrë masa që, në planin vjetor të të ardhurave të bashkisë të parashikojë të ardhurat që do të sigurohen nga zërat, tarifë leje transporti plus shërbime, taksë vendore e regjistrimit të biznesit, tarifë vendore për vërtetime, etj., si dhe të ardhurat nga të gjitha taksat/tarifat e tjera të parashikuara në paketën fiskale të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak.

#### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**8. Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2022 në Bashkinë Peqin niveli i realizimit të të ardhurave është 35%, duke sjellë diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit të bashkisë për sa i takon pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve. Niveli i ulët i realizimit të të ardhurave ka ndikuar në mosrealizimin e shpenzimeve të planifikuara me burim financimi të ardhurat e veta të bashkisë dhe marrjen e angazhimeve buxhetore pa patur burime financimi reale. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e kuadrit ligjor dhe rregullator për hartimin dhe zbatimin e buxhetit, përkatësisht:

- Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Udhëzimi i MFE nr. 7, datë 27.02.2019 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2020-2022";
- Për vitin 2022 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Peqin është miratuar me VKB-në nr. 64, datë 23.12.2022 “Për sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Peqin”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 1575/1 Prot. datë 09.01.2023”;
- VKB nr. 121, datë 29.12.2021, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 24-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.1 Rekomandim:** Drejtoria e të Ardhurave Lejeve dhe Licencave të angazhohet në marrjen e masave gjatë gjithë vitit me qëllim mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në nivelet më të larta sipas planifikimit.

#### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**9. Gjetje nga auditimi:** Mos pasqyrim i saktë në kontabilitetin e institucionit të llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” për vlerën 137,497,700 lekë. në kundërshtim me ligjin 68/2012 “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 34, pika 1, neni 40 pika 3. urdhërit nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.8 “Të ardhurat”, pika 8 e standardit ku përcaktohet njohja fillestare e të ardhurës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 49-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës së Bashkisë Peqin të marrë masa për sistemimin e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, për vlerën 137,497,700 lekë, e cila është njohur me vlerën 0 në pasqyrat financiare.

#### **Në mbylljen e pasqyrave financiare për vitin 2024**

**10. Gjetje nga auditimi:** Mos shlyerje e pagave të punonjësve në vlerën 36,552,054 lekë, për muajt Korrik, Gusht, Shtator dhe Dhjetor të vitit 2022 procedurë kjo e ndjekur në kundërshtim me ligjin 68/2012 “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 34, pika 1, neni 40 pika 3, Udhëzimi i MFE-së, nr.2 datë, 06.02.2012, pika 101, Kodi i Punës, neni 95, neni 101 pika 283, neni 119 pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 49-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**10.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Peqin dhe Drejtoria e Financës së Bashkisë Peqin të marrin masa të menjëhershme për shlyerjen e pagesave të punonjësve në vlerën 36,552,054 lekë duke respektuar të drejtën themelore të punonjësve aspektin social dhe shoqëror.

#### **Menjëherë**

**11. Gjetje nga auditimi:** Mbi mangësitë e konstatuara në llogarinë 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje” në pasqyrat financiare, për vlerën kontabël 23,290,504 lekë, ku nuk janë likuiduar garancitë (llog.466) e punimeve që kanë mbushur afatin kohor në vlerën 3,229,135 lekë, për 5 objekte që Bashkia Peqin nuk i ka marrë në dorëzim, në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 49-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**11.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës në Bashkinë Peqin, të marrin masa për likuidimin e garancive të punimeve, të cilat e kanë mbushur afatin, në vlerën 3,229,135 lekë për 5 objektet.

#### **Menjëherë dhe në vijim**

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit publik u konstatua se **në 6 (gjashtë)** procedura prokurimi, në kriteret e veçanta të kualifikimit, është kërkuar nga Autoriteti Kontraktor që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të kenë si kusht s’kualifikimi kërkesa/kritere të cilat nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Gjithashtu rezultoi se disa prej kërkesave të veçanta, në këto procedura si dhe specifikimet teknike nuk janë argumentuar në mënyrë teknike dhe ligjore. Veprimet e mësipërme ndikojnë në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorve ekonomik, uljen e konkurrencës. Veprime e mosveprime që nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 1, nenin 3, Kreu V, neni 21, pikat 1 dhe 5, neni 36, pika 4, . Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, nenin 2, neni 12, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu X, neni 40, pika 3, neni 78, pika 2, paragrafi dytë, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27, pika 3, neni 61, pika 2, paragrafi dytë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 73-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**12.1. Rekomandimi:** Autoritetit Kontraktor Bashkia Peqin, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kriterëve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave të pa argumentuara, ndaj operatorëve ekonomikë.

**Në vijimësi**

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se; për vitin 2021 janë kryer 2 procedura blerje me vlera të vogla duke copëzuar fondin dhe duke shmangur procedurat standarde të prokurimit, konkretisht: Në 2 procedura në shumën totale të fondit limit në vlerën 957,827 leke lekë pa TVSH, procedura duhet të kryheshin tenderim, pasi kanë objekt të njëjtë procedur; është kryer procedura me objekt “Ndërtim bazamenti Qendra Shëndetësore Shez”, në muajin prill me fond limit në shumën 512,500 lekë pa tvsh, procedura me objekt “Ndërtim bazamenti Qendra Shëndetësore Shez , me fond limit në shumën 783,761 lekë pa tvsh e zhvilluar në muajin shtator, procedura me objekt “Ndërtim i bazamentit Qendra Shëndetësore Karine”, me fond limit në shumën 795.689 lekë pa TVSh, e zhvilluar në muajin shtator, dhe procedura me objekt “Ndërtim i bazamentit Qendra Shëndetësore Karine)” me fond limit në shumën 795.689 lekë pa TVSh zhvilluar në muajin mars. *Këto veprime nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 2, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenin 40, pika 1, Udhëzimin nr.3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar, pika 3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 73-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**13.1. Rekomandimi:** Autoriteti kontraktor Bashkia Peqin, të marrë masa që në planifikimin e regjistrimit të prokurimeve, përzgjedhja e metodës që përdoret për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit, të shmang copëzimin e fondeve, me qëllim që procedurat e prokurimit të zhvillohen sipas kufijve monetar.

**Në vijimësi**

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit u konstatua se **në gjashtë** procedura prokurimi, nuk argumentohet dhe dokumentohet llogaritja e fondit limit dhe përzgjedhja e procedurës. Nga ana e titullarit të AK, nuk ka urdhër për caktimin e një personi apo ngritjen e një komisioni për llogaritjen e vlerës së fondit limit të procedurës së prokurimit. Nisja e kësaj procedure referuar dhe inventarizimit të dosjes, ka filluar me urdhrin e prokurimit nr. 310 prot, datë 08.02.2021. Sipas Vkm nr.914, datë 29.12.2014, Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në nenin 60, përcaktohet se; *“Pas përlllogaritjes së fondit limit sipas nenit 59 të këtyre rregullave, titullari i autoritetit kontraktor, nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit.”*. Pra nuk argumentohet dhe dokumentohet mënyra e llogaritjes së si është nxjerrë kjo vlerë limit e kontratës, veprim jo në përputhje me nenin 59, pika 2. Gjithashtu rezultoi se nuk është bërë një përshkrim i punëve të cilat do të kryhen dhe arsyeja e përzgjedhjes së kësaj procedure prokurimi “E hapur punë”. Veprime jo në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, me 59, pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 73-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**14.1. Rekomandim:** Titullari i Autoritetit Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimit, të marrin masat që, në procedurat e prokurimit në vijim, përpara hartimit të urdhrin të prokurimit të aplikojë mënyrën dhe përlllogaritjen e vlerës së kontratës me qëllim dokumentimin dhe argumentimin e saj në përputhje me fondet buxhetore të miratuara. Gjithashtu të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e përzgjedhjes së procedurës së prokurimit.

**Në vijimësi**



**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me zbatimin e kontratës me objekt furnizim me *“Blerje Automjeti për Bashkinë Peqin”* me vlerë 3,360,000 lekë me TVSh, rezulton se: Nga titullari i AK, nuk janë marrë masat e duhura për caktimin e personave për mbikëqyrjen e zbatimit të kontratës, hartimin e planit për zbatimin e kontratës, për tu siguruar nëse cilësia e mallrave të furnizuar është në përputhje me ato të kërkuara. Nga komisioni i krijuar për marrjen në dorëzim të automjetit, është mbajtur procesverbali nr. 532/1prot., datë 15.03.2021, në të cilin citohet ndër të tjera se verifikimi i automjetit është kryer pranë një Autoservisi në emër të F.K. Me këtë subjekt AK nuk ka asnjë marrëdhënie kontraktuale apo dokumentacion mbi të cilin komisioni ti drejtohej për të garantuar cilësinë e mallit të kërkuar nëse është në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktor apo jo. Këtë veprim komisioni e ka kryer pa autorizim nga titullari i AK dhe pa asnjë marrëveshje midis palëve (Autoservisit dhe AK). Pavarësisht se nga Autoservisi është lëshuar një dokument si Çertifikatë e kontrollit teknik të automjetit, në këtë dokument nuk përshkruhen të gjitha cilësitë për të cilat janë hartuar specifikimet teknike të mjetit në Dokumentet e Tenderit. Pra marrja në dorëzim e mjetit, nuk është bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi pasi nuk është në përputhje me kushtet e kontratës. Gjithashtu nuk është raportuar pranë APP sipas formularit përkatës për ecurinë e zbatimit të kontratës. *Veprime të cilat nuk janë në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 77. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 73-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**15.1. Rekomandim:** Titullari i Autoritetit Kontraktor të marrë masat që në të gjitha kontratat e furnizimit të mallrave, të caktojë personat përgjegjës për mbikëqyrjen e kontratës me qëllim garantimin e cilësisë së aktiveve të furnizuara në përputhje me kriteret dhe specifikimet e kërkuara. Gjithashtu të raportohet në APP për cdo rast mbi ecurinë e zbatimit të kontratës.

#### Në vijimësi

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *“Blerje Automjeti për Bashkinë Peqin”*, AK nëpërmjet NjP, ka dërguar ftesë për ofertë 5 Operatorëve ekonomikë për pjesëmarrje në tender. Referuar verifikimit të OE të ftuar rezulton se një prej OE të ftuar nuk ka në fushë veprimtarinë e ekstraktit të QKB, objektin e prokurimit dhe konkretisht OE “G. G.” me objekt Veprimtarie *“Tregti me pakice materiale ndërtimi, bojra, artikuj elektroshtëpiake, elektrike, vegla pune, hidraulike, rrjeta teli.”* Gjithashtu nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes së procedurës së prokurimit rezulton se nuk është argumentuar dhe dokumentuar përzgjedhja e OE të ftuar. *Veprime të cilat nuk janë në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39, pika 4. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 73-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**16.1. Rekomandimi:** Autoriteti Kontraktor Bashkia Peqin, Përgjegjësi i Prokurimeve dhe Njësia e Prokurimit të marrin masat e duhura që, në procedurat e prokurimit “Kërkesë për propozim”, në vijim, të kryejnë verifikimin e OE të cilët do t’u dërgojnë ftesën për ofertë, me qëllim që veprimtaria e tyre në ekstraktin e QKB të jetë në përputhje me objektin e kontratës që do të prokurohet.

#### Në vijimësi

**17. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në tre raste të audituara, projekti ndërtimor nuk është i plotë, si dhe mungon dokumentacioni shoqërues, siç janë problematika me kartelat e pasurisë së paluajtshme, mangësi në projektet që përbëjnë projektin ndërtimor, polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale dhe licencat. Në një rast konstatohet se informacioni i dokumentacionit të aplikimit për leje ndërtimi nuk është i saktë në të gjitha rastet, pasi plani i rievimit nuk është i plotësuar me të gjitha të dhënat e domosdoshme, polica e sigurimit nuk është brenda afatit të vlefshmërisë, informacioni i vendosur në plan-

vendosjen e miratuar nuk është i saktë. Gjithashtu, nga auditimi i procedurave të miratimit të kërkesave për pajisje me certifikatë përdorimi, konstatohet se në dy raste, këto certifikata janë miratuar në mungesë të theksuar të dokumentacionit të detyrueshëm, siç janë policat e sigurimit të përgjegjësive profesionale për hartuesit e projekteve ndërtimore, aktet përkatëse nga UK, OSHEE, PMNZSH, menaxhimi i mbetjeve urbane, kontrata midis zhvilluesit dhe shoqërisë ndërtuese, licencat e shoqërive ndërtuese, certifikata përfundimtare e auditimit të efikasitetit energjitike, etj. *Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr.111/2018, Neni 17, pika 4 dhe 6, Vendimin nr. 457, datë 29.6.2022, Neni 18 dhe 21. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 128-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**17.1. Rekomandim:** Nga DPKZHT dhe Bashkia Peqin, të merren masa për të kërkuar në çdo rast që aplikohet për t'u pajisur me leje ndërtimi ose certifikatë përdorimi, të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, sipas legjislacionit dhe rregulloreve në fuqi, si dhe të mos miratojnë asnjë leje ndërtimi me mangësi në projektin ndërtimor dhe dokumentacionit shoqërues të tij. Gjithashtu, DPKZHT të kontrollojë vërtetësinë, saktësinë dhe origjinalitetin e dokumentacionit të dorëzuar nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, si dhe të shmangë miratimin e lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit, deri në plotësimin e dokumentacionit sipas kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në tre raste nuk është kërkuar mendimi i asnjë prej autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, veprime në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, Neni 10/1, pika 6. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 128-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**18.1. Rekomandim:** Nga DPKZHT Peqin të merren të gjitha masat për marrjen dhe respektimin e mendimit dhe vendimeve të të gjitha autoriteteve, të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**19. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se **në asnjë rast**, objekti i miratuara me leje ndërtimi nuk është pajisur me vërtetim për riskun nga organi kompetent që lëshon lejen. Edhe pse në sistemin elektronik të lejeve nuk është parashikuar dritarja e nevojshme aplikim për pajisje me vërtetim për riskun, DPKZHT nuk ka kërkuar asnjë rast dokumentacionin e parashikuar në vendimin e poshtë-cituar. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Nenin 1 të VKM-së nr. 1162, datë 24.12.2020, *“Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi”*, si dhe në mungesë të dokumentacionit të kërkuar sipas Shtojcës 1 të këtij vendimi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 128-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**19.1. Rekomandim:** DPKZHT të ndërpresë praktikën e miratimit të lejeve të ndërtimit, për objekte të cilat nuk janë të pajisura me vërtetim për riskun nga organi kompetent që lëshon lejen. Në çdo rast, DPKZHT të kërkojë dokumentacionin e detyrueshëm sipas legjislacionit në fuqi, deri në krijimin e hapsirës së nevojshme në sistemin elektronik të lejeve për pajisje me vërtetim për riskun.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**20. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në një rast, më konkretisht për objektin *“Leje ndërtimi për kabanon frigoriferik 1 kat”*, miratuar me vendim nr. 120, nr. 148 prot; datë 26.11.2021 të Kryetarit të Bashkisë Peqin, me subjekt zhvillues “R.” ShPK, me adresë në Bardhas, Peqin, nuk është respektuar kondicioni urban i

intensitetit maksimal të lejuar. Për rastin në fjalë, gjatë përlogaritjes së intensitetit të ndërtimit, si parcela ku mbështetet objekti, janë marrë në konsideratë katër parcela të cilat nuk kanë lidhje fizike me njëra tjetrën, duke zvogëluar në mënyrë fiktive intensitetit e ndërtimit, veprime këto në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, Neni 38, pika 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 128-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**20.1. Rekomandim:** Nga DPKZHT Peqin të merren masa për të mos miratuar leje ndërtimi për objekte të cilat nuk respektojnë të gjitha kondicionet urbane, DPKZHT të verifikojë situatën e parcelave mbi të cilat mbështetet objekti në zhvillim, si dhe në çdo rast të kërkojë mendimin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) për të marrë verifikimin mbi ndërlidhjen e parcelave, kur objekti zhvillohet në më shumë se një pasuri.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**21. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në një rast, në lejen e ndërtimit të miratuar me vendim nr. 148, nr. 177 prot; datë 24.08.2022 të Kryetarit të Bashkisë Peqin për objektin “Rikonstruksion i ish-repartit ushtarak nr. 5012, në Peqin, Godina 3, 4 dhe sistemimet përreth tyre” me subjekt zhvillues “A.” ShPK, me adresë në Karinë, Peqin, lloji i ndërhyrjes që parashikohet të kryhet, nuk i përshtatet kategorisë së lejes së ndërtimit për të cilën është aplikuar. Në këtë rast është aplikuar për leje ndërtimi për rikonstruksion, pa ndryshim funksioni, por në fakt, objekti i rikonstruktuar nuk do të ketë të njëjtin funksion si më parë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Nenin 12 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 128-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**21.1. Rekomandim:** DPKZHT të marrë masa për të mos miratuar aplikime, për të cilat lloji i ndërhyrjes nuk i përshtatet kategorisë së lejes së ndërtimit për të cilën është aplikuar.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**22. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të dhënave të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Peqin, u konstatua se për periudhën nën auditim, 01.01.2021 – 31.12.2022, struktura e IMTV është përbërë nga nëntë kryeinspektor dhe inspektor, (aktualisht në marrëdhënie pune janë një kryeinspektor dhe P. inspektor), por vetëm dy prej tyre plotësojnë kriteret e formimit arsimor. Gjithashtu edhe dy kryeinspektor dhe një inspektor të cilët kanë qënë të punësuar në këtë strukturë, por kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës, kanë patur të njëjtën mangësi. Mangësitë e mësipërme nuk japin siguri për garantimin e zbatimit të ligjshmërisë dhe standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe janë në kundërshtim me Ligjin 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 11. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 141-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**22.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Peqin dhe Njësia e Burimeve Njerëzore, të marrin masa që struktura e IMTV-së të përbëhet nga punonjës të cilët të jenë me arsim të lartë në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogeologjisë dhe mjedisit, sipas parashikimeve ligjore.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**23. Gjetje nga auditimi:** IMTV Bashkia Peqin nuk ka respektuar procedurat e parashikuara në ligj në lidhje me mbajtjen e akteve përkatëse. IMTV nuk ka mbajtur në asnjë rast proces verbalin e pezullimit të punimeve. Gjithashtu IMTV nuk ka ndërmarrë të gjitha masat për prishjen e objekteve pa leje, pasi IMTV ka detyrimin të kërkojë asistencë nga IKMT për kthimin në gjendjen

fillestare të këtyre shkeljeve. IMTV nuk ka kallëzuar penalisht në asnjë rast kundërvajtësit, duku mos përdorur të gjitha masat ndëshkuese dhe shtrënguese për të parandaluar shkelje të tilla. IMTV nuk ka kërkuar në asnjë rast heqje e licencës profesionale për zhvilluesin, subjektin ndërtues, mbikëqyrësin e punimeve ose kolaudatorin. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 141-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**23.1. Rekomandim:** Nga ana e IMTV Bashkia Peqin të merren masat që për çdo rast, të respektohen procedurat sipas parashikimeve ligjore, në varësi të shkeljes së konstatuar, të aplikohen të gjitha masat ndëshkuese ndaj kundërvajtësve, si dhe të kërkohet e gjithë asistenca e nevojshme për ekzekutimin e vendimeve të prishjes.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**24. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me ekzekutimin, kontabilizimin dhe vjeljen e gjobave, konstatohet se nga struktura e Inspektoratit të Mbrojtjes së Teritorit, për periudhën objekt auditimi, janë vendosur 23 gjoba me vlerë 11,500,000 lekë, të cilat nuk janë arkëtuar. Për 14 vendime për gjobë në vlerën 7,000,000 lekë, IMTV i është drejtuar Gjykatës Administrative, duke i kërkuar nxjerrjen e titullit ekzekutiv, nuk është vendosur në dispozicion asnjë dokumentacion që të vërtetojë nxjerrjen e këtij titulli, duke pretenduar se IMTV dhe Bashkia Peqin nuk janë informuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Peqin, mbi vendimet e marra për këto raste, nëse për këto vendime gjykata e ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit. Bashkia Peqin, IMTV, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Financës nuk kanë përdorur mënyrat e parashikuara në Ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010, *“Për kundërvajtjet administrative”*, Neni 31, pika 5, për arkëtimin e këtyre masave administrative, siç janë vjelja e gjobës nëpërmjet pagës ose vendosje sekuestro mbi pasuri deri në pagimin e gjobës. Në asnjë rast nuk është faktuar se vlera e masës administrative është e barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, si parashikohet në Ligjin 107/2014, *“Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”*, i ndryshuar, Neni 52, *“Kundërvajtjet administrative”*, pika 1, nënpika e) dhe ë), si dhe pika 2 e po këtij neni, kjo me qëllim maksimizimin e të ardhurave nga vjelja e gjobave. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 141-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**24.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Peqin, Drejtoria e Financës, Drejtoria Juridike, në bashkëpunim me IMTV, të marrin masa për kryerjen e të gjitha procedurave që ligji parashikon, siç janë vjelja e gjobës nëpërmjet pagës ose vendosje sekuestro mbi pasurinë e të dënuarit, për të bërë të mundur arkëtimin vlerave financiare në gjobat e aplikuara, si dhe përlllogaritjen e kamat-vonesave, sipas afateve dhe kriterëve ligjore.

**24.2. Rekomandim:** Nga ana e IMTV Bashkia Peqin, të merren masa për ndëshkimin e kundërvajtësve, në raport të drejtë me llojin e shkeljes së konstatuar, duke përdorur mënyrat e parashikuara në ligj për përlllogaritjen e vlerës së masës administrative në varësi të investimit të kryer pa leje të miratuar ose në shkelje të saj.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**25. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentave të paraqitura nga IMTV Peqin për periudhën objekt auditimi, u konstatua se kjo strukturë ka hartuar plane mujore të punës vetëm për periudhën nëntor – dhjetor 2022, ndërsa për periudhën tjetër janar – dhjetor 2021 dhe janar - tetor 2022, nuk janë hartuar plane pune mujor, kjo në kundërshtim me VKM-në nr. 894, datë 04.11.2015 *“Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njesisë Vendore”*, pika 1/b/ii. Gjithashtu u konstatua se Kryeinspektori i IMTV nuk ka përgatitur informacion periodik dhe nuk ka raportuar pranë Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Teritorit. Këto raportime duhet të jenë çdo tre muaj, mbi aktivitetin e IMTV, kryesisht mbi gjobat e vendosura sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, mbi vendimet për pezullimin e punimeve, mbi vendimet për prishjen e

ndërtimeve të kundër-ligjshëm, etj. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9780, datë 06.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundraligjshme”, i ndryshuar, Neni 5, pika f. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 141-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**25.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Peqin dhe IMTV të merren masa për të inspektuar territorin dhe garantuar zhvillimin e kontrolluar të tij, duke organizuar punën inspektuese mbi planet mujore të punës të miratuara nga kryeinspektori. Gjithashtu, të merren masa për kryerjen e raportimit çdo tre muaj mbi aktivitetin e IMTV, pranë IKMT, me qëllim rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe efektivitetit.

#### Menjëherë dhe në vijimësi

**26. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna konstatohet se, Bashkia Peqin ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën me shkresën nr. 1683/1, datë 15.11.2022, por nuk ka dërguar raport brenda 6-muajve për realizimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna. Gjithashtu rezulton se Bashkia Peqin nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak mbi rezultat e zbatimit të këtyre rekomandimeve, veprime këto jo në përputhje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5, “Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit., kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 144-159 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**26.1. Rekomandim:** Bashkia Peqin të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi. Gjithashtu të raportohet në auditimet në vijim brenda afatit të përcaktuar për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

#### Menjëherë

**27. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm u konstatua se, Bashkia Peqin nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe anekseve përkatëse, përcjellë nga KLSH me shkresën nr. 1683/1, datë 15.11.2022 për zbatimin e rekomandimeve pasi nuk ka ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative e ligjore për përmirësimin e gjendjes, konkretisht:

- Nga 15 masa organizative janë pranuar 15 masa nga të cilat është realizuar 1 masa, janë zbatuar pjesërisht 3 masa dhe nuk janë zbatuar 11 masa.

Nga 5 për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia - të ardhura të munguara, janë pranuar për zbatim 5 masa, nuk janë zbatuar të 5 masat.

Në lidhje me masat disiplinore në kompetencë të Bashkisë Peqin, për punonjësit e saj konstatohet se nga ana e Bashkia Peqin nuk janë marrë masat e duhura për dhënien e masave disiplinore për punonjësit e konstatuar me shkelje dhe me përgjegjësi në Raportin e auditimit të mëparshëm, për të cilën kjo masë rezulton e pa zbatuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 144-159 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**27.1 Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Peqin të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Rikërkojmë zbatimin e rekomandimeve që janë të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht dhe përsheptimin e zbatimit të atyre në proces zbatimi si vijon:

#### Menjëherë dhe në vijimësi

**1.1 Rekomandim:** Bashkia Peqin, me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së, të marrë masat në mënyrë që:

- Temat më problematike që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, të diskutohen gjatë takimeve periodike ndërmjet menaxherëve të niveleve të ndryshme në njësinë e sektorit publik dhe të dokumentohen takimet e realizuara nga GMS dhe vendimet e marra për diskutimet përkatëse.

- Të hartohet në mënyrë periodike plani i veprimit për kontrollin e brendshëm, i cili ndihmon në organizimin e aktiviteteve të kontrollit me qëllim menaxhimin e risqeve kryesore dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme se objektivat dhe qëllimet do të arrihen.

- Të hartohet në mënyrë periodike plani i veprimit për arritjen e objektivave, duke bërë të mundur realizimin dhe përmbushjen e objektivave duke siguruar minimizimin e risqeve.

### **Deri më datë 31.12.2023**

**2.1 Rekomandim:** Bashkia Peqin duhet të marrë masa në mënyrë që Njësia e Auditit të Brendshëm, të funksionojë me punonjës të certifikuar dhe kualifikuar, kërkesë e cila bazohet në kriteret për krijimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**3.1 Rekomandim:** Bashkia Peqin, Drejtoria e Financës të marrë masa që pas miratimit të programit buxhetor afatmesëm të japë opinion për rekomandimet e lëna nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë si dhe PBA-ja të publikohet brenda afatit.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**4.1 Rekomandim:** Bashkia Peqin të ndjekë hapat dhe të marrë masa për hartimin e një buxheti real, objektiv në realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, për të mos krijuar diferenca midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, të dokumentojë procesin e konsultimeve me komunitetin dhe grupet e interesit si dhe mbledhjet e strukturës dhe të institucioneve të varësi duke parashtruar dhe kërkesat e tyre buxhetore.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**5.1 Rekomandim:** Nga ana e Bashkisë Peqin të merren masa për hartimin e raporteve të monitorimit të zbatimit të buxhetit duke plotësuar të gjitha anekset me të dhënat përkatëse si dhe të dërgojë në institucionet përkatëse këto raporte sipas afateve të përcaktuara. Gjithashtu, të miratojë rregulla specifike dhe procedurale që duhet të ndiqen në procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**6.1 Rekomandim:** Bashkia Peqin të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve të reja, të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe të raportojë periodikisht në MFE.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**7.1 Rekomandim:** Drejtoria e Financës dhe Sektori i Buxhetit të hartojnë grafikun e shlyerjes së vendimeve gjyqësore dhe të zbatojnë me rigorozitet radhën e regjistrimit të vendimeve në bashki kur të kryejnë likuidimet.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**8.1 Rekomandim:** Drejtoria e të Ardhurave Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Peqin të marrë masa që, në planin vjetor të të ardhurave të bashkisë të parashikojë të ardhurat që do të sigurohen nga zërat, taksë vendore e përkohshme, tarifë e regjistrimit të veprimtarive të ndryshme, tarifë për leje zhvillimi, taksë vendore për mirëmbajtje, të ardhura nga qira e tokës bujqësore, të ardhura nga

qira troje, tarifë licence radiotelevizive, si dhe të ardhurat nga të gjitha taksat/tarifat e tjera të parashikuara në paketën fiskale të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**9.1 Rekomandim:** Drejtoria e të Ardhurave Lejeve dhe Licencave të angazhohet në marrjen e masave në terren gjatë gjithë vitit me qëllim mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në nivelet më të larta sipas planifikimit.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**10.1 Rekomandim:** Drejtoria e Financës Bashkia Peqin, të marrë masat e nevojshme që të kryhet vlerësimi dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr. 468 “*Debitorë të ndryshëm*”.

#### **Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2023**

**12.1 Rekomandim:** Drejtoria e Financës, Bashkia Peqin, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë 466 “*Kreditorë dhe mjete në ruajtje*” si dhe të njoftojë subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe likuiduar garancitë, të cilave tashmë ju ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**13.1 Rekomandim:** Bashkia Peqin të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**14.1 Rekomandim:** Nga Bashkia Peqin të merren masa për:

- Të ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej 190,000 lekë të konsideruar dëm ekonomik, nga 9 subjekte persona fizik;
- Të ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej 650,000 lekë, nga 5 subjekte ndërtimi;
- Arkëtimin e vlerës prej 261,528 lekë pa TVSh nga BOE “B.” Shpk & “P. V.” Shpk;
- Arkëtimin e vlerës prej 744,984 lekë pa TVSh nga BOE “B.” Shpk & “P. V.” Shpk & “Z.” Shpk;
- Arkëtimin e vlerës prej 137,300 lekë pa TVSh nga BOE “L.” ShPK & “B. B” ShPK & “G.P.G” ShPK;
- Lidhjen e kontratave të qirasë me personat të cilët kanë zaptuar tokat bujqësore dhe të kërkojë arkëtimin e vlerës 4,941,853 lekë.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**15.1 Rekomandim:** Nga Bashkia Peqin të merren masa për:

- Kryerjen e akt rakordimeve për debitorët e taksave të bizneseve dhe të familjarëve, raportimin në Drejtorinë e Financës me qëllim pasqyrimin në kontabilitet të debitorëve, në vlerën 46,332 mijë lekë;
- Përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm duke hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara, për secilin sektor dhe drejtori, për përcaktimin në përputhje me strukturën organizative, të ndarjes së detyrave, përkrahimit të detyrave funksionale, si dhe përcaktimit të përgjegjësive dhe të drejtave të punonjësve të njësisë. Gjithashtu, të merren masa për aplikimin e programe elektronike për kontrollin dhe menaxhimin e veprimeve financiare si dhe ato për vjeljen e të ardhurave për tatim taksat lokale;

- Shqyrtimin e të dhënave teknike të objekteve të planifikuara për zbatim dhe të pajisen me lejen e ndërtimit, ku të përcaktohen me detaje kushtet e zbatimit të projektit përpara fillimit të punimeve;
  - NJAB dhe Titullari i institucionit të nisin procedurën e certifikimit për të gjithë strukturën e NJAB;
  - Shndërrimin e vendimeve për kundërvajtjet administrative në titull ekzekutiv. Sektori Juridik në bashkëpunim me IMTV, të marrin masa për arkëtimin i vlerës prej 3,500,000 lekë nga 7 persona;
- Mbi përdorim pa ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike:*
- Analizimin e efektit ekonomik të vlerës ekonomike prej 7,332,397 lekë pa Tvsh në vit kalendarik që OE fitues “V.G.” ShPK, ka përfituar si rezultat i përlogaritjes së gabuar të fondit limit, mos përfshirja në FL e zërit të shërbimit “Ndarja e sistemimi i mbeturinave në vend depozitim e kompostim” me vlerë ekonomike vjetore 4,560,422 lekë pa TVSh dhe përfshirja në FL e zërit të shërbimit “Mirëmbajtje e rrugëve kryesore” me vlerë ekonomike vjetore 3,979,555 lekë pa TVSh;
  - Analizimin e efektit që ka shkaktuar vendosja e kërkesave/kritereve të panevojshme që nuk mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e Autoritetit Kontraktor për realizimin e shërbimit;
  - Analizimin e performancës financiare të Shoqërisë “Klubi Futbollit Shkumbini” ShA dhe mbi këtë bazë, të përcaktojë për të ardhmen vlerën dhe destinacionin e fondeve për këtë subjekt.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**1.1 Rekomandim:** Titullari i Bashkisë Peqin të marra masa që Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të angazhohet në procesin e planifikimit të të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet. Gjithashtu, të dyja drejtoritë, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave dhe Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit duhet të bashkëpunojnë dhe të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë **për 446 debitorë në vlerën 19,299,928 lekë** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Drejtoria e të Ardhurave të dërgojë informacion periodik në Drejtorinë e Financës lidhur me listën e debitorëve për taksën e ndikimit në infrastrukturë. Nga strukturat e Bashkisë Peqin të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen si dhe për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**2.1 Rekomandim:** Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë të marrin masa dhe të ndjekin të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës **5,982,624 lekë** nga qiramarrësit që nuk kanë paguar detyrimet për tokën e marrë me qira, si dhe të raportojnë periodikisht në Drejtorinë e Financës detyrimet që kanë qiramarrësit.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**3.1 Rekomandim:** Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Peqin, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën:

- **8,202,497 lekë** për 269 biznese;
- **7,616,000 lekë** nga taksat dhe tarifatat vendore për familjet;
- **9,640,000 lekë** për taksën e tokës bujqësore për **4820 familjeve;**



a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Tatim Taksave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Sektorit të Tatim Taksave, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- Sektori i Tatim Taksave të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Peqin, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**4.1 Rekomandim:** Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave të marrë masa që subjektet “B.” SHPK, “J. P.” SHPK, “K.” SHPK, “O.” SHPK, “A. H. 2013” SHPK dhe “O.” SHPK të pajisen menjëherë me autorizimin përkatës për ushtrimin e aktivitetit duke paguar detyrimet ndaj Bashkisë Peqin me vlerë vjetore 200,000 lekë secili. Gjithashtu, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet me qëllim që të kryhen pagesat e plota brenda afateve.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**5.1 Rekomandim:** Inspektorati i Mbrojtës Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekin me përpikmëri procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjokat e vendosura nga IMTV për vlerën totale **7,500,000 lekë**. Gjithashtu, IMTV të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrit ligjor në fuqi.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

KLSH mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 germa b, c dhe ç, ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore”, pika 1 dhe pika 4 germa b, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, “Masa disiplinore”, **i rekomandon Kryetarit të Bashkisë Peqin t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.**

#### **Menjëherë**

### **MASA SHPËRBLIM DËMI**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga kontrolli në terren për zbatimin e kontratës me objekt “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellsit fshati Bicaj dhe Caushaj” me vlerë kontrate në shumën 114,345,663 lekë me TVSh, me BOE kontraktues “B. B” SHPK & “P.V.” SHPK & “B.-N” SHPK & “D.C.” SHPK, u konstatuan se: Zëri me nr.3.352 “Mbushje e ngjeshje me gurë kave”, me sasi 1057 m<sup>3</sup> dhe vlerë 2,238,726 lekë, nuk ishte realizuar ende në terren.

Zëri me nr.3.212/d Shtresë stabilizanti t=20cm me sasi 5533 m<sup>3</sup> dhe vlerë 4,614,522 lekë, nuk ishte realizuar ende në terren.

Zëri me nr.3.222/2 Shtresë binder me granil gur kave 6cm me makineri me sasi 1476 m<sup>3</sup> dhe vlerë 2,637,612 lekë nuk ishte realizuar ende në terren.

Zëri me nr.Shtresë asfaltobetoni me granil gur kave 4cm me makineri me sasi 1476 m<sup>3</sup> dhe vlerë 11,969,364 lekë, nuk ishte realizuar ende në terren.

Në total për rubrikën “Sistemim i sheshit të objekteve ne vendburim” të situacionit nr.11 ka vlerën 11,696,364 lekë.

Për rubrikën “Punime sistemimi i sheshit të objekteve në depo Kodras” nga kontrolli në terren u konstatua se:

Zëri i punës 3.352 Mbushje ngjeshje me gur kave me sasi 482 m<sup>3</sup> dhe vlerë 1,020,876 lekë nuk ishte realizuar ende në terren.

Shtresë stabilizanti t=20cm me sasi 1190 m<sup>3</sup> dhe vlerë 992,460 lekë nuk ishte realizuar ende në terren.

Zëri i punës Shtresë binderi me granil e gur kave 6 cm me makineri me sasi 1190 m<sup>3</sup> dhe vlerë 2,126,530 lekë nuk ishte realizuar edhe në terren.

Zëri i punës 3.226/1 Shtresë asfaltobetoni me granil e gur kave 4 cm me makineri me sasi 1190 m<sup>3</sup> dhe vlerë 1,769,530 lekë.

Në total për rubrikën “Punime sistemimi i sheshit të objekteve në depo Kodras” sipas situacionit 11 ka vlerën 5,909,396 lekë.

Zëri i punës “Mbushje me zhavorr pas mureve” në titullin “Punime sistemimi i sheshit të objekteve në depo Kodras” me sasi 750 m<sup>3</sup> dhe vlerë 885,000 lekë nuk ishte realizuar ende në terren. Duke u bazuar situacionit nr.11 i cili nuk është situacioni përfundimtar dhe verifikimin në terren për punimet e kryera shuma **18,763,760** lekë është vlere e punimeve ende të pakryera. Në lidhje me këto konstatime të grupit të auditimit, nga subjekti kontraktor por edhe nga Bashkia Peqin, pas përfundimit të punës audituese në subjekt, janë paraqitur observacione dhe dokumentacion shtesë nga ai i paraqitur gjatë fazës së auditimit në terren. Në lidhje me këto pretendime grupi i auditimit nuk mund të dalë në përfundime nëse volumet e zëravë të punimeve të mësipërme janë në përputhje si nga ana sasiore dhe ajo cilësore me projektin e miratuar pasi e ka përfunduar verifikimin dhe auditimin në terren. *Veprime të cilat nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12, Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, pika 3 dhe kontratën e lidhur midis sipërmarrësit dhe investitorit me Nr.704 Prot, datë 19.04.2021. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 73-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1. Rekomandim:** Për arsye se gjatë vazës së verifikimit në teren të investimit nga ana e grupit të auditimit, punimet nuk kanë qenë tërësisht të përfunduara, nga Bashkia Peqin të ngrihet një grup pune me inxhinierë specialistë të fushës të cilët të kryejnë verifikimet e punimeve, referuar konstatimeve të bëra nga grupi i auditimit të KLSH. Bazuar në verifikimet e kryera të bëhen rakordimet në situacionin përfundimtar. Grupi i punës të mbajë një proces-verbal për atë çfarë do konstatojë në terren, të cilin t’ja paraqes për veprime të mëtejshme Kryetarit të Bashkisë. Për ato zëra punimesh të cilat do të konstatohen të pa kryera, të kërkohet prej kontraktorit realizimi i tyre dhe, në rast mospranimi, të kërkohet shlyerja e dëmit në vlerën e punimeve të pa kryera të cilin ta vendosë në dispozicion grupit të auditimit radhës nga KLSH që do jetë në vijim në Bashkinë Peqin.

### **Menjëherë dhe në vijim**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga kontrolli në terren për dosjen me objekt “Ndërtimi i pritave lumore dhe përforcimi i këmbëve të urës në shtratin e Lumit Shkumbin” për të cilin është lidhur kontrata nr. 1613, datë 13.10.2022, janë situacionuar 68 m<sup>3</sup> gabione me rrjetë teli 1x1x2 m dhe 34 m<sup>3</sup>

gabione me rrjetë teli 1x1x1m. Në total janë 102 m<sup>3</sup> Sipas librezës së masave gjatësia e gabionit është 17 metër. Gjatësia faktike e matur në terren është 15.3 metër linear. Diferenca prej 1.7 metër linear gabion me rrjetë teli, u konstatua e pa vendosur nga kontraktori, e cila e konvertuar në vlera financiare është **102,000 lekë**. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 73-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Rekomandim:** Bashkia Peqin të marrë masa për arkëtimin e vlerës 102,000 lekë nga BOE "LL." ShPK, "V.K." dhe "B. N" ShPK., për mos vendosjen në punimet e kontratës me objekt "Ndërtimi i pritave lumore dhe përforsimi i këmbëve të urës në shtratin e Lumit Shkumbin", të gabionit me rrjetë teli në gjatësinë 1.7 m linear.

**Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi për zbatimin e punimeve të kontratës me objekt "Ndërtimi dhe sistemimi me gabion i përroit të Rrushtës njësi administrative Karinë", u konstatua se: volumi total i betonit i cili duhet të realizohet është 99 m<sup>3</sup> ndërkohë që në fatk është realizuar sasia prej 93.5 m<sup>3</sup>. Diferenca në volum prej 99 m<sup>3</sup>-93.5 m<sup>3</sup>= 5.5 m<sup>3</sup> e cila me çmimin për m<sup>3</sup> në shumën 10,000 lekë/m<sup>3</sup>, punë e cila nuk është realizuar, ka sjellë për pasojë dëm ekonomik në vlerën 55,000. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 73-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**Rekomandim:** Bashkia Peqin të marrë masa për arkëtimin e vlerës 55,000 lekë nga BOE LL. ShPK" dhe "M. ShPK, për mos realizimin në teren të sasisë së betonit prej 5.5. m<sup>3</sup>, në kontratën me objekt "Ndërtimi dhe sistemimi me gabion i përroit të Rrushtës njësi administrative Karinë".

**Menjëherë**

## **MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR RRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).**

**1. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Peqin për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2022 ka shpenzuar vlerën 1,163,505 lekë, e cila konsiderohet efekt financiar negativ në buxhetin e njësisë vendore. Vlera e mësipërme, i përket vendimeve gjyqësore me objekt "dëmshpërblim page" për largime nga puna të punonjësve dhe vlerë përmbartimore.

Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej Tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, ndikon pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësi vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, ndihmon në evidentimin e procedurave të bëra gabim, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Mos kryerja e kësaj analize nga Titullari është në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 24-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1 Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Peqin dhe Drejtoria/Spektori Juridik, të analizojnë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohen, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore, si dhe të dalin përgjegjës të administrative. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**2. Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2022, janë legalizuar gjithsej 122 objekte me vlerë totale të detyrimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet, në vlerën 7,526,463 lekë.

Rezulton se kanë paguar detyrimet 34 qytetarë me vlerë 1,600,529 lekë dhe janë debitorë ndaj bashkisë 88 prej tyre ne vlerën 5,925,934 lekë.

Gjithashtu për periudhën përpara vitit 2022, për këtë taksë u konstatua se janë debitorë 386 qytetarë për vlerën 15,910,147 lekë. Në total vlera e detyrimeve ndaj Bashkisë Peqin, nga mos pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet nga 474 objekte të legalizuara, rezulton në vlerën 21,836,081 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Peqin. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27. Ligjit nr. 95/2018 “për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c. Ligjit nr. 98/2020 “për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 1, “në nenin 27, pika 3, shkronja “c”. VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5. VKB nr. 120, datë 29.12.2021 “Mbi miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Peqin për vitin 2022”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 24-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1 Rekomandim:** Titullari i Bashkisë Peqin të marra masa që Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të angazhohet në procesin e planifikimit të të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet. Gjithashtu, të dyja drejtoritë, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave dhe Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit duhet të bashkëpunojnë dhe të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për **474 debitorë në vlerën 21,836,081 lekë** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Nga strukturat e Bashkisë Peqin të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen si dhe për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

### ***Menjëherë dhe në vijimësi***

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga 5 subjekte që kanë kontratë qiraje në vitin 2022 rezulton se vetëm qiramarrësi “A.M.” për vlerën 116,100 lekë nuk kanë paguar detyrimet e kontratës. Detyrimi që subjekti ka ndaj Bashkisë Peqin për vitin 2022 në vlerën është 116,100 lekë, dhe detyrime progresive deri në fund të vitit 2022 janë 1615 akt marrëveshje për dhënie sipërfaqesh toke me qira familjeve në P. njësitë e saj administrative. Nga këto akt marrëveshje priten që të arkëtohen të ardhura vjetore në vlerën 5,982,624 lekë. Nga auditimi i pagesave të qirave për këto akt marrëveshje rezultoi se, për vitin 2022 nuk është paguar asnjë detyrim dhe mbetet për t’u paguar detyrimi në vlerën 5,982,624 lekë. Të ardhurat e munguara në buxhetin e Bashkisë Peqin më datë 31.12.2022 si rezultat i mos pagesës së detyrimit për sipërfaqet e marra me qira janë në vlerën totale 5,982,624 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me:

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840.
- Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36.
- VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar.
- VKM nr. 391 datë 21.06.2006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.
- VKB nr. 120 datë 29.12.2021 “Mbi miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Peqin për vitin 2022. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 24-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1 Rekomandim:** Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë të marrin masa dhe të ndjekin të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës **5,982,624 lekë** nga qiramarrësit që nuk kanë paguar detyrimet për tokën e marrë me qira.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Vlera e detyrimeve ndaj Bashkisë Peqin për taksat dhe tarifatat vendore, e krijuar vetëm gjatë vitit 2022 është 16,882,981 lekë, nga e cila vlera 9,008,131 lekë i përket detyrimeve nga debitorët private dhe 7,874,850 lekë detyrimeve nga debitorët e kategorisë familjare.

Vlera e detyrimeve progresive ndaj Bashkisë Peqin për taksat dhe tarifatat vendore, në datën 31.12.2022 është 30,568,308 lekë, nga e cila vlera prej 11,590,558 lekë është krijuar nga 238 debitorë privat, ndërsa vlera 18,977,750 lekë nga debitorët familjar (përfshirë edhe taksën e tokës bujqësore në vlerën 9,873,750 lekë nga 4 930 familjeve)

Vlera prej 30,568,308 lekë konsiderohet e ardhur e planifikuar, por e pa arkëtuar.

Për taksën e tokës bujqësore për vitin 2022 janë debitorë 4 930 familjeve me vlerë të detyrimit 9,873,750 lekë, ndërsa vlera progresive deri me 31.12.2022, që përbën të ardhura të munguara për Bashkinë Peqin është në vlerën 10,200,000 lekë.

Dokumentacioni i vënë në dispozicion lidhur me hapat që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, janë njoftuar të gjithë bizneset debitorë për kalimin e afatit të pagesave të detyrimit për taksat dhe tarifatat vendore.

Pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet vendore, nuk janë marrë masa të tjera bazuar në përcaktimet e ligjit. Këto veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89,90,91,93. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 24-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1 Rekomandim:** Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Peqin, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën:

- 11,590,558 lekë për 238 biznese;

- 9,104,000 lekë nga taksat dhe tarifatat vendore për familjet;

- 10,200,000 lekë për taksën e tokës bujqësore;

a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c- Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Tatim Taksave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Sektorit të Tatim Taksave, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- Sektori i Tatim Taksave të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Peqin, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit që administrojnë IMTV-ja në Bashkinë Peqin u konstatua se për vitin 2022 janë mbajtur në total 15 proces verbale për konstatimin e kundërvajtjes. Janë dhënë 15 masa për “Prishje të objekteve të kundërligjshëm” si dhe 15 masa “Dënim me gjobë”. Nuk ka paguar asnjë subjekt vullnetarisht me vlerë totale të gjobave prej 7,500,000 lekë të vendosura për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, duke krijuar të ardhura të munguara në Bashkinë Peqin, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme” i ndryshuar, neni 5, Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 9, neni 22. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 24-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1 Rekomandimi:** Inspektorati i Mbrojtës Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekin me përpikmëri procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjobat e vendosura nga IMTV për vlerën totale **7,500,000 lekë**. Gjithashtu, IMTV të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrin ligjor në fuqi.

#### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**6. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Peqin nga 7 subjekte që kanë aktivitet tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, 2 subjekte (“B.” SHPK dhe “J. P.” SHPK) nuk janë pajisur me autorizim/licencë për ushtrimin e aktivitetit, që sjellin të ardhura të munguara në Bashkinë Peqin në vlerën 400,000 lekë. Subjekti “D.O.” SHPK, është pajisur me autorizim nga data 07.10.2021-06.10.2022, për periudhën 07.10.2022-31.12.2022 është i pa pajisur me autorizim duke sjellë të ardhura të munguara për 9 muaj në vlerën 153,340 lekë. Subjekti “K.” SHPK, është pajisur me autorizim nga data 11.10.2022-10.10.2023, për periudhën 01.01.2022-10.10.2022 është i pa pajisur me autorizim duke sjellë të ardhura të munguara për 9 muaj në vlerën 155,550 lekë. Subjekti “O.” SHPK për të dy pikat e aktivitetit të mësipërm, është pajisur me autorizim nga data 10.06.2022-09.06.2023 dhe 10.06.2022-09.06.2027, për periudhën 01.01.2022-09.06.2022 të dy pikat janë të pa pajisura me autorizim duke sjellë të ardhura të munguara për 5 muaj e në vlerën 176,666 lekë. Ushtrimi i aktivitetit nga subjektet që tregtojnë lëndë djegëse të pa pajisur me autorizim/licencën përkatëse ka sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Peqin për vitin 2022 në vlerën 885,556 lekë, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4, neni 15, neni 20. VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, kreu II, pika 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 24-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1 Rekomandim:** Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave të marrë masa që subjektet “B.” SHPK, “J. P.” SHPK, “K.” SHPK, “O.” SHPK, “D.O.” SHPK, “S.G” ShPK dhe “O.” SHPK të plotësojnë kriteret e nevojshme e më pas të pajisen me autorizimin përkatës për ushtrimin e aktivitetit duke paguar detyrimet ndaj Bashkisë Peqin me vlerë vjetore 200,000 lekë secili. Gjithashtu, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet me qëllim që të kryhen pagesat e plota brenda afateve.

#### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**MASA DISIPLINORE.**

### **Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:**

Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në V.K.M-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Peqin**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

#### **A. “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, për;**

1. **Zj. G.N.**, me detyrë Drejtor i drejtorisë Juridike, Burimeve njerëzore dhe TIK për problemet e konstatuara në lidhje me hartimin e kërkesave për kualifikim në DST, në 3 procedura, në një rast për mos dokumentimin e llogaritjes së fondit limit dhe një rast për mos argumentimin përzgjedhjes së procedurës së prokurimit;
2. **Zj. Xh.S.**, me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimeve, për problemet e konstatuara në lidhje me hartimin e kërkesave për kualifikim në DST, në 3 procedura, në dy raste për mos dokumentimin e llogaritjes së fondit limit dhe dy raste për mos argumentimin përzgjedhjes së procedurës së prokurimit, gjithashtu në cilësinë e personit përgjegjës për parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit të miratuara, dy raste, dhe çertifikatave të përdorimit të miratuara, dy raste;
3. **Z. E.H.**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Urbanistikës, për problemet e konstatuara në lidhje me hartimin e kërkesave për kualifikim në DST, në 3 procedura, në dy raste për mos dokumentimin e llogaritjes së fondit limit dhe dy raste për mos argumentimin përzgjedhjes së procedurës së prokurimit, gjithashtu në cilësinë e personit përgjegjës për parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit të miratuara, tre raste, dhe çertifikatave të përdorimit të miratuara, dy raste;
4. **Z. A.D.**, me detyrë Specialiste mjedisi, për problemet e konstatuara në lidhje me hartimin e kërkesave për kualifikim në DST, në 3 procedura, në një rast për mos dokumentimin e llogaritjes së fondit limit dhe një rast për mos argumentimin përzgjedhjes së procedurës së prokurimit, gjithashtu në cilësinë e personit përgjegjës për parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit të miratuara, tre raste, dhe çertifikatave të përdorimit të miratuara, dy raste;
5. **Zj. Xh.L.**, me detyrë përgjegjëse e Arkës në Drejtorinë e financës, për problemet e konstatuara në lidhje me hartimin e kërkesave për kualifikim në DST, në 2 procedura, në një rast për mos dokumentimin e llogaritjes së fondit limit dhe një rast për mos argumentimin përzgjedhjes së procedurës së prokurimit;

#### **Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me status të parashikuar në ligje të veçanta:**

Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë, neni 12 “Masa Disiplinore”, të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Peqin**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

**B. “Vërejtje” për;**

1. **Z. A.K.**, me pozicion specialist në Drejtorinë e financës, për parregullsitë e konstatuara në zbatimin e kontratës për marrjen në dorëzim të automjetit;
2. **Zj. V.M.**, me specialist finance, për parregullsitë e konstatuara në zbatimin e kontratës për marrjen në dorëzim të automjetit;
3. **Z. Sh.M.**, për parregullsitë e konstatuara në zbatimin e kontratës për marrjen në dorëzim të automjetit;
4. **Znj. B.T.**, me detyrë specialiste ndërtimi pranë Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e personit përgjegjës për parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit të miratuara, një rast.
5. **Z. A.Ç.**, me detyrë specialist ndërtimi pranë Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e personit përgjegjës për parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit të miratuara, një rast.
6. **Z. K.S.**, me detyrë kryeinspektor i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, në cilësinë e personit përgjegjës për parregullsitë e konstatuara në lidhje me mos ndjekjen të gjitha procedurat dhe mosmarrjen e të gjitha masave për ndëshkimin e kundërvajtësve, sipas parashikimeve ligjore, për mosmarrjen e të gjitha masat për vjeljen e gjobave, si dhe përlllogaritjen e kamat-vonesave, sipas parashikimeve ligjore.

**C. “Vërejtje me paralajmërim” për:**

1. **Z. J.S.**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, në lidhje me problemet dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit të miratuara, dy raste, dhe çertifikatave të përdorimit të miratuara, një rast;

**Për punonjësit të cilët kanë shkëputur marrëdhëniet e punës me Bashkinë Peqin, cilët janë trajtuar me Shërbim civil apo Kodin e Punës për arsye se janë larguar, masa e dhënë konsiderohet e ezauruar dhe konkretisht për:**

1. **Z. M.S.** me pozicion Zëvendës Kryetar i Bashkisë, në cilësinë e personit përgjegjës për prokurimet, për parregullsitë e konstatuara në hartimin dhe zbatimin e regjistrit të prokurimeve, përzgjedhjes së procedurave të prokurimit dhe fondit limit, në 5 raste, në një rast për mos raportim të zbatimit të kontratës për marrjen në dorëzim të automjetit, në 4 procedura prokurimi blerje me vlera të vogla duke copëzuar fondet, të cilat duhet të kryheshin me procedurë standarde tenderimi duke, për të cilin masa e dhënë do të ishte **“Vërejtje me paralajmërim”**, i cili është larguar me dorëheqje nga puna.
2. **Z. H.M.** me pozicion Drejtor i Financës, për problemet e konstatuara në lidhje me hartimin e kërkesave për kualifikim në DST, në 3 procedura, në një rast për mos dokumentimin e llogaritjes së fondit limit dhe një rast për mos argumentimin përzgjedhjes së procedurës së prokurimit; për të cilin masa e dhënë do të ishte **“Vërejtje me paralajmërim”**, i cili është larguar për mbushjen e moshës së daljes në pension.
3. **Z. K.L.**, me detyrë ish- Drejtor i të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave.



Shënim: Të gjithë punonjësit që atakohen në këtë projekt raport auditimi duhet t'u bëhet prezent mangësitë dhe problemet për të cilat mbajnë përgjegjësi, mundësisht t'u jepen fotokopje të dokumentacionit që ka lidhje me ta, në mënyrë që të njihen dhe të bëjnë komentet dhe shpjegimet përkatëse, nëse kanë.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**